Food consumption behavior and habits	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. The most of university students does not go grocery shopping by himself, so it is not aware of what does it mean to go shopping and take care of food purchase. They usually leave this action to parents or roommates.</li> <li>2. The principal places where students go grocery shopping is represented by shopping malls and retail shops. Only a few buy food at open air markets. Quite nobody does it online or self-produces it.</li> <li>3. The students mostly go shopping once or twice a week. It means that food is stored for periods which are longer than usually.</li> <li>4. The most of students spend each week for food purchase in a range from less than 50 to 100 €</li> <li>5. They mostly take care of the quality-ratio price. Quite nobody buys food only based on the quality regardless of the price.</li> <li>6. In the most of cases they use a list when they go shopping, but the percentage of students who does not is still high.</li> <li>7. More than 90% of university students eat at-home between 2 and 3 main meals (based on 3 main meals per day). However, when eating out-of-home, they usually go to lunch.</li> <li>8. In terms of portion sizes, they consider restaurant portions bigger than home ones.</li> </ol>
Qualification and quantification of food wastage	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. The main categories of food wastage are represented by pasta, fruit and vegetables. Milk and dairy products, meat and eggs are disposed with less frequency.</li> </ol>
Personal perception of food wastage	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Only half of the students are aware of food waste phenomenon.</li> <li>2. The highest percentage of thrown away food is disposed within organic waste, but still a high quantity goes to not-differentiated waste. Only a few uses it to feed animals.</li> <li>3. The principal reason for food disposal regards expired food and bad organoleptic characteristics (e.g. smell, taste, color), while misunderstanding related to labels and bad cooking skills does not seem to be accounted in such causes.</li> <li>4. The main solutions related to food wastage phenomenon seem to be food donation, animal feed and composting, while reduction in portion sizes, intelligent packaging and improvement in food labels have not obtained particular attention by university students.</li> <li>5. The principal information channels to share such solutions are represented by websites and social networks. University students suggest improving food labels with specific information such as places of food donations and efficient and adequate techniques of food storage. They even suggest the sharing of leftovers recipes.</li> </ol>

**Table 4 - Main findings from questionnaire**

Despite the limits of the analysis proposed, the first result is that DEMDI students, included in “*high food wasters*” category (based on age classification), when are faced with food wastage problem show an increasing sensitivity towards its solution. The authors are still studying and researching in this field with the final aim to enlarge the dataset useful to support policies providing solid decision-making ground.

## References

- <sup>1</sup> FUSIONS, 2016
- <sup>2</sup> FAO, 2017
- <sup>3</sup> FAO, 2018
- <sup>4</sup> FAO, 1981
- <sup>5</sup> Parfitt et al., 2010
- <sup>6</sup> WRAP, 2009
- <sup>7</sup> McCarthy et al., 2018
- <sup>8</sup> World Hunger Education Service, 2016
- <sup>9</sup> EuropeanParliament, 2017
- <sup>10</sup> BCFN, 2012
- <sup>11</sup> Lucifero, 2016
- <sup>12</sup> Ravandi and Jovanovic, 2019
- <sup>13</sup> Hamilton et al., 2005

- <sup>14</sup> Lyndhurst, 2007  
<sup>15</sup> Knezevic, Kurnoga and Anic, 2019  
<sup>16</sup> Schanes, Dobernig, and Gozet, 2018  
<sup>17</sup> FAO, 2019  
<sup>18</sup> FUSIONS, 2014  
<sup>19</sup> Corrado et al., 2019  
<sup>20</sup> Lagioia et al., 2019  
<sup>21</sup> Porpino, Parente and Wansink, 2015  
<sup>22</sup> Van Geffen, Van Herpen, Van Trijp, 2016  
<sup>23</sup> Blas, Garrido, and Willaarts, 2018  
<sup>24</sup> Setti et al., 2018  
<sup>25</sup> Guillier, Duret, Hoang, Flick, Nguyen-Thé and Laguerre, 2016  
<sup>26</sup> European Commission, 1999  
<sup>27</sup> Brundtland, 1987  
<sup>28</sup> Esnouf, Russel and Bricas, 2013  
<sup>29</sup> European Commission, 2015  
<sup>30</sup> European Commission, 2019  
<sup>31</sup> European Commission, 2014.  
\* The questionnaire is available on request.  
<sup>32</sup> Jörissen, Priefer and Bräutigam, 2015  
<sup>33</sup> Mondéjar-Jiménez et al., 2016  
<sup>34</sup> Gaiani, 2013  
<sup>35</sup> Martindale, 2014  
<sup>36</sup> Kowalewska and Ko<sup>3</sup>ajtis-Do<sup>3</sup>owy, 2018  
<sup>37</sup> Visschers, Wickli and Siegrist, 2016  
<sup>38</sup> Leal Filho et al., 2019

## Bibliography

1. Barilla Center for Food & Nutrition (BCFN), 2012. "Lo spreco alimentare: cause, impatti e proposte", available at <https://www.barillacfn.com/m/publications/spreco-alimentare-cause-impatti-proposte.pdf> (accessed 12 September 2019)
2. Blas, A., Garrido, A. and Willaarts, B., 2018. "Food consumption and waste in Spanish households: Water implications within and beyond national borders", *Ecological Indicators*, 89, pp. 290-300.
3. Brundtland, G.H., 1987. "Our Common Future: Report of the World Commission on Environment and Development". Geneva, UN-Dokument A/42/427
4. Corrado, S., Caldeira, C., Eriksson, M., Hansen, J.O., Hauser, H.E., Holsteijn, F., Lui, G., Ostergren, K., Parry, A., Secondi, L., Stenmarck, A. and Sala, S. (2019). "Food waste accounting methodologies: Challenges, opportunities, and further advancements". *Global Food Security*, 20, 93-10.
5. Esnouf, C., Russel, M. and Bricas, N., 2013. "Food System Sustainability: Insights from dualine". New York: Cambridge University Press.
6. European Commission (EC), 2014. What can I do in my daily life to limit food waste?, available at: [https://ec.europa.eu/food/sites/food/files/safety/docs/fw\\_lib\\_tips\\_stop\\_food\\_waste\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/food/sites/food/files/safety/docs/fw_lib_tips_stop_food_waste_en.pdf)
7. European Commission, 1999. "White Paper on Food Security", Commission of the European Communities, Bruxelles.
8. European Commission, 2015. Communication from the Commission to the European Parliament, the council, the European economic and social committee and the committee of the regions. Com/2015/0614 final. Closing the loop - an EU action plan for the circular economy.
9. European Commission, 2019. "Circular Economy. Implementation of the Circular Economy Action Plan. Final Circular Economy Package". Available at: <https://ec.europa.eu/environment/circular-economy/> (accessed 12 September 2019)
10. European Parliament, 2017. "Food waste: the problem in the EU in numbers [infographic]", available at: <http://www.europarl.europa.eu/news/en/headlines/society/20170505ST073528/food-waste-the-problem-in-the-eu-in-numbers-infographic> (accessed 11 September 2019)
11. FAO, 1981. Food loss prevention in perishable crops, in *Agricultural Service Bulletin*, n. 43, FAO Statistics
12. FAO, 2017. Global Initiative on Food Loss and Waste, Food and Agriculture Organization of the United States, Rome, Italy.
13. FAO, 2018. World Food and Agriculture – Statistical Pocketbook 2018, Food and Agriculture Organization of the United States, Rome, Italy.
14. FAO, 2019. "Save Food: Global Initiative on Food Loss and Waste Reduction", available at: <http://www.fao.org/save-food/en/> (accessed 6 May 2019).
15. FUSIONS, 2014. "Report on review of (food) waste reporting methodology and practice. Reducing food waste through social innovation", available at: <https://www.eu-fusions.org/index.php/publications/266-establishing-reliable-data-on-food-waste-and-harmonising-quantification-methods> (accessed 12

- September 2019)
16. FUSIONS, 2016. "Estimates of European food waste levels", available at: <https://www.eu-fusions.org/phocadownload/Publications/Estimates%20of%20European%20food%20waste%20levels.pdf> (accessed 11 September 2019).
  17. Gaiani, S., 2013. "Lo spreco alimentare domestico in Italia: stime, cause ed impatti".
  18. Guillier, L., Duret, S., Hoang, H.M., Flick, D., Nguyen-Thé, C., Laguerre, O., 2016. "Linking food waste prevention, energy consumption and microbial food safety: the next challenge of food policy?", *Current Opinion in Food Science*, 12, pp. 30–35.
  19. Hamilton, C., Denniss, R. and Baker, D., 2005. "Wasteful consumption in Australia", Discussion Paper No.77, The Australia Institute, Manuka.
  20. Jörissen J., Priefer, C. and Bräutigam, K.R., 2015. "Food Waste Generation at Household Level: Results of a Survey among Employees of Two European Research Centers in Italy and Germany", *Sustainability*, 7, 2695-2715
  21. Knezevic, B., Kurnoga, N. and Anic, I., 2019. "Typology of university students regarding attitudes towards food waste", *British Food Journal*, Vol. ahead-of-print No. ahead-of-print.
  22. Kowalewska, M. and Kośajtis-Dołowy, A., 2018. "Food, nutrient, and energy waste among school students", *British Food Journal*, 120, 8, pp. 1807-1831.
  23. Lagioia, G., Amicarelli, V., Gallucci, T. and Bux, C., 2019. "Food waste reduction towards food sector sustainability", in Erokhin and Gaoed., *Handbook of Research on Globalized Agricultural Trade and New Challenges for Food Security*, PA: IGI Global, Hershey, pp. 147-169.
  24. Leal Filho, W., Will, M., Lange Salvia, A., Adom̄sent, M., Grahl, A. and Spira, F., 2019. "The role of green and Sustainability Offices in fostering sustainability efforts at higher education institutions", *Journal of cleaner production*, 232, pp. 1394-1401.
  25. Lucifero, N., 2016. "Food loss and waste in the EU law between sustainability of well-being and the implications on food system and on environment", *Agriculture and Agricultural Science Procedia*, 8, pp. 282 – 289.
  26. Lyndhurst, B., 2007. "Food behavior consumer research – findings from the Quantitative Surbey", briefing paper, WRAP, Banbury.
  27. Martindale, W., 2014. "Using consumer surveys to determine food sustainability", *British Food Journal*, 116 7, pp. 1194-1204.
  28. McCarthy, U., Uysal, I., Badia-Melis, R., Mercier, S., O'Donnell, C. and Ktenioudaki, A. (2018). "Global food security – Issues, challenges and technological solutions", *Trends in Food Science & Technology*, 77, pp. 11-20.
  29. Mondéjar-Jiménez, J.A., Ferrari, G., Secondi, L. and Principato, L., 2016. "From the table to waste: An exploratory study on behaviour towards food waste of Spanish and Italian youths", *Journal of cleaner production*, 138, pp. 8-18.
  30. Parfitt, J., Barthel, M. and Macnaughton, S., 2010. "Food Waste within Food Supply Chains: Quantification and Potential for Change to 2050. Philosophical transactions of the Royal Society of London". Series B, *Biological sciences*.
  31. Porpino, G., Parente, J. and Wansink, B., 2015. "Food waste paradox: antecedents of food disposal in low income households", *International Journal of Consumer Studies*, 39, pp. 619–629.
  32. Ravandi, B. and Jovanovic, N., 2019. Impact of plate size on food waste: Agent-based simulation of food consumption, *Resources, Conservation and Recycling*, 149, pp. 550-565.
  33. Schanes, K., Dobernick, G. and Gozet, B., 2018. "Food waste matters - a systematic review of household food waste practices and their policy implications", *Journal of Cleaner production*, 182, pp. 978-991.
  34. Setti, M., Banchelli, F., Falasconi, L., Segrè, A. And Vittuari, M., 2018. "Consumers' food cycle and household waste. When behaviors matter", *Journal of cleaner production*, 185, pp. 694-706.
  35. Van Geffen, L.E.J., Van Herpen, E., Van Trijp, J.C.M., 2016. Causes and Determinants of Consumers Food Waste, Project Report, EU Horizon 2020 REFRESH. Wageningen University and Research, Wageningen, The Netherlands, pp- 1-44.
  36. Visschers, V.H.M., Wickli, N. and Siegrist, M., 2016. "Sorting out food waste behaviour: A survey on the motivators and barriers of self-reported amounts of food waste in households", *Journal of Environmental Psychology*, 45, pp. 66-78.
  37. World Hunger Education Service, 2016. "Food Loss and Waste in the United States and Worldwide", available at: <https://www.worldhunger.org/food-loss-and-waste-in-the-united-states-and-worldwide/> (accessed 11 September 2019).
  38. WRAP, (Waste and Resources Action Program), 2009. "Household Food and Drink Waste in the UK", Report prepared by WRAP, Banbury.

# E drejta e mjedisit dhe mbrojtja juridike penale e tij nga krimet mjedisore; siguria mjedisore dhe siguria kombëtare



■ **MSc. Luan MEMA**  
Ekspert për krimet mjedisore,  
Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit  
[luan.mema@asp.gov.al](mailto:luan.mema@asp.gov.al)

## Abstrakt

Ky punim trajton çështjen komplekse të mbrojtjes juridike penale të mjedisit, duke u fokusuar në qasjen e ligjvënësist shqiptar në trajtimin me efektivitetet e legjislacionit penal për të siguruar mbrojtjen e mjedisit, në këndvështrimin e tendencave të reja bashkëkohore nëpërmjet të drejtës penale, duke iu referuar nismave konkrete për harmonizim të legjislacioneve kombëtare, veçanërisht iniciativave të institucioneve të Bashkimit Evropian. Ky punim synon që të jap një përgjigje rreth ndikimit që ka fusha e mbrojtjes së mjedisit në kuadrin e procesit të integritetit në BE, që synojnë përafërimin me *acquis* mjedisor. Nga kjo pikënisje do të trajtohet objekti i mbrojtjes juridike penale, në përputhje me standardin minimal të përcaktuar në direktivat e krimit. Metoda që do të përdoret për të nxjerrë të dhëna në lidhje me punimin do të jetë metoda e analizës së përmbajtjes për të adresuar problematikat e shfaqura gjatë zbatimit të tij në praktikë. Mbrojtja mjedisore në vendin tonë, synojnë të rrisin efektivitetin e rregullave të BE-së mbi mbrojtjen e mjedisit. Po ashtu, ky punim synon t'i japë një përgjigje mundësisë mbi veprat penale kundër mjedisit, të miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi penal i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar me ligjin nr. 44/2019, me synimin për ta përshtatur atë me këto zhvillime të reja. Në këtë kontekst, ndryshime dhe plotësime të rëndësishme janë bërë në kreun e posaçëm të "Kodit penal" mbi veprat penale kundër mjedisit, ku ka pasur ndryshime që lidhen me eksperiencat e shteteve të Bashkimit Evropian, ku janë zbatuar gjatë zhvendosjes (transpozimit) të direktivave të krimit mjedisor në legjislacionin kombëtar. Ndryshimet në legjislacion kombëtar për krimet e mjedisit janë shoqëruar me marrjen e masave të tjera parandaluese, që do të ndihmojnë në arritjen e qëllimit kryesor për një mbrojtje më efektive të mjedisit. Të dhënat e nxjerra nga analiza do të trajtohen në qasjet kryesore teorike dhe praktike të kohës.

## Fjalëkyçe:

**mbrojtja e mjedisit, legjislacioni penal, veprat penale kundër mjedisit, direktivat e krimit mjedisor.**

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

## 1. Hyrje

Krimi mjedisor përbëhet nga aktivitete të paligjshme që dëmtojnë mjedisin për qëllim të përfitimit të grupeve apo individëve nëpërmjet shfrytëzimit dhe/ose shkatërrimit të burimeve natyrore, ujit, ajrit, tokës, pyjeve, kafshëve apo dëmtimit të zonave të mbrojtura. Veprimet dhe mosveprimet që shkelin legjislacionin mjedisor dhe shkaktojnë dëme të konsiderueshme ose rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut klasifikohen përgjithësisht si kundërvajtje administrative, por në një pjesë të mirë rasteve janë krime të mirëfillta mjedisore. Për shkak të rëndësisë së madhe që ka mjedisi në jetën e njeriut, mbrojtja e tij është sanksionuar në aktin normativ më të lartë të hierarkisë së burimeve të së drejtës, në kushtetutë. Mbrojtja e mjedisit bën pjesë në kategorinë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në kushtetutë, dy dispozita lidhen drejtpërdrejtë me mjedisin dhe mbrojtjen e tij. Dispozita e parë sanksionin të drejtën e çdo individi për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij (neni 56), si një ndër të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Dispozita e dytë (neni 59) është përfshirë në kreun "Objektivat sociale", ku parashikohet se shteti shqiptar synon të arrijë këto objektiva lidhur me mjedisin dhe mbrojtjen e tij:

- një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, si dhe,
- shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Në mbështetje të kushtetutës dhe ligjeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, mbrojtja juridike penale parashikohet në kodin penal, ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, i ndryshuar, i cili përmban një varg dispozitash që parashikojnë veprat penale në këtë fushë. Veprimet/mosveprimet e paligjshme të kryera me faj, që cenojnë mjedisin duke



shkaktuar dëmtime të rënda në mjedis dhe që për pasojë kanë një ndikim negativ në jetën e komunitetit, sipas kuadrit ligjor penal përbëjnë veprat penale kundër mjedisit. Për të arritur në përfundimin nëse veprimet apo mosveprimet kanë sjell dëmtime në mjedis, është e rëndësishme të sqarohet koncepti i termit “dëmtim i mjedisit”. Përkufizimi i termit “dëmtim i mjedisit” gjendet në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, si ligj specifik i cili, një nga objektivat kryesor ka mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. “Dëmtim i mjedisit” është dëmi i kryer ndaj mjedisit apo humbja e funksionit natyror të pjesëve përbërëse të mjedisit, shkaktuar nga humbja e ndonjë prej përbërësve të tij, nga ndërhyrjet nga njeriu ndaj lidhjeve të përbërësve të mjedisit dhe/ose rrjedhës natyrore të zhvillimit të tyre”.<sup>1</sup>

Ndryshimet ligjore të bëra së fundi në kodin penal janë bërë në përputhje me Direktivën e BE-së 2008/99<sup>2</sup>, duke plotësuar kuadrin ligjor të veprave penale kundër mjedisit. E drejta e mjedisit është një fushë relativisht e re e së drejtës. Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit janë prioritet të një rëndësie të veçantë për mirëqenien e popujve dhe zhvillimin e botës në tërësi. Mbrojtja e mjedisit përmes të drejtës penale, përfshihen masat për luftën kundër krimeve mjedisore të përmbledhura me nenet në kodin penal shqiptar. Politika penale lidhur me mjedisin synon një nivel më të lartë mbrojtjeje duke pasur parasysh zbatimin e parimit “ndotësi paguan”. Mbrojtja e mjedisit me anë të së drejtës penale është një risi në të drejtën e mjedisit<sup>3</sup>. E drejta e mjedisit kërkon mjetet e duhura siç është dhe dënimi penal, kur kemi raste të krimeve mjedisore. Mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për të gjitha organet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ngritja e një sistemi bashkëpunimi të ndërsjellët të institucioneve që kanë kompetenca në fushën e ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit do sillte një parandalim për të gjithë ata që shkaktonin dëmtime, ndonjë apo shkatërrime mjedisore. Karakteristikat kryesore të shfaqjes së krimeve mjedisore kanë ketë formë:

a. krimet e mjedisit kanë një rritje të vazhdueshme dhe sjellin dëmtim në fushën ekonomike, sigurisë dhe jetën njerëzore;

b. dimensionet e kriminalitetit janë të dallueshëm, dhe lufta ndaj këtij kriminaliteti arrihet vetëm nëpërmjet veprimeve të përbashkëta të organeve të zbatimit të ligjit.

Prandaj, njohja e dëmeve mjedisore, dhe monetare është e rëndësishme për vënien në funksion të një politike efektive parandaluese ndaj krimeve mjedisore. Sipas konventës së CITE-s<sup>4</sup> termi i “paligjshmërisë” i referohet edhe prerjes të specieve së mbrojtura ose nxjerrjes së drurit që tejkalon kufijtë e rënë dakord.<sup>5</sup> Por, përpos prerjes, paligjshmëria mund të ndodhë gjatë transportit, përpunimit dhe eksportit, për shembull përmes mos deklarimit në dogana, ose shmangien e taksave dhe detyrimeve të tjera. Kohët e fundit, INTERPOL-i ka dokumentuar se ndikimi i prerjeve të paligjshme në pyje në rang botëror, ka arritur në vlerat 51-152 miliardë USD.<sup>6</sup> Përcaktimi i sasisë së pasojave të

<sup>1</sup>Neni 5 i ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar.

<sup>2</sup> Directive 2008/98/EC of the European Parliament and of the Council of 19 November 2008 on waste and repealing certain Directives (Text with EEA relevance), ( Direktiva 2008/98 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 19 nëntorit 2008 mbi mbetjet).

<sup>3</sup> Përafrimi i ligjilacionit shqiptar me atë Evropian, [www.ajls.org/doc/8\\_IPetrela\\_Takimi\\_V.pdf](http://www.ajls.org/doc/8_IPetrela_Takimi_V.pdf)

<sup>4</sup> Konventa për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara.

<sup>5</sup> Saunders, J. And J. Hein. 2015. *EUTR CITES and money laundering: A case study on the challenges to coordinated enforcement in tackling illegal logging. A study for the EFFACE project.* London: Chatham House, p. 15-16.

<sup>6</sup> Nellemann, C., Henriksen, R., Kreilhuber, A., Stewart, D., Kotsoyova, M., Raxter, P., Mrema, E., and Barrat, S. (Eds). 2016. *The Rise of Environmental Crime - A growing threat to natural resources, peace and development and security.* UNEP and INTERPOL p. 7.

krimit mjedisor nuk është një detyrë e lehtë. Aktualisht, boshllëqet në të dhëna përbëjnë sfidën më të madhe. Megjithatë, në disa fusha specifike të dhënat e krimit mjedisor janë bërë të disponueshme dhe numrat janë ilustrues të dëmit të rëndësishëm. Siç dëshmohet në Saunders et al. (2015), eksporti i paligjshëm i mbetjeve elektronike në Kinë dhe në vende të tjera ka çuar në një humbje ekonomike prej pothuajse 30 000 vende të punës në industrinë evropiane të riciklimit vetëm në vitin 2012.

Në Itali, zjarrvënja e pyjeve vrau mbi 50 vetë dhe plagosi pothuajse 450 njerëz në mes të viteve 2003 dhe 2012.<sup>7</sup> Në vendin tonë, gjatë vitit 2018 krimet mjedisore zënë vetëm 0.78% të krimeve totale të kryera në rang vendi.<sup>8</sup> Në vlerë sasiore krimet mjedisore ishin 247 raste të regjistruara ku 57.8% e përbëjnë krimet në pyje dhe prerja e paligjshme.<sup>9</sup> Ndërsa, në harkun kohor 2005-2012, Ministria e Mjedisit ka referuar edhe mbi dëmin e shkaktuar nga këto kundërvajtje duke përllogaritur vlerën për secilin rast. Vlera më e lartë e dëmit llogaritet në vitin 2010 me 1.1 miliardë lekë (· Euro, 11 308 467) nga të cilat rreth 1.1 miliardë lekë dëmi i kundërvajtjeve administrative dhe 215 milionë lekë kundërvajtjet penale.<sup>10</sup> Viti 2010 (shih tabelën 1) ka nivelin më të lartë të vlerës së kundërvajtjeve administrative me rreth 1.1 miliardë lekë dëme të shkaktuara. Vlera e regjistruar në këtë vit është më e lartë se vlera e gjithë viteve të tjera së bashku.

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2012
Kundërvajtje Penale (numër)	335	525	321	212	321	169	148
kundërvajtje Penale (000 leke)	411,467	272,886	283,569	758,429	283,569	215,461	280,162
Vlera mesatare e një kundërvajtjeje e penale	1,228	520	883	3,577	883	1,275	1,893
kundërvajtje Administrativ e (numër)	2,820	2,793	2,096	1,495	1,204	1,408	1,417
kundërvajtje Administrativ e (ooo leke)	87,196	74,330	132,230	282,991	78,402	1,164,172	233,280
Vlera mesatare e një kundërvajtjeje administrative	31	27	63	189	65	827	165

**Tabela 1. Kundërvajtjet administrative dhe penale dhe vlera e tyre për periudhën 2005-2012**

Vlerësimi real i dëmit mjedisor në vendin tonë bazohet duke iu referuar nenit 61 të *Kodit të procedurës penale* lidhur me “Padia civile në procesin penal” ose “Shpërblimin e dëmit” sipas neneve 640 dhe 644 të *Kodit civil* i cili është i bazuar në shpërblimin e

<sup>7</sup>Saunders, 2015, p. 8-9

<sup>8</sup> Prokuroria e Përgjithshme. *Raporti Vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2018*. Tiranë, f. 161.

<sup>9</sup> Prokuroria e Përgjithshme, 2019, f. 162.

<sup>10</sup> Ministria e Mjedisit 2013, f.1.

dëmtimit të shkaktuar dhe fitimit të munguar.<sup>11</sup>

### **1.1 Metodologjia e përdorur**

Ky studim për ndërtimin e një metodologjie do t'i referohet vetëm veprave penale kundër krimeve mjedisore, është teori e bazuar në analiza cilësore përshkruese, krahasuese dhe statistikore, kryesisht në kërkimin dokumentar dhe zhvillimin e intervistave të drejtpërdrejta apo nëpërmjet telefonit me nëpunës të ndryshëm në ministritë e linjës, Ministrinë e Mjedisit dhe me përfaqësues të bashkive. Metodologjia kryesore e përdorur gjithsesi mbetet krahasimi analitik dhe rregullator i ligjeve dhe akteve ligjore e nënligjore ekzistuese, me qëllim identifikimin e mbivendosjes ose konfliktit midis klauzolave në ligjet sektoriale dhe përcaktimeve në ligjin kuadër. Një pjesë e rëndësishme e punimit është përdorur metoda e krahasimit e dy apo me shumë legjislacioneve penale prej ngjashmërisë, dhe ndryshimeve të disa shteteve të tjera, në procesin e shkallës së implementimit të direktivave të krimit mjedisor (2008/99/KE dhe 2009/123/KE).

#### **1.1.2 Qëllimet specifike të studimit**

1. Analiza e standardeve, studimeve, raporteve dhe metodave për vlerësimin e krimit mjedisor, vlera ekonomike të dëmtimeve në territorin e Shqipërisë, mjedisi dhe tërësia e elementeve në vendin tonë.

2. Kuptimi i krimit mjedisor dhe legjislacioni i zbatueshëm, figura konkrete të veprave penale kundër mjedisit si edhe dënimet përkatëse për autorët e këtyre veprave penale.

## **2. Vështrim i përgjithshëm**

### **2.1 Vlerësimi i krimit mjedisor në Shqipëri**

#### **2.1.1 Analiza ligjore**

Për shkak të rëndësisë së madhe që ka mjedisi në jetën e njeriut, mbrojtja e tij është sanksionuar në aktin normativ më të lartë të hierarkisë së burimeve të së drejtës, në Kushtetutë. Mbrojtja e mjedisit bën pjesë në kategorinë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në zbatim të normave kushtetuese, kuadri ligjor në fushën e mbrojtjes së mjedisit është e përbërë nga një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore. Pas ndryshimit të sistemit post-komunist dhe vendosjes së demokracisë, më së fundi Shqipëria ka miratuar një sërë ligjesh që përbëjnë legjislacionin e saj të ri mjedisor, si bazë dhe reference: “Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë” që përfshin lloje të ndryshme aktesh normative, në shërbim të mbrojtjes së mjedisit, si dhe ligje të përgjithshme e të veçanta për mjedisin e përbërës të tij, vendime të Këshillit të Ministrave, urdhra e udhëzime të ministrive, rregullore specifike, norma e standard, në rrugën e saj drejt integritimit evropian. Ky legjislacion është përgjithësisht i përqasur me standardet e BE-së<sup>12</sup>, sepse mbështetet në të njëjtat parime si ai i legjislacionit mjedisor evropian, që pasqyron përgjithësisht kërkesat e konventave, në të cilat Shqipëria është pale. *Kuadri ligjor përbëhet nga një shumëllojshmëri aktesh juridike.* Kushtetuta, ligji kuadër, ligjet sektoriale, aktet nënligjore (VKM), urdhra, udhëzime

<sup>11</sup> Kodi civil (2014), neni 640 +644, f. 112.

<sup>12</sup> Manual për menaxhimin e problemeve mjedisore, Elektronik: [www.osce.org/sq/albania/22652?doenload=true](http://www.osce.org/sq/albania/22652?doenload=true)

etj.), kodi penal, marrëveshjet ndërkombëtare për mjedisin, në të cilat RSH është palë. Legjislacioni i përafuar mjedisor në Shqipëri është shumë i nevojshëm për mbrojtjen e mjedisit në vendin tonë. Konventat dhe marrëveshjet mjedisore ndërkombëtare dhe evropiane për mbrojtjen e mjedisit në vendin tonë, kanë një ndikim në reformën dhe miratimin e ligjeve bashkëkohore. Ndryshimet ligjore të bëra së fundi në kodin penal janë bërë në përputhje me Direktivën e BE-së 2008/99, duke plotësuar kuadrin ligjor të veprave penale kundër mjedisit. Veprat penale kundër mjedisit së bashku me ndryshimet që kanë hyrë në fuqi në datën 8.10.2019 janë parashikuar në kreun IV të kodit penal aktual.

### 2.1.2 Analiza institucionale

Institucionet kompetente për identifikimin, parandalimin dhe ndëshkimin e veprimeve të paligjshme ndaj mjedisit janë, Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, që ka në organikë institucionet në vartësi si Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve Ujërave dhe Turizmit me organet e tyre në varësi (ISHMPUT), Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJQV), Policia e Shtetit, prokuroria dhe gjykata. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura është institucioni qendror shtetëror përgjegjës për zonat e mbrojtura, në varësi të ministrit, që ka për detyrë administrimin e kontrollin e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ligji “Për mbrojtjen e mjedisit nga dëmtimet” ka përcaktuar pothuajse të njëjta kompetenca për administratën e zonave të mbrojtura ashtu sikurse për inspektorin e policisë pyjore (ISHMPUT), duke i dhënë në këtë mënyrë zonave të mbrojtura një mbrojtje të dyfishtë. Ndryshe nga sa përcaktohet në mënyrë të shprehur, se inspektori i policisë pyjore ka të drejtë të vendosë gjobave administrative në rast të shkeljeve administrative, në rastin e AZM-së në nenin 66-të nuk parashikohet në mënyrë të shprehur e drejta për të vendosur gjoba administrative. Mirëpo, në një interpretim sistematik të ligjit, referuar nenit 69-të, administrata e zonave të mbrojtura ka të drejtë të marrë vendim për kundërvajtjet administrative, ashtu sikurse edhe inspektori i policisë pyjore.

Në të njëjtën kohë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, synojnë të rrisin bashkëpunimin mes autoriteteve të ndryshme të zbatimit, që janë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit dhe të nxisë koordinimin me aktorë të tjerë, në ndjekjen dhe hetimin e rasteve të papajtueshmërisë, në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe atë penal, referuar kjo edhe ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Policia e Shtetit, prokuroria, gjykata kanë detyrimet kushtetuese që detajohen në akte të rëndësishme ligjore ku përfshihet dhe “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë”. Legjislacioni ynë penal garanton mbrojtje juridiko-penale ndaj mjedisit duke marrë përsipër të mbrojtë në mënyrë të drejtpërdrejtë marrëdhëniet juridike të vendosura në kushtetutë apo në ligje të tjera që lidhen me mjedisin. Jo vetëm individët, por edhe personat juridikë përgjigjen penalisht për vepra penale, të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre. Njësitë e qeverisjes vendore përgjigjen penalisht vetëm për veprime të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre nga funksionarët e tyre.

Përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton atë të personave fizikë, të cilët kanë kryer ose janë bashkëpunëtorë në kryerjen e të njëjtave vepra penale. Veprat penale dhe masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë, si dhe procedura për vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohen me ligjin nr. 9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”.

### 2.1.3 Vlerësimi i mjedisit dhe tërësia e elementeve

Përkufizimi për mjedisin në vendin tonë si në të drejtën penale, ashtu dhe në ligjet organike dhe sektoriale, ka shtrirje të përgjegjësisë në rastet e shkaktimit të demit,<sup>13</sup> ashtu si është përshkruar në *Konventën evropiane për të drejtat e mbrojtjes së mjedisit*. Në termin e përgjithshëm ka ketë përkufizim. “Mjedisi është tërësia e elementeve dhe faktorëve natyror dhe njerëzor me veprimet dhe bashkëveprimet e tyre që synon ruajtjen ose përmirësimin e përbërësve biotikë dhe jo biotikë që nxisin dhe ushqejnë jetën e gjallë në tokë, duke përfshirë mjedisin biofizik natyror të ajrit, të tokës, të ujërave, larminë e ekosistemeve biologjike, shëndetin e njeriut”.<sup>14</sup> Sipas legjislacionit shqiptar përkufizimi i termit “mjedis” është përcaktuar në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit” që ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe mjedisit, mbron përbërësit e mjedisit dhe proceset mjedisore, siguron kushtet materiale për zhvillimin e qëndrueshëm, duke plotësuar kuadrin e nevojshëm për zbatimin e kërkesës kushtetuese për një mjedis ekologjikisht të pastër. Sikurse vihet re nga përkufizimi, tërësinë e elementëve e grupon në dy kategori kryesore:

1. faktorë natyrorë dhe elementët siç janë: organizmat bimorë e shtazorë, uji, ajri, toka, nëntoka dhe rrezatimi diellor;

2. kryerja e veprimtari ekonomike e sociale nga faktorët njerëzorë si veprimtari e dobishme në shoqëri që lidhet me natyrën.

Synimi i këtij ligji është përdorimi racional i mjedisit, kufizimi i shkarkimeve të ndotjeve, parandalimin e dëmtimit të tij, rehabilitimin dhe shëndoshjen e mjedisit të dëmtuar, përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut. Synimi i shtetit shqiptar për integrimin në familjen evropiane shoqërohet me një kërkesë prioritare për përafrimin e legjislacionit kombëtar mjedisor me kushtet dhe standardet e Bashkimit Evropian<sup>15</sup>. Mjetet e veprimtarisë të së drejtës penale në të drejtën e mjedisit janë shumë të larmishme. Ato janë juridike, parandaluese dhe sanksionuese. Definicioni juridik i të drejtës penale në mbrojtje nga ana kriminale e mjedisit, fillon nga norma e legjislacionit penal material. Ajo dallohet me theksimin e shkeljes së ligjit. Nëse do të kryenim një vlerësim të vërtetë të tij, atëherë dëmin do ta klasifikonim në:

- a) dëmin ekonomik të shkaktuar, dhe
- b) dëmin në mjedis.

Disa nga pasojat më të rëndësishme të ndotjes së mjedisit janë: dëmtimi i ekosistemeve, ndikimi të shëndeti i njeriut, kostoja ekonomike, problemet shoqërore. Në aspektet juridike, dallohen dy kategori instrumentesh:

- a. metodat e instrumenteve rregullatorë;
- b. instrumentet ekonomikë në zbatimin të parimit “*ndotësi paguan*”, vlefte e së cilës është në raport me ndotjen e shkaktuar.

*Instrumentet rregullatorë* janë aksione kryesore që detyrojnë sjelljen e ndotësve në nivelin efikas dhe të kontrolluar me sanksione administrative ose juridike. Instrumentet ekonomike synojnë të ndryshojnë sjellje të caktuara për mjedisin ekonomik të ndotësit,

<sup>13</sup> Enkelejda Turkeshi, *Mbrojtja juridike penale e mjedisit*, Disertacion, Tiranë 2014.

<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/09/Doktoratura-Enkelejda-Turkeshi-Fakulteti-i-Drejtësisë-Departamenti-i-te-Drejtës-Penale.pdf>

<sup>14</sup> Shih ligjin nr. 8934, datë 5.9.2002.

<sup>15</sup> Iris Petrela, *Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian*. [www.ajls.org/doc/8\\_IPetrela\\_Takimi\\_V.pdf](http://www.ajls.org/doc/8_IPetrela_Takimi_V.pdf)

të cilin njeriu e ka ndërmarrë me vetëdije për të nxitur pranimin vullnetar të sjelljeve më pak ndotëse në dallim nga pikëpamja e ndotësit, por ndotja të bëhet e kushtueshme nëpërmjet pagesës prej tij të një takse. Prandaj, njohja e dëmeve mjedisore, dhe monetare është e rëndësishme për vënien në funksion të një politike efikase parandaluese ndaj krimeve mjedisore.

### 3. Veprat penale kundër mjedisit

#### 3.1 Kuptimi i krimit mjedor dhe legjislacioni i zbatueshëm

Në kuptimin e zakonshëm, krimi mjedor nënkupton të gjitha veprimet që i shkaktojnë dëm mjedisit. Mirëpo në kuptimin ligjor ky përcaktim në mënyrë të përmblodhur mund të kuptohet si “tërësia e dispozitave që vendosin përgjegjësinë penale (apo administrative/civile kur nuk kemi të bëjmë me vepër penale) për sjelljet e caktuara për shkak të dëmit qoftë ky i mundshëm apo efektiv ndaj mjedisit”. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë* parashikon në nenin 56 të saj se kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij. Më tej, në kapitullin e objektivave sociale në nenin 59 paragrafi 1 pika “d” dhe “dh” kushtetuta përmban një rregullim më specifik të mjedisit duke parashikuar që “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm; dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm”. Detyrimet e mësipërme kushtetuese detajohen edhe në akte të rëndësishme ligjore ku përfshihet dhe *Kodi penal i Republikës së Shqipërisë*. Legjislacioni ynë penal garanton mbrojtje juridiko-penale ndaj mjedisit duke marrë përsipër të mbrojtje në mënyrë të drejtpërdrejtë marrëdhëniet juridike të vendosura në kushtetutë apo në ligje të tjera që lidhen me mjedisin.

Normat penale sigurojnë mbrojtje të mjedisit nga të gjitha veprimet apo mosveprimet shoqërisht të rrezikshme si të tilla të kundërligjshme të kryera me faj dhe që shoqërohen me ardhjen e pasojave të rrezikshme. Në kuadër të mbrojtjes juridiko-penale parashikohen dënime konkrete penale të cilat zbatohen nga gjykata ndaj autorëve të këtyre veprave penale. Jo vetëm individët, por edhe personat juridikë përgjigjen penalisht për vepra penale, të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre. Në “Kodin penal të Republikës së Shqipërisë” janë parashikuar figura konkrete të veprave penale kundër mjedisit si edhe dënimet përkatëse për autorët e këtyre veprave penale. Veprat penale kundër mjedisit, së bashku me ndryshimet që kanë hyrë në fuqi në datën 8.10.2019, janë parashikuar në kreun IV të kodit penal aktual.

#### 3.1.1 Llojet e veprave penale kundër mjedisit, si një objekt grupor i veçantë

Ligji penal mbi veprat penale kundër mjedisit përcakton llojin e veprave penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndaj mjedisit ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit<sup>16</sup>. Në kodin penal parashikohen veprat penale me një objekt grupor të veçantë, vepra penale veç e veç, elementet e tyre, formën e fajit me të cilën ato kryhen dhe sanksionet penale që mund tu jepet shkelësve të ligjit penal. Vepra

<sup>16</sup> Kodi penal i Republikës së Shqipërisë.

penale kundër mjedisit, kualifikohet atëherë kur autori ndërmerr veprim për shkak të arritjes së pasojës së caktuar dhe është e domosdoshme, përmbushja ndërmjet ndërmarrjes së veprës së kryer dhe pasojës, e cila paraqitet me qëllim reduktimin e mëtejshëm të ndikimit në mjedis.

### 3.1.2 Neni 201, “Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës”

Vepra e ndotjes së ajrit, e ujërave dhe e tokës mund të kryhet me dashje ose nga pakujdesia, nga personi fizik/juridik, që është i detyruar të marrë masa të caktuara për mbrojtjen nga ndotja, të ajrit, tokës dhe ujit. Në këto raste, kryerja e veprimeve apo mosveprime të kundërligjshme, qëndron në ndotjen në sipërfaqe apo në thellësi e tokës, dëmtimin e rëndë të kafshëve ose bimëve, nëpërmjet shkarkimit, emetimit ose futjes së rrezatimit jonizues ose të një sasive materialesh në ajër, tokë apo ujë, tej kufirit të normave të lejuara me ligj, ose zona të mbrojtura posaçërisht me ligj, si zona me vlera mjedisore, kulturore, artistike, historike, arkitektonike apo arkeologjike, ose kur ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë të ekosistemit, biodiversitetit, të florës ose faunës. Rastet kur ndotja përbën kundërvajtje administrative janë të caktuara në ligjin<sup>17</sup> “Për mbrojtjen e mjedisit”, si dhe ligjet e tjera të veçanta që lidhen me të dhe kanë objekt mbrojtjen e ajrit, ujit dhe tokës nga ndotja. Dënimi për kundërvajtjet penale është parashikuar me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Përbëjnë kundërvajtje penale vetëm rastet kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative. Vepra konsiderohet e kryer në rrethana cilësuese kur nga ndotja e ajrit, e kryer nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve të sipërpërmendura në kundërshtim me ligjin, kanë ardhur *pasoja të rënda* për jetën e shëndetin e njerëzve, konkretisht, vdekja apo gjymtimi, shëmtimi, ndërprerja e shtatzënisë, ose rrezikimi për jetën në çastin e shkaktimit të tij. Dënimi, në këto raste, është me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

### 3.1.3 Neni 201/a, “Menaxhimi i mbetjeve”

Vepra menaxhimi i mbetjeve mund të kryhet me dashje ose nga pakujdesia dhe konsiston në grumbullimin, transportimin, rikuperimin ose asgjësimin e mbetjeve, përfshirë mbikëqyrjen e këtyre veprimeve, kujdesin e vend depozitimeve, si dhe veprimet e ndërmarra në shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëme të rënda në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë ose në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet. Në këtë mënyrë ligjvënësi ka bërë një lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore me mosrespektimin e legjislacionit në fuqi që përbëhet nga ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve<sup>18</sup> dhe aktet e tij plotësuese. Kur kjo veprë kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Kur kjo veprë konsiderohet e kryer në rrethana cilësuese, dënimi, për këto raste, është me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

### 3.1.4. Neni 201/b, “Transportimi i mbetjeve”

Vepra “transportimi i mbetjeve”, që parashikon transportimin e mbetjeve që hyjnë, dalin apo kalojnë nga territori i Shqipërisë, në sasi jo të papërfillshme, i kryer në një transportim të vetëm ose në disa transportime në dukje të lidhura me njëri-

<sup>17</sup> Neni 69 i ligjit nr. 10 431 datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar.

<sup>18</sup> Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.

tjetrin, në shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dënohet me gjobë ose burgim deri në pesë vjet. Kjo vepër penale kryhet me dashje ose nga pakujdesia, nga persona apo subjekte juridikë që kanë shkelur rregulla të vendosura për transportimin pa leje të lëndëve ose mbeturinave të ndryshme. Në këto raste, veprimet aktive të kundërligjshme, qëndrojnë në transportimin (me mjete të transportit rrugor, hekurudhor, ajror ose edhe ujor) transit (për në një shtet të huaj) të mbeturinave. Vëmendja edhe në këtë rast, duhet drejtuar tek fakti që kjo vepër penale mund të shkaktohet pikërisht duke shkelur elementë të caktuar të ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve apo ligjet të tjera sektoriale, duke kriminalizuar kështu veprime të caktuara që gjithsesi vlerësohen rast pas rasti nga organet ligj zbatuese.

### 3.1.5 Neni 201/c, “Aktivitetet e rrezikshme”

Vepra “aktivitetet e rrezikshme” konsiston në funksionimin e një impianti ku zhvillohet aktivitet i rrezikshëm ose ku ruhen apo përdoren substanca ose preparate të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, të cilat shkaktojnë ose ka mundësi të shkaktojnë dëme të rënda jashtë impiantit në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë apo në bimë, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet. Edhe këtu lidhja shkakësore bëhet me ligjin sektorial, por në ndryshim nga nenet e tjera, pasoja që vjen nga shkelja është shumë e qartë dhe ka të bëjë me shkaktimin e dëmeve të rënda jashtë impiantit në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë apo në bimë. Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet. Kur kjo vepër konsiderohet e kryer në rrethana cilësuese, dënimi, për këto raste, është me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

### 3.1.6 Neni 201/ç, “Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme”

Në veprën “materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme”, prodhimi, përpunimi, trajtimi, përdorimi, ruajtja, magazinimi, transportimi, importimi, eksportimi ose asgjësimi i materialeve bërthamore ose substancave të tjera radioaktive të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëm të rëndë në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, apo në kafshë ose në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet. Kjo vepër kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet. Kur nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë si pasojë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë vjet deri në njëzetë vjet. Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet. Po të analizojmë paragrafin e dytë të veprës, kur ka shkakuar pasoja të rënda, vepra penale e kualifikuar si pasojë e rëndë, përmban në vete dy pasoja. Pasoja e formës kryesore të veprës penale e cila pastaj rritet, shndërrohet në pasojë tjetër të rëndë e cila rrjedh nga veprimi i veprës kryesore të kryer për shkak të kësaj që ligji parasheh dënim më të rëndë. Po të analizojmë procedurat e regjistruara dhe çështjet e gjykuara, rezulton se nga periudha 2004 deri në vitin 2015 ka pasur 48 çështje të regjistruara për procedim 54, që do i paraqes me tabelë.

**AKADEMIA  
E SIGURISIA**

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

“Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare”



**Tabela dhe grafiku 2: Procedime penale dhe çështje të gjykuara, gjykimet.**

Nr.	Emërtimi	Vitet												
		2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	
1	Procedime të regjistruara	0	0	0	0	6	0	0	0	0	0	0	1	
2	Çështje të gjykuara	0	0	0	0	0	6	0	0	0	0	0	0	



Po të analizojmë procedimet e regjistruara nga viti 2016-2019, do shikojmë se kjo veprë është evidentuar dhe hetuar, si pasojë e punës së bërë nga institucionet e ngarkuara me ligj, si dhe masat e marra nga Policia e Shtetit, për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe goditjen e autorëve të kësaj veprë penale, që do i paraqes me tabelë dhe grafik.



**Tabela dhe grafiku 3: Procedime penale për veprën penale të ndotjes së ajrit**

Vepra penale	VITET			
	22016	22017	22018	22019
Ndotja e ajrit	20	33	95	86

Në tabelën në vijim paraqiten të dhënat mbi numrin total të procedimeve të regjistruara në shkallë republike gjatë periudhës 2008-2015, për ndotje të ujërave.

**Tabela dhe grafiku 4: Procedime penale dhe çështje të gjykuara për ndotje ujërave.**

Nr	Emërtimi	VITET								
		2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	
1	Procedime te regjistruara	1	2	0	0	0	0	0	3	
2	Çështje te gjykuara	0	0	0	0	0	0	0	0	



### 3.1.7 Neni 202, “Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër”

Vepra penale e dëmtimit të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër, kryhet me dashje ose nga pakujdesia, nga persona apo subjekte juridikë që kanë shkelur rregulla të vendosura me ligj për mbrojtjen e mjedisit, për zonat e mbrojtura dhe ligjin për peshkimin. Veprimet e kundërligjshme konsistojnë në vrasjen, shkatërrimi, zotërimin, marrjen e ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve. Kundërvajtësi në këto raste dënohet me gjobë ose me burgim. Këto veprime konsiderohet se i kanë sjellë pasojat e tyre kur shkaktojnë prishjen e ekuilibrit ekologjik, që do të thotë se pasojat ndjehen në faunën dhe florën, duke dëmtuar apo zhdukur specie peshqish, bimësi, kafshë etj.

### 3.1.8 Neni 202/a, “Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër”

Vepra “tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër” parashikon tregtimin e ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura, apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve. Kjo vepër dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

### 3.1.9 Neni 202/b, “Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore”

Vepra e dëmtimit të habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore, përbëhet nga veprimet që shkelin kërkesat e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dhe që shkaktojnë përkeqësim të rëndë të një habitati, që ndodhet brenda një zone të mbrojtur mjedisore dhe dënohen me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet. Kjo vepër mund të kryhet, me dashje ose nga pakujdesia, nga persona apo subjekte juridike që kanë shkelur rregulla të vendosura me ligj për mbrojtjen e mjedisit, të ujërave të deteve, lumenjve, tokës nga ndotja me lëndë toksike, radioaktive apo substanca të tjera. Në këtë rast, veprimet e kundërligjshme qëndrojnë në hedhjen ose shkarkimin, nga anijet që lundrojnë apo të ankoruara në porte, nga avionët, nga mjetet të tjera transportit rrugor apo hekurudhor, nga uzinat, nga fabrikat, nga ente të ndryshme, nga individët, etj., të mbeturinave apo lëndëve toksike, radioaktive apo substancave të tjera. Këto ndryshime ligjore plotësojnë kuadrin ligjor penal për mbrojtjen e zonave të mbrojtura. Është zgjeruar diapazoni i veprimeve të paligjshme të cilat dëmtojnë mjedisin, si vrasja, shkatërrimi, zotërimi, marrja apo tregtimi. Neni 202/a e lë të hapur sferën e veprimeve që do të konsiderohen të paligjshme. Këto veprime që të konsiderohen të kundërligjshme duhet të jenë kryer në shkelje të legjislacionit për lejet dhe autorizimet. Neni 202 i ndryshuar dhe neni 202/a i shtuar, e kategorizojnë dëmtimin në zonat e mbrojtura si krim, për shkak të pasojave të rënda që

AKADEMIA  
E SIGURISIA

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

“Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare”

sjell dëmtimi i një zone të mbrojtur. Në të dy këto dispozita, përcaktohet se, veprimi që të konsiderohet krim duhet të sjellë dëme të konsiderueshme në zonën e mbrojtur.

### 3.1.10 Neni 203, “Substancat ozonholluese”



Vepra tjetër që konsiston në prodhimin, importimin, eksportimin, nxjerrjen në treg ose përdorimin e substancave ozonholluese, duke shkelur kërkesat e legjislacionit përkatës apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dënohet me burgim nga një deri në shtatë vjet.

### 3.1.11. Neni 204, “Peshkimi i ndaluar”

Vepra penale e peshkimit të ndaluar<sup>19</sup>, kryhet me dashje ose nga pakujdesia, nga persona apo subjekte juridike që kanë shkelur rregulla të vendosura me ligj për mbrojtjen e mjedisit dhe ligjin “Për peshkimin” nr. 64/2012, i ndryshuar. Veprimet e kundërligjshme, qëndrojnë te peshkimi në kohë të ndaluar: në kohën e shtimit; peshkimi me mjete të ndaluara, peshkimi në vende të ndaluara, si zonat e mbrojtura etj. Peshkimi i kryer në kohë, me mjete, në vende dhe mënyra të ndaluara nga ligji “Për peshkimin”, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj. Në rastet kur peshkimi kryhet me mjete të rrezikut të përbashkët si eksploziv, lëndë helmuese etj., kjo veprë, konsiderohet e kryer në rrethana cilësuese<sup>20</sup> dhe kundërvajtësi penal dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Ndërkohë, nga të dhënat e Vjetarit Statistikor të Ministrisë së Drejtësisë për vitet 2004 deri 2015 rezulton se numri maksimal i çështjeve të gjykuara për kundërvajtjen penale të peshkimit të ndaluar është regjistruar në vitin 2008 dhe në 2015-n, ndonëse vetëm me 12 dhe 14 çështje të gjykuara në të gjithë vendin. Në total, gjatë kësaj periudhe 8-vjeçare janë gjykuar 57 çështje penale. Konkretisht, në formë tabelore, të dhënat mbi numrin e çështjeve të gjykuara për këtë veprë penale paraqiten si vijon:

**Tabela dhe grafiku 5: Procedimet penale dhe çështje të gjykuara peshkim i ndaluar.**

Nr	Emërtimi	VITET								
		2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	
1	Procedime të regjistruara	3	2	0	0	1	0	4	5	
2	Çështje të gjykuara	0	0	0	0	2	0	0	0	



<sup>19</sup> Neni 204 i Kodit penal.

<sup>20</sup> Neni 204 paragrafi i dytë i Kodit penal.



### 3.1.12. Neni 205, “Prerja e paligjshme e pyjeve”

Vepra e prerjes së paligjshme e pyjeve kryhet me dashje nga persona apo subjekte juridike që kanë shkelur rregulla të vendosura me ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin, nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”. Veprimet e kundërligjshme aktive konsistojnë në prerjen apo dëmtimin e pyjeve pa lejen e organeve kompetente, prerjen apo dëmtimin e pyjeve në kohë të ndaluar, (në kohën e rigjenerimit, moratorium) dhe prerjen apo dëmtimin e pyjeve në vende të ndaluara (në zonat e mbrojtura, vende që rrezikohet erozioni, përmbytja, rrëshqitja e tokës, etj.). Rastet se kur prerjet apo dëmtimi i pyjeve përbëjnë kundërvajtje administrative janë të caktuara në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin, nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim tyre. Prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Neni 205 është një dispozitë *blanket* (e bardhë) i cili i referohet ligjit nr. 9385/2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i cili përcakton se kur veprimi i paligjshëm përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë.

Ligji nr. 9385/2005 ka parashikuar se për kundërvajtjet administrative, që kryhen në pyjet me funksion mbrojtës të veçantë, dënimi me gjobë është sa trefishi i vlerës së gjobës për çdo rast të kundërvajtjeve administrative. Kundërvajtësi detyrohet të paguajë, krahas gjobës, edhe vlerën e dëmit të shkaktuar. Nga ana subjektive, vepra penale kryhet vetëm me dashje, sepse personi e di që prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje, në kohë dhe vende të caktuara është e ndaluar dhe megjithatë e kryen veprimin e paligjshëm. Ky veprim i paligjshëm përbën kundërvajtje penale. Në ndryshim nga dispozitat e tjera të këtij kreu, kjo dispozitë nuk parashikon rrethana cilësuese, si p.sh., dëmtimi apo prerja e pyjeve në zona të mbrojtura, që përbën një veprim me pasoja më të rënda në mjedis.

**Tabela dhe grafiku 6: Procedime penale dhe çështje të gjykuara për prerje të paligjshme.**

Nr	Emërtimi	VITET											
		00 4	00 5	00 6	00 7	00 8	00 9	01 0	01 1	01 2	01 3	01 4	01 5
1	Procedime të regjistruara	05	07	64	82	74	56	26	31	70	04	56	63
2	Çështje të gjykuara	26	83	62	29	24	27	9	9	2	05	97	05



AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

### 3.1.13. Neni 206, "Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë"

Vepra e prerjes së drurëve dekorativë dhe frutorë kryhet me dashje, nga persona apo subjekte juridik, duke prerë drurët dekorativë (pisha, bredha, plepa, etj.) që janë mbjellë anës rrugëve në qytete e në vende të tjera; dëmtuar lulishite dhe parqe nëpër qytete (shkukur lule, futur bagëti në këto lulishite e parqe, etj.); prerë drurët në pemëtore, ullishita e vreshta, pasi është refuzuar më parë leja e prerjes nga organet kompetente. Dënimi për kundërvajtjen penale, të prerjes së drurëve dekorativë dhe dëmtimin e parqeve dhe lulishiteve është me gjobë, ndërsa për prerjen e pemëtoreve, ullishtave e vreshtave, është me burgim deri në tre muaj. Në kodin penal të shteteve të tjera vihet re se janë përfshirë të dyja format e fajit<sup>21</sup>, duke parashikuar në disa raste edhe sanksion të veçantë në varësi të formës së fajit me të cilën është kryer vepra.



Grafiku 7: Procedime penale dhe çështje të gjykuara, drurët dekorativ 2016-2019.

### 3.1.14. Neni 206/a, "Shkatërrimi me zjarr i pyjeve"

Vepra e shkatërrimit me zjarr të pyjeve dhe mjedisit pyjor, kryhet, me dashje, me veprime aktive duke përdorur mjete te rrezikut te përbashkët me zjarr qe shkaktojnë:

- shkatërrimin apo dëmtimin, me pasoja të rënda materiale, të fondit pyjor, të fidanishtes pyjore, të grumbullit pyjor ose të çdo njësie të ngjashme me to. Dënimi për këtë veprim është me burgim nga pesë deri në tetë vjet;
- ndryshimin e kategorisë dhe destinacionit të tokës;
- dënimi për këtë veprim është me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kjo vepër, konsiderohet e kryer në rrethana të cilësuar, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve si dhe kur ka shkaktuar dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura. Dënimi për këto raste është me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet. Duke filluar nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 10 023 të vitit 2008 mbi disa shtesa dhe ndryshime në "Kodin penal"<sup>22</sup>, dëmtimi apo shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor përbën një vepër penale të veçantë kundër mjedisit. Këto shtesa në kodin penal, të cilat janë bazuar edhe në modelet e ngjashme franceze e italiane, kanë ardhur si një reagim ndaj situatës problematike të shfaqur në praktikë nëpërmjet përhapjes së ndjeshme të zjarrvënies (me dashje ose nga pakujdesia) në pyje, kullota, pemishte, e cila kishte shkaktuar djegien e qindra mijëra hektarëve, duke dëmtuar rëndë mjedisin.<sup>23</sup> Në dispozitat e reja të shtuara në kreun e veçantë mbi veprat penale kundër mjedisit janë parashikuar figurat konkrete të veprës

<sup>21</sup> Madje edhe në rastet kur nuk ka qenë e dënueshme penalisht kryerja e të njëjtës vepër nga pakujdesia, ajo është shtuar më vonë, sikurse është për shembull rasti i KP të ri të Kosovës (shih paragrafin e tretë të nenit 356).


<sup>22</sup> Ligji nr. 10 023, datë 27.11.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 190 të datës 31 dhjetor 2008.

<sup>23</sup> Relacion për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", 2008, f.14, në faqen e internetit <[www.justice.gov.al](http://www.justice.gov.al)>, aksesuar

penale të shkatërrimit me zjarr të pyjeve dhe mjedisit pyjor, të cilat në ngjashmëri me veprën penale të shkatërrimit të pronës, por në të njëjtën kohë në dallim me figurat e tjera konkrete të veprave penale kundër mjedisit. Në bazë të dhënave statistikore mbi procedimet penale të regjistruara në shkallë republike për veprën penale të shkatërrimit me zjarr të pyjeve dhe mjedisit pyjor rezulton si në tabelat e mëposhtme.

**Tabela dhe grafiku 8: Procedime penale dhe çështje të gjykuara shkatërrimit të pyjeve me zjarr.**

Nr.	Emërtimi	VITET						
		2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
1	Procedime të regjistruara	0	0	5	0	0	0	0
2	Çështje të gjykuara	0	0	5	0	0	0	0




### 3.1.15. Neni 206/b, "Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor"

Vepra e shkatërrimit me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor, kryhet me pakujdesi, duke përdorur mjete të rrezikut të përbashkët me zjarr që shkaktojnë shkatërrimin apo dëmtimin, me pasoja të rënda materiale të fondit pyjor, fidanishtes pyjore, grumbullit pyjor ose të çdo njësie të ngjashme me to. Dënimi për këtë veprim është me burgim nga dy deri në pesë vjet. Kjo vepër, konsiderohet e kryer në rrethana të cilësuar kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, për shëndetin ose jetën e njerëzve si dhe kur ka shkaktuar dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura. Dënimi për këto raste është me burgim nga tre deri në tetë vjet. Sikurse vihet re nga përmbajtja e dispozitës, të gjithë elementet e figurës së thjeshtë të kësaj vepre penale, me përjashtim të formës së fajit, janë të njëllojtë me ato të veprës penale të shkatërrimit me zjarr të pyjeve dhe mjedisit pyjor, të parashikuar në dispozitën pararendëse. Si rrjedhim, i vetmi dallim midis dy veprave penale është forma e fajit, e cila në këtë rast konsiston në pakujdesinë e autorit. Në lidhje të ngushtë me dallimin që ekziston në formën e fajit, edhe rrethanat cilësuese të parashikuara për këtë vepër penale përmbajnë vetëm rrethana me karakter objektiv, duke përjashtuar atë me karakter subjektiv që lidhet me qëllimin e posaçëm të ndryshimit të kategorisë dhe destinacionit të tokës, e cila është më se e kuptueshme se mund të parashikohet vetëm për veprën penale të shkatërrimit me zjarr të pyjeve dhe mjedisit pyjor, të kryer me dashje.

**Tabela dhe grafiku 9: Procedime penale dhe çështje të gjykuara nga pakujdesia.**

NR	EMËRTIMI	VITET								
		2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
1	Procedime të regjistruara	3	4	6	3	2	3	5	6	7
2	Procedime të gjykuara	3	4	0	0	1	0	5	6	7



### 3.1.16 Neni 207, "Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve"

Vepra e shkeljes së karantinës së bimëve dhe kafshëve kryhet, nga subjekte të posaçme, duke vepruar apo mos vepruar në kundërshtim me rregullat e caktuara për karantinën e bimëve dhe shërbimin veterinar. Këto rregulla janë të caktuara me ligjin "Mbi shërbimin veterinar" nr. 10465, datë 29.9.2011, i ndryshuar dhe ligjin "Për mbrojtjen e bimëve" nr. 105/2016. Për të pasur përgjegjësi penale duhet, që nga shkelja e rregullave të karantinës të kenë ardhur pasoja të rënda, në kuptimin që dëmtimi i bimëve nga sëmundjet e rrezikshme, ose ngordhja e kafshëve nga sëmundje ngjitëse të jetë në masë të lartë, ose të rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve. Kjo vepër penale klasifikohet si kundërvajtje penale dhe është e dënueshme me gjobë.

Shkelja e rregullave për karantinën e bimëve apo të kafshëve, krime që cenojnë jetën dhe shëndetin, njerëzve dhe kur sjellin pasoja të rënda materiale, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.<sup>24</sup> Duke iu referuar legjislacionit përkatës në mbrojtje të bimëve dhe atij për shërbimin veterinar, me termat "bimë" dhe "kafshë" kuptohen përkatësisht: "Bimë" janë bimë të gjalla ose pjesë të tyre të gjalla, përfshirë farërat dhe germoplazmën,<sup>25</sup> "Kafshë" janë gjitarët, shpendët, amfibët, zvarranikët, peshqit, molusqet, krustacët, vertebrorë ose jovertebrorë, që mbarështohen nga njerëzit për qëllime tregtare ose jotregtare ose që jetojnë të lira në natyrë.<sup>26</sup> Në këtë dispozitë të përbashkët,<sup>27</sup> të pandryshuar ndër vite në asnjë nga elementët e saj përbërës, nuk janë marrë në mbrojtje të veçantë si bimët, ashtu edhe kafshët. Të gjithë elementët përbërës të veprës, si dhe lloji dhe kufijtë e masës së dënimit janë parashikuar të njëjtë, pavarësisht nga lloji i objektit material. Në këtë kontekst, e drejta penale për mbrojtjen e kafshëve është jo vetëm fushë relativisht e re, por edhe një fushë në zhvillim dhe drejt përafrimit, së paku për sa i përket formave të rënda të krimit ndaj kafshëve të parashikuara në direktivat përkatëse të BE-së, në të cilën synojmë të anëtarësohemi.

<sup>24</sup> KP i Republikës së Shqipërisë Kreu IV, veprat penale kundër mjedisit neni 207 "Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve".

<sup>25</sup> Neni 2, pika 13 e ligjit nr. 9362, datë 24.3.2005 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve", i ndryshuar.

<sup>26</sup> Neni 4, pika 26 e ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë".



<sup>27</sup> Në dallim nga KP të mëparshme, në të cilët parashikoheshin dy dispozita të veçanta për shkeljen e karantinës së bimëve dhe të kafshëve. Shih për shembull nenet 170 dhe 171 të KP 1977, në të cilët parashikoheshin përkatësisht shkelja e dispozitave mbi karantinën e bimëve dhe shkelja e dispozitave mbi veterinarinë. Nga ana tjetër, neni 207 i KP në fuqi paraqet ngjashmëri në këtë drejtim me shumë KP të shteteve të tjera.

Tabelë 10: Përmbledhje e dënimeve për veprat penale kundër mjedisit

Nr.	Vepra penale kundër mjedisit	Masa ndëshkimore në varësi të rrezikshmërisë
1.	Neni 201, “Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës”	Burg deri në 15 vite
2.	Neni 201/a, “Menaxhimi i mbetjeve”	Burg deri në 15 vite
3.	Neni 201/b, “Transportimi i mbetjeve”	Gjobë deri në burgim 5 vite
4.	Neni 201/c, “Aktivitetet e rrezikshme”	Burg deri në 15 vite
5.	Neni 201/ç, “Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme”	Burg deri në 20 vite
6.	Neni 202, “Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër”	Gjobë deri burgim 7 vite
7.	Neni 202/a, “Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër”	Gjobë deri burgim 3 vite
8.	Neni 202/b, “Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore”	Gjobë deri burgim 5 vite
9.	Neni 203, “Substancat ozonholluese”	Burg nga 1 deri në 7 vite
10.	Neni 204, “Peshkimi i ndaluar”	Gjobë ose burgim deri në 2 vite
11.	Neni 205, “Prerja e paligjshme e pyjeve”	Gjobë ose burgim deri në 1 vit
12.	Neni 206, “Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë”	Burg deri në 3 muaj
13.	Neni 206/a, “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve”	Burg deri në 20 vite
14.	Neni 206/b, “Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor”	Burg deri në 8 vite
15.	Neni 207, “Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve”	Gjobë

Tabela dhe grafikët 11: Procedime penale dhe çështje të gjykuara për krimet mjedisore sipas veprave penale.

Nr	Treguesit	Veprat Penale					
		Ndotja e Ajrit	Ndotja e Ujrave	Peshkimi i Ndaluar	Prerja e Pyjeve	Shkatërrimi me zjarr	Shkatërrimi nga pakujdesia
1	Procedime të regjistruara	4	3	838	08	3	
2	Çështje të gjykuara	8	7	828	3	6	



**AKADEMIA E SIGURISË**

Konferencë shkencore ndërkombëtare:  
 « Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare »



Nr	Veprat Penale	VITET			
		2016	2017	2018	2019
1	Ndotja e ajrit	20	33	95	86
2	Transportimi mbeturinave toksike	0	0	0	0
3	Ndotja e ujërave	4	13	17	8
4	Peshkimi i ndaluar	12	19	13	8
5	Prerja e pa ligjshme e pyjeve	183	220	214	147
6	Prerja e drurëve dekorative dhe frutore	16	26	25	15
7	Shkatërrimi me zjarr pyjeve	4	14	3	8
8	Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve	0	10	10	11
9	Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve	4	0	5	2





Tabela dhe grafiku 12 : Procedime penale për krimet mjedisore sipas veprave penale për vitin 2016, 2017, 2018, 2019

### 3.1.17 Metoda e vlerësimit analitik të dëmit mjedisor

Qasja analitike e bazuar në vlerësimin e funksioneve individuale ekonomike të mjedisit janë më të artikuluarat, por dhe më komplekset. Metoda e propozuara bazohet në funksione të vlerësuara me kritere të ndryshme për prerjen e paligjshme të pyjeve:

Vlera totale e dëmit mjedisor është shuma e shtatë funksioneve sipas figurës së më poshtme.

Figura 1. Funksionet dhe kriteret për vlerësim in analitik të dëmit mjedisor



### 3.1.18. Diskutime dhe përfundime të përgjithshme mbi veprat penale në fushën e mjedisit

Ajo që bashkon pjesën më të madhe të veprave penale kundër mjedisit, kryesisht ato të shtuara ose ndryshuara të vitit 2019, është pikërisht referenca tek legjislacioni sektorial në fuqi, çka do të thotë se kodi penal tashmë i shtrin automatikisht pasojat penale në ligje të tjera të referuara në tabelat. Ligjet sektoriale, nga ana e tyre, kanë në fakt të parashikuara ndëshkimin e masave administrative të mirëpërcaktuara për çdo shkelje, duke i kategorizuar këto masa sipas llojit, rëndësisë së shkeljes dhe shpeshësisë së saj. Masat janë kryesisht të karakterit administrativ (pezullim dhe/ose pushim aktiviteti) ose monetar (gjoba të ndryshme për shkeljet e kryera apo zhdëmtim, rikuperim i pasojave negative), por kur shfaqen pasojat e specifikuara në secilën vepër të kodit penal, transformohen automatikisht në krime ose kundërvajtje penale mjedisore dhe rrjedhimisht të dënueshme edhe burgim.

Ajo që mbetet problematike dhe që nuk arrin ta shterojë plotësisht është ambiguiteti ligjor i kompetencave që i janë dhënë NJQV-ve nga pikëpamja administrative, por edhe vetë identifikimi i atyre veprimeve apo mosveprimeve që mund të bien nën suazën e krimit mjedisor. Sistemi i mbrojtjes së mjedisit në Shqipëri, që përbëhet pikërisht nga lidhja midis ligjeve administrative dhe dispozitave të kodit penal, nuk përmban një dallim të qartë se çfarë përbën kundërvajtje administrative dhe çfarë përbën vepër penale nën dritën e mbrojtjes së mjedisit. Nëse i referohemi për shembull neneve të shtuara rishtazi gjatë 2019-s në kodin penal, konstatojmë një diapazon shumë të zgjeruar të anës objektive të figurave të veprave penale përkatëse. Kjo do të thotë që mund të ketë vështirësi në zbatim në praktikën e punës së organeve të drejtësisë, parimi i njohur i së drejtës penale, që asnjë të mos mbetet pa u dënuar dhe, asnjë të pafajshmi të mos i privohet liria. Rrjedhimisht, dallimi ndërmjet kompetencave administrative dhe penale nuk ndahen dhe lënë hapësirë për zbatim të ndryshëm në situata të ngjashme, që në fund të fundit do të adresohen ekskluzivisht në varësi të bindjes së brendshme të gjyqtarit.

## 4. Konkluzione dhe rekomandime

- Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale brenda standardeve të mira apo shumë të mira në nivel kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar, duhet të synojnë mbrojtjen e mjedisit me të gjithë mjetet e mundshme ligjore, duke garantuar një mbrojtje sa më efektive të mjedisit duke e plotësuar me kuadër ligjor për ta zbatuar atë ndaj çdo keqbërësi.

- Në "Kodin penal" të ndryshuar me ligj, të hyrë në fuqi më datë 8.10.2019, duhet të ishin përfshirë edhe plotësime e ndryshime të tjera të nevojshme, ashtu siç u parashikuan në ndryshimin e veprave penale, ndryshime, konkretisht duhen bërë në nenin 205, prerjen e paligjshme të pyjeve, duke marrë parasysh edhe problematikat kryesore të shfaqura ndër vite në vendin tonë.

- Zhvillimi në mënyrë sa më transparente i lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve, dhe të veçohen nga format e tjera të menaxhimit të mbetjeve, për shkak të elementëve të ndryshëm specifikë, sikurse përcaktohet edhe në direktivën e BE-së.

- Bashkëpunimi ndërmjet shteteve partnere në mbrojtjen e mjedisit nga efektet e dëmshme të substancave ozonholluese të parashikuara në direktivën e BE-së për krimin mjedisor, të bëhet në formën e një figure specifike për shkak të elementëve të ndryshëm

AKADEMIA  
E SIGURISIA

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

të anës objektive të këtyre dy veprave.

- Shteti duhet të krijojë mundësinë e mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit, sigurimin e tij, deri në forcimin financiar në investimet për mjedisin.

- Edukimi i publikut për pjesëmarrje në problemet e mjedisit duke u përqendruar në edukimin shkollor të së gjitha niveleve.

## Bibliografia

1. Directive 2008/98/EC of the European Parliament and of the Council of 19 November 2008 on waste and repealing certain Directives (Text with EEA relevance) ( Direktiva 2008/98 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 19 nëntorit 2008 mbi mbetjet).  
[www.ajls.org/doc/8\\_IPetrela\\_Takimi\\_V.pdf](http://www.ajls.org/doc/8_IPetrela_Takimi_V.pdf) Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë Evropian, Iris Petrela.
2. *Konventa për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara.*
3. Saunders, J. And J. Hein. 2015. EUTR CITES and money laundering: A case study on the challenges to coordinated enforcement in tackling illegal logging. A study for the EFFACE project. London: Chatham House.p.15-16.
4. Nellemann, C., Henriksen, R., Kreilhuber, A., Stewart, D., Kotsovova, M., Raxter, P., Mrema, E., and Barrat, S. (Eds). 2016. *The Rise of Environmental Crime - A growing threat to natural resources, peace and development and security.* UNEP and INTERPOL p.7
5. Kodi civil (2014).
6. Manual për menaxhimin e problemeve mjedisore [www.osce.org/sq/albania/22652?download=true](http://www.osce.org/sq/albania/22652?download=true) internetit \www.justice.gov.al>, aksesuar.
7. Enkelejda Turkeshi, Mbrojtja juridike penale e mjedisit, Disertacion, Tiranë 2014.  
<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/09/Doktoratura-Enkelejda-Turkeshi-Fakulteti-i-Drejtësisë-Departamenti-i-te-Drejtës-Penale.pdf>
8. Prokuroria e Përgjithshme, Raporti Vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2018, Tiranë.
9. Ligji nr. 8934, datë 5.9.2002.
10. Kodi penal i Republikës së Shqipërisë.
11. Ligji nr. 10431 datë 9.6.2011" Për Mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar.
12. Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar.
13. Kodit penal i Republikës së Shqipërisë.
14. Madje edhe në rastet kur nuk ka qenë e dënueshme penalisht kryerja e të njëjtës veprë nga pakujdesia, ajo është shtuar më vonë, sikurse është për shembull rasti i KP të ri të Kosovës (shih paragrafin e tretë të nenit 356).
15. Ligji nr. 10 023, datë 27.11.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 'Kodi penal i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në *Fletoren Zyrtare nr. 190* të datës 31 dhjetor 2008.
16. Relacion për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 'Kodi penal i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar", 2008.
17. Neni 2, pika 13 e ligjit nr. 9362, datë 24.3.2005 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve", i ndryshuar.
18. Ligji nr. 10465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë".
19. "Kodi penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", 1977.



---

## **AKADEMIA E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »**

# Keqplanifikimi urban dhe ndikimi i tij, në gjeografinë e krimit urban



■ **MSc. Alma BELA**  
Ministria e Brendshme  
[alma7bela@yahoo.com](mailto:alma7bela@yahoo.com)

## Abstrakt

*Qëllimi i këtij punimi është ai i të kuptuarit të lidhjes që ekziston ndërmjet dy fushave aq të ndryshme, por tejet të rëndësishme siç janë inxhinieria dhe planifikimi urban, me krimin urban. Fokus i punimit do jetë studimi i elementëve të veçantë të fushës së inxhinierisë dhe efekti i tyre në nivelin e krimit në përgjithësi dhe në gjeografinë e krimit urban specifikisht. Rëndësi paraqet njëkohësisht dhe çështja e lëvizjes demografike në qytetit e Tiranës. Dizajnimi i ndërtesave, llojeve të shtëpive dhe identifikimi i rasteve të mirëmbajtjeve të tyre krijojnë pashmangshmërisht lidhje me teorinë e dritareve të thyera ("Broken windows theory"). Përmendja e elementëve, si më lart, dëshmon në ekzistencën e një sërë faktorësh specifikë që ndikojnë në vëllimin, strukturën dhe gjeografinë e krimit urban. Duke parë gjeografinë e zonës ku krimi urban ka tendencë zhvillimi, mund të themi në një këndvështrim tjetër, që mjedisi ka një rol të rëndësishëm. Tashmë, mjedisi nuk ndikon vetëm tek autori i veprës penale, por edhe tek viktima si dhe te shifrat e krimit. Zhvillimi i shpejtë i urbanizimit në Tiranë, shoqërohet ndjeshëm me rritjen e krimit në këtë qytet, për rrjedhojë niveli i krimit është më i lartë në zonat urbane se sa në ato rurale.*

## Fjalëkyçe:

**inxhinieri, krim, krimi urban, ligj, mjedis, urbanizim.**

## 1. Hyrja

Gjatë viteve të fundit në vendin tonë është rritur ndjeshëm numri i personave të cilët kërkojnë të jenë banorë ose rezident në zonat urbane. Një rritje të ndjeshme kanë pësuar kryesisht ato qytete të cilët ofrojnë numrin më të lartë të shërbimeve apo të vendeve të punës, si dhe qytetet të cilët kanë në zonën e tyre territoriale universitetet. Lëvizjet e shumta demografike me drejtimin drejt zonave urbane, kanë ndikuar pashmangshmërisht në procesin e urbanizmit, proces ky, i cili ka sjellë *efektin domino* në shumë fusha, të cilat e kanë atë, objekt të tyre të studimit. Ritmi i shpejtë i urbanizmit është i lidhur në mënyrë të konsiderueshme me rritjen e nivelit të krimit në qytetet kryesore të Shqipërisë dhe kryesisht në qytetin e Tiranës. Përzgjedhja e këtij qyteti, bëhet për arsyen pasi ai ka pësuar ndryshime në përmasat e tij dhe për faktin, që lëvizjet demografike janë më të dukshme në këtë zonë.

Me zhvillime të tilla, erdhi në rritje edhe numri i personave të cilët kryenin vepra penale nga më të ndryshme, duke filluar nga ato me dënimet më të lehta deri në rastin e atyre veprave të cilat kanë rrezikshmëri të lartë shoqërore. Për rrjedhojë qetësia urbane dhe siguria u vunë në pikëpyetje. Ajo çka do ta përshkojë këtë punim në vetvete dhe, që ka për qëllim evidentimin e elementëve përbërës të cilët ndërlidhin dy fusha kaq të ndryshme, është gjetja, studimi e analizimi i faktorëve që ndikojnë në vëllimin dhe strukturën e krimit urban si dhe studimi i ndikimit të elementëve specifikë të fushës inxhinierike në gjeografinë e krimit urban në veçanti. Dhënia e një përgjigjeje për pyetjen: “Si ndikojnë elementë të caktuar të fushës inxhinierike, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në nivelin e krimit në përgjithësi dhe krimit urban në veçanti?”, është sfidë më vete në realizmin e këtij punimi. Gjithashtu një vëmendje specifike i kushtohet hartimit të zonave të ndërtimit, identifikimit të llojit të banesave dhe rolit të tyre në

zona të caktuara urbane. Njëkohësisht, i rëndësishëm është edhe përqendrimi dhe dhënia e përgjigjes për pyetjen: “Cila është arsyeja që ndryshon vëllimin dhe strukturën e krimit urban që ka të bëjë me planifikimin urban, shërbimet e mirëmbajtjes së ndërtesave, etj.?” Sigurisht që gjetja e përgjigjeve bazohet në kuptimin e vetë qytetit të Tiranës.

Dizajnimi i ndërtesave, llojeve të shtëpive dhe identifikimi i rasteve të mirëmbajtjeve të tyre krijojnë pashmangshmërisht lidhje me teorinë e “dritareve të thyera” (“Broken Windows theory”) e cila ngre pyetjen se cili është shkaku që gjërat e vogla kanë rëndësi.<sup>1</sup>

Dalja në përfundimin (ndër të tjera) se ekziston lidhja e ndërsjellët, direkte ose indirekte, ndërmjet krimit urban dhe krimit mjedisor, me fokus të veçantë sigurinë e individit, por jo vetëm, përbën synimin kryesor të realizimit të këtij punimi. Një ndër synimet e këtij punimi është dhe “shtrimi i një rruge”, për njohjen e krimit urban në Shqipëri nga ana e lexuesit. Në këtë material është parë e arsyeshme sjellja e pasqyrimin të krimit urban në vendin tonë duke filluar që nga sqarimi i kuptimit të termi “krim urban”, ku ky i fundit përbën risi gjatë viteve të fundit. Një vëmendje të veçantë do ketë fokusi në analizën e faktorëve që ndikojnë në rritjen apo uljen e nivelit të tij.

Gjatë dekadave të fundit ka pasur mjaft punime në fushën penale, ku një pjesë të konsiderueshme e ka zënë ajo e luftës kundër krimit. Vetë situata politike, socioekonomike gjatë kësaj periudhe, ka qenë një indikator i pasurimit të doktrinës shqiptare në këtë fushë. Njohja me politikën kryesore të luftës ndaj këtij fenomeni nga ana e institucioneve shqiptare, por dhe atyre të huaja si dhe kuptimi në vetvete i krimit, janë çelësi i zhvillimit të politikës informuese që do të ulte nivelin e krimit në shoqëri.

Për sa i përket metodologjisë së përdorur për realizimin e këtij materiali dhe për arritjen e qëllimeve të lartpërmendura, jam përqendruar në mbështetjen tek literatura shqiptare, por dhe ajo e huaj (kryesisht në fushën penale), në kërkimin dhe krahasimin me atë çka ofrojnë studiuesit shqiptarë, por edhe të huaj ku rëndësi ka njohja e eksperiencave dhe interpretimi i tyre. Gjithashtu rëndësi ka marrë dhe evidentimi në mënyrë të qartë të elementëve që formohen nga përpunimi i të dhënave të marra nga institucionet shqiptare dhe të huaja në lidhje me krijimin e një panorame të ambientit shqiptar si dhe fokusimi në punimin në terren duke evidentuar nga afër si *hotspot*-et (pikat e nxehta ku përqendrohet numri më i lartë i veprave penale të kryera nga autorët), por dhe në pamjen vizuale nga afër të ndërtesave objekt-studimi.

## 2. Krimi urban dhe shkaqet e tij

Në shoqërinë e sotme moderne, në kushtet e rritjes së teknologjisë dhe të konsumit, ka shumë veprime dhe mosveprime të njerëzve që shkaktojnë viktima të shumta. Ekziston mundësia, që një person të mund të viktimizohet më shumë se një herë nga i njëjti person apo nga persona të ndryshëm dhe këto viktima, shkaktojnë krimet konvencionale (ose të quajtura krimet e rrugës) të cilat jo pak herë kanë qenë në shifra të larta. Viktima të krimit ka si në zonat urbane ashtu dhe në ato rurale, por duke qenë se objekti i studimit lidhet me krimin urban dhe mjedisin në këto zona, do ndalem tek ato vepra penale që shkaktojnë viktima në zonat urbane si dhe lidhja që ekziston mes tyre dhe atij mjedisi. Disa individë, përfshihen në veprimtari kriminale e disa të tjerë,

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

<sup>1</sup> William H. Sousa dhe George L. Kelling, *Police Innovation; Contrasting Perspectives*, 2019 (Cambridge University Press), 128.

janë më të ekspozuar ndaj tij dhe bien lehtë “pre” e tij. Siç vëmë re edhe në përditshmërinë tonë, në atë çka transmeton media, por jo vetëm (kryesisht të dhëna nga Policia e Shtetit), kriminaliteti nuk ka përhapje të njëjtë në persona apo zona të ndryshme. Por, institucionet e posaçme bëjnë të mundur që nëpërmjet bazës së të dhënave që disponojnë (*database*), arrijnë në identifikimin e zonave të nxehta apo *hotspoteve*.

Përse persona të veçantë kryejnë vepra penale? Përse krimi është më i përhapur në zonat urbane se ato rurale? Cili është ndikimi i lëvizjeve demografike? Për t’u dhënë përgjigje sa më të saktë këtyre pyetjeve, na vjen në ndihmë *etiologjia* (pjesë e kriminologjisë), si shkencë që studion faktorët që ndikojnë në kriminalitet, lidhjet e faktorëve të ndryshëm socialë me kriminalitetin dhe aspekte të tij të veçanta.<sup>2</sup> Gjatë kryerjes së një krimi ndikojnë faktorë të cilët janë të brendshëm apo të jashtëm. Ata janë të shumëllojshëm dhe veprojnë në lidhje me njëri-tjetrin, ku te individë të ndryshëm ndikojnë në mënyra të ndryshme. Disa faktorë ndikojnë në ekzistencën e krimit dhe të dhunës. Këta (faktorë) përfshijnë rrethanat politike dhe ekonomike që prodhojnë mundësi dhe nxitje për sjellje kriminale e akte të dhunshme. Faktorë të tjerë që lidhen me dhunën dhe krimin urban përfshijnë ritmin e shpejtë të urbanizimit, pasjen e një planifikimi, menaxhimi dhe dizajnit të varfër urban, rritja e numrit të popullsisë në qytetin e Tiranës, por edhe frika që ekziston kur kalon në disa zona të caktuara, në orare të caktuara. Dëmtimet e makinave apo të bizneseve në lagje të ndryshme, vjedhja e banesave, vandalizmat etj., kanë qenë shqetësuese, ku kryesisht këto krime kanë pasur shifra të larta në fillim të viteve ‘90.

Më pas, me përmirësimet në Kodin Penal ndër vite, këto shifra patën rënie, por përsëri janë të pranishme. Lidhja e ngushtë e faktorit social me faktorin shoqëror ndikon në forma të ndryshme në nivelin e krimit, ku si element kryesor të organizimit social përmendim urbanizimin. Relativisht, në praktikë, vërejmë që normat më të larta në të krimit janë në lagjet e varfra dhe me dendësi popullore të lartë, por përjashtim nuk bëjnë dhe lagjet e tjera apo zonat e tjera të qytetit, të ndryshme nga zonat në fjalë. Duke ndjekur modelin e vendeve të tjera, urbanizimi, industrializimi i shpejtë dhe migrimi drejt qyteteve, janë faktorët kryesorë që kontribuojnë në norma më të larta të krimit në Shqipëri. Ndikimi i mjedisit tek individë ka qenë i pashmangshëm. Mjedisit ka qenë (dhe vazhdon të jetë) objekt i studimit të kriminologjisë. Ndikimi i mjedisit tek individë dhe tek sjellja kriminale e tij ka një ndikim të tërthortë ose indirekt. Vendbanimi dhe tendenca e krimit janë të lidhura për shkak të pranisë së grupeve të mëdha sociale që janë të përqendruara në lloje të caktuara të banesave. Duke parë dhe gjeografinë e zonës ku krimi urban ka tendencë zhvillimi, mund të themi se në një këndvështrim tjetër, mjedisit ka një rol të rëndësishëm në vëllimin e strukturën e krimit në zonat urbane.

Nisur nga çfarë përmendëm më lart, ritmi i shpejtë i urbanizimit shoqërohet ndjeshëm me rritjen e procedimeve penale të regjistruara në prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore (kryeson Tirana me 31% të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi) që është më i përhapur në zonat urbane se sa në ato rurale.<sup>3</sup> Gjithashtu, studiuesit e kanë shpjeguar këtë fenomen duke iu referuar stilit të jetesës ose densitetit të popullsisë. Kriminaliteti në këto fusha ndryshon nga veprat penale të kohës dhe mënyra e kryerjes së tyre.<sup>4</sup>

<sup>2</sup> Vasilika Hysi, *Kriminologjia*, 2010, 349

<sup>3</sup> Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm “Për gjendjen e kriminalitetit për vitin 2018”, 2019, 2.

<sup>4</sup> Alma Bela, Konferenca 17 Ndërkombëtare e European Society of Criminology, Cardiff, Wales, UK, 2017.



Autorë të shumtë kanë përmendur në përgjithësi në studimet dhe gjetjet e tyre se cilat janë teknikat për të minimizuar krimin. “Nëse dikush dëshiron të zvogëlojë krimin, duhet të shmangë përqendrimin e njerëzve në zona shumë të urbanizuara (Christie, 1975, f. 91)”.<sup>5</sup>

Tashmë mjedisi nuk ndikon vetëm tek autori i veprës penale por dhe tek viktima si dhe në shifrat e krimit. Mjedisin në zonat urbane e bëjnë më së shumti ndërtesat e larta që përdoren në të shumtën e rasteve për banim. Gjithashtu ato përdoren dhe për qëllime biznesi ku katet e para dhe të dyta (tanimë dhe katet e tjera me raste, duke përjashtuar qendrat tregtare) shndërrohen në zyra apo në lokale. Ndërtimet e shumta, pa kriter dhe afër njëra tjetrës, kanë krijuar rrugicat e ngushta ose bllokimin e disa prej rrugicave ekzistuese në vitet e mëparshme. Moszbatimi i saktë i ligjit ka sjellë një kaos urban. Planifikimi urban është kaluar në një plan të dytë për fat të keq.

Për të kuptuar se si individi ndikohet nga mjedisi (apo anasjelltas) dhe efektet që kanë faktorët e tjerë, paraqes më poshtë një grafik, i sjellë si rezultat i studimit të rasteve të ndryshme nga praktika apo dhe nga evidentimi i situatave të caktuara.




Figura 1.

Por ç’kuptojmë me planifikim urban, në vetvete, që të ndalemi më tej në ndikimin që ka tek mjedisi dhe tek niveli i krimit. Dr. Alfred Frashëri, pedagog në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minerave, në një ndër punimet e tij e cilëson *planifikimin urban* si një veprimtari komplekse, natyrore, inxhinierike, klimatike, biologjike, sociale dhe legjislative, e shoqërisë njerëzore të civilizuar, mbështetet në radhë të parë mbi mjedisin gjeologjik dhe ekosistemet e lidhur me të.<sup>6</sup>

Në vitin 2011, hyri në fuqi *Rregullorja uniforme e kontrollit të zhvillimit*, ku një ndër qëllimet e saj është dhe kontrolli i zhvillimit të territorit dhe përcaktimi i hapësirave ndërmjet ndërtesave. Pika 5, e nenit 40 (treguesit e distancave) tregon në detaje distancën në metra që duhet zbatuar me korrektësi:

<sup>5</sup> Per-Olof H, *Urban crime, criminals and victims. The Swedish experience in an Anglo-American Comparative Perspective*, 1991, 7

<sup>6</sup> Dr. Frashëri, A., “Gjeofizika inxhinjerike dhe mjedisore”, Tiranë, 2012, 1

“Distanca minimale për faqet pa dritare dhe pa çarje fasade të çdo lloji tjetër, të cilat ndodhen përballë njëra tjetrës, duhet të jetë 4 metra. Në rast se zgjidhja arkitektonike është e tillë që ndërtesat janë në bashkim të plotë në këto dy faqe, zgjidhja arkitektonike në planimetri dhe volum duhet të ofrojë të gjitha zgjidhjet e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 7707, datë 17.5.1993, “Për mbrojtjen nga zjarri”, dhe duhet të sigurojë nënkalime me përmasa minimale prej 4 metrash gjerësi dhe 6 metrash lartësi. Në çdo rast, dy strukturat duhet të sigurojnë hapësirën e nevojshme publike sipas të gjithë treguesve të kërkuar të zhvillimit nga kjo rregullore dhe nga rregulloret vendore të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit”.

Por, në shumë zona të Tiranës, largësia e duhur dhe e përcaktuar ndërmjet godinave nuk është respektuar nga ndërtuesit. Ndërtimi fare pranë i godinave me njëra-tjetrën, vihet re me sy të lirë në shumë zona të qytetit. Kjo sjell kufizimin e hapësirave ndërmjet tyre e për rrjedhojë shumë rrugë janë kthyer tashmë në rrugica. Kjo ka shkaktuar dhe devijimin e “rrugës” së këmbësorëve në qendrat e banimit. Pasojë e këtij “fenomeni” është dhe mungesa e ndriçimit të tyre në shumë raste. Automatikisht rritet rreziku që individit të jetë viktimë, pasi autorët e veprave penale në zonat urbane, shfrytëzojnë këto zona ku ka pak (ose shumë pak) hapësirë midis ndërtesave, dhe ndriçimi i rrugëve e rrugicave gjatë natës mungon, ose nuk është i mjaftueshëm. Vjedhjet, grabitjet, plaçkitjet, etj., nuk ndodhin vetëm gjatë orëve të vona të natës, por dhe gjatë ditës.

Janë disa zona të qytetit, të cilat konsiderohen si jo të sigurta për kalimtarët. Në përgjithësi ato janë të banueshme, numri i automjeteve që kalojnë në rrugët është mjaft i madh (zona të zhurmshme) ku dhe numri i grabitjeve është i lartë. Do të dëshiroja të ndalesha në disa prej tyre, që bëjnë pjesë në territorin e Bashkisë së Tiranës, ku më problematiket janë ato të quajtura: “Ali Demi”, “Don Bosko”, “Unaza e Re”, “Tirana e Re”, “Kombinat” dhe “Kinostudio”. Sipas të dhënave të fundit nga drejtoria e policisë së Qarkut Tiranë, në këto zona ka pasur një rritje të numrit të vjedhjeve krahasuar me vitet e mëparshme, por gjithashtu duhet përmendur që në proporcion me to ka qenë dhe numri i zbulimit të tyre.

Pas fasadave me ngjyra të pallateve buzë rrugës, pas çdo blloku pallatesh që kalon, shfaqet një pamje tjetër. E ajo nuk është dhe aq premtuese. Pamjet nga jashtë të disa godinave, lënë për të dëshiruar. Një pjesë e mirë e tyre kanë tek-tuk ndonjë dritare, të tjerat mund të kenë muret rrethuese të shtëpive private pjesërisht të rrëzuara dhe diku tjetër, shikohen dritare pa xhama. Studiuesit kriminologë, paraqitjen e kësaj situatë tek njerëzit e shikojnë si një indikator i jashtëm në perceptimet e tyre për këto zona. Madje ata tashmë e quajnë “Teoria e dritareve të thyera” (“Broken Windows Theory”).

Kjo teori është një ndër teoritë kriminologjike sipas të cilës edhe mirëmbajtja e thjeshtë e mjedisit urban, parandalon vandalizmin dhe shkallëzimin drejt krimit më serioz. Teoria thekson se mbajtja dhe monitorimi i mjedisëve urbane në një gjendje të mirë, mund të ndalojë këtë vandalizëm dhe shkallëzimin e mëtejshëm të krimit, Ja se si e ilustron këtë teori autorët e saj James Q. Wilson dhe Geroge L. Kelling:

“Le të konsiderojmë një ndërtesë që i ka disa dritare të thyera. Nëse dritaret nuk rregullohen (meremetohen), vandalët do priren që të thyejnë dritare të tjera. Herët a vonë, edhe do të shpërthejnë ndërtesën dhe, po të jetë kjo e zbrazët, do të vendosen aty ose do të ndezin zjarre aty brenda. Ose le të konsiderojmë një trotuar, ku kanë hedhur plehra. Herët a vonë, po të mos i heqë kush, do të grumbullohen edhe më shumë. Më në fund, njerëzit do të fillojnë t’i çojnë atje plehrat e tyre dhe vendi do të marrë pamjen

e një zone të braktisur..”<sup>7</sup> Është thënë se kjo teori ka gjetur zbatim të gjerë dhe të suksesshëm në praktikë në SHBA, duke e ulur ndjeshëm krimin në zonat e mëdha urbane.

Nëse do vihej në zbatim dhe në Tiranë, ajo do parandalonte sadopak krimin në këto zona. Për të pasur një ndikim pozitiv në lidhje me uljen e shifrave të krimit në zonat urbane, vihet re që kohëve të fundit kemi disa lëvizje dhe ide nga individë dhe nga organizmat ndërkombëtarë. Një ndër këto ide është ajo e *Programit të Kombeve të Bashkuara për vendbanimet* (UN- HABITAT). Në drejtim të përmirësimit të qetësisë dhe sigurisë urbane, politika urbane është përkthyer në projektimin e planifikimin urban, në programe dhe procedura operuese dhe masa që mund të ndikojnë drejtpërdrejt në mjedis dhe në sjelljen shoqërore.<sup>8</sup> Planifikimi është mbledhja dhe analizimi i informacionit, formulimi i objektivave dhe qëllimeve, zhvillimi i ndërhyrjeve specifike, duke përfshirë edhe ato të destinuara për të përmirësuar sigurinë urbane dhe proceset organizative të nevojshme, për t'i sjellë ato të realizuara.

Dizajni urban përfshin projektimin e ndërtesave, grupet e ndërtesave, hapësirat në qytete, në mënyrë që të krijojnë ndërtesa me një mjedis të qëndrueshëm dhe të sigurt. Ai mund të sjellë gjithashtu, projektimin e sistemeve të transportit në ato mënyra që përmirësojnë sigurinë për gratë, apo të rrugëve lidhëse me ndërtesat, në mënyrë që të minimizojë mundësitë e zhvillimit të krimit përmes përmirësimit të ndriçimit. Ka prova që tregojnë se planifikimi i varfër, projektimi dhe menaxhimi i mjedisit urban, i përball qytetarët me rrezik lëndimesh që mund t'u shkaktohen, humbjeje jete apo prone. Mungesa e integritit të strategjive të parandalimit të krimit brenda praktikave të planifikimit të qytetit është cituar si një faktor në lehtësimin e mundësive për krimin urban. Projektimi dhe menaxhimi i mjedisit luan rol në lehtësimin ose zvogëlimin e mundësive për krimin dhe dhunën. Ndërsa nuk ka asnjë mënyrë për të numëruar saktë numrin e incidenteve që lidhen me projektimin apo menaxhimin e planit urban, vlerësohet se 10 deri 15 për qind e krimeve, ndikohen nga planifikimi dhe menaxhimi i planit urban, veçanërisht ato të lidhurat me shikueshmërinë, objektet e rrënuara dhe hapësirat publike, si dhe fiziko-izolimi i objekteve publike, në mesin e të tjerëve.

Po marrim një rast, të cilin e vë re secili prej nesh në zonat e banuara: ndeshemi me imazhe të tilla jo rrallë herë. Në fotot e mëposhtme, të cilat janë bërë në një ndër zonat më të banuara të Tiranës, shikojmë që nuk është ruajtur aspak distanca e parashikuar ndërmjet pallateve shumëkatëshe. Për sa i përket cilësisë së punimeve etj., mbetet për t'u parë nga specialistët e fushës. Por, ajo çka më bën përshtypje në këto pallate shumëkatëshe kaq pranë njëri-tjetrit (ngjitur!) është se në këto dy godina banimi, numri i personave, banorëve që jetojnë në to, është i konsiderueshëm. Për rrjedhojë, probabiliteti që aty të kemi individë të cilët mund të jenë ose të bëhen autorë të veprave penale (vjedhje, grabitje, shkatërrim prone etj., – vepra penale të atilla që janë në fokusin e krimit urban), është i lartë. Ndërkohë, mos njohja e njerëzve (komshinjeve) me njëri-tjetrin e rrit më shumë këtë përqindje. Shumë ndërtesa të tilla nuk kanë ndriçim të mjaftueshëm në ambientet e përbashkëta dhe pjesa dërrmuese e tyre nuk kanë kamera CCTV. Këto elementë e bëjnë më të lehtë mosidentifikimin e personave të cilët mund të jenë ose janë autorë të veprave penale të sipërcituara, por jo vetëm.

<sup>7</sup> [http://en.wikipedia.org/wiki/Broken\\_windows\\_theory](http://en.wikipedia.org/wiki/Broken_windows_theory), (përkthim vetjak)

<sup>8</sup> ENHANCING URBAN SAFETY AND SECURITY GLOBAL REPORT ON HUMAN SETTLEMENTS 2007, page 6 & 15, Abridged Edition Volume 1, Reducing Urban Crime and Violence: Policy Directions, United Nations Human Settlements Programme, <http://www.unhabitat.org/content.asp?typeid=19&catid=555&cid=5359>



Figura 2, 3

Ndërkohë dy nga zonat e Tiranës ku dallimi mes tyre është i qartë lidhet me diferencën e ndërtimeve (llojit dhe numri i kateve) mes tyre. Shikojmë zonën e “Ali Demi”, “Vasil Shanto” dhe “Medar Shtylla” (siç shpesh përmendet “Komuna e Parisit”). Dallimi është i qartë dhe me sy të lirë, duke parë këto imazhe të ruajtura nga aplikacioni *google earth*.



Figura 4, “Ali Demi”

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »



Figura 5, “Vasil Shanto” dhe “Medar Shtylla”/ “Komuna e Parisit”

Nga imazhet e mësipërme kuptojmë që gjatë njëzet viteve të fundit, ndërtimet pa kriter teknik, inxhinierik apo ligjor, kanë qenë shumë të mëdha në numër. Kjo ka ndikuar ndjeshëm dhe ka sjellë në mënyrë direkte kufizimin e hapësirave ndërmjet ndërtesave dhe evidentohet qartë që shumë rrugë janë shndërruar në rrugica. Një rezultat i tillë na del kryesisht në figurën 5 të zonave “Vasil Shanto” dhe “Komuna e Parisit” (në vazhdim Komuna). Ndërkohë nuk shikojmë këtë agresivitet ndërtimesh pa kriter në zonën e “Ali Demit”. Kjo zonë kryesisht ka banorë të cilët kanë jetuar prej më shumë se 40-50 vitesh dhe nuk janë të ardhur. Duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e tyre ndodhen dhe preferojnë shtëpitë private me 1, 2 ose 3 kate, rrjedhimisht rreziku për të qenë viktimë e veprave penale në momente të caktuara bie ndjeshëm, ashtu siç në momente të caktuara ka pasur raste sporadike të kundërta.

Ndërkohë efekt të menjëhershëm kanë dhënë ndërtimet në zonat ku densiteti i banorëve është tejet i lartë, pasi ajo lëvizje ka shkaktuar devijimin e trotuarit në zona urbane (foto më poshtë, nr. 6). Në shumë prej tyre shikohet dhe mungesa e dritës në orët e vona të natës. Ky fakt rritën rrezikun që një person delikat të shndërrohet në viktimë të autorëve të akteve kriminale që shfrytëzojnë këto zona, ku distanca ndërmjet ndërtesave nuk respektohet.

Figura 6



Do doja të ndalesha dhe në ndikimin që kanë ambientet e gjelbëruara dhe mbjelljet e pemëve në qytet. Sipas një studimi<sup>9</sup> të ri, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mund të ketë një lidhje direkte midis numrit të pemëve në lagjen tuaj dhe sa të sigurt mund të ndjeheni. Hulumtimi ishte një studim rasti i qytetit të Baltimore, një zonë metropolitane me shifra të larta të kriminalitetit. Studiuesit përdorën imazhet satelitore për të krahasuar në të gjithë qytetin vendndodhjen e veprave penale me numrin e pemëve në ato zona. Edhe pse në shumicën e rasteve është krijuar perceptimi që delinkuentët fshihen pas shkurreve dhe pemëve pasi kryejnë veprimin antiligjor, duke pritur të na sulmojnë, studimi flet për të kundërtën. Sipas këtij studimi, një rritje prej 10% të pemëve në zonë, ishte e barabartë me një rënie në 12% të nivelit të krimit. “Është më të vërtetë befasuese kjo marrëdhënie e fortë mes të dyjave”, shprehet një ndër autorët dhe studiuesit kryesor, Austin Troy (drejtor i Qendrës Kërkimore të Transportit në Universitetin e Vermontit, SHBA).

Lidhjen ndërmjet individit, krimit, probabilitetit të së qenit viktimë, planifikimit urban, mjedisit dhe frikës ndaj krimit e perceptoj si të tillë nëpërmjet këtij grafiku (figura 7):




Figura 7

Ndërkohë lidhur me vëllimin dhe strukturën, jam përqendruar në të dhënat e vitit 2015, pasi e konsideroj në aspektin studiues (deri më tani) si një ndër vitet me të dhënat më konkrete që i afrohen realitetit; nisur kjo nga ballafaqimi i rasteve nga praktika dhe ato të denoncuara në autoritetet përkatëse. Sipas *Vjetarit statistikor* të Ministrisë së Drejtësisë, në vitin 2015, koeficienti i kriminalitetit 156 krime për 100 000 qytetarë (*Raporti vjetor* i Ministrisë së Drejtësisë); të dhënat nga prokuroria: shkalla e kriminalitetit për procedurat penale të regjistruara ishte 1088 për 100 000 qytetarë. Paralelisht kemi të dhënat që vijnë nga *Analiza vjetore e policisë*: Analiza 12 mujore, 2012: 5850 vepra luftarake. Ndërkohë nga gjykatat: qasje në gjykatë dhe numri i vendimeve të marra (libri vjetor i burimit, Ministri i Drejtësisë), vlen të përmendet koeficienti i kriminalitetit

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

<sup>9</sup> Troy, A., Grove, J. M., O'Neil-Dunne, J., "The relationship between tree canopy and crime rates across an urban-rural gradient in the greater Baltimore region", "Landscape and Urban Planning" Journal, 2012  
[http://www.nrs.fs.fed.us/pubs/jrnl/2012/nrs\\_2012\\_troy\\_001.pdf](http://www.nrs.fs.fed.us/pubs/jrnl/2012/nrs_2012_troy_001.pdf)

<sup>10</sup> Editorial, Zimring, E. F., "How to Stop Urban Crime Without Jail Time. What cities can learn from NYC's safest decade", The Wall Street Journal, January 28, 2012.

në vitet 2015-2065. Kështu, sipas të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë, të botuara në vjetarët statistikorë të viteve të lartpërmendur, vërejmë se kemi një rritje të këtij koeficienti. Nga studimi i të dhënave të përfunduara kriminale (krime dhe vepra penale në tërësi), rezulton se për vitin 2054 ka 156 krime për 100 000 banorë në shkallë vendi (22 më shumë sesa në vitin 2014).

*Pas trajtimit të temave kryesore që lidhen me krimin urban, është e nevojshme që të njihet dhe masat që do të merren për luftën ndaj fenomeni dhe për parandalimin e tij.* Problematika e krimit urban, në Shqipëri dhe më gjerë, është koherente. Ndërsa në vendet Perëndimore kemi studime të veçanta për këtë temë, tek ne është në fazat embrionale të studimit. Analizat e organeve shtetërore janë të rëndësishme, por ata nuk janë specifike që të përqendrohen vetëm tek krimi urban. Kështu që e shikoj si të nevojshme, që në të ardhmen, të krijohet *data base* (të dhënat të strukturuar) vetëm për krimin në zonat urbane. Kjo, do ndihmonte shumë studiuesit e shkencave penale në fushën e kriminalistikës, viktimologjisë, por dhe ato të statistikave në institucionet shtetërore apo edhe studiuesit nga fakultetet e ndryshme që kanë interes në këtë fushë.

Politika sociale gjen përgjigjen për të luftuar krimin në gjenezën e tij. Format e krimit mund të parandalohen ose kundërshtohen duke pasur një politikë sociale shumë të mirë, përveç politikave të tjera të luftimit të krimit. Vetëm njohja e problemit përmes studimit të kurbës së krimit dhe analizës së faktorëve nxitës, do të çojë në hartimin e politikave parandaluese dhe frenuese për luftën kundër fenomenit. Në Shqipëri, politikat e parandalimit të krimit janë ato kryesisht përmes ndryshimeve që i janë nënshtruar Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

*Rekomandimet e Bashkimit Evropian.* Në Shqipëri, parandalimi i krimit arrihet kur çdo cikël i sistemit të drejtësisë penale funksionon me efikasitet, thjeshtësi dhe qartësi, si dhe me objektivitet.

Për sa kam trajtuar më sipër arrij në disa konkluzione:

- Nga analiza e kodeve penale të viteve 1928, 1952, 1977, 1955 shikojmë që disa figura të veprave penale të parashikuara më parë, nuk janë të pasqyruara në Kodin Penal aktual. Do ishte e udhës që figura të veprave penale të tilla si, *grabitja* apo *shtrëngimi*, të parashikuara nga kodet penale të 1952-shit dhe të 1977-ës, dukë përmirësuar përmbajtjen e tyre dhe duke ndryshuar masën e dënimit, të ishin të parashikuara në Kodin e sotëm.

- Nga studimi i faktorëve që ndikojnë (nxisin) krimin urban, do të veçoja ndikimin tejet të fortë të politikave urbane në përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe në uljen e shifrave të krimit në zona urbane, nëse do zbatohen me përpikëri rregullat e planifikimit urban.

- Vëllimi dhe struktura e kriminalitetit: krahasimi i të dhënave (të siguruara nga organet kryesore të sistemit të drejtësisë penale) të viteve të fundit tregon që krahas rritjes së numrit të popullsisë, evidentohet edhe një rritje e vogël e numrit të veprave penale si dhe një rritje në numrin e personave të kapur, të proceduar dhe të dënuar për veprimet e tyre joligjore.

- Roli i policisë, prokurorisë dhe gjykatave: pasqyrim (deri diku i plotë) publik i të dhënave nga ana e prokurorisë (Analiza vjetore e Prokurorit të Përgjithshëm) dhe gjykatave (Vjetarët statistikorë, Ministria e Drejtësisë). Nëse do kishte një studim të veçantë për krimin urban, kjo gjë do ishte tejet pozitive dhe ndihmuese për studiuesit e rinj. Ndërkohë që Policia e Shtetit, duhet të jetë më transparente për publikun, në pasqyrimin e të dhënave në mënyrë publike, theksoj se ka një rritje të besueshmërisë së

publikut ndaj policisë. Sa më shumë aktive të jetë ajo, aq më shumë ndikim pozitiv do të ketë tek publiku.

- Rritja e numrit të patrullave të policisë në rrugët e Tiranës, gjatë ditës, por kryesisht gjatë natës, do i shtynte autorët potencialë të krimit, të mendoheshin dy herë për veprimin që do kryenin. Në shtetin e New York-ut (SHBA), të tilla masa u morën nga Drejtoria e Policisë dhe rezultuan efektive. Qyteti zbatoi dhe taktika të reja të luftës kundër krimit. Shtimi i numrit të policëve u realizua kur u morën të dhënat e nevojshme të krimit (dhe hartat e zonës) për ato zona që konsideroheshin të nxehta.<sup>10</sup>

- Interes të madh duhet të ketë te planifikimi urban (në Evropë dhe në kontinentin amerikan njihet tashmë me emërtimin “*Crime Prevention through Environmental Design*”) dhe politikat e tij në luftën kundër krimit. Tashmë, mjedisi nuk duhet parë thjeshtë te ndikimi që ka pastrimi i ajrit, por edhe te ndikimi që ai ka në luftën e përditshme kundër krimit.

- Krijimi i qendrave kërkimore në universitete, për studimet e ndryshme në fushat penale në përgjithësi, do ishte një ndër politikat kryesore të njohjes (studimit), luftimit dhe parandalimit të krimit në Tiranë e në gjithë rrethet e tjera të Shqipërisë.

- Aplikimi i “parandalimit të krimit përmes modelit mjedisor”.

- Bashkëpunim më i ngushtë midis institucioneve shtetërore.

- Në uljen e shifrave të krimit dhe në luftën kundër tij, kamerat e vëzhgimit, të sigurisë luajnë një rol kryesor. Sa më shumë të jetë numri i tyre në zona të caktuara të Tiranës dhe më gjerë, duke qenë në harmoni me respektimin e të drejtave te individit, aq më e ashpër do ishte lufta ndaj krimit dhe kapja e autorëve të veprave penale do ishte më e lehtë.

## Bibliografia

1. William H. Sousa dhe George L. Kelling, *Police Innovation; Contrasting Perspectives*, 2019 (Cambridge University Press).
2. Vasilika Hysi, *Kriminologjia*, 2010.
3. Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm “Për gjendjen e kriminalitetit për vitin 2018”, 2019.
4. Alma Bela, *Konferenca 17 Ndërkombëtare e European Society of Criminology*, Cardiff, Wales, UK, 2017.
5. Per-Olof H, *Urban crime, criminals and victims. The Swedish experience in an Anglo-American Comparative Perspective*, 1991.
6. Dr. Frashëri, A., “*Gjeofizika inxhinjerie dhe mjedisore*”, Tiranë, 2012.
7. [http://en.wikipedia.org/wiki/Broken\\_windows\\_theory](http://en.wikipedia.org/wiki/Broken_windows_theory), (përkthim vetjak)
8. *Enhancing urban safety and security global report on human settlements 2007*, Abridged Edition Volume 1, *Reducing Urban Crime and Violence: Policy Directions*, United Nations Human Settlements Programme.
9. Troy, A., Grove, J. M., O’Neil-Dunne, J., “The relationship between tree canopy and crime rates across an urban-rural gradient in the greater Baltimore region”, *Landscape and Urban Planning Journal*, 2012.
10. Editorial, Zimring, E. F., “How to Stop Urban Crime without Jail Time. What cities can learn from NYC’s safest decade”, *The Wall Street Journal*, January 28, 2012.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »



# Zhvillimi i aktivitetit privat në zonën e Fushë-Krujës, pas viteve 1990, burim i problemeve mjedisore



■ **Dr. Manjola XHAFERRI**  
Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës,  
Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike,  
mxhaferr@yahoo.com



■ **Dr. Mirela TASE**  
Universiteti “Aleksandër Moisiu”  
Durrës, Fakulteti i Biznesit  
mirelatase@hotmail.com

## Abstrakt

*Ky punim ka për qëllim të nxjerrë në pah problematikat që ka sot në zonën e Fushë-Krujës, në lidhje me nivelin e lartë të ndotjes së mjedisit, burim parësor i shumë shqetësimeve shëndetësore për banorët e kësaj zone, të cilët përballen çdo ditë me rrezikun e shumë sëmundjeve kryesisht sëmundje tumorale. Fushë-Kruja është një ndër zonat e njohura për nivelin e lartë të ndotjes në Shqipëri. Fabrikat e çimentos, aktiviteti i guroreve të paligjshme dhe furrat e gëlqeres që djegin goma, lëkurë nga fabrikat e këpucëve dhe sende shtëpiake, duken si një mallkim për këtë zonë të varfër. Madje shumë familje janë larguar nga fshatrat, Borizanë, Thumanë, Halil, Cudhi-Zall, Nojë dhe Qerekë për shkak të ndotjes së madhe, kryesisht këto dhjetë vitet e fundit. Aktualisht në zonën e Fushë-Krujës zhvillojnë aktivitetin e tyre ekonomik disa biznese private, të cilat e kanë kthyer në gangrenë çështjen e ajrit. Nëpërmjet këtij punimi do nxjerr problematikat të cilat kanë vite që janë aty por nuk po gjejnë zgjidhje. Sipas banorëve të kësaj zone, por edhe pohimit të strukturave të larta drejtuese, ndotja në zonën e Fushë-Krujës po sfidon shtetin. Megjithëse janë zhvilluar dhjetëra aksione për mbylljen e furrave, ato vazhdojnë aktivitetin në mënyrë ilegale. Pyetja që shtrohet është: Nëse shteti gjunjëzohet përballë këtij fenomeni kaq problematik, kush do përgjigjet për jetën dhe të ardhmen e këtyre banorëve?*

## Fjalëkyçe:

**zhvillim, aktivitet Fushë-Krujë, problem, mjedis.**

## 1. Hyrja

Sfidat e mjedisit janë ato që kanë rritur presionin mbi qeveritë për të gjetur mënyra për të zvogëluar dëmtimin e mjedisit, duke minimizuar dëmin në rritjen ekonomike. Qeveritë kanë një gamë të mjeteve në dispozicion të tyre, duke përfshirë sistemin rregullator, iniciativat e suksesshme në politikat mjedisore, programet informative, subvencionet, taksat mjedisore, etj. Duke u ndalur tek sfidat e ndotjes së mjedisit në zonën e Fushë-Krujës, e cila përbën një ndër zonat me nivelin më të lartë të ndotjes në Shqipëri, duhet thënë se pavarësisht përpjekjeve nga aktorë të ndryshëm shtetëror, por edhe komunitare për minimizimin e këtij fenomeni, rezultatet janë të papërfillshme, pasi sa vjen dhe rëndohet situata e ndotjes mjedisore. Nëse në zona të tjera të vendit problem kryesor janë mbetjet urbane, në Fushë-Krujë mbetjet urbane përbëjnë vetëm një problematikë, pasi ajo përballet edhe me ndotjen nga aktivitetet private që ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në këtë zone.

Inspektimi si nga pushteti qëndro ashtu dhe ai lokal, sot konsiderohet si e vetmja rrugë, i vetmi mjet, i cili duke qenë se ka autoritetin e marrjes së masave administrative apo penale, ndikon drejtpërsëdrejti në mbarëvajtjen e punës dhe minimizimin e abuzimeve që bëhen në mjedis. Ndotja në zonën e Fushë-Krujës është e gjithanshme, dhe siç e theksova më lart, subjektet ekonomike private nëpërmjet veprimtarisë së paligjshme, kryejnë një sërë krimesh mjedisore, duke përfshirë ndotjen e ujit, tokës dhe shkarkimet në ajër. Po ashtu burim i ndotjes mjedisore në mënyrë të drejtpërdrejtë janë edhe mbetjet urbane të cilat pushteti lokal i Bashkisë Krujë i depoziton në vendgroposjen (landfillin) në afërsi të fshatit Halil, ku në mënyrë të papërgjegjshme, këto mbetje digjen gjatë natës, por edhe ditën nga punonjësit e bashkisë, që jo vetëm ndotin ajrin që thithin banorët e zonës dhe fshatrave përreth, por bëjnë të papërdorshme

tokën bujqësore, kullotën për bagëtinë dhe ujin e pijshëm.

## 2. Metodologjia

Metodologjia e përdorur ka konsistuar në kërkimin dokumentar dhe sidomos zhvillimin e pyetësorëve dhe anketave. Nga pikëpamja metodologjike, studimi ka synuar përcaktimin e saktë të bazës së hulumtimit, parametrat matës, si dhe përfundimet e alternativave të përgjigjeve. Formulimi i pyetjeve është bazuar dhe ka ndjekur identifikimin e problematikave, me një gjuhë të thjeshtë, të kuptueshme, me qëllim marrjen e opinionit të grupeve të ndryshme nga komuniteti i anketuar. Studimi u bazua në sondazhin e drejtpërdrejtë me anë të një pyetësori të strukturuar në 10 kategori pyetjesh, që lidhen drejtpërsëdrejti me problematikën e studimit. Si mostër anketimi është zgjedhur forma e thjeshtë e rastit, e konceptuar në: a) gjini, b) arsimim, c) moshë, ç) vendbanim/lagje. Këto elemente sigurojnë një mostër të mjaftueshme dhe gjithëpërfshirëse për përgjigjet e mbledhura, të zotëruara për objektin e hulumtimit, duke siguruar përfaqësimin cilësor dhe sasior të popullsisë, si dhe duke mbajtur nën kontroll konfliktin e interesit apo faktorëve negativë.

Nga ky pyetësor është synuar përmbushja e qëllimit të këtij studimi, njohja me perceptimin e qytetarëve mbi gjendjen e mjedisit në zonën e tyre të banimit dhe sjelljen e tyre qytetare në përfshirjen në nismat vendore. Nisur nga numri i popullsisë (sipas INSTAT, Censurit 2011), bashkia Krujë ka një numër prej afërsisht 59 814 banorë dhe, mostra e marrë është mbi 100 pyetësor, që ka për qëllim:

- sigurimin se karakteristikat e të intervistuarve dhe të mostrës së përzgjedhur për studim përmbushin objektivat e studimit;
- të krijojë besueshmërinë dhe efektivitetin e metodologjisë së përdorur;
- të qartësojë problematikën e trajtuara për pjesëmarrësit në pyetësor;
- të marrë përgjigjet e pyetësorëve të zhvilluar në komunitet;
- të ndihmojë në analizën e gjetjeve për realizimin e punimit për të cilin u zhvillua pyetësori.

## 3. Vështrim i përgjithshëm i rrethit të Krujës

### a. Pozicioni gjeografik dhe organizimi administrativ i rrethit Krujë

Rrethi i Krujës gjendet në pjesën qendrore-perëndimore të territorit të Republikës së Shqipërisë. Zona kodrinore ka një lartësi 100-300 m lartësi mbi nivelin e detit. Zona malore përbëhet nga dy vargje paralele me drejtim veriperëndim dhe juglindje. Vargu Krujë-Dajt dhe vargu Skënderbej (maja e Liqenit që është dhe maja më e lartë e rrethit Krujë).<sup>1</sup> Zona fushore shtrihet në perëndim midis kodrave të Ishmit – Prezë, Tapizë, Krastë Krujë. Bashkia ka si qendër qytetin e Krujës, që shtrihet në faqen perëndimore të malit të Krujës me një lartësi 600m mbi nivelin e detit. Pas ndarjes së re territoriale Bashkia Krujë ka 6 njësi administrative, 2 qytete dhe 50 fshatra, të shtrirë në një sipërfaqe prej 339.02 km.

### b. Demografia<sup>2</sup>

Popullsia në Bashkinë Krujë ka një numër prej 59 814 banorë dhe dendësi 176.43

<sup>1</sup> Të dhëna të marra nga Bashkia Krujë.

<sup>2</sup> Burimi: INSTAT për 2011 dhe zyra e gjendjes civile në Bashkinë Krujë.

banorë/km<sup>2</sup>, ndërsa sipas regjistrit të gjendjes civile 80,870 banorë. Ky ndryshim i madh flet për dukurinë e emigracionit dhe lëvizjeve të popullsisë që nga 1989, që ndikon në mosparaqitjen e gjendjes reale të popullsisë. Migrimi i brendshëm ka ndodhur nga zonat periferike drejt qendrave urbane dhe zonave me qasje në infrastrukturë.

Shtesa natyrore e popullsisë deri në vitet '90 ka qenë e lartë falë politikave sociale dhe ritmeve të larta të lindshmërisë, të shoqëruara nga ulja e vazhdueshme e treguesve të vdekshmërisë. Pas viteve '90 vihet re një ulje e ndjeshme e nivelit të lindjeve. Shkak kryesor është migracioni i theksuar për moshën 20-35 vjeçare, ndryshimi i mentalitetit dhe ndryshimi i nevojës për krahe pune në bujqësi. Një faktor tjetër i uljes së lindjeve, është edhe numri i lartë i vdekjeve vitet e fundit, rezultat i aksidenteve, por dhe prekja nga sëmundje të pashërueshme, në mosha shumë të reja.

**Tabela 2. Popullsia e rrethit Krujë 2011-2016**

Vitet	Krujë	F. Krujë	Cudhi	Nikël	Bubq	Thumanë
2011	11,721	18,477	1,812	9,518	5,951	12,335
2016	16,342	26,277	3,099	10,219	8,617	16,253

Nga të dhënat e mësipërme, vihet re një rritje të numrit të banorëve në të gjitha njësitë administrative.

Shifrat tregojnë një rritje prej rreth 5.3% të popullsisë në 22 vite me një mesatare vjetore rreth 0.24%. Megjithatë studimet tregojnë që Bashkia Krujë ka tendenca për të mos pësuar rritje të konsiderueshme të popullsisë, duke ruajtur kryesisht numrin aktual të popullsisë, ose duke u reduktuar në zona të caktuara (zonat e thella) dhe do të vazhdojë të ketë lëvizje të brendshme popullore nga zonat e thella drejt qendrave ekonomike, atyre të shërbimeve dhe infrastrukturës.

*- Aktivitetet ekonomike që operojnë në Bashkinë Krujë*

Lloji	Aktiviteti	Nu mri
Biznes i Vogël	Tregti	680
	Shërbime	254
	<b>Total</b>	<b>934</b>
Biznes i Madh	Ndërtim	30
	Tregti	150
	Shërbim	50
	Prodhim dhe faqosje këpuce	10
	Prodhim druri	15
	Prodhim inertesh	2
	Shfrytëzim burimesh natyrore	1
	Ndërtim linje prodhim e shitje sheqeri	1
	Prodhim energjie	1
	Prodhim çimento	1
	Përpunim mermeri	1
	Gurore	42
	Të tjera	27
	<b>Total</b>	<b>331</b>

Aktivitet kryesore ekonomike janë përqendruar përgjatë rrugës nacionale midis njësisë administrative Fushë-Krujë dhe Krujë; si dhe fasone të përqendruar rreth qytetit të Krujës. Aktualisht, tokat bujqësore zënë rreth 40% të territorit të së gjithë bashkisë, megjithatë prodhimet aktuale janë nën potencialin e tyre. Ndër aktivitetet ekonomike, një përqindje të madhe zënë ato që shfrytëzojnë drejtpërdrejt pasuritë natyrore, si p.sh.: guroret dhe pikat e shfrytëzimit të inerteve. Sektor tjetër i rëndësishëm është ai i industrive përpunuese, si ajo e çimentos, drurit, mermerit, përpunimit të sheqerit, etj. Ndërkohë që industritë përpunuese ushqimore, tradicionale për zonën, si fabrika e zhveshjes së orizit, e çembrionizimit të misrit, e tharjes së prodhimeve bujqësore, janë tashmë jashtë funksionit. Aktualisht, në Bashkinë e Krujës janë vendosur 1 265 aktivitete ekonomike, nga të cilat 934 janë biznese te vogla dhe 331 biznese të mëdha.

*- Krimi mjedisor dhe mosndëshkimi. Kuptimi i veprave penale në fushën e mjedisit*

Mosndëshkimi i krimit mjedisor është shkaktari kryesor që po na vret të gjithëve çdo ditë, paçka, se duket sikur, nuk na prek neve asnjë pemë që pritet, asnjë zog që nuk ka më ku të qëndrojë, asnjë peshk në ujën e lumit tërësisht të kontaminuar, asnjë fëmijë apo i rritur që lufton çdo ditë me sëmundjen e tmerrshme që e gllabëron pak e nga pak, deri sa përfundon me një fund tragjik, “nuk i mbijeton”. Ndëshkimi i krimit mjedisor është metoda më efikase për ruajtjen e mjedisit që na rrethon. Krimi mjedisor në Republikën e Shqipërisë, prej vitesh tashmë është i formatuar, si nga ana e parashikimeve ligjore për parandalimin dhe ndëshkimin e veprave të kësaj fushe, ashtu edhe nga lloji i veprave penale që janë shfaqur dhe shfaqen çdo ditë me evoluimin e shoqërisë në përgjithësi dhe të teknologjisë në veçanti.

#### *a. Evolucioni i legjislacionit shqiptar në fushën e mjedisit*

Legjislacioni mjedisor përpara viteve ‘90 ka qenë i varfër. Nuk mund të flitej për ligje të veçanta mjedisore. “Në këtë periudhë nuk njihen personat juridik privat pra ndotësi më i madh ishte shteti. Shteti i kushtonte më shumë rëndësi prodhimit se sa ndotjes pasi ndotja shfaqej më vonë deri sa shteti e harronte atë”<sup>3</sup>.

Para viteve ‘90 veprat penale në fushën e mjedisit nuk ishin të parashikuara në ndonjë kapitull të veçantë sikundër janë sot. Kështu, në Kodin Penal të mëparshëm (miratuar me ligjin nr. 5591, datë 15.6.1977 dhe ndryshuar me ligjin nr. 6300, datë 27.03.1981) parashikohet në nenin 170 “Shkelja e dispozitave mbi karantinën e bimëve”, në nenin 173 “Prerja e paligjshme e pyjeve ose dëmtimi i tyre” si edhe “Peshkimi i paligjshëm”, në nenin 174. Janë vetëm këto tre veprat penale kundër mjedisit të parashikuara nga ky kod.

Mbrojtja “e vërtetë” juridiko-penale e mjedisit garantohet nga legjislacioni penal pas viteve ‘90 ku u parashikua një krë i veçantë për veprat penale kundër mjedisit në nenet 201-207. Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë janë parashikuar figura konkrete të veprave penale kundër mjedisit si edhe dënimet përkatëse për autorët e këtyre veprave penale. Veprat penale kundër mjedisit janë parashikuar në kreun IV të Kodit

<sup>3</sup> Për më gjerë shih: Sazan Guri, Marianthi Guri, Kristo Koçi E drejta mjedisore - Bazat e legjislacionit krahasimor mjedisor shqiptar e evropian, Tiranë 2010.

Penal aktual, e përkatësisht: neni 201: ndotja e ajrit; neni 202: transportimi i mbeturinave toksike; neni 203: ndotja e ujërave; neni 204: peshkimi i ndaluar; neni 205: prerja e paligjshme e pyjeve, neni 206: prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë, neni 206/a: shkatërrimi me zjarr i pyjeve; neni 206/b: shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor; neni 207: shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve. Dy vepra te reja penale “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve” dhe “Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor” i janë shtuar këtij kreu, me ndryshimet e fundit që ka pësuar Kodi Penal me ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008 (neni 22 i këtij ligji).

Kapitulli i IV i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, rregullon dhe standardizon veprat penale në fushën e mjedisit. Në këndvështrim të studimeve të bëra si nga Ministria përgjegjëse për Mjedisin, ashtu edhe nga progres-raporti, kapitulli 27, “Mjedisi”, veprat penale të sipërcituara, jo vetëm që nuk janë të plota për kohën në të cilën jemi, për kërkesat dhe standardet mjedisore që duam të arrijmë, por nuk mund të arrijnë ndëshkimin e pjesës më të madhe të autorëve të veprimeve dëmtuese të mjedisit, pasi këto vepra janë të përgjithshme dhe nuk përmbledhin tërësinë e problematikave vendase dhe prirjeve ndërkombëtare.

Veprat penale në fushën e mjedisit, referuar Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, sikurse e cituam edhe më sipër, në kreun IV, të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, të ndryshuar, janë listuar si veprat penale kundër mjedisit.

Ky listim fillon me *nenin 201* “Ndotja e ajrit” ku sanksionohet se “Ndotja e ajrit përmes çlirimit të tymrave, gazrave dhe lëndëve të tjera toksike radioaktive e bërë tej kufirit të normave të lejuara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet.”

Nëse i referohemi masave të marra, deri më sot kjo, vepër penale nuk ka pasur asnjë të proceduar të dënuar, jo se nuk ka pasur në praktik raste të kësaj lloji ndotjeje, por sepse nuk ka, ose nuk funksionon në vendin tonë asnjë lloj laborator i qëndrueshëm ose i lëvizshëm, i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, i cili të mund të bëjë me aparaturë bashkëkohore matjen e elementeve të mjedisit në këtë kontekst. Pra referuar praktikës penale, prova që do të dënonte penalisht dëmtuesin e këtij rasti duhet të jetë analiza laboratorike, e cila aktualisht është e pamundur për t’u realizuar. Përpos kësaj, të evidentosh një dëmtues të kësaj natyre, me përjashtim kur kjo ndotje është e dukshme vizualisht që po del në formë tymi, p.sh. nga një instalim, është shumë e vështirë, për të mos thënë që është e pamundur në mungesë të aparaturave dhe laboratorëve fiziko-kimik të posaçëm për këtë lloj ekspertize.

Në *nenin 202* “Transportimi i mbeturinave toksike”, parashikohet se “Transportimi tranzit apo depozitimi në territorin shqiptar të mbeturinave toksike dhe radioaktive, dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.”

Në *nenin 203* ku trajtohet “Ndotja e ujërave”, parashikohet se “Ndotja e ujërave të deteve, lumenjve, liqeneve apo burimeve të rrjetit grumbullues e shpërndarës të ujërave me lëndë toksike, radioaktive apo substanca të tjera, që prishin ekuilibrin ekologjik, dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.”

Në *nenin 204*, ku trajtohet “Peshkimi i ndaluar”, parashikohet se “Peshkimi në kohë, me mjete, vende dhe mënyra të ndaluara përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj. Peshkimi i kryer me mjete të rrezikut të përbashkët si eksploziv, lëndë helmuese, etj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.” Në *nenin 205* ku trajtohet “Prerja e paligjshme e pyjeve” parashikohet se “Prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.” Prerja e pyjeve, tashmë me shpalljen e moratoriumit në pyje me ligj të veçantë, ka edhe një dënim tjetër administrativ që arrin në 5 000 000 lekë. Në asnjë nga dispozitat, as atë penale as atë administrative, nuk bëhet një ndarje mes dënimeve për individ dhe për shoqëri shfrytëzimi. Nuk ka një ndarje për sasi të materialit drusor të prerë etj. Këto gjëra e bëjnë thuajse të pazbatueshme këtë dispozitë.

Në *nenin 206*, ku parashikohet “Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë”, parashikohet “Prerja e drurëve dekorativë dhe dëmtimi i lulishteve dhe parqeve nëpër qytete përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë. Prerja e drurëve në pemëtore, ullishta e vreshta, pasi është refuzuar më parë leja e prerjes nga organet kompetente, përbën kundërvajtje penale e dënohet me burgim gjer në tre muaj.” E njëjta logjikë vlen edhe për këtë dispozitë si dispozita e sipërcituar. Gjithsesi është mirë që është parashikuar një dispozitë e tillë sepse jep një mbrojtje specifike kësaj kategorie pyjore.

Në *nenin 206/a* ku trajtohet “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor” që është amedim i bërë nga nevoja në praktikë me anë të ligjit nr. 10 023, datë 27.11.2008 dhe me anë të ligjit nr. 144, datë 2.5.2013, parashikon se:

“Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet. Po kjo vepër, e kryer me qëllim ndryshimin e kategorisë dhe destinacionit të tokës, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkakton dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.”

Në *nenin 206/b* ku trajtohet “Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor” që është amedim i bërë nga nevoja në praktikë me anë të ligjit nr. 10 023, datë 27.11.2008 dhe me anë të ligjit nr. 144, datë 2.5.2013, parashikohet se: “Shkatërrimi apo dëmtimi nga pakujdesia, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkakton dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.” Si në *nenin 206/a* ashtu edhe në *nenin 206/b*, është bërë një ndërhyrje cilësore ligjore, por që do të ishte shumë mirë që të zbatohet në praktikë. Sikurse e citoj edhe në pjesë të tjera të këtij studimi, pyjet dhe mjedisi në tërësi nuk duhet të trajtohen si “të huaja”, por duhet të trajtohen si “të tonat” që të mund të kemi një mbrojtje cilësore e për pasojë të kemi një zhvillim të qëndrueshëm në një mjedis të shëndetshëm.

Në *nenin 207*, ku trajtohet “Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve” parashikohet se “Shkelja e rregullave për karantinën e bimëve apo të kafshëve, kur ka sjellë pasoja të rënda materiale ose që rrezikojnë jetën e shëndetin e njerëzve, përbën

kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.” Kjo lloj vepre është shumë e rëndësishme për t’u pasur parasysh me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njerëzve mbi të gjitha. Shpesh emisione investigative në vend kanë denoncuar raste të trajtimit për produkte ushqimore të kafshëve të sëmura ose të kafshëve-kufomë (të ngordhura) pas përmytjeve masive të zonave të ndryshme në vend.

Kjo vepër penale, me një inspektim cilësor do të çonte përpara drejtësisë shumë tregtar gjedhësh apo produktesh mishi, por në bazat e të dhënave të Policisë së Shtetit e të Prokurorisë së Përgjithshme, këto procedime janë thuajse joekzistuese.

## 4. Gjendja e përgjithshme mjedisore për Bashkinë e Krujës

Udhëtimi drejt Krujës ka disa stacione të rëndësishme natyrore, arkeologjike dhe historike. Përveç kësaj aty zhvillojnë aktivitetin e tyre dhe disa ndërmarrje industriale. Është e pamundur të udhëtosh për në Krujë e të mos vëresh zhdukjen e pyjeve të mrekullueshëm me pisha përgjatë rrugës. Shpyllëzimi është një faktor që ndikon në mjedis, dhe nëse i referohemi Bashkisë Krujë në rrugën nacionale Fushë-Krujë – Krujë, shihet qartë se nga veprimtaria e guroreve nga Zona e Halilit deri në krastë kanë bërë masakër dhe po bëjnë ende në zhdukjen e një pjese të pishave që ndikon jo vetëm në reduktimin e gjelbërimit, por edhe në prishjen e bukurisë natyrore. Çdo turist i huaj që viziton qytetin e Krujës e vë re me sy të lirë dhe e komenton negativisht këtë fenomen.

Ndotësi kryesor ndër vite është cilësuar aktiviteti i furrave të shuarjes së gëlqeres duke ndikuar drejtpërsëdrejti në tokë, ujë dhe ajër. Prania e gropave të gëlqeres në Krujë ka qenë një problem serioz prej vitesh jo vetëm për degradimin e mjedisit, shëndetin e njerëzve, por edhe për cilësinë e tyre të jetesës. Këto aktivitete veprojnë në mënyrë të pakontrolluar duke mos respektuar asnjë normë për mbrojtjen e mjedisit. Në vitin 2013 dhe 2017 janë kryer aksione për mbylljen e këtyre aktiviteteve, pasi u cilësuan si tejet ndotës dhe krejtësisht jashtë standardeve të përcaktuara në legjislacionin mbi mjedisin. Megjithatë një pjesë e mirë e tyre vazhdojnë ende sot në mënyrë të paligjshme brenda zonave të banimit, ku as pushteti lokal dhe as ai qendror, nuk arrijnë t’i kontrollojnë dhe për më tepër t’i eliminojnë.

Guroret duke qenë se operojnë afër burimeve ujore çojnë drejtpërsëdrejti në ndryshimin e cilësisë së ujit të pijshëm për shkak të filtrimit në thellësi të ujërave të shpëlarjes që përdoren në gurore, si dhe ndotësve të tjerë. Gjithsesi, ndikimi më i dukshëm është ai i ndryshimit të peizazhit dhe cilësia e ajrit.

E ndërsa disa familje krutane e kanë të vetmen mënyrë jetese punën në këto gurore, nuk ndodh të jetë kështu me fabrikat e çimentos. Projektuar sipas “standardeve evropiane”, këto fabrika jo vetëm që kanë mbjellë pakënaqësinë e banorëve për ndotjen e kryer, por ato janë bërë shpesh shkak i efekteve të tjera si, dëmtimi i ujësjellësit dhe burimeve të ujit. Bashkia Krujë në territorin e saj ka dy fabrika çimentoje, duke çliruar kështu sasi të konsiderueshme të CO<sub>2</sub>-së, SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>-it dhe në rritjen e sasisë së grimcave të pluhurit në ajër. Në Bashkinë Krujë ka fabrika tullash, të cilat, në rast se nuk monitorohen në mënyrën të vazhdueshme mund të jenë burim ndotjeje për mjedisin përreth. Në Bashkinë Krujë është shumë i zhvilluar biznesi fason për prodhimin e këpucëve apo të produkteve të ngjashme prej lëkure. Edhe pse produktet importohen të përgatitura vetëm për montim, është i nevojshëm trajtimi i efluentëve të këtyre industrive, të cilat janë të pasura me tretës apo kimikate të tjera. Nëse hedh një sy dhe




vëren se si janë kushtet brenda fabrikave, duket qartë, se nuk plotësojnë asnjë standard që të mbrojë shëndetin e punëtorëve edhe pse këto janë potencial ekonomik për pushtetin lokal, por edhe për punësimin e mbi njëmijë punëtorëve, të cilët nuk kanë mundësi të tjera punësimi.


Aeroporti “Nënë Tereza” përbën një nga burimet më të mëdha gjeneruese të ndotjes së ajrit, kryesisht nëpërmjet emetimit të gazeve serrë, si pasojë e përdorimit të sasive të mëdha të karburantit (kerosen). Duke marrë secilin nga këto element, vërehet qartë se Kruja, Fushë-Kruja dhe 50 fshatra që rrethojnë janë tejet të rrezikuar jo vetëm në përkthim të thjeshtë mjedisor, por më shumë në burime njerëzore. Duke u nisur nga intervistat dhe pyetësorët e realizuar në terren vërejmë se ndodhemi përballë një situ-ate dramatike në rrethin e Krujës, siç shprehet edhe një banor i kësaj zone, “askush nuk po bën asgjë, as pushteti lokal, por as edhe vetë ne komuniteti që jetojmë këtu, ku përballemi me këtë katastrofë mjedisore që po na vret përditë neve, por sidomos të ardhmen e fëmijëve tanë”.

Duke u ndalur më konkretisht në përgjigjet e dhëna nga pyetësori, që si pika referimi ka pasur disa nga zonat më të rrezikuara të rrethit Krujë, si Thumanë, Borizanë, Fushë-Krujë, Halil, Zallë dhe Krujë. Siç e kam shprehur dhe më lart pyetësori është i hartuar me 14 pyetje ku dhjetë pyetje janë të lidhura drejtpërsëdrejti me problematikën e marrë në studim.

Nga analiza e bërë e 100 pyetësorëve rezultojnë 60% femra dhe 40% meshkuj. Numri më i madh i të anketuarve ishte mosha 60-69 vjeç me 40%, ndër të cilët pjesa më e madhe janë me arsim të mesëm 45%, me arsim të lartë 30%, pasuniversitar, master, doktoraturë 15% dhe arsim 9-vjeçar 10%, (grafiku 1,2).

**Grafiku 1. Të dhënat sipas grupmoshave**






Grafiku 2. Të dhënat sipas arsimimit

Në lidhje me shpërndarjen e pyetësorëve në bazë të vendbanimit; zone urbane, gjysmëurbane dhe rurale nga përgjigjet e marra rezultojnë 60% e të anketuarve janë zone rurale, 15% zonë gjysmëurbane dhe 25% zone urbane. Ndërsa për sa i takon pyetjes sa kohë jetojnë në këtë zone, në bazë dhe të përgjigjeve rezultojnë se 40% janë vendas (autoktonë), 30% janë këtu për më shumë se një shekull, gjysmëvendas dhe gjysmë të ardhur siç shprehen ato dhe 30% e tyre janë të vendosur këtu pas viteve '90.


Duke u ndalur te problematika e ndotjes mjedisore, pyetja si është situata në zonën tuaj, nga përgjigjet e banorëve rezultojnë se 80% e tyre shprehen problematike, 20% pak problematike dhe 0% aspak problematike. Në bazë të përgjigjeve banorët e kësaj zone, pranojnë se jetojnë përditë në një zonë problematike me përqindje të lartë rrezikshmërie për shëndetin e tyre. Më poshtë do pasqyrojmë grafikët 3 dhe 4 në lidhje me pyetjet e sipërpërmendura: *sa është problematike zona juaj dhe cilat janë moshat më të rrisuara.*

Grafiku 3. Si është situata në zonën tuaj për sa i përket ndotjes mjedisore?




Pyetjes se “cilat janë moshat më të rriskuara” nga përgjigjet rezulton se 40% e të anketuarve shprehen se më të rriskuar janë mosha 0-15 vjeç, 50% janë mosha 15-64 vjeç dhe 10% mosha mbi 64 vjeç.

**Grafiku 4. Cilët janë moshat më të rriskuara nga ndotja mjedisore**



Për pyetjen, “a mund të përdoret toka në zonën tuaj për produkte bujqësore apo është e kontaminuar”, nga përgjigjet e marra rezulton se 35% shprehen se është e përdorshme dhe 65% është e pa përdorshme. Më poshtë do të paraqesim grafikun me përgjigjet e dhëna.

**Grafiku 5. A mund të përdoret toka në zonën tuaj për produkte bujqësore apo është e kontaminuar?**




Një pyetje tejet e rëndësishme në lidhje me njohjen e dispozitave ligjore që veprojnë kundër ndotjes mjedisore, nga përgjigjet e marra rezulton se 35% e tyre shprehen për një nivel të ulët njohës, 50% shprehen për nivel mesatar njohës të dispozitave ligjore dhe vetëm 15% e tyre njohin shumë mirë bazën ligjore që vepron kundër ndotjes mjedisore.


Nga ana tjetër, për pyetjen se, “cila është alternativa më e përshtatshme në lidhje me mbrojtjen mjedisore”, nga përgjigjet e marra rezulton se 15% e të anketuarve shprehen se duhet të ketë një monitorim dhe ndëshkim pa rezerva nga shteti në përputhje me

dispozitat ligjore në Shqipëri, ndërsa 85% janë të mendimit se duhen ndryshuar dispozitat ligjore në fuqi dhe përfshirja e akteve ligjore me ndëshkime më të ashpra, deri në dënime kapitale. Më poshtë do paraqesim dy grafikë në lidhje me pyetjet a vepron pushteti lokal në përputhje me standardet mjedisore për mënyrën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në këtë zonë dhe nga përgjigjet rezultojnë se 30% përgjigjen pozitivisht “po” dhe 70% përgjigjen negativisht, “jo”. “A ka reaguar komuniteti kundër pushtetit lokal” është tjetër pyetje ku përgjigjet kanë qenë: 80% pak, 20% mjaftueshëm dhe 0% shumë.

**Grafiku 6. A vepron pushteti lokal në përputhje me standardet mjedisore për mënyrën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta?**




**Grafiku 7. A ka reaguar komuniteti kundër pushtetit lokal?**



Pyetjes a duhet të ndikojë komuniteti në vendimmarrjen për vendosjen e modeleve të reja për ruajtjen dhe përkujdesjen ndaj mjedisit nga përgjigjet e dhëna rezultojnë se 100% janë përgjigjur pozitivisht po, që do të thotë se komuniteti duhet të jetë një aktor i rëndësishëm në vendimmarrje por edhe duhet të kontribuojë më shumë për ruajtjen dhe përkujdesjen e tij. Më poshtë do paraqesim grafikun me përqindjet e përgjigjeve të pyetjeve.

**Grafiku 8. A duhet të ndikojë komuniteti në vendimmarrjen për vendosjen e modeleve të reja për ruajtjen dhe përkujdesjen ndaj mjedisit?**



Duke u nisur nga përgjigjet pyetësorit, vëmë në dukje se ndotja mjedisore sa vjen dhe bëhet problematike dhe se komuniteti e ndien veten të kërcënuar duke marrë parasysh edhe indiferencën e pushtetit lokal, ku nuk zbatohen siç duhet dispozitat ligjore dhe për më tepër s’ka baza koordinuese midis pushtetit lokal dhe atij qendror. Kur flasim për përgjegjësi, kuptohet qartë që asnjëri prej tyre s’mban përgjegjësi, por ja delegon përgjegjësinë një institucioni tjetër. Siç e përmenda më lart, problematike paraqitet edhe menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane, ku 81% e të anketuarve mendojnë se mbetjet janë problem për ndotjen mjedisore. Këtë e vërtetojnë edhe fotot e pasqyrua më poshtë, të realizuara në vendet e depozitimeve të mbetjeve urbane të kësaj bashkie.



**Foto e realizuar në fshatin Halil në vendin e depozitimeve të mbetjeve urbane të Bashkisë Krujë.**



Foto e shkrepur ku duken qartë afërsia e qendrës së banimit me vendin e depozitimit të mbetjeve urbane.



Foto të realizuara në krastën e Krujës ku duken qartë shpyllëzimi nga aktiviteti privat i inerteve që zhvillohet në këtë zonë.



## 5. Konkluzione dhe rekomandime

Në mbyllje të këtij punimi do të sugjeroja disa rekomandime, ku pushteti lokal, por dhe komuniteti, duhet të kontribuojnë në minimizimin dhe ruajtjen e mjedisit.

*Së pari*, bashkia duhet të vazhdojë përpjekjet për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe sidomos të atyre bizneseve industriale që shkaktojnë ndotje përtej normave të lejuara si rezultat edhe i mospërdorimit të filtrave apo të teknologjisë më të mirë të vlefshme.

*Së dyti*, inspektorët e mjedisit në këtë bashki të ndjekin nga afër raportet e vetëmonitorimit për shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë. Për këtë duhet edhe një bashkëpunim më i mirë me drejtoritë rajonale të mjedisit dhe Inspektoratin e Mjedisit. Mbetet detyrë parësore sidomos për vazhdimin e monitorimit edhe pas mbylljes së guroreve apo aktiviteteve karrierë që janë shumë pranë zonave të banuara.

*Së treti*, pushteti lokal duhet të ketë kontroll të vazhdueshëm për mbrojtjen e pyjeve të Krastës nga abuzimet e prerjeve, zjarret dhe dëmtimet e çfarë do lloji.

*Së katërti*, bashkia duhet të gjejë zgjidhje për vendqëndrimin e mbetjeve urbane në fshatin Halil dhe t'i japë fund djegieve të mbetjeve gjatë natës dhe ditës, gjë që përbën një problem serioz për shëndetin dhe jetesën e banorëve të kësaj zone.

*Së pesti*, komuniteti i zonës së Fushë-Krujës duhet të jenë më aktivë dhe më kërkues në politikëbërjen dhe vendimmarrjen e nismave për gjetjen e zgjidhjeve afatgjata në bashkëpunim me pushtetin vendor, por edhe struktura të tjera drejtuese në funksion të mbrojtjes mjedisore. *Së gjashti*, informim dhe përfshirje të qytetarëve në raste katastrofash mjedisore nga pushteti lokal.

## Bibliografia

1. Afrida Domnori, Valbona Mazreku, *Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane në bashkinë Krujë*, LevizAlbania, 2019.
2. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*.
3. *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*.
4. *Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë*.
5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave <http://www.moe.gov.al>
6. Sazan Guri, Marianthi Guri, Kristo Koçi, *E drejta mjedisore*, Tiranë 2010.
7. Progres Raporti i Monitorimit për Shqipërinë 29 mars 2015, kapitulli 27 "Mjedisi"
8. Projekti "Reforma në mjedisin e biznesit dhe fuqizimin institucional" (beris) maj-tetor 2008.
9. Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis nga shfrytëzimi i gurit gëlqeror, Zona Nr 373/3, rrethi Krujë, Qarku Durrës, 2014.



---

## **AKADEMIA E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »**



# Ndotja akustike dhe aspektet ndikuese: rasti i Durrësit



■ **Dr. Piro TANKU**  
Universiteti “  
Aleksandër Moisiu” Durrës  
[piro.tanku@gmail.com](mailto:piro.tanku@gmail.com)



■ **Prof. Asc. Dr. Gaqo TANKU**  
Universiteti  
“Aleksandër Moisiu” Durrës  
[gaqotanku@hotmail.com](mailto:gaqotanku@hotmail.com)

## Abstrakt

*Industria e turizmit po zhvillohet nga viti në vit me ritme të shpejta. Me synim përmirësimin e mëtejshëm, marrin rëndësi edhe masat për uljen e ndotjes akustike. Në këtë këndvështrim, ndotja akustike mund të konsiderohet problem i rëndësishëm, veçanërisht gjatë muajve të verës, kohë kur është edhe fluksi më i madh turistik. Vendimi nr. 587 cakton detyra dhe për strukturat vendore të Policisë së Shtetit, për të mbështetur Inspektoratin e Mjedisit në drejtim të kontrollit dhe monitorimit të emetimit të zhurmave dhe të zbatimit të orareve nga aktiviteti i lokaleve me muzikë. Nga sa më sipër, edhe komunikimi në gjuhë të huaj (anglisht) i punonjësve të policisë kërkon vëmendjen e duhur. Punimi është një përpjekje modeste për trajtimin dhe ofrimin e zgjidhjeve të problematikave të sipërcituara.*

## Fjalëkyçe:

**trafiku i rëndë, zhurmat, punonjësi i policisë, menaxhimi i mjedisit, gjuha angleze.**

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

“ Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare ”

## 1. Hyrje

Vendi ynë ka bërë progres në fushën e mjedisit, të cilat janë shprehur në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të legjislacionit dhe zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit. Kushtetuta e Shqipërisë e konsideron zhvillimin e qëndrueshëm të mbrojtjes së mjedisit dhe të turizmit si një nga objektivat kryesore të qeverive. Ligji i viti 2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” siguron bazat ligjore në drejtim të mbrojtjes së mjedisit. Në këtë drejtim janë miratuar mjaft akte ligjore specifike, të cilat normojnë procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, në drejtim të cilësisë së ajrit, të ujit, të menaxhimit të mbetjeve, si dhe të ndotjes akustike të mjedisit.

Lidhur me problemin e ndotjes akustike, janë miratuar disa akte ligjore, si ligji nr. 9774, dt. 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrim e zhurmës në mjedis”, VKM nr. 587, dt. 7.7.2010 “Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane e turistike”, udhëzimi i përbashkët nr. 8, dt. 27.11.2007 i Ministrisë së Shëndetësisë dhe asaj së Turizmit “Për nivelet kufi të zhurmave në mjediset e caktuara”.

Mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi përbën një përparësi kombëtare dhe detyron për të gjitha organet shtetërore, të personave fizikë e juridikë, vendas dhe të huaj që ushtrojnë aktivitet e veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Masat e mbrojtjes nga zhurma përbëjnë tërësinë e ndërhyrjeve dhe të veprimeve që merren ndaj burimit të zhurmës, duke e sjellë atë në nivelin kufi. Për të përmbushur këtë qëllim përdoren pajisje teknologjike që lëshojnë zhurma në nivele të ulëta. Për më tepër, përzgjidhet vendi i duhur ku bëhet instalimi dhe funksionimi i pajisjeve që lëshojnë zhurmë, të cilat të garantojnë nivelin kufi në të gjitha mjediset që ndikohen prej saj. Rëndësi marrin edhe zbatimi me korrektësi i masave parandaluese e zbutëse të zhurmës në pikën e lëshimit dhe përgjatë rrugëve të përhapjes e në mjediset që ndikohen prej saj.

Këto masa ndërmerren në bazë të matjes, llogaritjeve dhe monitorimeve të nivelit të zhurmës. Qëllimi është mbrojtja e shëndetit dhe mjedisit nga zhurmat, duke përcaktuar mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme përfshi bezdinë nga zhurmat.

Në ditët e sotme, ndotja nga zhurmat konsiderohet si një nga problemet kryesore të komuniteteve urbane të cilat kanë efekte shumë të rrezikshme në ambientin urban dhe mund të rezultojë në një kosto të madhe për shoqërinë (Martin et al., 2006; Chien dhe Shih, 2007). Trafiku mund të konsiderohet si burimi kryesor i ndotjes përmes zhurmës në qytetet e mëdha (Jamarah et al., 2006 dhe Murthy et al., 2007). Studiuesit kanë arritur në përfundimin se efektet e zhurmës kufizojnë memorien episodike (Enmarker, 2004). Krahas popullsisë që pushon edhe punonjësit e policisë janë më të prekurit, pasi janë të ekspozuar ndaj këtij faktori të rrezikshëm gjatë orëve të tyre të punës e për më tepër kur punojnë me orar të zgjatur.

Muzika me tone të larta në bare dhe jo vetëm gjatë mbrëmjeve, thuajse është e pranishme kudo. Edhe nëse u kërkon me mirësjellje që mundësisht të ulet tonaliteti, përgjigja është e gatshme: “Kemi porosi nga pronari pasi klientët nuk duhet të dëgjojnë njëri tjetrin gjatë konsumimit të kafes pasi tavolinat janë afër”.

Nisur nga fakti se vendndodhjet e hoteleve përgjatë plazhit përshkohen edhe nga arteriet kryesore rrugore, ku ka qarkullim të dendur mundësitë e ndotjes si efekt i zhurmave rritet edhe më shumë. Sirenat e trenave, boritë e makinave, tonet e larta të muzikës, janë të pranishme duke krijuar probleme shëndetësore në vend që të rigjenerojnë aftësitë për punë. Si rezultat i zhurmave në disa pjesë të qyteteve mund të çojë në efekte afatgjata dhe të pakthyeshme shëndetësore për qytetarët.

Referuar kronikës së televizionit *Top Channel*, të datës 4 tetor 2019, lidhur me ndotjen në Tiranë, qytetarët reagojnë si më poshtë: “Nëse jeton në Tiranë detyrohesh të bashkëjetosh me zhurmat e tmerrshme të *strip-klubeve*. Vendet e argëtimit për meshkujt gjendjen në çdo cep të kryeqytetit; zonat më të preferuara janë ato të mbipopulluara. Për të hapur një biznes të tillë argëtues për gjininë mashkullore, duhet të pajisesh me leje mjedisore të *Tipit C* nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit”.

Kërcimi i balerinave erotike zakonisht bëhet në bodrumet e pallateve; biznese të tillë pothuajse nuk ekzistojnë në periferi të Tiranës, aty ku nuk mund të shqetësojnë askënd. Ndërsa një grup i vogël individësh argëtohen, për banorët e zonës një jetesë e tillë është kthyer në makth. “Është tmerr të jetosh në një vend të tillë. Vuajmë shumë, është zhurmë e tmerrshme”, – tha një qytetar. “Nuk do doja kurrë që poshtë pallatit tim të kishte biznese të tillë, nuk është e moralshme”. “Vajza ime është vetëm 17 vjeçe, nuk do më vinte mirë që të jetonte në një ambient të tillë. Biznese të tilla bëjnë mirë të ngrihen jashtë qytetit dhe të kontrollohen”, – tha një tjetër. Shumë biznese nuk kanë të shënuar logon e *stripit*, ato kamuflohen si bare, që ofrojnë muzikën *live* të këngëtarëve të muzikës së tallavasë, por në vende të tilla ka kërcimtare nate.

## 2. Metodologjia

Për përgatitjen e këtij studimi janë përdorur metoda sasiore dhe cilësore, janë organizuar intervista me punonjës të rajonit të policisë dhe drejtues të tyre, në qytetin dhe plazhin e Durrësit, janë studiuar dokumente për problemin që trajton ky punim, takim me specialist të mbrojtjes së mjedisit po në qytetin e Durrësit. Është shfrytëzuar literaturë rreth zhurmave dhe pasojat që sjellin në ambientin ku akomodohen turistët

dhe është shfrytëzuar faqja e internetit të Drejtorisë së Mbrojtjes së Mjedisit dhe strukturave të tjera përgjegjëse.

### 3. Strukturat për mbrojtjen e mjedisit

Miratimi i ligjeve nr. 9774, dt. 12.7.2007. “ Për vlerësimin dhe administrim e zhurmës në mjedis , VKM nr. 587, dt. 7.7.2010 “Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane e turistike”, udhëzimi i përbashkët nr. 8 dt. 27.11.2007 i Ministrisë së Shëndetësisë dhe asaj të Turizmit “Për nivelet kufi të zhurmave në mjediset e caktuara”, ka bërë të mundur përmirësimin e sistemit.

Krahas këtyre akteve ligjore të miratuara, janë ngritur mjaftë institucione në nivel qendror dhe lokal, të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në përmirësimin, si në drejtim të menaxhimit të mjedisit nga aktiviteti dhe veprimtaria e subjekteve ekonomike, ashtu dhe në drejtim të monitorimit të mjedisit nga faktorë të ndryshëm ekonomiko-social. Në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit funksionon Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me drejtoritë rajonale në nivel qarqesh, e cila ndjek miratimin dhe licencimin e lejeve të mjedisit, në varësi të klasifikimit ligjor të aktiviteteve të subjekteve ekonomike. Gjithashtu, në varësi të kësaj ministrie funksionon dhe Inspektorati i Mjedisit, me degët e tij rajonale, i cili ushtron kontrole mbi zbatimin e detyrave të lejeve mjedisore.

Sipas VKM-së 587, strukturat e pushtetit vendor në zbatim të nenit 8 të ligjit 9774 dt. 12.7.2017 aplikojnë dhënien e lejeve për veprimtaritë e lokaleve me muzike, për ditët e javës nga ora 19 deri në orën 23, ndërsa për të premteve/shtunave nga ora 19 deri në orën 24, ndërsa për mjediset e mbyllura veprimtaria e lokaleve me muzikë lejohet pa kufizime në orar, por duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës sipas udhëzimit të përbashkët nr. 8 dt. 27.11.2007 të Ministrisë së Mjedisit dhe të Ministrisë së Shëndetësisë. Dhënia e lejeve për këto subjekte, bëhet nga drejtoritë rajonale të mjedisit pranë qarqeve në bashkëpunim me ISHP Tiranë (Institutit Shëndetit Publik), i cili kryen monitorimin e nivelit të zhurmave, si dhe, me pushtetin vendor në dhënien e mendimit për ushtrimin e aktivitetit, kjo pas organizimit të një konsultimi të grupit të interesit me komunitetin e zonës. Vendimi nr. 587 cakton detyra dhe për strukturat vendore të Policisë së Shtetit, për të mbështetur Inspektoratin e Mjedisit në drejtim të kontrollit dhe monitorimit të emetimit të zhurmave dhe të zbatimit të orareve nga aktiviteti i lokaleve me muzike.

### 4. Monitorimi i ajrit urban dhe zhurmat

Rrjeti i monitorimit të ajrit përbëhet nga *121 stacione monitorimi*. Treguesit e monitorimit të ajrit urban janë: *shkarkimet e ndotësve urbane të ajrit (PM, SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, O<sub>3</sub>, CO, HC), shkarkimet e ndotësve të metaleve të rënda të ajrit (Pb, As, Mn, Ni, Cu, Zn, Cd), nivelet e zhurmës*. Nga monitorimi do të regjistrohen parametrat e mëposhtëm:

- përqendrimi mesatar ditë/vjetor (mg / m<sup>3</sup>),
- numri vjetor i ditëve që tejkalon kufijtë.

Rrjeti i monitorimit të zhurmave urbane përbëhet nga *57 stacione monitorimi të vendosura në 10 qytete të Shqipërisë: Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Fier, Sarandë, Korçë, Berat dhe Gjirokastrë*. Qëllimi është monitorimi i nivelit të ndotjes akustike, në pikat e monitorimit të 10 qyteteve kryesore të vendit tonë, për të dhënë mundësinë që të gjykohet mbi masën e ekspozimit të popullatës ndaj zhurmave.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

#### 4.1 Treguesit


Parametra të veçante të cilat vrojtohen në investigimet e zhurmës janë niveli ekuivalent i

vazhdueshëm i zhurmës (*Leq*), niveli maksimal i zhurmës (*Lmax*) nivelet e 10% dhe 90% (*L10*, *L90*). Monitorimi i zhurmës mund të ndahet në matje/nivele të ditës dhe natës për shkak të rëndësisë që kanë kushtet e cilësisë së gumit në shëndetin e njerëzve.

#### 4.2 Ndotja e ajrit

Skenari bazë supozon që monitorimi i ndotjes së ajrit bazohet në pajisjet ekzistuese. Në këtë rast, kostot u referohen dy kategorive bazë: a) ruajtjes së kostove për pajisjen ekzistuese, b) kostove për kampionet dhe analizat kimike. Skenari i zbatimit të plotë supozon instalimin e 8 stacioneve automatike shtesë që do të mbulojnë edhe 3 pika të tjera në Tiranë (5 në total), një stacion shtesë në Durrës dhe në Vlorë dhe qendrat e tjera urbane me popullatë mbi 50 000 banorë.

Skema: Ndarja e fondeve për matjen e ndotjeve.



#### 4.3 Monitorimi i ajrit dhe zhurmave

Skema aktuale e monitorimit të ndotjes së ajrit në Shqipëri

ma/Mbulimi tematik:	Ndotja e ajrit
Referenca në politikën kombëtare/ndërkombëtare:	Ligji 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis" dhe VKM Nr. 352, date 29.4.2015 "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të". Direktiva e Cilësisë së Ajrit (2004/107/KE dhe 2008/50/KE), siç përcaktohet në Vendimin e Komisionit për Zbatimin (2011/850/BE)
Mbulimi gjeografik i të dhënave:	Monitorimi realizohet nëpërmjet stacioneve automatake (8) duke përfshirë edhe laboratorin e lëvizshëm (9), stacionet gjysmë automatake (4) dhe tubat pasiv. Në program janë planifikuar 121 pika monitorimi
Indikatorët:	SO <sub>2</sub> , NO <sub>2</sub> (NO <sub>x</sub> ), CO, O <sub>3</sub> , Benzen, PM <sub>10</sub> (PM <sub>2.5</sub> ) dhe metale të rënda (Pb, As, Mn, Ni, Cu, Zn, Cd). * Përgendrimi mesatar ditor / vjetor (mg / m <sup>3</sup> ) * Numri vjetor i ditëve tejkalon kufijtë.
Frekuenca dhe disponueshmëria në kohë:	8 stacione automatike (6 AKM-ja dhe 2, ISHP-ja janë instaluar në pozicione fikse dhe monitorimi me pajisje automatike për 24 orë pa ndërprerje, i cili do të gjenerojë të dhëna çdo orë në bazë të të cilave mesataret mujore llogariten. Këto do të monitorojnë listën e plotë të parametrave të sipërpërmendur. Tubat pasive janë përdorur për monitorimin e Benzen (C <sub>6</sub> H <sub>6</sub> ), O <sub>3</sub> , SO <sub>2</sub> , NO <sub>2</sub> do të organizohet në katër fushata (një në çdo stinë) gjatë periudhës 2-3 javore. Stacione gjysmë automatike janë përdorur për monitorimin PM <sub>2.5</sub> ) dhe përmbajtjen e metaleve toksike (Pb, Cd, Zn, dhe Cu) ne qytetet Kukës, Fier, Gjirokastrë dhe Berat.

Duke e parë këtë problem në qytetin e Durrësit i cili është qyteti i dytë më i madh në vendin tonë me një popullsi mbi 200 mijë banorë, porti kryesor i vendit me destinacionet turistike me popullore (turizëm detar dhe kulturor). Prioriteti i Bashkisë Durrës ka qenë dhe është rritja gjithnjë e më shumë e fluksit të vizitorëve të ndryshëm, duke hapur e krijuar mundësi për rritjen e vazhdueshme të turizmit, si një nga prioritetet e zhvillimit ekonomik të qytetit. Performanca e turizmit dhe përmirësimi i shërbimeve të mbështetur nga politikat e ndjekura nga Bashkia e Durrësit, ka bërë të mundur që në pik të sezonit turistik të kemi mbi 150 mijë pushues. Rritja e numrit të pushuesve, rritja e aktivitetit ekonomik e kulturor në zonën turistike të Plazhit ka bërë të mundur dhe rritjen e ndotjes akustike.

Bazuar në “Programin kombëtar të monitorimit të mjedisit” për vitin 2018 sipas VKM nr. 1189 datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar për monitorimin e mjedisit”, AKM (Agjencia Kombëtare e Mjedisit) hartoi “Raportin vjetor të monitorimit të mjedisit në shkallë vendi”. Bazuar në të dhënat për vitin 2018 nga kjo agjenci, vërejmë se monitorimi i nivelit të zhurmave urbane për këtë vit janë kryer në 11 qytete si Tirana, Vlorë, Fier, Korçë, Sarandë, Berat, Kukës, Shkodër, Pogradec, Lezhë, Gjirokastër, duke përfshirë 43 stacione monitorimi. Konstatojmë se në qytetin e Durrësit, si qytet i dytë i vendit, nuk kemi monitorim të nivelit të zhurmës, jo vetëm në qytet, por as në zonën e “Plazhit”. Niveli mesatar i zhurmave për vitin 2018, për qytetin e Tiranës, është regjistruar: gjatë ditës 66.10 dB(A) dhe gjatë natës 57.94 dB(A); ndërsa për qytetin e Vlorës, niveli mesatar i zhurmës gjatë ditës është regjistruar: 63.34 dB(A) dhe gjatë natës 53.41dB(A). Në qytetet e tjera niveli mesatar i zhurmës ishte nën nivelet e matura në qytetin e Tiranës dhe Vlorës.

I morëm këto të dhëna nga dy qytetet, si bazë krahasuese për të arritur në një përfundim të drejtë për nivelin e zhurmës edhe në qytetin e Durrësit, i cili duhet të jetë midis intervalit të nivelit të zhurmave të këtyre dy qyteteve kryesore. Duke u bazuar në nivelet e matura në të gjitha qytetet, konstatohet se ato janë mbi nivelin e zhurmës së lejuar e cila gjatë ditës duhet të jetë 55dB (A) dhe gjatë natës 45 dB (A).

Mendojmë se edhe për qytetin e Durrësit, duke marrë si të mirëqenë nivelet e zhurmave bazuar në matjet në Tiranë dhe në Vlorë, ndotja akustike është në të njëjtët tregues. Kjo mund të vijë si rezultat i fluksit të madh të lëvizjes së mjeteve motorike, mosfunksionimi i sinjalistikës në shumicën e kryqëzimeve, mungesa e theksuar e vendparkimeve të përkohshme apo të përhershme, mungesa e rrugëve dytësore, të cilat do të ulnin ndjeshëm trafikun e mjeteve në kryqëzimet kryesore, aktiviteti i lokaleve me muzikë gjatë natës deri në orën 24, sidomos ato në ambiente të hapura etj.

Gjykojmë se këta faktorë janë edhe për qytetin e Durrësit, ndonëse nga ana e Bashkisë janë bërë përpjekje në zonën e Plazhit, për uljen në maksimum të fluksit të mjeteve, duke e kthyer rrugën dykalimshe nga sektori Apolonia deri në sektorin e Ilirisë në një rrugë me një kalim, duke krijuar parkime të përkohshme anash rrugës etj. Gjithashtu për uljen në maksimum të trafikut në zonën e “Plazhit”, bashkia investoi në krijimin e rrugës dytësore. Për më tepër, Drejtoria e Policisë e qarkut Durrës, në periudhën turistike i kushton vëmendje përmes hartimit të planit të masave, kontrollit të zbatimit të orareve për lokalet me muzikë *live*. Lidhur me lokalet me muzikë *live* në ambiente të mbyllura e me orar të pakufizuar, vazhdimisht është monitoruar nga Inspektorati i Mjedisit. Në çdo 3 muaj këto subjekte raportojnë mbi zbatimin e detyrave të lejes së mjedisit, në mënyrë të veçante në respektimin e normave të nivelit të zhurmës, që monitorohen nga laboratorët e akredituar.

## 5. Domosdoshmëria e komunikimit në gjuhë të huaj (anglisht)

Industria e turizmit po luan rol vendimtar në ekonominë e vendit. Numri i turistëve po vjen gjithmonë e në rritje. Në këtë këndvështrim, edhe shërbimi i policisë luan rol kryesor. Në këto kushte, oficerët e policisë, që punojnë veçanërisht në zonat turistike, duhet të kenë aftësi të mjaftueshme në dëgjim e në të folur të gjuhës angleze. Vetëm gjatë periudhës kulmore janë më shumë se 140 mijë turistë në plazhin e Durrësit.

Për rritjen e aftësive gjuhësore gjykojmë se do të jetë e dobishme edhe përdorimi i metodave bashkëkohore të mësimi si përdorimi i *E-learning* dhe kurse trajnimi.

Në fakt, në kriteret kryesore të përzgjedhjes së kandidatëve për punonjës policie të përfshiheshin edhe aftësitë gjuhësore në anglisht si, të dëgjuarit e të folurit. Koha e tanishme kur fluksi i turistëve po vjen gjithmonë në rritje, kërkon domosdoshmëri përdorimin e saj. Kjo nënkupton gjithashtu edhe për masat që duhen marrë për të ardhmen për turistët civilë.

Në punën rutinë e gjatë komunikimit veçanërisht me turistët e huaj, punonjësit e policisë jo vetëm që menaxhojnë situatat por paraqesin edhe imazhin e vendit. Richards (1996) thekson se gjuha angleze është një gjuhë ndërkombëtare dhe e nevojshme për ata që punojnë në turizëm, biznes dhe shërbime civile. Aftësitë e mira në dëgjim e të folur minimizojnë keqkuptimet për çështjet më bazike. Në të njëjtën kohë, këto aftësi ngjallin përshtypje pozitive dhe ndihmojnë në arritjen e qëllimeve të ndërsjella.

Gjatë takimeve të ndryshme me punonjës të policisë, u theksua se komunikimin me turistët ata e kanë kryer nëpërmjet përkthyesve që shoqërojnë grupet, apo punonjësve të hoteleve ku akomodohen turistët. Punonjësit e policisë janë ndërgjegjësuar tashmë se koha kërkon me patjetër edhe komunikimin në gjuhë të huaj. Ndonëse në kuadrin e bashkëpunimit me policinë italiane gjatë sezonit turistik (kulmit të tij), të pranishëm janë edhe punonjës të policisë italiane, kjo nuk e zgjidh problemin. Gjeografia e ardhjes së turistëve është tashmë zgjeruar si nga vendet e Lindjes dhe ato të Perëndimit e komunikimi kryhet vetëm në anglisht. Ende nuk ka testimet ku të njihet niveli i aftësive kryesisht në komunikimin bazë (të dëgjuarit dhe të folurit). Për sa më sipër:

Oficerët e policisë duhet të përmirësojnë aftësitë e tyre gjuhësore, si më poshtë:

1) përsëritje dhe si t'i ofrohet ndihmë turistit, 2) pyetje rreth detajeve personale dhe çfarë ata duan, 3) dhënie e informacionit për akomodimin, informacion turistik, transport dhe në raste urgjente, 4) dhënie udhëzimesh e këshillash, 5) masa të veçanta për siguri, udhëtim dhe blerje të ndryshme, 6) mundësi gjuhësore për të shpjeguar rregullat mbi qarkullimin rrugor dhe oraret e lejuara për baret e hapura me muzikë të lartë. Punonjësit e policisë të mësojnë duke përdorur tekstet në anglisht dhe duke praktikuar dialogun. Lidhur më kohën e zhvillimit të kurseve mund të gjendet zgjidhje përmes bashkëveprimit midis të dy institucioneve (Drejtoria e Policisë dhe UAMD, ku mësimi mund të zgjasë 1.30 minuta dhe jo më shumë se dy herë në javë).

## 6. Procedura për dhënien e lejes. Rasti i “Night Club Divas” në Durrës.

Për të ilustruar marrjen e lejes për hapjen e aktivitetit, le të shikojmë rastin konkret

të subjektit “Night Club Divas”, në Durrës. Instituti i Shëndetit Publik (departamenti i shëndetit dhe mjedisit) në shkresën nr. 955/1 dt. 16.10.2018, i përgjigjet kërkesës së Drejtorisë Rajonale të Mjedisit në Durrës si më poshtë:

Në vijim të shkresës nr. 1176 prot., dt. 4.7.2018, drejtuar ISHP-së, sektori i fizikës sanitare kreu matje zhurmash me subjektin argëtues “Night Club Divas”, Durrës, me qëllim vlerësimin e situatës së nivelit të zhurmave që gjeneron subjekti gjatë punës. Procesi i matjeve u krye gjatë natës së datës 26.9.2018, me matje integrale dhe diferenciale çdo 2 sek./një nivel zhurme, në mjediset e jashtme dhe të brendshme të lokalit. Vlerësimi është kryer me aktivitet maksimal të bokseve në sallën kryesore të subjektit. Aparati i përdorur për matje është i tipit *Sound Level Meter EXTECH 407764 RS-232/Datalogger* me një korigjim +/-1.5 dB(A) dhe *Larson 831 Davis* me një korigjim +/-0.35 dB(A). Nga vlerat e matura paraqesim si më poshtë vijon:

*I. brenda në subjekt, me aktivitet maksimal të bokseve, Laeq 96.2 Db (A),*

1. pas derës së parë të subjektit (derë dopioxham), niveli 70-71 Db (A),
2. pas derës së dytë të subjektit (derë dopioxham), niveli 55-56 Db (A),
3. buzë rrugës rreth 6m larg nga subjekti, niveli 57-58 Db (A),
4. pas derës së pasme, ana perëndimore (hekur me sfungjer), niveli 54-55 Db(A),
5. te fasada e pallatit përballë, ana perëndimore rreth 15 m larg, niveli 49-50 Db(A).

*II. foni i rrugës, kur pajisjet zhurmëprodhuese nuk punojnë, Laeq 57,3 Db(A),*

1. pas derës së parë të subjektit (derë dopioxham), niveli 58-59Db(A),
2. pas derës së dytë të subjektit (derë dopioxham), niveli 55-56 Db (A),
3. tek fasada e pallatit përballë, ana perëndimore rreth 15 m larg, niveli 53-54 Db(A),
4. pas derës së pasme, ana perëndimore (hekur me sfungjer), niveli 54-55 Db (A).

Rezultatet e mësipërme të shqyrtohen dhe analizohen duke u mbështetur në udhëzimin e përbashkët të MMPAU dhe MSH, nr. 8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjediset të caktuara”. Në këto vlerësime merret në konsideratë dhe vlera e fonit të zhurmës urbane për zonën, gjatë natës.

Si përfundim: në kushtet e mungesës së aktivitetit muzikor, foni i ambientit të jashtëm, pranë subjektit është 55-56 Db(A) pikëmatja I/2.

## **7. Vlerësimi i ndikimeve në mjedis (raporti teknik, përpiluar nga eksperti i mjedisit)**

Nëse i referohemi lokalit *Divas* konstatohet se nuk krijon asnjë ndikim në mjedis për sa i përket cilësisë së ajrit, nuk ka asnjë emetim pluhurash apo elementë të tjerë gazrash që ndotin ajrin dhe ambientin e jashtëm, ndërsa për ambientin e brendshëm si gjatë periudhës së verës dhe dimrit, janë vendosur pajisje ventilimi si dhe kondicionerë. Për cilësinë e ajrit në ambientet e lokalit, subjekti ka vendosur aspirator me fuqi 800 m3/orë.

Për marrjen e lejes së mjedisit në ushtrimin e aktivitetit të subjektit fizik, një nga kushtet, është matja e nivelit të zhurmave. Në këto kushte drejtoria rajonale e mjedisit (në rastin konkret e Durrësit) i drejtohet Institutit të Shëndetit Publik Tiranë për matjen e nivelit të zhurmave që emetohen nga aktiviteti i subjektit fizik. Kjo mbështetet në ligjin nr. 9774, dt. 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »



Në vijim të procedurave inspektorët e ISHP Tiranë, kryen procesin e matjes integrale dhe diferenciale çdo 2 sek. Një nivel të zhurmës brenda mjedisëve të lokalit dhe jashtë tij me fuqi maksimale të bokseve. Për matjen e nivelit të zhurmës është përdorur aparati *Sound Level Meter Extech 407764 Rs-232*.

Në vijim ISHP-ja Tiranë i dërgon DRM Durrës konkluzionet e ekspertizës së nivelit të zhurmave lokalit *Night Club Divas*. Në përfundim inspektorët nga matjet e bëra arritën në përfundime se: në kushtet e mungesës së aktivitetit muzikor, foni i ambientit të jashtëm pranë subjektit, është Laeq 57.3 Db(A), pikëmatja II, dhe niveli i zhurmës që gjeneron subjekti është 55-56 Db(A) pikëmatja I/2. Gjithashtu në arritjen e këtyre rezultateve të nivelit të zhurmave inspektorët u bazuan në impiantet e instaluar në objekt, në numrin e bokseve dhe të amplifikatorëve dhe pajisjeve të tjera, të deklaruara nga subjekti, sipas deklaratës së subjektit.

Në përfundim, me respektimin e nivelit të muzikës sipas vlerave të matura nga inspektorët e ISHP si brenda dhe jashtë ambientit të aktivitetit të subjektit si dhe duke respektuar rigorozisht mbylljen e dyerve dhe vetratave gjatë aktivitetit e për rrjedhojë subjekti nuk përbën shqetësim për mjedisin gjatë orëve të natës.

### **7.1 Efektet negative**

Efekte të drejtpërdrejta: gjatë ushtrimit të aktivitetit kemi edhe efekte të drejtpërdrejta të ndikimit në mjedis, kjo si rrjedhojë e rritjes së nivelit të pranueshëm të zhurmave në ambientet e lokalit dhe jashtë tij në nivelet e pranueshme brenda normave të lejuara me ligj.

### **7.2 Masat në minimizimin e ndikimeve në mjedis**

Në planin e punës për organizimin e funksionimit e aktivitetit, subjekti fizik duhet të veprojë në mënyrë të tillë që të minimizojë ndikimet negative në mjedis, të parandalojë shkarkimet mbi normën e miratuar në ndotjen e mjedisit dhe konkretisht:

Janë marrë masat për vendosjen e grilave tek dritaret si dhe vetratat janë të montuara me dopioxham, kjo për ruajtjen e nivelit të zhurmave jashtë ambientit të lokalit sipas normave të miratuara në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Shëndetësisë nr. 8, dt. 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjediset e caktuara".

Punonjësit që janë në kontakt të vazhdueshëm me emetimin e zhurmave do të pajisen me mjete mbrojtëse (kufje) duke punuar me orar të reduktuar dhe jo më shumë se 4 orë në ditë të ekspozuar në mjediset me zhurmë. Për rrjedhojë të respektohen nivelet e zhurmave sipas matjeve të bëra nga inspektorët e ISHP të cilat janë brenda normave të miratuara në udhëzimin nr. 8, dt. 27.11.2007.

- *Takimi me komunitetin*. Në bashkëpunim me Agjencinë e Mjedisit në Durrës dhe specialistët e mjedisit të bashkisë Durrës u organizua një takim me disa banorë dhe punonjës të njëjësive të shërbimit pranë ambienteve të aktivitetit të subjektit fizik. Në përfundim të takimit nuk u shpreh ndonjë shqetësim por ishin dakord për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në fund ata nënshkruan procesverbalin e mbajtur në këtë takim.

- *Mendimi i organeve vendore*. Praktikës i bashkëlidhet edhe shkresa e Bashkisë (Durrës), ku jepet mendimi për vazhdimin e procedurave për tu pajisur me leje mjedisi Tipi C konformë akteve ligjore për lejet e mjedisit.

- *Monitorimi i ndikimit në mjedis*. Plani i monitorimit të ndikimit në mjedis konsiston

në: respektimin e normave të lejuara të nivelit të zhurmës brenda e jashtë ambientit të lokalit. Këto norma janë miratuar në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Shëndetësisë, nr. 8, dt. 27.11.2007, “Për nivelet kufi të zhurmave në mjediset e caktuara”.

Gjithashtu të mos ndryshojë projekti akustik dhe teknik që lidhen me izolimet ndaj efekteve të zhurmës në mjediset pranë lokalit. Në vazhdim të monitorojë gatishmërinë teknike të pajisjeve amplifikuese, të bokseve, të aspiratorëve dhe të kondicionerëve. Nga ana tjetër kërkohet monitorimi i zbatimit të kushteve teknike të personelit, zbatimi i masave teknike kundër zjarrit, masat për zbatimin e kushteve të higjienës në lokal, evadimin e mbetjeve në vendet e caktuara nga pushteti vendor dhe zbatimi i detyrave të lëna nga organet përkatëse.

- *Theksojmë se* ushtrimi i aktivitetit nga subjekti fizik në lokalin *Night Club Divas*, i cili ndodhet në rajonin e plazhit, Durrës, të ushtrohet sipas rregullave e lejeve të miratuara nga organet e qeverisjes vendore e qendrore si dhe akteve ligjore në fuqi.

Me qëllim eliminimin e parandalimin e pasojave negative në mjedis rekomandojmë:

1. të respektohen normat e lejuara të nivelit të zhurmave brenda e jashtë ambientit të lokalit sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Shëndetësisë nr. 8, dt. 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjediset e caktuara”;

2. të merren masa për mbajtjen pastër të ambienteve të lokalit;

3. të instruktohen punonjësit mbi rregullat e mbrojtjes në punë;

4. të mos ndryshojë projekti akustik dhe teknik që lidhen me izolimet ndaj efekteve të zhurmës në mjediset pranë lokalit dhe në çdo gjashtë muaj të dërgohet informacion me shkrim mbi vetëmonitorimin e detyrave të caktuara nga leja mjedisore e *Tipit C* pranë organeve përkatëse.

Në mbyllje të praktikës theksohet se subjekti nuk krijon ndikim negativ në mjedis, pasi subjekti garanton njohjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor si dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në ushtrimin e aktivitetit në lokalin “Night Club Divas”, pasi subjekti fizik do të rrisë bashkëpunimin e tij me organet e qeverisjes vendore si dhe me organet e mjedisit në qarkun e Durrësit. Në këto kushte të pajiset me leje mjedisore *Tipi C*.

## 8. Përfundime dhe rekomandime

Bazuar në “Programin kombëtar të monitorimit të mjedisit” për vitin 2018 monitorimi i zhurmave urbane është realizuar në 11 qytetet kryesore të vendit tonë, ditën dhe natën në mungesë të erës së fortë dhe reshjeve të shiut, pasi kanë ndikim në nivelin e zhurmave. Nga monitorimi i kryer bazuar në të dhënat mesatare rezulton se niveli i ndotjes nga zhurmat është i lartë, në përgjithësi në të gjitha qytetet.

Niveli më i lartë është monitoruar në qytetin e Tiranës ku kemi tejkalim të normës ditën me 20% dhe natën me 29%, ndërsa nivelet më të ulëta janë monitoruar në qytetin e Kukësit dhe Pogradecit. Ndikimi kryesor në rritjen e nivelit të zhurmave është ÷uksi i madh i automjeteve në akset rrugore. Zhurma shkaktohen edhe nga muzika e lartë e lokaleve. Gjatë natës, zhurma mjedisore duke filluar në nivelet *Lnight* nën 45 dB mund të shkaktojë efekte negative në gjumë të tilla si lëvizjet e trupit, zgjimet, shqetësimet, si dhe efektet në sistemin kardiovaskular që bëhen të dukshme mbi 55 dB. Në të mirë të mirëmenaxhimit të turistëve, numri i të cilëve është në rritje edhe punonjësit e policisë të jenë në gjendje të komunikojnë në gjuhën angleze. Për këtë qëllim bashkëpunimi me

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

“Krimi mjedisore,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare”

UAMD për organizimin e trajnimeve dhe hartimin e një fjalori xhepi do të ishte dobiprurëse.

Në të ardhmen do të jetë e dobishme edhe rritja e numrit të matjeve e kontrolleve për matjen e zhurmave në zonën e plazhit.

Masat që duhet të ndërmerren për zvogëlimin e ekspozimit ndaj zhurmave, të përfshijnë instalimin e barrierave të zhurmave rrugore dhe hekurudhore, reduktimin e numrit të automjeteve në rrugë, si dhe ristrukturimin dhe cilësinë e asfaltimit të rrugëve.

## Literatura

1. Martin, M.A., Tarrero, M.A., Gonzalez, A. and Machimbarrena, M. (2006). Exposure-effect relationships between road traffic noise annoyance and noise cost valuations in Valladolid, Spain. *J. Appl. Acoust.*, 67 (10), 945-958.
2. Chien, M. K. and Shih, L. H. (2007). An empirical study of the implementation of green supply chain management practices in the electrical and electronic industry and their relation to organizational performances. *Int. J. Environ. Sci. Tech.* **4** (3), 383 –394.
3. Jamrah, A., Al-Omari, A. and Sharabi, R. (2006). Evaluation of traffic noise pollution in Amman, Jordan. *Environ. Monitor. Assess.*, **120**, 499–525.
4. Murthy, K., Kamruzzaman Majumder, A., Nath Khanal, S. and Prasad Subedi, D. (2007). Assessment of traffic Noise Pollution in Banepa, A semi urban town of Nepal. Kathmandu University. *J. Sci. Eng. Tech.* **1**, 4.
5. Enmarker, I. (2004). The effects of meaningful irrelevant speech and road traffic noise on teachers attention, episodic and semantic memory. *Scand. J. Psychol.*, **45**(5), 393-405.
6. Richards, G. (1996), *Cultural Tourism in Europe*, CAB International, Wallingford.
7. <https://qbz.gov.al/?doc=docs%2FLigj%20Nr%209774%20Dat%2012-07-2007.htm>
8. <http://www.ikub.al/LIGJE/1007070115/Article-PeR-MONITORIMIN-DHE-KONTROLLIN-E-NIVELIT-Te-ZHURMAVE-Ne-QENDRAT-URBANE-DHE-TURISTIKE.aspx>
9. [https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligj\\_nr\\_162\\_dt\\_4\\_12\\_2014\\_20658\\_11.pdf](https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligj_nr_162_dt_4_12_2014_20658_11.pdf)
10. [https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/VKM\\_352\\_2015.pdf](https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/VKM_352_2015.pdf)
11. <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2004/107/oj>
12. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/ALL/?uri=CELEX%3A32008L0050>
13. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32011D0850>



## **AKADEMIA E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »**

# Mbrojtja e mjedisit me anë të legjislacionit penal në Bashkimin Evropian dhe ndikimi i tij në Shqipëri



■ MSc. Enea SHEQI  
Ministria e Financave dhe Ekonomisë,  
enea.sheqi@yahoo.com

## Abstrakt

Mjedisi është një e mirë e përbashkët e cila synohet që të mbrohet nga të gjithë, individët, shteti dhe bizneset. Siguria mjedisore është një hap i fortë drejt një të ardhme të sigurt dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Luftimi i krimit mjedisor është një detyrë e cila i takon secilit shtet, e më tej rajonit e organizatave ndërkombëtare. Bashkimi Evropian në këtë drejtim ka përfunduar disa direktiva dhe vendime kuadër me qëllim parandalimin, luftimin dhe hetimin e krimit mjedisor. Ndërgjegjësimi i publikut, ruajtja e sigurisë mjedisore, ruajtja e interesave kombëtarë nën fokusin e politikave globale, roli i mjedisit në lidhje me shoqërinë, janë disa nga shtyllat kryesore të politikave mjedisore të Bashkimit Evropian. Legjislacioni komunitar mbi krimin mjedisor ka pasur ndikim edhe në legjislacionin tonë duke synuar përmirësimin e tij. Në vijim të këtij punimi do të bëhet një analizë e legjislacionit evropian mbi krimin mjedisor, përgjegjësinë mjedisore, mënyrat e hetimit dhe parandalimit të tij, mbrojtjes juridike penale të tij si dhe përafrimin që është bërë nga legjislacioni ynë në kuadër të evidentimit të praktikave më të mira dhe të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

## Fjalëkyçe:

krim mjedisor, siguria mjedisore, politika mjedisore, zhvillim i qëndrueshëm.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

## 1. Hyrje

Krimi mjedisor është një nga krimet më të rënda dhe një krim i cili prek jetën e të gjithë personave që jetojnë në një shoqëri të caktuar. Ai përbën kërcënim për jetën e përditshme, planetin dhe për gjeneratat e brezat e ardhshëm.<sup>1</sup> Ky krim mund të jetë i kufizuar në një vend të caktuar, por ndonjë herë kufijtë e këtij krimi i kalojnë shtetet duke u bërë një krim ndërkombëtar e duke dhënë pasoja në të njëjtën kohë në një numër të madh njerëzish. Krimi mjedisor ka një ndikim negativ qoftë në natyrën në vetvete ashtu dhe në popullatën që jetojnë në një mjedis të caktuar. Mbi natyrën krimi mjedisor mund të shkaktojë:<sup>2</sup>

- rritjen e nivelit të ndotjes;
- degradimin e jetës së egër;
- ulje të biodiversitetit;
- shqetësim të ekuilibrit ekologjik.

Ndër pasojat më të mëdha të krimeve mjedisore që mund të cenojnë jetën dhe natyrën mund të përmendim:<sup>3</sup>

- rrezikun e sëmundjeve të ndryshme;
- katastrofat mjedisore;
- ndryshimin klimaterik;
- ndotjen e zinxhirit ushqimor;

<sup>1</sup> <https://www.interpol.int/Crimes/Environmental-crimeaksuesuar> më 13.10.2019.

<sup>2</sup> <https://www.europol.europa.eu/crime-areas-and-trends/crime-areas/environmental-crime-aksuesuar> më 20.10.2019.

<sup>3</sup> <https://www.europol.europa.eu/crime-areas-and-trends/crime-areas/environmental-crimeaksuesuar> më 21.10.2019.

- ulje të jetëgjatësisë;
- vdekje të qenieve njerëzore.

Drejtimit më të njohura të krimit mjedisor janë emetimet e paligjshme apo shkarkimet e substancave në ajër, ujë apo tokë, tregtia e paligjshme e kafshëve të egra, tregtia e paligjshme e substancave që ndikojnë në pakësimin e ozonit apo transportimi ose hedhja e plehrave të mbeturinave në mënyrë të paligjshme.<sup>4</sup>

Bashkimi Evropian në drejtim të parandalimit të krimeve mjedisore dhe ndëshkimit të kriminelëve ka ndërmarrë një sërë masash legislative duke synuar që të ofrojë një qasje eficiente për të adresuar këto çështje. Një nga aktet më kryesore në këtë drejtim është Direktiva 2008/99 EC “Mbi mbrojtjen e mjedisit me anë të legjislacionit penal”. Kjo direktivë ishte e domosdoshme për të unifikuar qëndrimin e Bashkimit Evropian në drejtim të adresimit të një çështje tepër delikate si ajo mjedisore.

## 2. Kuadri ligjor i Bashkimit Evropian, në drejtim të mbrojtjes së mjedisit

Komisioni Evropian e ka përcaktuar krimin mjedisor si një akt i cili është në kundërshtim me legjislacionin mjedisor dhe mund të shkaktojë dëmtime apo rreziqe të rënda në mjedis, apo në jetën e njerëzve.<sup>5</sup>

Direktiva 2008/99 EC “Mbi mbrojtjen e mjedisit me anë të legjislacionit penal” është akti legjislativ më i rëndësishëm i BE-së për mbrojtjen e mjedisit me anë të masave penale. Kjo direktivë parashikon një sërë veprash të cilat duhet të parashikohen nga ana e legjislacioneve të shteteve anëtare të BE-së si sanksione penale. Direktiva 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal lindi sepse situata e krijuar jo vetëm në vendet e BE-së, si pasojë e rritjes ekonomike, po çonte drejt një mjedisi aspak premtues as për brezat e kohës.<sup>6</sup>

Ndër veprat e sanksionuara në këtë direktivë si krime mjedisore mund të përmendim:<sup>7</sup>

- shkarkimin, emetimin ose futjen e një sasive të materiale ose rrezatim jonizues në ajër, tokë ose ujë, që shkakton ose ka të ngjarë të shkaktojë vdekje ose dëmtim serioz për çdo person ose dëmtim të konsiderueshëm të cilësisë së ajrit, cilësia e tokës ose cilësia e ujit, ose të kafshët ose bimët;
- mbledhjen, transportin, rikuperimin ose largimin e mbeturinave, i cili shkakton ose ka të ngjarë të shkaktojë vdekje ose dëmtim serioz ndaj ndonjë personi ose dëm të konsiderueshëm ndaj cilësisë së ajrit, tokës, ujit, kafshëve ose bimëve;
- funksionimi i një impianti në të cilën ushtrohet një aktivitetet i rrezikshëm apo substanca të rrezikshme në të cilën mund të jenë në përdorim rrezikojnë jetën, shëndetin e njerëzve, bimëve apo kafshëve;
- prodhimin, përpunimin, trajtimin, përdorimin, mbajtjen, ruajtjen, transportin, importin, eksportin ose asgjësimin e materialeve bërthamore ose substancave të tjera të rrezikshme radioaktive;
- vrasjen, shkatërrimin, posedimin ose marrjen e mostrave të specieve të mbrojtura

<sup>4</sup> Iris Petrela, “Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë evropian në mbrojtje të mjedisit”, *Revista shqiptare për studime ligjore*, Volumi 2, 2011. f. 116.

<sup>5</sup> European Union Action to Fight Environmental Crime, “Environmental Crime and the EU”, Berlin, Mars, 2016, f. 11.

<sup>6</sup> Ulsi Manja, *Veprat penale kundër mjedisit (Neni 201-207 Kp)*, Tiranë, shtator 2017, f. 68.

<sup>7</sup> Neni 3 i Direktivës 2008/99/EC.

të faunës së egër ose florës.

- tregtimin në ekzemplarë të faunës së egër të mbrojtur apo specieve të florës, ose pjesë apo derivate të tyre;

- çdo sjellje që shkakton përqesim të ndjeshëm në një habitat brenda një lokacioni të mbrojtur;

- prodhimin, importimin, eksportimin, vendosjen në tregti ose përdorimi i substancave që shkatërrojnë ozonin.

Të gjitha veprat e sipër përmendura sipas direktivës<sup>8</sup> duhet të parashikohen si vepra penale në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Pra është një listë shteruese e veprave të cilat janë të detyrueshme që të përfshihen në legjislacionin penal të vendeve anëtare të BE-së. Vendet anëtare duhet që të ndërmarrin të gjitha masat që këto vepra të dënohen në mënyrë eficiente, proporcionale në mënyrë që krimet mjedisore të parandalohen dhe autorët e tyre të ndëshkohen.

Duhet thënë se kjo direktivë e Bashkimit Evropian parashikon që autorët të cilët mund të kryejnë këto vepra penale nuk janë vetëm personat fizikë, por edhe ata juridikë. Kështu duhet të merren masa nga vendet anëtare të BE-së që të dënojnë në mënyrë eficiente dhe proporcionale edhe personat juridikë të cilët kryejnë ndonjë nga veprat penale të sipër përmendura në direktivë.<sup>9</sup>

Po në kuadrin evropian mund të përmendim edhe iniciativën e Këshillit të Evropës për hartimin e *Konventës evropiane për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal të Këshillit të Evropës* (PECL).

Tipari kryesor i konventës PECL është detyrimi për palët kontraktuese në nenin 2 të sigurojnë, që disa aktivitete të rrezikshme për mjedisin të penalizohen, gjithashtu sanksionon edhe aktivitete të tjera të paligjshme të kryera me dashje ose nga pakujdesia, të cilat rrezikojnë të ndikojnë negativisht në mjedis. Aktivitete të tilla përfshijnë ndërhyrje të paligjshme në habitatet e mbrojtura të kafshëve të egra ose trajtimin e paligjshëm apo dëmtimin e florës apo faunës, si dhe shkeljen e standardeve ligjërish të detyrueshme mjedisore, sipas ligjeve kombëtare. Palët kontraktuese nuk janë të detyruara të kriminalizojnë një sjellje të tillë, duke pasur mundësinë për të aplikuar lloje të tjera të sanksioneve më pak ndëshkuese në natyrë, por janë të detyruara të penalizojnë veprimet e qëllimshme dhe veprimet e kryera me pakujdesi të rëndë, duke zgjeruar përgjegjësinë penale në situata, kur aktivitete të tilla kryhen me neglizhencë.<sup>10</sup>

### 3. Kuadri ligjor shqiptar në drejtim të mbrojtjes së mjedisit

Legjislacioni penal shqiptar në drejtim të mbrojtjes së mjedisit ka parashikuar disa vepra penale, duke kriminalizuar akte të cilat konsiderohen të paligjshme dhe që mund të dëmtojnë mjedisin, jetën e shëndetin e njeriut. Shteti shqiptar, është bërë palë e mjaft konventave në fushën e mjedisit, duke i nënshkruar e duke marrë përsipër angazhimin për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga këto konventa. Kërkesat dhe detyrimet e këtyre konventave janë bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm duke i parashikuar një

<sup>8</sup> Neni 4, po aty.

<sup>9</sup> Nenet 6 dhe 7 të Direktivës.

<sup>10</sup> Stela Meçaj, *Politikat mjedisore në Bashkimin Evropian dhe ndikimi i tyre në vendet në stabilizim-asociim*, Doktoratura, Tiranë, 2017, f. 120.



numër të madh ligjesh e aktesh nënligjore. Gjithashtu, duke mbajtur parasysh pozitën e Shqipërisë si vend kandidat për në Bashkimin Evropian, kërkesat e shumë prej direktivave të Bashkimit Evropian në fushën e mjedisit janë pasqyruar në legjislacionin mjedisor shqiptar.<sup>11</sup>

Kështu në kreun IV të “Kodit penal të Republikës së Shqipërisë” janë parashikuar veprat penale kundër mjedisit. Me vepra penale kundër mjedisit kuptohen ato vepra (veprime apo mosveprime) të kundërligjshme që cenojnë mbrojtjen e mjedisit (ajrit, ujit, dhe tokës) nga ndotja, të kryera me faj dhe të parashikuara shprehimisht nga legjislacioni penal. Këto figura të veprave penale kanë objekt grupor të përbashkët, marrëdhëniet juridike të vendosura në sferën e sigurisë së mjedisit nga ndotja, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal nga veprimet apo mosveprimet kriminale.<sup>12</sup>

*Ndotja e ajrit*<sup>13</sup> është vepër penale e parashikuar në kodin penal e cila synon të mbrojë mjedisin nga ndotja. Nga ana objektive kjo vepër penale kryhet me anë të veprimeve apo mosveprimeve të kundërligjshme të cilat ndotin ajrin nëpërmjet çlirimit të tymrave, gazrave dhe lëndëve të tjera toksike apo radioaktive, të bëra kundrejt normave të lejuara. Ajo që është e rëndësishme është fakti se kjo parashikohet një vepër penale në rastet kur këto veprimet nuk përbëjnë kundërvajtje administrative të cilat janë të parashikuara në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja”.<sup>14</sup> Kjo vepër penale mund të kryhet nga subjekte të përgjithshme dhe nga ana subjektive kryhet me faj në të dyja format e saj dashje apo pakujdesi.

*Neni Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër*<sup>15</sup>, synon të mbrojë speciet e mbrojtura të faunës apo florës nga veprimet apo mosveprimet kriminale të vrasjes, shkatërrimit, zotërimit apo marrjes së ekzemplarëve, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura, apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve.

*Substancat ozonholluese*<sup>16</sup>, është një vepër penale e cila synon që të mbrojë dhe respektojë kërkesat ligjore të legjislacionit përkatës mbi këtë pjesë të atmosferës. Kjo vepër penale kryhet me anë të prodhimit, importimit, eksportimit, nxjerrja në treg ose përdorimi i substancave ozonholluese, duke shkelur kërkesat e legjislacionit përkatës apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente.

*Peshkimi i ndaluar*<sup>17</sup> është gjithashtu një vepër penale e cila ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen e peshqve në përputhje me legjislacionin për peshkimin. Kjo vepër penale kryhet me anë të mjeteve, vende dhe mënyra të ndaluara. Kjo është përcaktuar si kundërvajtje penale në kodin tonë penal. Kur kjo vepër kryhet me anë të lëndëve të cilat rrezikojnë shoqërinë apo njerëzit si për shembull me anë të eksplozivit apo me anë të lëndëve hetuese, konsiderohet se është kryer në rrethana të cilësuar. Subjekt i kësaj vepre është i përgjithshëm dhe nga ana subjektive kjo vepër penale kryhet me dashje.

Prerja e paligjshme e pyjeve<sup>18</sup> është një tjetër kundërvajtje e parashikuar në kodin

<sup>11</sup> Ulsi Manja *Veprat penale kundër mjedisit ( Neni 201-207 Kp.)*, Tiranë, Shtator, 2017, f. 28.

<sup>12</sup> Ismet Elezi, “E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, pjesa e posaçme”, Botimet Kumi, Tiranë, 2014, f. 326.

<sup>13</sup> Neni 201 i *Kodit penal të Republikës së Shqipërisë*.

<sup>14</sup> Ismet Elezi, *E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, pjesa e posaçme*, Botimet Kumi, Tiranë, 2014, f. 327.

<sup>15</sup> Neni 202 i *Kodit penal të Republikës së Shqipërisë*.

<sup>16</sup> Neni 203, po aty.

<sup>17</sup> Neni 204 i *Kodit penal të Republikës së Shqipërisë*.

<sup>18</sup> Neni 205, po aty.

tonë penal. Objekt i kësaj vepre janë mbrojtja e marrëdhënieve juridike të vendosura në ligjin “Për pyjet”, për të siguruar paprekshmërinë e ekonomisë pyjore, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal me anë të veprimeve apo mosveprimeve kriminale. Nga ana objektive kjo veper penale kryhet me anë të veprimeve aktive si prerja e paligjshme e pyjeve dhe pa leje, në kohë apo në vende të ndaluara. Që kjo veper të konsiderohet si kundërvajtje penale ajo nuk duhet që të konsiderohet si kundërvajtje administrative sipas ligjit përkatës material. Subjekt i kësaj vepre penale është i përgjithshëm dhe nga ana subjektive kjo veper kryhet vetëm me dashje.<sup>19</sup>

Prerja e drurëve dekorativë dhe frutore<sup>20</sup> gjithashtu konsiderohet si veper penale nga ana e kodit tonë penal. Kështu kjo veper penale synon të mbrojë paprekshmërinë e drurëve dekorativë dhe frutorë, lulishteve apo parqeve nga ana e veprimeve si prerja, dëmtimi, i pemëtoreve, ullishtave apo vreshtave, pa marrë më përpara leje nga organi kompetent për pemët frutor dhe duke i dëmtuar ato dekorativë. Subjekt i kësaj vepre penale është i përgjithshëm dhe nga ana subjektive kjo veper penale kryhet me dashje.

Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe mjedisit pyjor<sup>21</sup> synon të mbrojë fondin dhe mjedisin pyjor nga shkatërrimi i tyre. Nga ana objektive kjo veper penale kryhet me anë të veprimeve si shkatërrimi apo dëmtimi me zjarr i mjedisit pyjor apo i pyjeve. Kjo veper penale kryhet nga subjekte të përgjithshme dhe me dashje.

Shkatërrimi nga pakujdesia i pyjeve dhe i mjedisit pyjor me zjarr<sup>22</sup> është parashikuar gjithashtu si veper penale nga ana e kodit penal, për të mbrojtur fidanishtet pyjore, fondin pyjor, grumbullin pyjor, apo çdo njësi të ngjashme me to me anë të zjarrit.

Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve<sup>23</sup> është një dispozitë e bardhë që i referohet akteve ligjore të “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve” dhe ligjit “Për shërbimin veterinar”, pasi në këtë dispozitë nuk janë të përcaktuara as rregullat dhe as shkeljet të cilat sjellin përgjegjësi penale. Element i domosdoshëm për kryerjen e kësaj vepre penale gjithashtu është ardhja e pasojave të rënda materiale, pra dëmtimi i bimëve apo i kafshëve në masë, apo shkaktimi i sëmundjeve të ndryshme etj. Kjo veper penale mund të kryhet si me anë të subjekteve të përgjithshme dhe posaçëm dhe me faj.<sup>24</sup>

Me ndryshimet ligjor të përcaktuara në korrik të vitit 2019<sup>25</sup> janë shtuar edhe veprat penale të: *Menaxhimi i mbetjeve*<sup>26</sup>, *Transportimi i mbetjeve*<sup>27</sup>, *Aktivitetet e rrezikshme*<sup>28</sup>, *Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme*<sup>29</sup>.

*Menaxhimi i mbetjeve* është shtuar si veper penale për të respektuar kërkesat ligjore të legjislacionit mbi menaxhimin e mbetjeve të cilat mund të dëmtojnë rëndë ajrin, tokën, ujin, apo mjedisin përreth. *Transportimi i mbetjeve* ka të bëjë me depozitimin e mbetjeve në Republikën e Shqipërisë ose me kalimin e tyre transit përgjatë territorit të Republikës së Shqipërisë. Vepra penale e *aktiviteteve të rrezikshme* synon të kriminalizojë aktivitetet apo impiantet të cilat përdorin substanca të rrezikshme në kundërshtim me legjislacionin përkatës. *Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme*

<sup>19</sup> Ismet Elezi, *E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, pjesa e posaçme*, Botimet Kumi, Tiranë, 2014, f. 331.

<sup>20</sup> Neni 206 i Kodit penal të Republikës së Shqipërisë.

<sup>21</sup> Neni 206/a, po aty.

<sup>22</sup> Neni 206/b i Kodit penal të Republikës së Shqipërisë.

<sup>23</sup> Neni 207, po aty.

<sup>24</sup> Ismet Elezi, *E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, pjesa e posaçme*, Botimet Kumi, Tiranë, 2014, f. 335.

<sup>25</sup> Ligji nr. 44/2019.

<sup>26</sup> Neni 201/a i Kodit penal të Republikës së Shqipërisë.

<sup>27</sup> Neni 201/b, po aty.

<sup>28</sup> Neni 201/c i Kodit penal të Republikës së Shqipërisë.

<sup>29</sup> Neni 201/ç i Kodit penal të Republikës së Shqipërisë.

është një vepër penale e cila është vendosur nga ana e legjislatorit për të kriminalizuar aktet e: prodhimit, përpunimit, trajtimit, përdorimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit, importimit, eksportimit ose asgjësimit të materialeve bërthamore ose substancave të tjera radioaktive të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente.

Gjithashtu nga ky ligj janë shtuar në kodin penal edhe këto vepra penale: *Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër*<sup>30</sup>, *Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore*<sup>31</sup>. *Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër*, si vepër penale, synon që të kriminalizojë veprimet e tregtimit të ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente. Nga ana tjetër, *dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore* synon që të kriminalizojë veprimet që shkelin kërkesat e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente dhe që shkaktojnë përkeqësim të rëndë të një habitati, që ndodhet brenda një zone të mbrojtur mjedisore.

Këto ndryshime kanë ardhur si rezultat i përafrimit pjesërisht me Direktivën 2008/99/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 19 nëntor 2008 “Për mbrojtjen e mjedisit përmes legjislacionit penal”, numri CELEX 32008L0099, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 328, datë 6.12.2008, faqe 28-37.

## 4. Konkluzione

Ndërmjet të drejtës penale dhe të drejtës së mjedisit ka një lidhje për shkak të vlerave të mbrojtura dhe qëllimeve të përbashkëta. Kriminalizimi i veprimeve të cilat dëmtojnë mjedisin me të gjithë komponentëve të tij është një masë tepër e nevojshme dhe duhet zbatuar në mënyrë efikase dhe proporcionale. Siguria mjedisore është një hap i fortë drejt një të ardhme të sigurt dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Direktiva 2008/99 EC “Mbi mbrojtjen e mjedisit me anë të legjislacionit penal” është akti legjislativ më i rëndësishëm i BE-së për mbrojtjen e mjedisit me anë të masave penale. Kjo direktivë parashikon një sërë veprash të cilat duhet të parashikohen nga ana e legjislacioneve të shteteve anëtare të BE-së si sanksione penale.

Në kodin tonë penal janë parashikuar në një krë të veçantë veprat penale në fushën e mjedisit të cilat kanë të njëjtin objekt grupor, pra marrëdhëniet juridike të vendosura në sferën e sigurisë së mjedisit nga ndotja, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal nga veprimet apo mosveprimet kriminale. Në korrik të vitit 2019 u kryen disa ndryshime ligjore në kodin penal për të përafruar pjesërisht legjislacionin tonë penal mjedisor, me Direktivën 2008/99/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 19 nëntor 2008 “Për mbrojtjen e mjedisit përmes legjislacionit penal”.

<sup>30</sup> Neni 202/a, po aty.

<sup>31</sup> Neni 202/b, i Kodit penal të Republikës së Shqipërisë.

## Bibliografia

1. Ismet Elezi, *E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, pjesa e posaçme*, Botimet Kumi, Tiranë, 2014.
2. European Union Action to Fight Environmental Crime, *Environmental Crime and the EU*, Berlin, mars, 2016.
3. Stela Meçaj, *Politikat mjedisore në Bashkimin Evropian dhe ndikimi i tyre në vendet në stabilizim-asociim*, Doktoratura, Tiranë, 2017.
4. Ulsi Manja, *Veprat penale kundër mjedisit (Neni 201-207 Kp)*, Tiranë, shtator, 2017.
5. Iris Petrela, "Përafrimi i legjislacionit Shqiptar me atë European në mbrojtje të mjedisit" *Revista shqiptare për studime ligjore*, Volumi 2, 2011.
6. *Kodi penal i Republikës së Shqipërisë*.
7. Direktiva 2008/99 EC "Mbi mbrojtjen e mjedisit me anë të legjislacionit penal".
8. <https://www.interpol.int/Crimes/Environmental-crime>
9. <https://www.europol.europa.eu/crime-areas-and-trends/crime-areas/environmental-crime>

# Mbrojtja e mjedisit, nëpërmjet legjislacionit penal në Shqipëri



■ Dr. (proc.) Gentiana BEKTASHI

Ministria e Brendshme  
gbektashi@yahoo.com

## Abstrakt

Mjedisi është bazë themeli për një zhvillim të qëndrueshëm dhe sigurinë e një vendi. E parë në këtë këndvështrim, sot mund të themi se mjedisi është në rrezik. Krimi mjedisor po përhapet masivisht duke rrezikuar jo vetëm jetën e qëndrueshme dhe burimet e të ardhurave për qeveritë, por dhe duke u bërë pjesë e një rrjeti global të krimeve ndërkombëtare mjedisore. Nëse i referohemi zhvillimeve në këtë fushë në nivel evropian, janë ndërmarrë disa iniciativa të rëndësishme në nivel kombëtar duke filluar nga fundi i viteve '90. Këto ndryshime kanë theksuar domosdoshmërinë e harmonizimit të legjislacioneve penale kombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit lidhur me disa shkelje të rënda të legjislacionit mjedisor që ishin kthyer në një kërcënim serioz për mjedisin. Qëllimi i kryesor i tyre ka qenë sigurimi i një mbrojtje më efektive të mjedisit, mbështetur edhe në "Konventën e Këshillit të Evropës" për mbrojtjen e mjedisit përmes së drejtës penale. Vetë Bashkimi Evropian ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim, duke miratuar direktivat e krimit mjedisor, të cilat i detyrojnë shtetet anëtare që të parashikojnë dënime penale në legjislacionin e tyre kombëtar, të cilat lidhen kryesisht me disa shkelje të rënda të dispozitave të legjislacionit komunitar si p.sh. ai për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e kundërligjshëm të mbetjeve, shkatërrimin ose veprimtari të paligjshme ndaj faunës ose florës. Po si i përgjigjet legjislacioni ynë, dhe specifikisht legjislacioni penal kësaj fushe? Marrë shkas nga ky realitet i ri për të përmbushur standardet e fundit evropiane në këtë fushë, Direktivës 2008/99/EC Shqipëria në fund të korrikut të vitit 2019 ka bërë disa ndryshime në kodin penal në fushën e mjedisit. Në këtë punim do të analizohet legjislacioni penal mjedisor i Republikës së Shqipërisë ne raport me atë të BE-së. Qëllimi i punimit është përshkrimi i arritjeve por dhe i nevojave për përmirësim, nevoja me të cilat është përballuar Shqipëria në rrugën drejt anëtarësimit përmes harmonizimit të legjislacionit në këtë fushë në raport me atë të BE, por dhe nevoja që lindin nga dinamikat e reja të brendshme.

## Fjalëkyçe:

mjedis, krim mjedisor, përafrim ligjor, legjislacion penal, standarde europiane.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

## 1. Hyrje

Një mjedis i ruajtur është baza për një zhvillim të qëndrueshëm dhe sigurinë e një vendi. Krimi mjedisor shpesh përkufizohet si një term kolektiv që përshkruan aktivitete të paligjshme që dëmtojnë mjedisin dhe sjellin përfitim për grupe apo individë nga shfrytëzimi ose shkatërrimi, tregtia dhe plaçkitja e burimeve natyrore, që përfshijnë krimet e rënda dhe krimet e organizuara ndërkombëtare. Nëse i referohemi një studimi të hartuar nga Qendra ACEG (*Albanian Center for Environmental Governance*), sipas një raporti të UNEP dhe INTERPOL të titulluar “Rritja e krimit mjedisor: Një kërcënim në ngritje për burimet natyrore, paqen, zhvillimin dhe sigurinë” (2017), citohet se:

“Krimet mjedisore po rriten me 5-7% çdo vit, 2-3 herë sa raporti i rritjes së ekonomisë globale; humbjet e të ardhurave për qeveritë përmes të ardhurave nga taksat për shkak të shfrytëzimit kriminal llogaritet të paktën 9-26 miliardë USD çdo vit; krimet në pyje dhe prerjet e paligjshme llogariten në 51-152 miliardë USD; peshkimi i paligjshëm në 11-24 miliardë USD; shfrytëzimi i minierave në mënyrë të paligjshme 12-48 miliardë USD; mbetjet në 10-12 miliardë USD”<sup>1</sup>.

Po kështu kur flasim për Shqipërinë, të gjithë kemi qenë dëshmitarë të shkatërrimit të parqeve kombëtare (Valbonë, Shebenik-Jabllancë, Divjakë-Karavasta, Nartë, etj.), zonave të mbrojtura, hedhjes së paligjshme të mbetjeve urbane dhe jo urbane, keq menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore si dhe industriale.<sup>2</sup>

Po si i është përgjigjur kuadri ligjor, dhe veçanërisht ai penal kësaj fushe? Mbrojtja e

<sup>1</sup> Raporti i UNEP dhe INTERPOL “Rritja e krimit mjedisor: Një kërcënim në ngritje për burimet natyrore, paqen, zhvillimin dhe sigurinë” (2017).

<sup>2</sup> Studim i hartuar nga Qendra ACEG.

mjedisit ka qenë objekt i iniciativave legjislative në Shqipëri në fillimin e viteve 90 duke marrë parasysh që zhvillimi ekonomik dhe shoqëror do të duhej të respektonte parimin e rëndësishëm të një zhvillimi të qëndrueshëm. Për më tepër, një ndër faktorët e rëndësishëm shtytës në drejtim të plotësimit të kuadrit ligjor ka qenë dhe procesi i përafrimit të legjislacionit kombëtar me *acquis* të Bashkimit Evropian, në të cilin mbrojtja e mjedisit është konsideruar si kryesore. Në këtë kontekst, ndryshime ka pasur në fushën e mbrojtjes së mjedisit nëpërmjet legjislacionit penal.

Ndryshimet e para në fushën e mbrojtjes së mjedisit janë bërë nëpërmjet “Kodit penal” të vitit 1995<sup>3</sup>.

Në fillim të viteve ‘90, ligjet në fushën e mbrojtjes së mjedisit nuk u përfshinë në një kod të veçantë por përfshinin një ligj kuadër “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe disa ligje sektoriale apo të posaçme në fusha të caktuara, si ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve, ligji për biodiversitetin, ligji për pyjet, ligji për mbrojtjen e ajrit etj.

Këto ligje janë amenduar disa herë me synim plotësimin dhe përshtatjen e tij me zhvillimet e reja në fushën e mbrojtjes së mjedisit, veçanërisht në kuadrin e procesit të rëndësishëm të përafrimit me legjislacionin komunitar, si një kërkesë e domosdoshme e procesit të integrimin në BE dhe veçanërisht në kuadër të kapitullit 27 të *acquis*-it: “Mjedisi”.

Por përveç këtyre aspekteve të përmirësimeve ligjore, një burim tjetër i rëndësishëm i mbrojtjes së mjedisit është legjislacioni penal. Ajo që vihet re është se legjislacioni penal shqiptar në mbrojtje të mjedisit është i përfshirë në kodin penal dhe veprat penale kundër mjedisit, nuk janë të shpërndara në ligje të ndryshme. Ajo që gjithashtu vihet re është se veprat penale kundër mjedisit, janë grupuar në një kapitull të veçantë.

## 2. Ndryshimet pas viteve 1990

Kodi penal i ri, i vitit 1995, është miratuar duke u mbështetur në ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese” të vitit 1991 dhe ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit” të vitit 1993. Veprat penale kundër mjedisit janë parashikuar në kreun IV të pjesës së tij të posaçme (nenet 201-207), i cili është ndarë nga veprat e tjera penale. Ky kod u pasurua gjithashtu me veprat penale të reja kundër mjedisit, siç është ndotja e ajrit (neni 201) ajo e krimit të transportimit të mbeturinave toksike (neni 202) apo dhe ndotja e ujërave (neni 203). Për herë të parë në legjislacionin penal shqiptar, në kod janë parashikuar masat penale për personat juridikë. Përfshirja e veprave penale kundër mjedisit në një sesion të veçantë është tregues i një ndryshimi të rëndësishëm në konceptimin e mjedisit përfshirë këtu ajrin, ujin, tokën, bimët, kafshët si objekte të drejtpërdrejta të veprave penale, të mbrojtura posaçërisht me normat penale.

## 3. Ndryshimet në kodin penal pas viteve 2000

Risi të tjera në kodin penal përmes shtesave dhe ndryshimeve të mëvonshme, në të cilat konstatohen disa elementë të rëndësishëm që lidhen me mbrojtjen juridike penale të mjedisit.

Pas shfuqizimit të dispozitës së veçantë mbi masat penale për personat juridikë në

<sup>3</sup> Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

vitin 2001, një hap pozitiv është ndërmarrë në vitin 2004 përmes rivendosjes së kësaj dispozite me një përbajtje të ndryshuar, e cila u bë e zbatueshme, në vitin 2007.

Po ashtu, si një reagim ndaj situatës problematike të shfaqur në praktikë nëpërmjet përhapjes së ndjeshme të zjarrvënies (me dashje ose nga pakujdesia) në pyje, kullota etj., e cila kishte shkaktuar djegien e qindra mijëra hektarëve, duke dëmtuar rëndë mjedisin, në kodin penal të vitit 2008, janë shtuar si figura të veçanta të krimeve kundër mjedisit “shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor” (neni 206/a), si dhe “shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor” (neni 206/b).

Me shtesat e vitit 2008, shumica e figurave të veprave penale kundër mjedisit në kodin penal në fuqi janë të cilësuar jo më si kundërvajtja penale, po si krime. Po ashtu, në ndryshimet e kodit penal në vitin 2013 është ashpërsuar dënimi i parashikuar mbi krimin e shkatërrimit me zjarr të pyjeve dhe të mjedisit pyjor, i parashikuar në vitin 2008, përmes një dispozite të re. Si pasojë e këtyre ndryshimeve, kjo figurë krimi konsiderohet si krimi më i rëndë mjedisor në Shqipëri. Kështu, aktualisht, shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor” (neni 206/a), masa e dënimit shkon nga pesë deri në 20 vjet si dhe “shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor” (neni 206/b), masa e dënimit shkon nga dy deri në tetë vjet.

Me gjithë ndryshimet e vazhdueshme, të cilat përgjithësisht ndjekin dinamikën, por dhe nevojën tonë për përshtatjen e legjislacionit tonë me atë të legjislacionit të BE-së, ajo që vihet re ishte që disa nga krimet e rënda të parashikuara në direktivat e krimit mjedisor, si p.sh. në fushën e mbrojtjes së florës dhe faunës, etj, nuk ishin përfshirë në kodin penal. Gjithsesi duhet evidentuar fakti që legjislacioni përkatës sektorial është përafëruar tashmë me legjislacionin e BE-së.

Gjithsesi, ajo që vlen të theksohet është që ndonëse zbatimi i ligjeve të reja sigurohej përmes një sistemi kundërvajtjesh administrative, për të cilat janë parashikuar edhe dënime të ashpra, ato nuk mund të konsideroheshin si të mjaftueshme për një mbrojtje efektive të mjedisit. Më tepër që, referuar standardit të përcaktuar në Direktivën e BE-së për krimin mjedisor, është e domosdoshme që shkeljet e rënda të legjislacionit kombëtar që zhvendos direktiva të caktuara të BE-së, të parashikohen si vepra penale.

Nevoja për përmirësime është evidentuar disa herë në qëndrimet apo takimet e përfaqësuesve më të lartë të ekzekutivit. Kjo nevojë u pa evidente, duke marrë parasysh dhe realitetin ku dëmet në mjedis ishin të konsiderueshme. Kështu në vitin 2014, ministri i Drejtësisë, Nasip Naço, në konferencën ndërkombëtare për parandalimin e Krimit Mjedisor të zhvilluar në Tiranë, u shpreh se “Të gjithë ata persona fizikë e juridikë që dëmtojnë mjedisin do të përballen me dënime, pasi dëmet në mjedis janë të konsiderueshme dhe për këtë arsye shtrohet nevoja e zbatimit të ligjit për mjedisin, ndërsa kërkoi idenë e ashpërsimit të masave penale ndaj abuzuesve me mjedisin”<sup>4</sup>.

“Në mjedis ka dëme të konsiderueshme, ndaj ligji për mjedisin duhet të vihet në zbatim. Për mjedisin kemi legjislacion të konsoliduar. Duhet të ashpërsohen masat penale për abuzuesit me mjedisin. Masat e deritanishme janë të pamjaftueshme”. Sipas Naços, krimi mjedisor në disa raste i kalon kufijtë. “Krimi mjedisor është i lidhur me krime të tjera. Ministria e Drejtësisë do të mbështesë luftën ndaj këtij krimi me ashpërsimin e masave penal”<sup>5</sup>.

<sup>4</sup> Nasip Naço, *Fjala*, Konferenca Ndërkombëtare për parandalimin e Krimit Mjedisor, mars 2014.

Agjencia e Lajmeve Sot News, “Krimi mjedisor, Ministria e Drejtësisë ashpërsor dënimet” ( 19.3. 2014).

Burimi elektronik:

<https://sot.com.al/politike/krimi-mjedisor-ministria-e-drejte/C3%ABsis%C3%AB-ashp%C3%ABrson-d%C3%ABnimet>

<sup>5</sup> Po aty.



Po kështu, në një takim, në hapje të sezonit turistik në vitin 2017, ministri i Mjedisit, z. Klosi u shpreh se: “Kush dëmton mjedisin tonë të përbashkët, që është malli ynë i përbashkët, pasuria jonë e përbashkët, mundësia jonë e përbashkët për të zhvilluar turizmin, mundësia jonë e përbashkët për të zhvilluar ekonominë, mundësia jonë e përbashkët për të zhvilluar mirëqenien, duhet të dënohet, të penalizohet”<sup>6</sup>. Ligji do të ashpërsohet, duke u kërkuar drejtuesve të policisë të jenë me të njëjtin vullnet të angazhuar në këtë operacion, ashtu si në operacionin e ndalimit të vjedhjes së energjisë elektrike. Klosi u kërkoj drejtuesve të policisë, që cdo biznes apo individ që ndot mjedisin të trajtohet dhe penalizohet njësoj sipas ligjit. “Historia që një biznes që ndot mjedisin apo krijon ndotje akustike, nuk penalizohet dhe tjetri pas tij po, duhet të marrë fund njëherë e përgjithmonë. Ne kemi nevojë të vendosim një legjislacion penalizues, edhe rregulla dhe dënime të barabartë në zbatim të ligjit”<sup>7</sup>.

Duke identifikuar nevojën për ndryshime, në fund të korrikut 2019, në kodin penal miratuar me ligjin nr. 44/2019 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar në fushën e mbrojtjes së mjedisit, janë bërë disa ndryshime të cilat kanë për qëllim të zhvendosin Direktivën 2008/99/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 19 nëntor 2008 “Për mbrojtjen e mjedisit përmes legjislacionit penal”.

Këto ndryshime, shkojnë dhe në linjën e plotësimit të detyrimeve të Shqipërisë në rrugën drejt Bashkimit Evropian. Kështu, nëse i referohemi, Raportit të Progresit për Shqipërinë për vitin 2016 ai evidentonte se “Direktiva për krimin në mjedis nuk është transpozuar ende”<sup>8</sup>.

Ky ndryshime përcaktojnë veprat penale të kryera nga persona fizike a juridike, me dashje apo nga pakujdesia dhe të cilat bien ndesh me legjislacionin specifik për mjedisin dhe për rrezatimet jonizuese apo me lejet/autorizimet që janë miratuar në zbatim të tyre dhe që rrezikojnë të shkaktojnë dëm real mbi cilësinë e ajrit, ujit, tokës, bimët, kafshët, shëndetin apo jetën e njeriut. Legjislacioni në fushën e mjedisit dhe të rrezatimeve jonizuese ka avancuar mjaft kohët e fundit, duke transpozuar në legjislacionin tematik/administrativ të vendit pjesë të rëndësishme të *acquis* së BE-së për mjedisin, të miratuar në përputhje me traktatin e KE-së dhe aktet për rrezatimet jonizuese të miratuara në përputhje me “Traktatin e Euratomit”. Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për kodin penal. Ky i fundit, për veprat penale në fushën e mjedisit, mbetet ende thjesht me parashikimet kombëtare. Problematika e deri sotme në zbatimin dhe detyrimin e legjislacionit për mjedisin ka treguar se mjedisi nuk mund të mbrohet siç duhet vetëm përmes legjislacionit specifik, administrativ. Prandaj ky legjislacion duhet të plotësohet edhe me veprat penale në fushën e mjedisit dhe sanksionet përkatëse të parashikuara në kodin penal. Për të siguruar një vazhdimësi dhe konsistencë midis kërkesave ligjore të legjislacionit specifik, sektorial për mjedisin dhe rrezatimet jonizuese të përafuar tashmë me ato të BE-së me parashikimet e kodit penal, kërkohet që edhe ky i fundit të reflektojë

<sup>6</sup> Bledi Klosi -Takim për fillimin e sezonit turistik , shtator 2017.

Agjencia e Lajmeve Sot News , “Takimi me drejtuesit e policisë, Ministri Klosi dhe Xhafaj: Krimi mjedisor do dënohet si çdo krim tjetër” ( 30.9. 2017).

Burimi elektronik:

<https://sot.com.al/politike/takimi-me-drejtuesit-e-policis%C3%AB-ministri-klosi-dhe-xhafaj-krimi-mjedisor-do-d%C3%ABnohet-si-%C3%A7do>

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Shqipërinë, viti 2016.

[shënim: termi *transpozim* i hasur shpesh në referime të kësaj natyre përdoret si huazim nga anglishtja: “transposition”, në shqip ka kuptimin “zhvendosje”, “ndërrim vendesh”].

kërkesat e legjislacionit Evropian në fushën e mjedisit.

Disa nga krimet që përshkruhen janë: shkarkimi i paligjshëm i substancave të dëmshme ose rrezatimi në ajër, tokë dhe ujë, mbledhja dhe transportimi, rikuperimi ose asgjësimi i mbeturinave në mënyrë të paligjshme, transportimi i mbetjeve në mënyrë të paligjshme, operimi i një instalimi industrial në të cilat substancat e rrezikshme ruhen, përdoren në mënyrë që shkakton dëmin e mjedisit, menaxhimi dhe trajtimi i materialeve nukleare i substancave të tjera radioaktive të rrezikshme në mënyrë të paligjshme, transporti i bimëve, kafshëve dhe specieve të mbrojtura të tyre, tregtimi i paligjshëm dhe ekzemplar të bimëve dhe kafshëve të mbrojtura, shaktimi i përqesimit të habitatit në tokat e mbrojtura, etj<sup>9</sup>.

Ky legjislacion tashmë është në fuqi, që nga data 8 tetor e këtij viti (2019). Në një intervistë për ATSH, zëvendësministrja Çuçi shtoi se: “Ne nuk duam të fusim njerëz në burg, absolutisht, por do të duhet që një herë e mirë njerëzit të bëhen koshtet që mjedisi nuk është një gjë që mund ta cenojmë kaq lehtë dhe nga e cila mund të shpëtojmë kaq lehtë nëse e cenojmë ndaj edhe janë bërë ndryshime të tilla në kodin penal”<sup>10</sup>.

Si pasojë e miratimit dhe zbatimit të këtyre amendimeve synohet dhe pritet që të rritet më shumë ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit i të gjithë aktorëve që veprojnë mbi mjedisin dhe që kanë potencial për ta rrezikuar atë përmes aktiviteteve të tyre.

## 4. Përfundime

Shqipëria, në përputhje me perspektivën tonë evropiane ka miratuar një kuadër penal duke ashpërsuar dhe dënimet për krimet në këtë fushë, dhe përafrimit të Direktivës së BE-së, duke përmbyshur kështu detyrimet për anëtarësim ku padyshim, mjedisi zë një vend të veçantë. Nga ana tjetër duke ju përgjigjur dhe situatës aktuale në Shqipëri ku shkatërrimi i parqeve, zonave të mbrojtura e diktonte si nevojë të menjëhershme. Mbetet për t’u parë zbatimi i këtij kuadri rregullues, si mundësi që do t’i presë rrugën abuzimeve me mjedisin.

## Bibliografi

1. *Kodi penal i Republikës së Shqipërisë*, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995.
2. Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. *Raporti i Progresi i Komisionit Evropian për Shqipërinë*, viti 2016.
4. Studim i Albanian Center for Environmental Governance.
5. Nasip Naço, *Konferenca Ndërkombëtare për parandalimin e Krimit Mjedisor*, Agjencia Sot, mars 2014.
6. Bledi Klosi, “Takim për fillimin e sezonit turistik”, Agjencia Sot, shtator 2017.
7. Ornela Çuçi, *Intervistë në ATSH*, shtator 2019.

<sup>9</sup> Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

<sup>10</sup> Ornela Çuçi, ATSH, “Çuçi: Mbrojtja e mjedisit nga krimi, plotësim i kushteve të BE-së”, (27.9.2019).

Burimi elektronik:

<https://ata.gov.al/2019/09/27/cuci-mbrojtja-e-mjedisit-nga-krimi-plotesim-i-kushteve-te-be-se/>

# Mbrojtja e mjedisit në këndvështrimin kushtetues



■ **Dr. (proc.) Jonida KONDILI**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë  
[jonidakondili@hotmail.com](mailto:jonidakondili@hotmail.com)

## Abstrakt

*Në këtë punim trajtohen disa probleme që lidhen me mbrojtjen e mjedisit duke evidentuar disa masa ligjore që ndikojnë në ndërgjegjësimin, edukimin dhe kujdesin që duhet të tregojmë për mjedisin. Mjedisi konsiderohet si një trashëgim i rëndësishëm, i cili duhet ruajtur me kujdes me qëllim që të kemi një trashëgimi të pasur. Mbrojtja e mjedisit bëhet jo vetëm duke njohur krimet mjedisore dhe vënies para përgjegjësisë së personave që i kryejnë ato, por dhe duke evidentuar e trajtuar dhe masa të tjera lidhur me mbrojtjen e mjedisit sikurse janë moratoriumet në fusha konkrete si lidhur me pyjet apo gjuetinë. Lidhur me papajtueshmërinë e ligjeve me kushtetutën, në rastin e moratoriumeve, si moratoriumi i gjuetisë, subjektet i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, për një gjykim abstrakt për t'u shprehur për papajtueshmërinë e tyre me kushtetutën. Në zbatim të ligjeve përkatëse për mbrojtjen e mjedisit si në rastin e pyjeve, në gjykatë janë paraqitur çështje për gjykim si kundërvajtje administrative. Gjatë gjykimit nga gjykata administrative është vlerësuar se ka mospërputhje të instituteve të caktuara me kushtetutën dhe i është adresuar Gjykatës Kushtetuese nëpërmjet gjykimit incidental. Qëllimi i punimit është të evidentojë disa të dhëna bazike dhe njohuri të reja në lidhje me problematikën e mbrojtjes së mjedisit, por dhe raportit që krijohet me marrjen dhe zbatimin e masave në këtë drejtim lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.*

## Fjalëkyçe:

**mjedisi, krim mjedisor, moratorium, gjykim abstrakt, gjykim incidental, të drejtat e njeriut.**

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

## 1. Hyrje

Rregullimi ligjor për mbrojtjen e mjedisit ka të bëjë me rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet njeriut dhe mjedisit. Mbrohen përbërësit e mjedisit dhe proceset mjedisore, sigurohen kushtet materiale për zhvillimin e qëndrueshëm duke plotësuar kuadrin e nevojshëm për zbatimin e kërkesës kushtetuese për një mjedis ekologjikisht të pastër<sup>1</sup>.

Mbrojtja e mjedisit përfshin fushë të gjerë si mbrojtjen e ajrit, burimeve natyrore e pasurive minerale, e ujërave, tokës dhe pyjeve, kullotave, biodiversitetit, që rregullohen me ligje të veçanta. Në mbrojtjen e biodiversitetit hyjnë të gjitha organizmat e gjalla, por dhe flora dhe fauna në një rajon pyjor, të cilat mund të përdoren vetëm nëse nuk dëmtohen proceset natyrore, si dhe nuk rrezikohen funksionet e tyre për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të mbrojtjes së mjedisit natyror. Në kreun IV të “Kodit penal të Republikës së Shqipërisë”, parashikohen vepra penale kundër mjedisit, midis të cilave: “Prerja e paligjshme e pyjeve”, “Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve” etj. Veprat penale mund të jenë krime ose kundërvajtje penale, por kur sipas ligjit shkeljet nuk sjellin përgjegjësi penale mund të jetë parashikuar përgjegjësia administrative. Lidhur me këto parashikime ligjore, ka rëndësi jo vetëm parashikimi i tyre si vepra penale ose kundërvajtje administrative, por me vend është edhe trajtimi i problematikave lidhur me masat dhe llojet e dënimit.

Në këtë punim trajtohen disa probleme lidhur me moratoriumin në pyje dhe gjueti. Shkelja e urdhërimeve të parashikuara në këto ligje, konsiderohet kundërvajtje administrative dhe ndaj personave përgjegjës zbatohen masat ndëshkuese të parashikuara në ligj. Gjatë evidentimit të shkeljeve dhe zbatimit të masave ndëshkuese subjekti përkatës

<sup>1</sup>Neni 56 i Kushtetutës, “Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij”.

i drejtohet gjykatës kompetente, konkretisht gjykatës administrative duke kundërshtuar aktin e nxjerrë nga organi lidhur me cilësimin e sjelljes si kundërvajtje administrative dhe zbatimin e masave ndëshkuese përkatëse. Në gjykimin e çështjeve gjykatat sipas vlerësimit të tyre kanë parashtruar argumente për papajtueshmëri të rregullimit ligjor me kushtetutën.

Mbi këtë bazë gjykata ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, e cila shqyrton çështjen dhe vendos mbi papajtueshmëri ose jo të ligjit. Në këto rrethana faktike dhe ligjore për mbrojtjen e mjedisit, kanë rëndësi të trajtohet kuptimi i gjykimit abstrakt dhe incidental, veçoritë që lidhen me këto gjykime, qëndrimet e gjykatës referuese, vendimi i Gjykatës Kushtetuese, për të arritur në disa përfundime konkrete. Metoda e përdorur është krahasimi analitik dhe rregullator i ligjeve dhe akteve nënligjorë në kuadër të gjykimit kushtetues.

## **2. Trajtimi i disa problematikave për mbrojtjen e mjedisit, lidhur me moratoriumet në pyje dhe të gjuetisë**

Mjedisi trajtohet si tërësi e kushteve natyrore e shoqërore dhe për rrjedhojë, nuk duhet kuptuar vetëm në aspektin e mbrojtjes së mjedisit natyror, sepse nëpërmjet marrjes së masave të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit natyror evidentohen dhe situata lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që mund të pretendohet se cenohen nga zbatimi i ligjeve apo akteve nënligjore që rregullojnë mbrojtjen e mjedisit.

Pjesë e mjedisit janë, mes të tjerave pyjet dhe biodiversiteti, mbrojtja e të cilëve merr një rëndësi të veçantë. Përveç ligjeve që rregullojnë drejtpërdrejt këto pjesë të mjedisit në kohë dhe situata të caktuara vendosen dhe rregulla të veçanta që reduktojnë ndërhyrjet mbi këto pasuri. Aktualisht është në fuqi ligji nr. 5/2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”. Qëllimi i këtij ligji është të reduktojë ndërhyrjet në fondin pyjor, të degraduar si pasojë e mbishfrytëzimit dhe dëmtimeve të tjera, me synim përmirësimin dhe rehabilitimin e gjendjes së tij<sup>2</sup>. Nëpërmjet këtij ligji ndalohet ushtrimi i veprimtarisë së shfrytëzimit të lëndës drusore në fondin pyjor publik/privat, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, tregtimi i produkteve të tij, ndalimi i eksportit të lëndës së drurit të papërpunuar, lëndës së ndërtimit, drurëve të zjarrit, si dhe qymyrit të drurit.

Në ligj përcaktohen dhe rastet e përjashtimit midis të cilave përfshihet shfrytëzimi i lëndës drusore për plotësimin e nevojave të banorëve të bashkive për dru zjarri. Afati i zbatimit të këtij ligji është 10 (dhjetë) vjet nga data e hyrjes së tij në fuqi.

Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në vlerën 5 (pesë milion) lekë. Ndaj vendimit të dhënë në këtë rast bëhet ankim në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Gjithashtu për përmirësimin e gjendjes së faunës së egër ka dalë ligji nr. 61/2016 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë ligj përcaktohen rregullat që do të zbatohen gjatë ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në këtë ligj janë përcaktuar rastet e përjashtimeve të caktuara nga fusha e zbatimit të tij. Afati për zbatimin e këtij ligji është 5 (pesë) vjet nga data e hyrjes në fuqi.

<sup>2</sup> Neni 1 ligjit nr. 5/2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”.

Edhe në këtë rast shkeljet e këtij ligji kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë nga 800 000 (tetëqind mijë) - 100 0000 (një milion) lekë, kur shkelja kryhet e organizuar nga operatorët e turneve të gjuetisë, shoqatat ose federatat e gjuetarëve, ndërsa kur shkelësi është individ ose është individ pjesëtar i subjekteve organizuese dënohet me gjobë në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) -100 000 (njëqind mijë) lekë<sup>3</sup>.

Me vendosjen e moratoriumit kanë lindur probleme lidhur me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e pyjeve, në rastin e prerjes së druve të zjarrit. Ligjvënësi këtë situatë e ka pasur parasysh duke përcaktuar një rregullim specifik lidhur me drutë e zjarrit. Por, në këtë drejtim, mund të lindin dhe mosmarrëveshje, sikurse janë konstatuar dhe raste konkrete. Në fakt, rezultojnë të ketë vështirësi praktike për të përcaktuar situatën konkrete, por ndodh që pa analizuar rrethanat konkretisht, të zbatohet gjoba fikse prej 5 milion lekësh<sup>4</sup>.

Në rastet e paraqitura për gjykim si kundërvajtje administrative, gjykatat kanë përdorur të drejtën e parashtrimit të kërkesës, gjatë gjykimit incidental, pranë Gjykatës Kushtetuese. Në kërkesë gjykata ka pretenduar për shkeljen e të drejtave të njeriut, sepse vetë zbatimi i një gjobe fikse duhet të konsiderohet një qëndrim antikushtetues. Është pretenduar gjithashtu në mënyrë konkrete se zbatimi i një gjobe fikse cenon parimin e sigurisë juridike dhe parime të tjera kushtetuese.

Por, subjektet e interesuara mund t'i drejtohen drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese, duke iniciuar një gjykim abstrakt kushtetues, sikurse është rasti i shfuqizimit si të papajtueshëm me kushtetutën i ligjit nr. 61/2016 lidhur me shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë<sup>5</sup>.

### 3. Roli i Gjykatës Kushtetuese në kontrollin dhe zbatimin e ligjit

Kushtetuta është ligji themelor mbi bazën e së cilës organizohet dhe funksionon një shtet. Vendi dhe roli i kushtetutës në hierarkinë e ligjeve është përcaktuar qartë në nenin 116 të saj. Ajo konsiderohet ligj që ka epërsi në raport me të gjitha ligjet e tjera, gjë që do të thotë se ligjet e tjera duhet të nxirren në bazë dhe për zbatim të kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të kushtetutës. Ndër kompetencat kryesore ka kontrollin abstrakt të ligjeve, me zbatimin e të cilit vendos për pajtueshmërinë e ligjit me kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare<sup>6</sup>.

Si parim gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm kushtetutës dhe ligjeve. Megjithatë kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe i a dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat.<sup>7</sup> Kontrolli abstrakt i ligjeve njihet si rishikim i drejtpërdrejtë, ndërsa rasti kur çështja Gjykatës Kushtetuese i adresohet prej gjyqtarëve njihet si gjykim konkret, gjykim i tërthortë ose gjykim incidental. Është gjykim konkret, sepse iniciativën për paraqitjen

<sup>3</sup> Neni 6 i ligjit nr. 61/2016 "Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë".

<sup>4</sup> Neni 6/1 i ligjit nr. 61/2016 "Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë."

<sup>5</sup> Vendim nr. 73, datë 17.11.2017 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>6</sup> Neni 131 shkronja "a" e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

<sup>7</sup> Neni 145 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

e kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese e ka gjykata, kur gjatë gjykimit të një çështje konkrete, konstaton se zgjidhja në themel e çështjes varet nga ligji që çmohet se është i papajtueshëm me kushtetutën. Subjektet të cilat kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, lidhur me papajtueshmërinë e ligjeve me kushtetutën, janë të përcaktuara në kushtetutë dhe Gjykata Kushtetuese rast pas rasti verifikon legjitimitetin e tyre.

Gjykatat njihen si subjekt për tu legjitimuar në gjykimin kushtetues. Por, njëkohësisht për tu krijuar kjo mundësi duhet të plotësohen disa kritere, të cilat përcaktohen nga karakteristikat e gjykimit incidental.

#### 4. Karakteristikat e gjykimit abstrakt dhe incidental

Gjykata Kushtetuese e ka kristalizuar këtë praktikë, e për rrjedhojë, është e rëndësishme njohja dhe zbatimi i saj. Kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e qasjes të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i kushtetutës, sipas të cilit kur gjyqtarët çmojnë se ligjet bien në kundërshtim me kushtetutën, nuk i zbatojnë ato, por pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e normës. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese është konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, i cili përcakton edhe disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental: *së pari*, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); *së dyti*, duhet të parashtrijë arsye serioze për papajtueshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij, duke referuar në normat ose parimet konkrete të kushtetutës, *së treti* përpara marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të arrijë në përfundimin se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa iu dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në të kundërt, nëse gjykata referuese çmon se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e saj për zgjidhjen e çështjes, edhe pse sipas saj vlerësohet si jokushtetues, ajo duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes<sup>8</sup>.

Në këtë kuptim, kërkohet një raport i domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës Kushtetuese (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese. Po ashtu, gjykata referuese, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me kushtetutën. Është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretuese, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjykata referuese është e detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues. Në rast se ajo vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me kushtetutën, atëherë duhet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret<sup>9</sup>.

Ndryshe paraqitet rasti në gjykimet e kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, nga

<sup>8</sup> Shih vendimin nr. 39, datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>9</sup> Shih vendimet nr. 7, datë 16.2.2015; nr. 39 datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134/2 të kushtetutës<sup>10</sup>, të cilat kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur.

Një ndër subjektet që i drejtohen shpesh Gjykatës Kushtetuese për gjykim abstrakt janë dhe shoqatat, të cilat ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pasur legjitimitet vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo interes bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të situatës së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi papajtueshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit me kushtetutën<sup>11</sup>.

Evidentimi në mënyrë konkrete lidhur me gjykatat dhe shoqatat, si subjekte iniciuese në gjykimin kushtetues, merr rëndësi nisur nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e rasteve që lidhen më papajtueshmërinë e moratoriumit të pyjeve dhe gjuetisë.

## 5. Raste nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese lidhur me moratoriumet

Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkëta. Ato, në cilësinë e “organizatave”, janë të specifikuar në nenin 134/1/h të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre<sup>12</sup>.

Federata Kombëtare Shqiptare për Gjueti dhe Konservim dhe Shoqata e Tregtarëve të Armëve dhe Materialeve të Gjahut i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar se ligji nr. 61/2016 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë” është i papajtueshëm me kushtetutën, për rrjedhojë kanë kërkuar shfuqizimin e tij. Pretendimet kryesore të tyre ishin se ky ligj cenonte parimin e sigurisë juridike, pasi nuk kishte respektuar qëndrueshmërinë e të drejtës së gjuetisë, pandryshueshmërinë e saj në substancë dhe ndryshimin e saj vetëm në mënyrë të favorshme për gjuetarët. Gjithashtu, sipas shoqatave, ligji cenonte të drejtën e pronës private. Personat që ushtrojnë këtë veprimtari fitojnë pronësinë mbi gjahun që vrasin. Kjo pronësi është ushtruar në përputhje me rregullat për një kohë të gjatë, pra nuk ka qenë një e drejtë fiktive, por reale dhe e ushtruar në kohë, e cila cenohet nga ligji i kundërshtuar.

Gjykata Kushtetuese gjatë shqyrtimit të çështjes vlerësoi se ligji nr. 61/2016 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë” ka vendosur ndalimin e ushtrimit të aktivitetit të

<sup>10</sup> Sipas nenit 134/2 të Kushtetutës parashikohet se subjektet si: Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, çdo gjykatë, çdo komisioner i krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta; Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë; organet e qeverisjes vendore; organet e bashkive fetare; partitë politike; organizata; individë.

<sup>11</sup> Shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>12</sup> Shih vendimin nr. 78, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese.



gjuetisë, por ai nuk ka parashikuar asnjë kufizim në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike të subjekteve tregtare që merren me armët dhe materialet e gjuetisë. Sipas gjykatës, shoqatat nuk kanë arritur të argumentojnë se cili ishte dëmi real dhe i drejtpërdrejtë që sillte ky ligj në veprimtarinë tregtare të anëtarëve të tyre, pra se në ç'mënyrë dhe në ç'masë prekeshin ata nga këto rregullime ligjore.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se pretendimet e shoqatave nuk ishin të bazuara, duke vendosur rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e moratoriumit të gjuetisë<sup>13</sup>.

Në rastin e shqyrtimit të ligjit nr. 5/2016, datë 4.2.2016 "Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë", iniciuese ka qenë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Korçë, para së cilës ishte paraqitur për shqyrtim çështja me palë paditëse shtetasin M.B. dhe palë të paditur Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Korçë, me objekt shfuqizimin e aktit administrativ nr. 78, datë 11.7.2016 të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Korçë, me vendimin e datës 20.3.2017 ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e saj pranë Gjykatës Kushtetuese. Gjykata ka pretenduar shfuqizimin e nenit 6/1 të ligjit nr. 5/2016, datë 4.2.2016 "Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë".

Gjykata Kushtetuese, në këtë rast arriti në përfundimin se gjykata referuese nuk ka argumentuar nëse dispozita për të cilën kërkohet shfuqizimi si e papajtueshme me Kushtetutën është e vetmja që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete dhe nëse ka bërë përpjekje për interpretimin e ligjit në pajtim me kushtetutën<sup>14</sup>, duke vendosur rrëzimin e kërkesës.

## 6. Përfundime

Konferenca, për qëllim të së cilës u trajtua dhe ky punim, ka temë krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare, që në një interpretim të zgjeruar mund të pranojmë çdo lloj shkelje të normave juridike përkatëse që parashikon dhe sanksionet përkatëse sikurse u trajtua dhe në punim.

Trajtimi i problematikës lidhur me sa trajtohet në këtë drejtim është një çështje sensibilizuese dhe e domosdoshme për krijimin e një opinioni sa më pozitiv lidhur me mbrojtjen e mjedisit. Mjedisi i shërben shoqërisë dhe midis anëtarëve të shoqërisë krijohet një marrëdhënie shoqërore objekt i së cilës është mjedisi. Mbrojtja e tij jo vetëm është detyrë morale e çdo anëtari të shoqërisë, porse në situata të caktuara vendosen norma juridike, rregulla të detyrueshme për tu zbatuar me qëllim që të vijnë pasojat e dëshiruara lidhur me mbrojtjen e mjedisit.

Normat shprehin interesat e shoqërisë për një problem kaq të rëndësishëm jetik, që është problem jo vetëm për shoqërinë e vendit tonë por dhe atë mbarë botërore. Në këtë drejtim është shumë i rëndësishëm njohja e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit, por dhe përcaktimi i përmbajtjes së tij lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

<sup>13</sup> Vendim nr. 36, datë 21.04.2017 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>14</sup> Vendim nr.73, datë 17.11.2017 i Gjykatës Kushtetuese.

## Bibliografia

### BOTIME E ARTIKUJ

1. Anastasi, Aurela. *E drejta Kushtetuese*. Tiranë: Pegi, 2003.
2. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri. *Debati kushtetues, Vëllim I*. Tiranë: P.S.H., 2006.
3. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri. *Debati kushtetues, Vëllim II*. Tiranë: P.S.H., 2006.
4. E. Lee, Rex. *Vështrime të një juristi për Kushtetutën*. Tiranë: Nënë Tereza, 2000.
5. Fasso, Guido. *Historia e filozofisë të së drejtës*. Tiranë: Luarasi, 2005.
6. Loloçi, Krenar. *E drejta Kushtetuese*. Tiranë: DERADA, 1997.
7. Loloçi, Krenar. *Kushtetuta e re dhe nevoja për një mentalitet të ri*. Tiranë: Horizont, 2009.
8. Martinez, Temistocle. *DirittoCostituzionale (settimaedizione) riveduta e aggiornata*. Milano: Giuffrè, 2000.
9. Nowicki, Antoni Marek. *Rreth Konventës Evropiane*. Përkthyer nga Edlira Lloha. Tiranë: Qendra Shqiptare për te Drejtat e Njeriut, 2003.
10. Omari, Luan. *Parime dhe institucione të së drejtës publike*. Tiranë: Botimet Elena Gjika, 2004.
11. Sadushi, Sokol. *Kontrolli kushtetues*. Tiranë: BOTIMPEX, 2004.
12. Sokoli, Lekë. *Metodat e kërkimit në shkencat sociale*. Tiranë: Institutit i Sociologjisë 2009.
13. Traja, Kristaq. *Drejtesia kushtetuese*. Tiranë: Luarasi, 2000.
14. Zaganjori, Xhezair. *Demokracia dhe shteti i së drejtës*. Tiranë: Luarasi 2000.
15. Zaganjori, Xhezair, Aurela Anastasi dhe Eralda Çani (Methasani). *Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*. Tiranë: Adel Co., 2011.

### AKTE NORMATIVE

16. Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
17. "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.
18. Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
19. Ligji nr. 5/2016, datë 4.2.2016 "Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë."
20. Ligj nr. 61/2016, datë 2.6.2016 "Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë".
21. Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

# Mjedisi, siguria dhe iniciativat globale



■ **MSc. Valeria BARDHAJ**  
Ministria e Drejtësisë  
valeriabardhaj@gmail.com

## Abstrakt

Mjedisi i përket të gjithëve dhe është frymëmarrje e çdo individ në planet. Nuk ka rëndësi emri, ngjyra e lëkurës, gjinia apo mosha, mjedisi është i të gjithëve e për këtë arsye mbrojtja e tij është detyrim moral dhe ligjor. Kur themi mbrojtje e mjedisit nuk nënkuptojmë vetëm marrjen e masave apo ashpërsimet e kodit penal për këtë krim, por është me rëndësi të kuptohet që mbrojtja e mjedisit ka të bëjë me forcimin e marrëdhënies mes njerëzve dhe ekosistemit. Për këtë apo dhe shumë arsye specifike shkencëtarë apo ekologë të ndryshëm e përcaktojnë njeriun si një nga pjesët më kryesore që përbën ekosistemin. Dy dekadat e fundit kemi parë ndryshime të jashtëzakonshme të ekosistemit, fakt ky i konstatuar dhe i krahasuar nga ekspertët e fushës veçanërisht nëpërmjet provave gjeologjike apo arkeologjike që lejojnë hetimin e një game të gjerë të tranzicioneve gjeografike, oqeanografike, klimatike dhe biotike. Ndryshimet mjedisore të shkaktuara nga globalizimi përllogariten aq të larta, sa edhe siguria duhet të kuptohet si një proces ekologjik. Në këtë punim nëpërmjet një këndvështrimi historik të ndryshimeve mjedisore do të nxjerr në pah sfidat kryesore me të cilat po përballet planeti ynë, si dhe forcimin e kapaciteteve nga qeveritë dhe profesionistë të fushës për të garantuar një mjedis të sigurt. Po ashtu, në këtë punim do të rendis disa prej krimeve më të tmerrshme mjedisore, si dhe do të përshkruaj iniciativat e ndërmarra globalisht për dënimin e autorëve, fushatat sensibilizuese apo përballimin e tyre në rastet kur janë shkaktuar nga vetë natyra. Në këtë punim do të gjej vend edhe një pyetësor mbi ndotjen akustike, i cili do të plotësohet online nga qytetarë të rastësishëm të Tiranës, të dhënat do të analizohen për një konkluzion mbi problematikën. Gjithashtu do të përshkruaj dhe komentoj iniciativat globale mbi hartimin e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit, si dhe përshtatjen e legjislacionit shqiptar, ashpërsimin e kodit penal për dënimin e krimeve mjedisore.

## Fjalëkyçe:

**mjedis, mbrojtje, globalizim, ekosistem, legjislacion.**

## 1. Komponentët e mjedisit dhe problematikat mjedisore në vendin tonë

Përgjatë disa dekadave, studiues të çështjeve të mjedisit, qytetarët e zakonshëm, qeveritë, të mbështetur edhe nga media i kanë kushtuar gjithnjë e më shumë vëmendje problematikave që lidhen me mjedisin dhe sigurinë mjedisore. Shoqëria në tërësi ka shfaqur gjerësisht shqetësime mbi ndotjen e mjedisit, veçanërisht vendet e mëdha industriale, ku mund të përmendim Kinën, e si rezultat kanë filluar të prodhohen politika, ligje e të ndërmerren një sërë fushatash sensibilizuese mbi mbrojtjen e mjedisit dhe garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit. Koncepti i mjedisit lidhet me marrëdhënien e ngushtë të njeriut me mjedisin natyror duke pasur në konsideratë të drejtën e natyrës, harmoninë e bashkëjetesës mes njeriut e natyrës, si dhe rëndësinë e përfshirjes së natyrës në përditshmërinë e njeriut. Mjedisi përkufizohet si habitati kryesor i zhvillimit të jetesës së njeriut dhe gjallesave në tokë. Pra, përbërësit natyrorë: ajri, toka, ujërat, klima, flora dhe fauna në tërësinë e ndërveprimeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore, si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu.<sup>1</sup>

Pa një histori konceptore të mjedisit, nuk është e mundur të fitohet një kuptim thelbësor i ndryshimeve në perceptimin dhe pritjet e njerëzve për mjedisin në një kontekst kulturor, shoqëror dhe politik.<sup>2</sup>

Pra, kërkimi shkencor mbi sigurinë mjedisore kërkon një qasje ndërdisiplinore, e cila përfshin një historik të shkurtër mbi zhvillimet e mjedisit në periudha të ndryshme.

<sup>1</sup> Ligj nr. 10 431, datë 9.6.2011 *Për mbrojtjen e mjedisit*, neni 5, pika 7.

<sup>2</sup> A History of Australasian Philosophy, Edition: first, Chapter: 18, Publisher: Springer, Editors: N.N. Trakakis and G. Oppy, pp.543-591

Shkencëtarët kanë besuar se planetët shkëmborë, ku një prej tyre është edhe Toka, u krijuan nga shembja e shpejtë e një reje pluhuri, por në vitet 1960 programi hapësinor *Apollo* e hodhi poshtë këtë qasje, pasi studimet e kraterëve të hënave zbuluan se këto masa janë shkaktuar nga ndikimi i objekteve që ishin me bollëk të madh rreth 4.5 miliardë vjet më parë. Pikërisht në këtë periudhë, nxehtësia dhe graviteti formuan evolucionin e planetit. Këto forca u bashkuan gradualisht nga efektet globale të shfaqjes së jetës.

Shkencëtari Clarie C. Patterson argumentoi se disa meteoritë ishin formuar rreth 4.56 miliardë vjet më parë, duke krijuar tokën, e cila me kalimin e viteve filloi të ruajë atmosferën e saj dhe të krijojë thelbin, nga ku më vonë u shfaqën kontinentet, e pjesa e vetme e kores së Tokës që nuk riciklohet. Formimi i atmosferës, është një tjetër dimension i rëndësishëm i mjedisit, pasi kjo bashkësi gazesh bënë të mundur të ketë jetë edhe përtej oqeanit. Nga ana tjetër, rreth 150 milion vjet më parë kur u vu re se në rajonet polare mbizotëruan pyjet, nga hetimi i këtij fenomeni, shkencëtarët arritën në konkluzionin se bimësia përshtatet me gjatësinë e orëve të dritës së diellit apo errësirës. Ky konkluzion, si dhe studimi i fosileve të vjetra prej 200 milion vitesh nga Groenlanda, ishin faktorët kryesorë, që ndihmuan ekspertët e fushës në qartësimin e pikëpyetjeve që kemi mbi ngrohjen globale lidhur me tendencat aktuale të niveleve të dyoksidit të karbonit do të ndikojnë në klimë.

Studiuesit kanë ngritur hipotezën se atmosfera tokësore u krijua nga gazrat që dilnin nga brendësia e planetit, dhe se atmosfera tokësore përmban sasi të mjaftueshme të gazrave siç janë amoniaku dhe metani për të dhënë lëndë organike. Rikrijimi i përbërjes atmosferike pas shpërthimeve të mëdha vullkanike në Siberi 250 milion vjet më parë, ka shtuar peshën në idenë, se këto shpërthime dëmtuan në mënyrë dramatike shtresën e ozonit në atë kohë.<sup>3</sup>

Si koncept, atmosfera është shtresa e gaztë e hapësirës rreth tokës e cila e mbështjell tërë planetin tonë. Toka mbështillet prej atmosferës, e cila kufizohet në pjesën e poshtme nga sipërfaqja e oqeanike dhe kontinentale.<sup>4</sup> Atmosfera e bën të mundshëm qarkullimin e ujit në natyrë, por edhe e mbron Tokën nga meteoritët e shumtë që bien në të. Pa atmosferën, klima në Tokë do të ishte si në Hënë, një shkretëtirë pa ujë dhe pa jetë.<sup>5</sup>

Pavarësisht se më sipër paraqitëm një retrospektivë të shkurtër lidhur me qasje të shkencëtarëve të ndryshëm për mjedisin, tokën, atmosferën do më duhet të theksoj faktin se marrëdhënia mes njeriut dhe mjedisit është tejet e ngushtë jo vetëm për faktin se është faktori kryesor që vendos harmoninë me mjedisin, por edhe për faktin se njeriu e përshtat mjedisin sipas kërkesave të tij. Kur themi përshtatje është e qartë që ai do të tentojë ta ndryshojë mjedisin. Njeriu rrethohet nga mjedisi, ndërsa ky i fundit kryesisht përbëhet nga atmosfera, hidrosfera, litosfera dhe biosfera.

## 2. Shpjegim mbi komponentët e mjedisit

Litosfera është shtresa e ngurtë e cila përmban masën kryesore të planetit. Hidrosfera është shtresa e lëngët e cila mbështjellë një pjesë të madhe të sipërfaqes së tokës. Ndërsa

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

<sup>3</sup> Department of Animal and Plant Sciences, Studying the earth's history predicts future global change <https://www.sheffield.ac.uk/aps/research-2016/impact/understanding-environmental-change/history>

<sup>4</sup> Punim Seminar, *Toka dhe dukuritë atmosferike*, Kujtim Baraliu, f. 10, Prizren 2014.

<sup>5</sup> Punim Seminar, *Toka dhe dukuritë atmosferike*, Kujtim Baraliu, f. 24, Prizren 2014.

atmosfera është shtresa e gaztë e hapësirës rreth tokës e cila e mbështjell tërë planetin tonë.<sup>6</sup> Ndërsa, biosfera, është shtresa e jetës në tokë që përfshin të gjithë organizmat e gjalla.

Njeriu nuk do të mund të jetonte pa pasur habitatin e tij, pra është pikërisht toka, mjedisi, i cili i shërben interesave të përditshme të njeriut, duke i krijuar rahatitë e një jetese cilësore. Por, qenia njerëzore është e çuditshme, pasi duke u fokusuar në parimin për të përfituar apo përvetësuar sa më shumë nga natyra shpeshherë ka prishur edhe ekuilibrat natyrorë. Jo vetëm kaq, por dëshira e botës njerëzore për tu zhvilluar sa më shumë, apo prirja drejt risive teknologjike ka bërë që ndërhyrja në mjedis nga dora e njeriut të sjellë pasoja negative, përmendim këtu dëmtimin e florës dhe faunës, ndotjen e tokës, ku vendin kryesor e zënë mbetjet kimike, si dhe shkatërrimin e ekosistemeve. Teksa hulumtoja për këtë kërkim shkencor, u fokusova tek dy prej pyetjeve të mija kërkimore mbi problematikat mjedisore në vendin tonë, të cilat gjenden më poshtë. *Po në vendin tonë dora e njeriut a ka sjellë shkatërrim? A ka shkaktuar dora e njeriut krime mjedisore në Shqipëri?*

Përpara se t'u jap përgjigje këtyre dy pyetjeve kërkimore, dua të sqaroj konceptin e krimit mjedisor: Krimi mjedisor mbulon akte që shkelin legjislacionin mjedisor, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme ose rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Fushat më të njohura të krimit mjedisor janë emetimi ose shkarkimi i paligjshëm i substancave në ajër, ujë ose tokë, tregtimi i paligjshëm i jetës së egër, tregtia e paligjshme e substancave që shkatërrojnë ozon dhe dërgesa e paligjshme ose hedhja e mbeturinave.<sup>7</sup>

Në një artikull të *Institutit të politikave mjedisore*, - pra bëhet fjalë për një OJF mjedisore (ky burim gjendet i cituar në fund të këtij punimi, në seksionin artikuj *online*), - u njoha me disa detaje interesante lidhur me gjendjen e mjedisit të vendit tonë gjatë regjimit komunist.

Pikërisht për këtë periudhë, ky artikull sqaronte situatën mjedisore në Shqipëri, që rezultonte alarmante për qytetarët, të cilët vuanin pasoja të tmerrshme, ndërsa për qeverinë shihej si një situatë normale. Duke qenë se regjimi komunist i asaj kohe kishte një qasje drejt industrisë së rëndë, e cila nuk përmbushte standardet për mbrojtjen e mjedisit, u sollën pasoja të tmerrshme. Këto pasoja lidheshin me shkatërrimin e faunës dhe florës, ndotjen e ajrit, ujit, kjo veçanërisht në zonat pranë fabrikave, po ashtu popullsia që jetonte në këto zona shfaqën probleme në frymëmarrje, apo edhe deformime që në lindje.

Në shumë studime të tjera arrihej në konkluzionin se Shqipëria ka pika të nxehta të ndotura të shpërndara në mbarë vendin: një trashëgimi e regjimit komunist 45-vjeçar, nëpërmjet zhvillimit të industrisë së rëndë ndotëse e cila nuk i kushtoi vëmendje mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit.<sup>8</sup>

Edhe pas rënies së regjimit komunist problematikat mjedisore të mbartura dhe ato të reja ishin edhe më evidente, madje qytetarët duke përfituar nga rënia e regjimit, periudha tranzicionit, moszbatimi i ligjit me përpikëri, si dhe kultura e trashëguar vazhduan të shkatërrojnë mjedisin, vazhduan të kryejnë krime mjedisore duke sjellë pasoja për vetë natyrën dhe brezat e ardhshëm. Shumë biznese, mbeturinat, inertet, i derdhnin në ujërat e lumenjve, deteve. Po ashtu, banorët e zonave rurale nga një

<sup>6</sup> Punim Seminarit, *Toka dhe dukuritë atmosferike*, Kujtim Baralio, f. 10, Prizren 2014.

<sup>7</sup> Combating Environmental Crime- <https://ec.europa.eu/environment/legal/crime/index.htm>

<sup>8</sup> Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, *Çështje europiane dhe të sigurisë* nr. 18, f. 7, [http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/01/ceshtje\\_te\\_sigurise\\_18.pdf](http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/01/ceshtje_te_sigurise_18.pdf)

kulturë e trashëguar më parë, mbeturinat i derdhnin buzë lumenjve, nisi prerja e pyjeve për përfitime monetare, gërmimi i maleve për nxjerrjen e gurëve, të cilët do të sillnin përfitime kolosale. Po ashtu, bizneset pranë zonave bregdetare, praktikonin derdhjen e ujërave të zeza në det. Nga ana tjetër, tregtia e paligjshme e gjallesave të detit apo dhe përdorimi i eksplozivit për kapjen e këtyre gjallëve, etj., ishin një sërë nga krimet mjedisore për të cilat vendi ynë ishte i papërgatitur t'i menaxhonte dhe t'i dënonte për shkak se nuk kishte një legjislacion të posaçëm.

Sqarimi i mësipërm tregon fare qartë se ndër vite, nga një sistem në tjetrin, njeriu është shkaktari kryesor në shkatërrimin e mjedisit. Sipas përkufizimit të mësipërm mbi krimin mjedisor dhe legjislacionit përkatës (të cilin do e sqarojmë edhe më poshtë) njeriu ka shkatërruar me ndërgjegje të plotë, për përfitime personale ambientin ku jetojmë, ka ndotur ujërat duke u bërë kështu burim kontaminimi për popullsinë, si dhe ka kontribuar negativisht në shkatërrimin e pyjeve, maleve apo zonave bregdetare. Ai ka shkelur legjislacionin mjedisor duke sjellë pasoja të rënda dhe me rrezik për mjedisin dhe shëndetin e popullsisë.

## **2. Legjislacioni shqiptar, ndryshimet ndër vite si garanci e një mjedisi të sigurt. Ndikimi i problematikave mjedisore në sigurinë e njeriut.**

Për herë të parë pas viteve 1990 fokusi po fillonte të vihej mbi mbrojtjen e mjedisit, veçanërisht në hartimin e legjislacionit përkatës, politikave mjedisore dhe ndryshimet në kodin penal. Po ashtu, duke u mbështetur në objektivat e partnerëve ndërkombëtarë, veçanërisht të BE-së, si dhe mbi parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, që ka të bëjë me plotësimin e nevojave të së tashmes pa rrezikuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre, ishin drejtimet kyçe për hartimin e legjislacionit mjedisor.

Në vitin 1993, kemi për herë të parë një ligj për mjedisin, konkretisht: ligj nr. 7664, datë 21.1.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Ky legjislacion, për shkak se ende vendi ynë nuk kishte kushtetutën, ishte i bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, ku mbrojtja e mjedisit cilësohej si:

“Mbrojtja e mjedisit përbën një kusht themelor për sigurimin e zhvillimit të shoqërisë dhe një përparësi kombëtare dhe ka këto elemente kryesore strategjike: parandalimin dhe uljen e ndotjes së ujit, të ajrit, tokës dhe të ndotjeve të tjera të çfarëdolloj, ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike sipas bazës natyrore biogeografike të vendit, shfrytëzimin racional të burimeve natyrore dhe shmangien e mbishfrytëzimit të tyre; riaftësimin ekologjik të zonave të dëmtuara nga veprimtaria njerëzore ose fenomenet natyrore shkatërruese si dhe ruajtjen e ekuilibrit ekologjik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës”.<sup>9</sup>

Më pas, një moment i rëndësishëm ishte edhe hartimi i “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, në vitin 1998, moment ky u pasua me hartimin e legjislacionit të ri për mjedisin, në vitin 2002, konkretisht ligj nr. 8934, datë 5.9.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i cili ishte i mbështetur në kushtetutë, si dhe përpara këtij ligji qeveria e asaj kohe kish hartuar edhe planin kombëtar për mjedisin i mbështetur në direktivat e BE-së, duke qenë se në ato vite prioritet ishte integrimi i vendit tonë në BE. Më pas kemi ratifikimin e një sërë konventash për mjedisin, shumë marrëveshje të përbashkëta mes dy apo më shumë shteteve, ligje për mbrojtjen e ujit, ajrit, biodiversitetit, për mbrojtjen

<sup>9</sup> Ligj nr. 7664, datë 21.1.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

e mjedisit detar, për pyjet, për mbrojtjen nga zhurmat etj., apo VKM-të për burimet ujore, për kufijtë ujorë etj. Po ashtu, kemi krijimin e institucioneve për mjedisin siç janë: Ministria e Mjedisit, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, apo edhe institucione të tjera të krijuara rishtazi për mbrojtjen e pyjeve, ujërave, zonave të mbrojtura, etj. Një tjetër etapë e rëndësishme, lidhet edhe me ndryshimet dhe risitë në kodin penal. Në kreun IV, nenet 201-207, kemi të parashikuar “Veprat penale kundër mjedisit”<sup>10</sup> si tregues i një ndryshimi të rëndësishëm që konsiston në konceptimin e mjedisit si një objekt grupor i veçantë dhe i përbërësve të tij (ajri, uji, toka, bimët, kafshët), si objekte të drejtpërdrejta të veprave penale, të mbrojtura posaçërisht me normat penale të këtij kreu të veçantë.

Po ashtu, në periudha të ndryshme, ka pasur evoluim të dënimeve në kodin penal, të cilat e përcaktojnë mjedisin si një e mirë e përbashkët, madje në kodin penal ndër vite, kemi një shtim të veprave penale, përmendim këtu shkatërrimin e pyjeve nga zjarri, cilësuar në nenin 206, apo dënime për shkatërrimin e zonave të mbrojtura. Gjithashtu në vijimësi të ndryshimeve ligjore kemi ashpërsim të dënimeve për vepra të caktuara, veçanërisht për krimet kundër mjedisve pyjore. Veçmas ndryshimeve thelbësore, një sërë fushatash sensibilizuese janë ndërmarë në kuadër të mbrojtjes së mjedisit, si dhe është përcaktuar në kalendarin e ditëve kombëtare e ndërkombëtare, data 5 qershor, si dita kombëtare e mjedisit, datë kjo, që e ka zanafillën në vitin 1972, në konferencën e mbajtur në Stokholm mbi çështjet mjedisore.

Pra, kemi të bëjmë me hartimin e një sërë aktesh juridike dhe institucionesh nga qeveria, duke konfirmuar kështu, rëndësinë për mbrojtjen e mjedisit e duke garantuar kështu forcimin e kapaciteteve të mbrojtjes mjedisore në kuadër të sigurisë kombëtare e asaj mjedisore. Ndonëse për kuadrin ligjor mjedisor janë bërë përpjekje në drejtim të përafrimit, ai ende vuan nga fenomeni i moszbatimit të detyrave dhe përgjegjësi. Ligji nuk praktikohet njësoj kudo dhe siguron një bazë të dobët për zbatueshmërinë e dispozitave për mbrojtjen mjedisore.<sup>11</sup> Ndër vite vihet re se Shqipëria ka përparuar mjaft pozitivisht në përafrimin e legjislacionit mjedisor me atë të vendeve të BE-së, si dhe në zbatimit të politikave, madje edhe “Kushtetuta e Shqipërisë” e cilëson zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit si një nga objektivat kryesore të shtetit.

### 3. Ndikimi i problematikave mjedisore në sigurinë e njeriut (rast studimi Tirana)

Teksa hulumtoja për hartimin e këtij punimi shkencor u mundova t’i jap përgjigje pyetjes së tretë kërkimore: “Sa ndikojnë këto problematika në sigurinë e njeriut dhe cilat janë pasojat që mund të sjellin?”

Prej vitesh, vendi ynë e kryesisht kryeqyteti, Tirana, po përjeton ndryshime e zhvillime të forta urbane. Migrimi nga zonat rurale, apo nga veriu e jugu drejt kryeqytetit e kanë “detyruar” Tiranën të mbajë mbi shpinë një kosto mjedisore për të cilën, nga pikëpamja natyrore dhe nga infrastruktura zhvilluar nga dora e njeriut, nuk ishte e përgatitur ta përballonte. Kjo kosto, me pasoja negative, është e njëjtë për të gjitha vendet e botës që duhet të paguajnë për kthimin nga një qytetet i zakonshëm në

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

<sup>10</sup> Dr. Enkelejda Turkeshi, Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale: vështrim krahasues mbi legjislacionin penal mjedisor në Shqipëri dhe Kosovë, f. 131.

<https://juridiku.uni-pr.edu/getattachment/Revista-E-Drejta-/6-Enkelejda-Turkeshi-B5-127-146.pdf.aspx>

<sup>11</sup> Legjislacioni bazë dhe mbështetës mjedisor për menaxhimin e zonave të mbrojtura, rrjeti për mbrojtjen e natyrës, korrik 2017, f. 7.



metropol.

Por, nga ana tjetër jemi të ndërgjegjshëm se faturën më të madhe të ndotjes e kemi “dhuratë” prej dorës së njeriut; ky i fundit, pa e kuptuar se çdo dëm që i bën mjedisit, është pasojë negative për të. Por, për t’i dhënë përgjigje kësaj pyetje kërkimore na duhet të bëjmë një pasqyrë sesi paraqitet situata mjedisore në Tiranë dhe problematikat.

-*Lidhur me cilësinë e ajrit në Tiranë* sipas raportit të OBSH-së publikuar në vitin 2018 (“Cilësia e ajrit”, 2018), si dhe një tjetër raporti të KLSH-së (vendim nr. 203, datë 29/12/2017, “Për evadimin e materialeve të auditimit të performancës, ‘Cilësia e ajrit’”) mund të nxjerrim përfundimin se<sup>12</sup> ndotja e ajrit është një çështje shumë e rëndësishme me ndikim jo vetëm social dhe mjedisor, por edhe ekonomik. Në të njëjtën kohë është një problem kompleks i cili parashtron sfida të shumta në aspektin e menaxhimit dhe reduktimit të substancave ndotëse.<sup>12</sup>

Cilësia e ajrit në zonat kryesore urbane është përmirësuar mesatarisht mbi 30%, por problematike ngelet shkalla e ekspozimit të popullatës ndaj ndotjes, si pasojë e tejkalimit të normës vjetore të ditëve të ndotura.<sup>13</sup>

Pavarësisht kësaj, duhet edhe sensibilizim nga vetë qytetarët, pasi ndotja tepër e ajrit ka pasoja negative në shëndetin e njeriut duke u bërë shkak për krijimin e një sërë sëmundjesh, infeksionesh, dëmtime të fetusit e deri në vdekjen e njeriut.

-*Ndërsa për cilësinë e tokës, ujërave dhe pyjeve* mund të themi shkurtimisht se një tjetër problem i rëndësishëm është edhe ndotja e burimeve ujore nga ku grumbullimi i inerteve apo mbeturinave sjellin jo vetëm kontaminimit e ujit, tokës, mjedisit, por edhe përhapjen e epidemive në vend dhe sëmundjeve nga më të ndryshmet të lëkurës apo organeve të brendshme duke rrezikuar edhe jetën e popullsisë. Lidhur me situatën e ujërave kemi përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së ujërave larës nga viti në vit, por sidomos në krahasim me vitin 2017. Numri stacioneve të cilësisë së shkëlqyer nga 68% është rritur në 82.4%, numri i stacioneve me cilësi të keqe është ulur nga 10% në 3.7%.<sup>14</sup>

Nga raporti i gjendjes së mjedisit për vitin 2018 thuhet se pyjet administrohen në mënyrë jo të qëndrueshme dhe se duhet t’i jepet prioritet rritjes së sipërfaqeve me pyje të mbjellja, nismë kjo që është përqafuar shumë fort nga qeveria, Bashkia e Tiranës dhe bashki të tjera në vend për shtimin e hapësirave të gjelbra dhe pyjore.

- *Ndërsa për sa i përket komponentit tjetër të mjedisit, tokës,* mund të themi së janë marrë një sërë nismash për pastrimin e tokës, plazheve, qyteteve, si dhe mospërdorimin e qeseve plastike apo e thënë ndryshe ndalimin e plastikës njëpërdorimshme. Madje së fundmi kemi një ligj të votuar nga BE për të ndaluar plastikën njëpërdorimshme.

Burimet e ndotjes së tokës në Shqipëri janë të shumta, por ndërmjet tyre mund të përmendim: aktivitetet industriale, emetimet dhe shkarkimet nga burime të ndryshme

<sup>12</sup> Vendim nr. 203, datë 29/12/2017 Për evadimin e materialeve të auditimit të performancës, “Cilësia e ajrit”), Kontrolli i Lartë i Shtetit, f. 1.

[http://www.klsh.org.al/web/203\\_vendim\\_cilesia\\_e\\_ajrit\\_203\\_date\\_29\\_12\\_2017\\_3800.pdf](http://www.klsh.org.al/web/203_vendim_cilesia_e_ajrit_203_date_29_12_2017_3800.pdf)

<sup>13</sup> Raport i gjendjes së mjedisit 2018.

<http://www.akm.gov.al/assets/raporti-i-gjendjes-ne-mjedis-2018.pdf>

<sup>14</sup> Raport i gjendjes së Mjedisit 2018, f. 17.

<http://www.akm.gov.al/assets/raporti-i-gjendjes-ne-mjedis-2018.pdf>

<sup>15</sup> Raport i gjendjes së mjedisit 2018.

<http://www.akm.gov.al/assets/raporti-i-gjendjes-ne-mjedis-2018.pdf>

kimizimi i bujqësisë sidomos sipërfaqet e serave mbetjet urbane dhe ujërat e përdorura.<sup>15</sup> Por, sipas përfundimeve të procesit të monitorimit mund të themi se tokat në vendin tonë janë të përshtatshme dhe të sigurta për aktivitet bujqësor, si dhe kanë një shumëllojshmëri kulturash në varësi të kushteve klimaterike sipas zonave të caktuara.

Përpos analizës shumë të shkurtër që bëmë më sipër për t'i dhënë përgjigje pyetjes sonë kërkimore, unë dua të ndalem edhe tek ndotja akustike, një tjetër kosto kjo për Tiranën, metropolin e Shqipërisë së vogël.

Pranë banesës së gjithkujt që jeton në Tiranë gjendet një bar, restorant, një qendër riparimi automjetesh apo edhe akset më të rëndësishme për automjetet, të cilat bashkërisht apo veçmas prodhojnë zhurmë duke shqetësuar kështu popullsinë që jeton përreth. Madje sipas Organizatës Botërore të Shëndetit ndotja akustike është një nga problemet më të mëdha për qytetarët që sjell pasoja të rënda për shëndetin.

Efektet në shëndet të ndotjes nga zhurma, janë të ndara sipas efekteve specifike: bezdisja, çrregullimet e gjumit, interferenca në komunikim, ulje të performancës, risk për sëmundjet kardiovaskulare, dëmtim të dëgjimit etj. Për një pjesë relativisht të vogël të popullatës këta faktorë mund të kalojnë në simptoma klinike si pagjumësi dhe sëmundje kardiovaskulare të cilat, si pasojë, mund edhe të rrisin shkallën e vdekshmërisë.<sup>16</sup>

Siç shihet ndotja akustike është një problematike e re dhe shumë e nxehtë për popullsinë në kryeqytet, duke u kthyer kështu në një prej elementëve kryesorë që cenojnë sigurinë e qytetarëve.

Madje, vendi ynë veç shtrëngimeve në kodin penal ka edhe një ligj për ndotjen akustike, i cili ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit nga zhurmat, duke përcaktuar mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma.<sup>17</sup>

E quajtur ndryshe nga ekspertët të fushës ndotje akustike, zhurma mjedisore përcaktohet si: “Një tingull i jashtëm i padëshiruar dhe i dëmshëm i shkaktuar nga veprimtaritë njerëzore, duke përfshirë zhurmat e emetuara nga mjetet e transportit, trafiku rrugor, trafiku hekurudhor, trafiku ajror dhe nga veprimtaritë industriale në të cilat njerëzit janë të ekspozuar, në veçanti në zonat e banimit, në parqet publike ose në zona të tjera të qeta të mbyllura, në zonat e qeta në vende të hapura, pranë shkollave, spitaleve dhe zonave e ndërtesave të tjera të ndjeshme nga zhurmat”.<sup>18</sup>

Pikërisht, ndaj kësaj problematike hartova edhe një pyetësor, në të cilin në një hark kohor prej 72 orësh, morën pjesë 213 qytetarë të Tiranës, duke i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve:

- Është për ju shqetësim ndotja akustike?
- Moshë e pjesëmarrësve në pyetësor.
- Gjinia e pjesëmarrësve në pyetësor.
- Ku keni ndjerë shqetësime prej zhurmave?
- Gjatë cilit aktivitet ditor të shqetësojnë më së shumti zhurmat?
- Nga 1 në 10, sa e lartë është ndotja akustike në ambientin ku jetoni/ punoni?
- Kush ka përgjegjësi për ndotjen akustike?
- Çfarë nevojitet për menaxhimin ndotjes akustike?

<sup>16</sup> Raport përfundimtar auditimi performances “Ndotja akustike”, Kontrolli i Lartë i Shtetit, [http://www.klsh.org.al/web/raporti\\_perfundimtar\\_ndotja\\_akustike\\_4943.pdf](http://www.klsh.org.al/web/raporti_perfundimtar_ndotja_akustike_4943.pdf)

<sup>17</sup> Ligj nr. 9774, datë 12.7.2007 Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis.

<sup>18</sup> Raport përfundimtar auditimi performances “Ndotja akustike”, Kontrolli i Lartë i Shtetit, f. 6. [http://www.klsh.org.al/web/raporti\\_perfundimtar\\_ndotja\\_akustike\\_4943.pdf](http://www.klsh.org.al/web/raporti_perfundimtar_ndotja_akustike_4943.pdf)

213 responses




SUMMARY INDIVIDUAL

Accepting responses

### Eshte per ju shqetesim ndotja akustike?

210 responses




Nga 213 pjesëmarrës, 210 prej tyre i janë përgjigjur pyetjes “*Është për ju shqetësim ndotja akustike?*” nga ku 195 ose e thënë ndryshe 92.9% e përcaktuan shqetësim ndotjen akustike në Tiranë, ndërsa 7.1% e tyre, 15 persona nuk e cilësuan si shqetësim. Kjo vërteton se ndotja akustike është një shqetësim madhor në kryeqytet. Madje sipas ekspertëve të fushës thuhet se ky problem do të jetë edhe më evident, pasi jeta në kryeqytet po bëhet gjithnjë më e preferuar sesa ajo në periferi.

Pjesëmarrësit më së shumti ishin femra, ku nga 209 përgjigje, 131 ishin femra; e shprehur në përqindje 62.7% dhe pjesa tjetër 37.3% meshkuj. Kryesisht mosha 20-30 vjeç ishte më aktive në këtë pyetësor me një pjesëmarrje prej 55.8%, pra 115 persona, e pasuar nga mosha 30-40 vjeç e përfaqësuar me 22.9% në këtë pyetësor, konkretisht 48 pjesëmarrës. Mosha 15-20 përfaqësoi 14.8%, 15 pjesëmarrës, ndërsa mosha 40+, 32 pjesëmarrës ose e shprehur ndryshe 14.8%.

### Mosha juaj eshte:

210 responses




AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

“Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare”

## Gjinia

209 responses




Nga 213 pjesëmarrës, 208 prej tyre i janë përgjigjur pyetjes: “*Ku keni ndjerë shqetësime prej zhurmave?*” nga ku 60.6% e tyre, e thënë ndryshe 127 persona shqetësohen nga zhurmat në rrugë, në punë, në shtëpi, shkollë, ndërsa 23.4% e tyre, pra 49 persona vetëm në rrugë, e pasuar nga 8.1% të pjesëmarrësve, ose 17 persona, që shqetësohen nga zhurmat kur janë në shtëpi. Po ashtu 4.3% e pjesëmarrësve ose 9 persona kanë zgjedhur alternativën “nuk kam ndjerë zhurma, është qetë”.

Në këtë pyetje kuptojmë qartësisht se ndotja akustike nga trafiku dhe boritë e automjeteve janë mjaft shqetësuese dhe shpesh sjellin dëme shëndetësore mjaft serioze, për ata që jetojnë e punojnë në Tiranë. Teksa mbledh të dhënat në këtë pyetësor kuptohet qartë duke se qytetarët e Tiranës e kanë pranuar jetesën me zhurmat, madje janë pjesë e zhurmës në ambiente të ndryshme në shkolla, në bare, në rrugë etj.

## Ku keni ndjere shqetesime prej zhurmave

208 responses




### AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »


## Gjate cilit aktivitet ditor te shqetesojne zhurmat?

208 responses



## Nga 1 ne 10, sa e larte eshte ndotja akustike ne ambientin ku jetoni/punoni?

196 responses



208 qytetarë të Tiranës janë përgjigjur pyetjes “Gjatë cilit aktivitet ditor të shqetësojnë zhurmat?” Më së shumti ata ndihen të shqetësuar gjatë kohës që pushojnë, flenë, pra 108 pjesëmarrës, ose 51.9% e tyre kanë zgjedhur këtë alternativë si më problematike. 15.4%, 32 persona në punë, 14.9%, 31 persona kur studiojnë, 21 persona e kanë cilësuar problematike zhurmën në trafik, ndërsa 16 nga 208 pjesëmarrës, pra 7.7%, e kanë cilësuar si normal nivelin e zhurmave në përditshmërinë e tyre.

Për sa i përket pyetjes “Nga 1-10 sa e lartë është ndotja akustike në ambientin ku jetoni/punoni?”, kemi një shpërndarje të madhe të përgjigjeve në alternative të ndryshme, por vihet re se 43 (21.9%) nga 196 persona që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje e cilësojnë në nivelin tetë (të lartë) dhe 41 (20.9%) të tjerë në nivelin 10 shumë të lartë. Ndërsa 11.2% e tyre e shohin në nivele mesatare ndotjen akustike. Të dhënat zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, tregojnë se ndotja akustike urbane në kryeqytet arrin në vlerën e 70 dB ditën dhe 57dB natën, pra rreth 20 dB më e lartë se standardi i normave të Bashkimit Evropian për nivelin kufi të ndotjes akustike.<sup>19</sup>

AKADEMIA  
E SIGURISË


Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

<sup>19</sup> Raport përfundimtar auditimi performances “Ndotja akustike”, Kontrolli i Lartë i Shtetit, f. 8  
[http://www.klsh.org.al/web/raporti\\_përfundimtar\\_ndotja\\_akustike\\_4943.pdf](http://www.klsh.org.al/web/raporti_përfundimtar_ndotja_akustike_4943.pdf)


## Sipas jush kush ka pergjegjesi per ndotjen akustike?

209 responses



## Per menaxhimin ndotjes akustike nevojitet:

213 responses



Pyetjes “Kush ka përgjegjësi për ndotjen akustike?” i janë përgjigjur 2018 pjesëmarrës nga ku 42.1% (88 pjesëmarrës kanë zgjedhur këtë alternativë) e tyre bëjnë përgjegjës autoritetet përkatëse, 27.3% qytetarët (57 pjesëmarrës kanë zgjedhur këtë alternativë), 14.8% (31 pjesëmarrës kanë zgjedhur këtë alternativë), si përgjegjësi personale pra qytetare, 8.1% (17 pjesëmarrës kanë zgjedhur këtë alternativë), e tyre ngarkojnë qeverinë dhe 7.7% bizneset (16 pjesëmarrës kanë zgjedhur këtë alternativë). Në këto kushte kuptojmë fare qartë se ndotja akustike është përgjegjësi e përbashkët e autoriteteve përkatëse dhe qytetarëve, të cilët duhet të bëhen bashkë ndaj këtij fenomeni. Qytetarët me denoncime dhe të sensibilizohen për mos-shkeljen e ligjit ndërsa autoritetet përkatëse për zbatimin e barabartë të ligjit, dënimin e abuzuesve dhe ruajtjen e standardit në mirëzbatimin e ligjeve.

Në pyetjen e fundit të këtij pyetësori qytetarët besojnë se për menaxhimin e ndotjes akustike nevojiten kombinim i fuqishëm mes institucioneve të ngarkuara me detyrën e zbatimit të legjislacionit, përgjegjësisë e drejtësisë qytetare dhe shoqërisë civile për organizimin e fushatave sensibilizuese. Ata besojnë se nëse këto tre komponentë do të bashkëveprojnë kjo problematikë do të marrë një zgjidhje.

Kësaj pyetje i janë përgjigjur 213 pjesëmarrës nga ku 118, ose 55.4% besojnë se zbatimi i ligjit, përgjegjësia qytetare dhe fushatat sensibilizuese janë zgjidhja e problematikës së ndotjes akustike. Ndërsa 17.4%, pra 37 pjesëmarrës e përcaktojnë vetëm si përgjegjësi qytetare, 16% ose 34 persona e përcaktojnë zbatimin e ligjit për

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

menaxhimin e problematikës, ndërsa 14 prej tyre ose 6.6% besojnë në fuqinë e fushatave sensibilizuese dhe vetëm 4.7% ose 10 prej tyre, besojnë se nuk është alarmante si problematikë.

Ndotja akustike është një prej problemeve madhore në kryeqytet, që shkakton dëme të mëdha, duke cenuar sigurinë e tij shëndetësore dhe atë psikologjike, madje raporte të Organizatës Botërore të Shëndetit përcaktojnë se ndotja akustike krijon problematika të pariparueshme në sistemin dëgjimor, madje edhe humbje të dëgjimit.

## 4. Iniciativat globale për një mjedis të sigurt ndaj krimeve mjedisore më të mëdha në botë

Kur themi mjedis nënkuptojmë bashkëveprimin e një sërë komponentësh apo aspektesh që lidhen ngushtë me ekonominë, trashëgiminë e një vendi, natyrë, çështjet sociale, ato arkeologjike, florën, faunën, pra me ekuilibrin e jetës së njeriut. Epoka e revolucionit teknologjik e industrial ka arritur kulmin në ditët e sotme, duke qenë se njeriu po e përshtat natyrën edhe këto risi në funksion të përmbushjes së nevojave jetësore të tij, por pa e kuptuar që po shkakton dëme në përmasat e një krimi të mirëfilltë.

Për shkak të përfitimeve të mëdha financiare por edhe rrezikshmërisë së madhe, krimi mjedisor tashmë ka marrë epitetin e krimit të organizuar, ku përfshihen organizata të tëra kriminale kufijkaluese. Përfitimet nga krimi mjedisor tashmë llogariten me dhjetëra miliarda dollarë në vit, që kryesisht realizohen me veprime kriminale nga 5 fusha kryesore: tregtia ilegale me specie të rrezikuara shtazore, peshkimi ilegal, inertet teknologjike, tregtia me substanca dëmtuese të ozonit dhe prerja ilegale e pyjeve.<sup>20</sup>

Lidhur me këtë problematikë kam cilësuar të rëndësishme këtë pyetje të fundit kërkimore mbi temën për të cilën po shkruaj. Po cilat janë disa nga krimet mjedisore më të përhapura dhe iniciativat për parandalim? Trafikimi i kafshëve të egra është konsideruar nga Interpol si biznesi i tretë më i madh ilegal në botë, pas trafikimit të drogës dhe armëve. Trafiku i kafshëve ngre një kërcënim serioz për mbijetesën e biodiversitetit në botë. Prerjet ilegale të pyjeve janë konsideruar si një nga krimet madhore ndaj mjedisit, veçanërisht për përfitime monetare, duke u kthyer kështu në shkakun kryesor të shpyllëzimit. Përmendim këtu shkatërrimi i Amazonës, i cili filloi në vitin 2013. Menaxhimi jo i mirë i mbetjeve elektronike, aktualisht në 50 milion ton mbeturina elektronike çdo vit (kompjuterë, televizorë, telefona celularë, pajisje, etj.). Këto mbeturina mbeten të hedhura në tokë apo mjedise ujore.

Prerja e paligjshme e pjesëve të turpit të një peshkaqeni është një tjetër krim i tmerrshëm ndaj mjedisit. Njëqind milion peshkaqenë kapen çdo vit nga anije të specializuara, të cilëve u priten krahët, apo bishti apo pjesë të tjera të trupit, pasi një kilogram i peshkaqenit vlen 600 euro në tregun aziatik.

Hedhja e mbetjeve/fekaleve në lumenj e dete është një tjetër krim i tmerrshëm nga i cili po vuan mbarë globi në ditët e sotme. Ky lloj krimi mjedisor më së shpeshti shkaktohet nga ndërmarrjet, fabrikat dhe bizneset lokale. Mbetjet derdhen në mënyrë të pakontrollueshme duke ndotur mjedisin ujor. Ky është një krim shumë i rëndë sepse ai gjen mënyrën e vet për të ndotur edhe florën përreth, duke ndikuar në

zinxhirin ushqimor.

Shumë shtete apo organizata në mbarë globin i kanë shpallur më së pari luftë grupeve kriminale, apo individëve, të cilët janë të organizuar për zhvillimin e këtyre veprave të paligjshme. Në Interpol është krijuar një strukturë e posaçme që ndihmon në prishjen dhe çmontimin e rrjeteve kriminale të organizuara kufijkaluese të përfshira në tregtinë e paligjshme të jetës së egër. Ekspertët kanë koordinuar disa operacione që kanë sjellë me sukses kriminelët e jetës së egër para drejtësisë, çmontuan rrjetet që fshihen pas këtij krimi dhe çuan në sekuestrimin e tonëve të produkteve të paligjshme.<sup>21</sup>

Po ashtu, disa organizata ndërqeveritare kanë adresuar përgjigje ndaj krimit mjedisor, duke filluar nga projektet individuale deri tek programet plotësisht të zhvilluara për të luftuar këto problematika. Nga ana tjetër, shtetet e BE-së kanë hartuar qindra direktiva e rregullore që janë në fuqi për mjedisin, me qëllim luftimin e krimit mjedisor përmes sanksioneve penale.

## 5. Konkluzione dhe rekomandime

### 5.1. Konkluzione

Qenia njerëzore duke u fokusuar në parimin për të përfituar shumë nga natyra shpeshherë ka prishur edhe ekuilibrat natyrorë. Po ashtu, prirja drejt risive teknologjike ka bërë që ndërhyrja në mjedis nga dora e njeriut të sjellë pasoja negative, përmendim këtu dëmtimin e florës dhe faunës, ndotjen e tokës, ku vendin kryesor e zënë mbetjet kimike, si dhe shkatërrimin e ekosistemeve.

Njeriu ka shkatërruar me ndërgegje të plotë, për përfitime personale ambientin ku jetojmë, ka ndotur ujërat duke u bërë kështu burim kontaminimi për popullsinë, si dhe ka kontribuar negativisht në shkatërrimin e pyjeve, maleve apo zonave bregdetare. Ai ka shkelur legjislacionin mjedisor duke sjellë pasoja të rënda dhe me rrezik për mjedisin dhe shëndetin e popullsisë.

Ndonëse për kuadrin ligjor mjedisor janë bërë përpjekje për hartimin e një sërë ligjesh dhe ndryshimet në kodin penal, ende ndihet problematika e moszbatimit të ligji nuk t'njësoj kudo. Ndër vite vihet re se Shqipëria ka përparuar mjaft pozitivisht në përfaqsimin e legjislacionit mjedisor me atë të vendeve të BE-së, si dhe në zbatimin të politikave, madje edhe kushtetuta e Shqipërisë e cilëson zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit si një nga objektivat kryesore të shtetit.

Cilësia e ajrit në zonat kryesore urbane është përmirësuar mesatarisht mbi 30%, por problematike ngelet shkalla e ekspozimit të popullatës ndaj ndotjes, si pasojë e tejkallimit të normës vjetore të ditëve të ndotura. Nga raporti i gjendjes së mjedisit për vitin 2018 thuhet se pyjet administrohen jo në mënyrë të qëndrueshme dhe se duhet t'i jepet prioritet rritjes së sipërfaqeve me pyje të mbjellja, nismë kjo që është përqaftuar shumë fort nga qeveria, Bashkia Tiranë dhe bashki të tjera në ven për shtimin e hapësirave të gjelbra dhe pyjore. Ndërsa për sa i përket komponentit tjetër të mjedisit, tokës, mund të themi së janë marrë një sërë nismash për pastrimin e tokës, plazheve, qyteteve, si dhe mospërdorimin e qeseve plastike apo e thënë ndryshe ndalimin e plastikës njëpërdorimshme. Madje së fundmi kemi një ligj të votuar nga BE për të ndaluar plastikën njëpërdorimshme. Por, sipas përfundimeve të procesit të monitorimit mund

<sup>21</sup> Wildlife Crime

<https://www.interpol.int/en/Crimes/Environmental-crime/Wildlife-crime>



të themi se tokat në vendin tonë janë të përshtatshme dhe të sigurta për aktivitet bujqësor, si dhe kanë një shumëllojshmëri kulturash në varësi të kushteve klimaterike sipas zonave të caktuara.

Po ashtu, si konkluzion të rëndësishëm në këtë punim dua të cilësoj edhe të dhënat e mbledhura nga pyetëtori, i cili pati 213 pjesëmarrës në 72 orë, nga ku:

195 ose e thënë ndryshe 92.9% e përcaktuan shqetësim ndotjen akustike në Tiranë.

Pjesëmarrësit më së shumti ishin femra, ku nga 209 përgjigje 131 ishin femra, e shprehur në përqindje 62.7% dhe pjesa tjetër 37.3% meshkuj.

Kryesisht moshë 20-30 vjeç ishte më aktive në këtë pyetësor me një pjesëmarrje prej 55.8%;

Nga 213 pjesëmarrës, 208 prej tyre i janë përgjigjur pyetjes “Ku keni ndjerë shqetësime prej zhurmave?” nga ku 60.6% e tyre, e thënë ndryshe 127 persona shqetësohen nga zhurmat në rrugë, në punë, në shtëpi, shkollë.

208 qytetarë të Tiranës i janë përgjigjur pyetjes “Gjatë cilit aktivitet ditor të shqetësojnë zhurmat?” se më së shumti ata ndihen të shqetësuar gjatë kohës që pushojnë, flenë, pra 108 pjesëmarrës, ose 51.9% e tyre kanë zgjedhur këtë alternativë si më problematike.

Për sa i përket pyetjes “Nga 1-10 sa e lartë është ndotja akustike në ambientin ku jetoni/punoni?”, kemi një shpërndarje të madhe të përgjigjeve në alternative të ndryshme, por vihet re se 43 (21.9%) nga 196 persona që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje e cilësojnë në nivelin tetë (të lartë) dhe 41 (20.9%) të tjerë në nivelin 10 shumë të lartë.

Pyetjes “Kush ka përgjegjësi për ndotjen akustike?” i janë përgjigjur 2018 pjesëmarrës nga ku 42.1% (88 pjesëmarrës kanë zgjedhur këtë alternativë) e tyre bëjnë përgjegjës autoritetet përkatëse.

Në pyetjen e fundit të këtij pyetëtori qytetarët besojnë se për menaxhimin e ndotjes akustike nevojiten kombinim i fuqishëm mes institucioneve të ngarkuara me detyrën e zbatimit të legjislacionit, përgjegjësisë e drejtësisë qytetare dhe shoqërisë civile për organizimin e fushatave sensibilizuese. Ata besojnë se nëse këto tre komponentë do të bashkëveprojnë kjo problematikë do të marrë një zgjidhje. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 213 pjesëmarrës nga ku 118, ose 55.4% besojnë se zbatimi i ligjit, përgjegjësia qytetare dhe fushatat sensibilizuese janë zgjidhja e problematikës së ndotjes akustike.

Përfitimet nga krimi mjedisor tashmë llogariten me dhjetëra miliarda dollarë në vit, që kryesisht realizohen me veprime kriminale nga tregtia ilegale me specie të rrezikuara shtazore, peshkimi ilegal, tregtia me substanca dëmtuese të ozonit dhe prerja ilegale e pyjeve. Për këtë arsye shumë shtete apo organizata në mbarë globin i kanë shpallur më së pari luftë grupeve kriminale, apo individëve, të cilët janë të organizuar për zhvillimin e këtyre veprave të paligjshme. Në Interpol është krijuar një strukturë e posaçme që ndihmon në prishjen dhe çmontimin e rrjeteve kriminale të organizuara kufijkaluese të përfshira në tregtinë e paligjshme të jetës së egër.

## 5.2. Rekomandime

Nevojitet me emergjencë një zbatim i barabartë i ligjit për krimet mjedisore, ndotjen e mjedisit.

Rekomandohet përfshirja e ekspertëve për minimizimin e problematikave mjedisore mbi ndotjen e ujërave, ajrit dhe zhurmave. Po ashtu ashpërsim i dënimeve dhe përfshirje e aktorëve shtetëror.

Nevojitet krijimi i fushatave sensibilizuese për të dhënë një mesazh të qartë për dëmet që njeriu i shkakton mjedisit, me qëllim rritjen e ndjeshmërisë së qytetarëve ndaj përgjegjësive qytetare në kuadër të problematikave mjedisore. Po ashtu përfshirja e shoqërisë civile të rritet më shumë.

Nevojiten bashkëveprim i fuqishëm mes institucioneve të ngarkuara me detyrën e zbatimit të legjislacionit, përgjegjësish e drejtësisë qytetare dhe shoqërisë civile, organizimin e fushatave sensibilizuese, me qëllim menaxhimin e problemeve mjedisore.

Të kryhet monitorim koherent nga ekspertë të fushës i parametrave të ndotjes së mjedisit duke garantuar kështu sigurinë e qytetarëve dhe minimin e rreziqeve ndaj sëmundjeve të shkaktuara nga ndotja e elementëve të mjedisit.

## Bibliografi

1. The Global Response to Transnational Organized Environmental Crime  
<https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2019/04/TGIATOC-The-Global-Response-to-Transnational-Organized-Environmental-Crime-web.pdf>
  2. Vendim nr. 203, datë 29/12/2017 Për Evadimin e materialeve të auditimit të performancës “Cilësia e ajrit”.
  3. Raport përfundimtar i auditimit të performancës “Ndotja akustike”, KLSH, qershor 2019.
  4. Manual, “Menaxhimi i problemeve mjedisore në nivel vendor” Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QShKE), 2006.
  5. Basics of Environmental Science 2nd Edition, Michael Allaby, 2000, Routledge is an imprint of the Taylor & Francis Group.
  6. Çështje Europiane dhe të Sigurisë, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë 2011.
  7. Raporti i gjendjes në mjedis për vitin 2017, Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
  8. Raporti i gjendjes në mjedis për vitin 2018, Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
  9. Strategjia ndërsektoriale e mjedisit 2013-2020.
  10. Ligj nr. 7664, datë 21.1.1993 Për mbrojtjen e mjedisit.
  11. Ligj nr. 8934, datë 5.9.2002 Për mbrojtjen e mjedisit.
  12. Ligj nr. 9774, datë 12.7.2007, Për vlerësimin dhe administrimin e zhurms në mjedis.
  13. Ligj nr. 39/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurms në mjedis”.
  14. Të drejtat tuaja për informim për çështjet e mjedisit, OSBE, 2006.
  15. Punim seminari, *Toka dhe dukuritë atmosferike*, Kujtim Baralio.  
[https://www.academia.edu/20335007/TOKA\\_DHE\\_DUKURIT%C3%8B\\_ATMOSFERIKE](https://www.academia.edu/20335007/TOKA_DHE_DUKURIT%C3%8B_ATMOSFERIKE)
  16. Dr. Enkelejda Turkeshi, Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale: vështrim krahasues mbi legjislacionin penal mjedisor në Shqipëri dhe Kosovë  
<http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2018/07/doktoratura-Ulsi-Manja-20-nentor-2017.pdf>
- ARTIKUJ ONLINE**
17. Department of Animal and Plant Sciences, Studying the earth's history predicts future global change  
<https://www.sheffield.ac.uk/aps/research-2016/impact/understanding-environmental-change/history>
  18. Evolution of Earth, The evolution of this planet and its atmosphere gave rise to life, which shaped Earth's subsequent development. Our future lies in interpreting this geologic past and considering what changes—good and bad—may lie ahead, By Claude J. Allgre, Stephen H. Schneider on July 1, 2005  
<https://www.scientificamerican.com/article/evolution-of-earth/>
  19. Where Did the Concept of Environment Come from and Where Is It Found?- A Conceptual History of Environment in Modern China, Qionglan Xu  
<https://www.duo.uio.no/bitstream/handle/10852/60804/master-s-thesis-Qionglan-Xu.pdf?sequence=1&isAllowed=y>
  20. ‘The biggest environmental crime in history’, By Cahal Milmo, December 2007  
<https://www.independent.co.uk/environment/the-biggest-environmental-crime-in-history-764102.html>

## AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare »

21. An Introduction to the Concept of Environmental Management: Indian Context, Pradip Kumar Das Jagannath Kishore College, Purulia (W.B.), India  
<https://researchleap.com/introduction-concept-environmental-management-indian-context/>
22. Top 5 Environmental Crimes  
<https://www.activesustainability.com/environment/crimes-against-the-environment/>  
<https://ec.europa.eu/environment/legal/crime/index.htm>
23. Meaning, Definition and Components of Environment  
<http://www.yourarticlelibrary.com/environment/meaning-definition-and-components-of-environment/6157>
24. Institute for Environmental Policy, Ndotja e mjedisit  
[https://iep-al.org/?page\\_id=58&lang=sq](https://iep-al.org/?page_id=58&lang=sq)
25. Dita e Mjedisit, të rinjtë në fushatë sensibilizuese  
<https://telegرافي.com/dita-e-mjedisit-te-rinjte-ne-fushate-sensibilizuese/>  
<https://www.vezhguesirural.org/lidhje/materiale>
26. Strategjia ndërsektoriale e mjedisit 2013-2020  
<https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/06/L2-Strategjia-Ndersektoriale-e-Mjedisit-2013-2020.pdf>
27. Mjedisi i kërcënuar nga krimi mjedisor  
<https://www.gazetaexpress.com/shkurt-e-shqip-mjedisi-i-kercnuar-nga-krimi-mjedisor-245974/>
28. Putting a Stop to Global Environmental Crime Has Become An Imperative  
<https://www.un.org/en/chronicle/article/putting-stop-global-environmental-crime-has-become-imperative>



**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »**

# Siguria mjedisore dhe cenimi i sigurisë kombëtare: analizë mbi burimet natyrore, financiare dhe zhvillimin historik të akteve ndërkombëtare



■ MSc. Xheklina BYLYKBASHI  
Drejtorja Vendore e Policisë, Durrës  
Policia e Shtetit  
[xheklina.bylykbashi@asp.gov.al](mailto:xheklina.bylykbashi@asp.gov.al)

## Abstrakt

*Siguria mjedisore po dominon gjithnjë e më shumë agjendat kombëtare dhe ndërkombëtare, duke zhvendosur para shtyllat e mbrojtjes dhe gjeopolitikës. Çfarë është e re dhe e ndryshme?*

*“Disa kërcënime për paqen dhe mbijetesën e bashkësisë njerëzore janë më të mëdha se ato të parashtruara nga perspektiva e degradimit në shtim dhe të pakthyeshmë të biosferës, nga e cila varet jeta e njeriut. Siguria e vërtetë nuk mund të arrihet duke montuar ndërtimin e armëve (mbrojtja në një kuptim të ngushtë) por vetëm duke siguruar kushte themelore për zgjidhjen e problemeve joushtarake që i kërcënojnë ata. Mbijetesa jonë, varet jo vetëm nga ekuilibri ushtarak, por nga bashkëpunimi global për të siguruar një mjedis të qëndrueshëm” (Raporti i Komisionit të Brundtland, 1987).<sup>1</sup> “Zhvillimi i qëndrueshëm është një çështje imponuese morale dhe humanitare, por është gjithashtu një domosdoshmëri e sigurisë. Varfëria, degradimi i mjedisit dhe dëshpërimi janë shkatërruesit e njerëzve, të shoqërive, të kombeve. Ky trinitet jo i shenjtë mund të destabilizojë vendet, madje edhe rajone të tëra” (Colin Powell, 1999).<sup>2</sup> Në nivelet globale, për shkak të përfitimeve të mëdha financiare por edhe rrezikshmërisë së madhe, krimi mjedisor tashmë ka marrë epitelin e krimin të organizuar, ku përfshihen organizata të tëra kriminale trans-nacionale. Përfitimet nga krimi mjedisor tashmë llogariten me dhjetëra miliarda dollarë në vit, që kryesisht realizohen me veprime kriminale nga 5 fusha kryesore: tregtia ilegale me mbeturina, tregtia ilegale me specie të rrezikuara shtazore, peshkimi ilegal, tregtia me substanca dëmtuese të ozonit dhe prerja ilegale e pyjeve. Ky punim, synon të vlerësojë gjendjen e sigurisë së mjedisit globale dhe të kryejë një përmbledhje se si është zhvilluar çështja e sigurisë mjedisore dhe asaj kombëtare, që nga shfaqja e saj e parë në mesin e viteve 1970 e deri më sot, duke u fokusuar në fund të Shqipëria.*

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

“Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare”

## Fjalëkyçe:

**siguri mjedisore, siguri kombëtare, siguri ndërkombëtare, ndotje e mjedisit.**

## 1. Koncepti i parë i sigurisë mjedisore

Në nivelet globale, për shkak të përfitimeve të mëdha financiare por edhe rrezikshmërisë së madhe, krimi mjedisor tashmë ka marrë epitetin e krimit të organizuar, ku përfshihen organizata të tëra kriminale trans-nacionale. Përfitimet nga krimi mjedisor tashmë llogariten me dhjetëra miliarda dollarë në vit, që kryesisht realizohen me veprime kriminale nga 5 fusha kryesore: tregtia ilegale me mbeturina, tregtia ilegale me specie të rrezikuara shtazore, peshkimi ilegal, tregtia me substanca dëmtuese të ozonit dhe prerja ilegale e pyjeve.

Edhe në BE, ku për rreth 30 vjet janë nxjerrë mbi 200 direktiva e rregullore që janë në fuqi për mjedisin, ka raste të shkeljeve të rënda të ligjit mjedisor. Kjo ka nxitur nevojën e nxjerrjes së një direktive të veçantë (Direktiva Nr. 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal) për luftimin e krimit mjedisor përmes sanksioneve penale efektive e proporcionale për veprat e rënda penale mjedisore. Kjo direktivë përfshin një listë të veprave penale mjedisore që duhet të konsiderohen të tilla në të gjitha shtetet anëtare, nëse kryhen me qëllim ose edhe nga pakujdesia e rëndë. Dënime të rrepta për raste të krimeve mjedisore ndodh edhe në SHBA. Kështu në vitin 2014 sipas “US Environmental Protection Agency”, një kompani e qymyrit (“Tonawanda Coke Cooperation”) u detyrua të paguaj 12.5 milion dollarë gjobë shtetit dhe 12.5 milion dollarë të tjerë komunitetit për shkeljet e dispozitave të ligjit mbi ndotjen e ajrit dhe atij për ruajtjen e resurseve natyrore. Në të njëjtin, rast edhe menaxheri i kontrollit të

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

<sup>1</sup> Uebi i organizatës ndërkombëtare të sigurisë mjedisore, marrë nga [http://www.envirosecurity.org/enviromental security/](http://www.envirosecurity.org/enviromental_security/); “What’s new and different, based on a policy backgrounder for the University of Peace”, 2002.

<sup>2</sup> Po aty.

mjedisit të korporatës u dënua me një vit burgim, 100 orë punë të detyruar për komunitetin dhe 20 000 dollarë.<sup>3</sup> Për shkak të rritjes së rrezikut dhe zgjerimit të rrjetit, në nivel global, rajonal dhe nacional viteve të fundit janë ndërtuar rrjete të tëra që luftojnë krimin mjedisor. Këto rrjete bazohen në bashkëpunimin e institucioneve përgjegjëse duke filluar prej autoriteteve të mjedisit në nivel nacional e lokal, rrjetet policore (përfshirë Interpol, Europol dhe policitë kombëtare), doganat dhe sistemin e gjyqësisë me fokus në prokurorinë. Disa shtete madje kanë zhvilluar edhe departamente të veçanta brenda këtyre strukturave që merren vetëm me çështjet e krimit mjedisor.

Ka ende një trafik të lëndëve të rrezikshme drejt vendeve të huaja? Sigurisht, por është shumë ndryshe nga ai i viteve 1980-90. Atëherë kjo gjë bëhej nga “zotët e luftërave” drejt Somalisë ose Lindjes së Afërme, duke i këmbyer me armë ose ndihma. Ne jemi duke hetuar në ato trafike, por edhe në këto të sotmet”.<sup>4</sup>

Alessandro Bratti, kreu i komisionit parlamentar për hetimin e aktiviteteve të paligjshme në lidhje me trafikun e mbetjeve nga Italia në drejtim të vendeve të tjera.

Në radarin tonë ne kemi disa çështje për të hedhur dritë në të shkuarën dhe të tashmen, e duke zbuluar e zbardhur dokumente të reja në lidhje me trafikun ndërkombëtar të mbetjeve të rrezikshme. Jemi të ndërgjegjshëm se ka pasur dhe ka probleme me mbetjet që trafikohen jashtë vendit. Për shembull, mbetjet italiane dërgohen nëpër vende të ndryshme, si në Gjermani, Austri, por më pas nisën dyshimet se plehurat që dërgoheshin atje, nuk ishin ato që deklaroheshin. Përderisa në Gjermani dhe Austri respektohen ligjet e vendeve ku dërgohen mbetjet e Italisë, ka shumë dyshime se në vende si Portugalia, Rumania, Bullgaria, Shqipëria, Kroacia e Maroku kjo gjë nuk ndodh. Deri pak vite më parë, Interpoli nuk i hetonte shumë krimet e ambientit, por në 4-5 vitet e fundit ky lloj krimi ka njohur një zgjerim të pabesueshëm. Italia ka një njohje të hershme me këto krime dhe për këtë ka bërë hetime, por vendet e tjera nuk janë shumë immune ndaj këtij lloj krimi.

Në kuptimin e zakonshëm, krimi mjedisor nënkupton të gjitha veprimet që i shkaktojnë dëm mjedisit. Mirëpo në kuptimin legal përkufizimi është më i thellë pasi këtu krimi mjedisor në rend të parë trajtohet si koncept formal e jo vetëm material. Përkufizimi legal i krimit mjedisor është si “tërësia e dispozitave që vendosin përgjegjësinë penale për sjelljet e caktuara për shkak të dëmit (potencial) ndaj mjedisit”<sup>5</sup>.

Pasi u krijua në mesin e viteve ‘70, veçanërisht përmes një kapitulli në Raportin e Brundtland, të sipërpërmendur, raport i cili pati disa vështirësi në vlerësimin profesional deri në mesin e viteve 1990, tërhoqi interes të mirëfilltë. Duke vazhduar më tej, çfarë është “e re” - dhe si mund të bëhet akoma më e re?<sup>6</sup>

Për herë të parë koncepti i sigurisë mjedisore (“Environmental Security”), u ngrit në mesin e viteve ‘70 kur u shkrua një raport për Organizatën për Unitetin Afrikan mbi luftën e Ogadenit midis Etiopisë dhe Somalisë. Lufta ishte shkaktuar në masë të madhe nga shpyllëzimi dhe erozioni i tokës, plus edhe rritja e arratisjes së popullsisë dhe varfëria, në malësitë Etiopisë, e cila shkaktoi uri të përhapur, e ndjekur nga një shpërngulje masive nga malësitë drejt ultësirave dhe, rrjedhimisht drejt Ogaden-Somali, e cila u pa si prelude i një pushtimi.

<sup>3</sup> Baechler, G. 1998. “Why Environmental Transformation Causes Violence: A Synthesis”. *Environmental Change and Security Project Report 4*: 24-44. Woodrow Wilson Center, Washington DC, USA.

<sup>4</sup> OSCE, *Manuali i OSCE për menaxhimin e problemeve mjedisore në nivel evropian*. Tiranë.

<sup>5</sup> Uebi i agjencisë kombëtare të mjedisit, marrë nga: <http://www.akm.gov.al>.

<sup>6</sup> *Raporti i Komisionit të Brundtland, 1987.*

## 2. “Agjenda 2030, për zhvillim të qëndrueshëm”

“Konferenca e OKB-së, e Stokholmit”, 1972, Komisioni i OKB-së mbi zhvillimin e qëndrueshëm, 1983, “Raporti Brundtland” i këtij komisioni, “Rio Earth Summit”, 1992, dhe “Agjenda 21” (e dalë prej tij), “Samiti i OKB-së, mbi sfidat e mijëvjeçarit”, në vitin 2000, “Samiti i Johannesburgut”, 2002, “Samiti Rio +20”, në vitin 2012 dhe së fundmi “Samiti i OKB-së mbi zhvillimin e qëndrueshëm”, në New York, janë disa nga ngjarjet më kryesore të cilat kanë ngritur në institucion përpjekjet e udhëheqjes dhe aktorëve të shoqërisë në nivel global, për të projektuar dhe për të zbatuar modelin e zhvillimit të qëndrueshëm si një model zhvillimi, i cili plotëson nevojat e shoqërisë gjithmonë e në rritje, duke përdorur burimet natyrore në mënyrë racionale, që ato t’i shërbejnë edhe nevojave e interesave të brezave të ardhshëm, ndërsa përdorimi i tyre mos të kërcënoje shëndetin e natyrës dhe ekosistemet.

Modeli në fjalë mbështet në tre shtylla kryesore: ekonomia, shoqëria dhe mjedisi, të cilat janë në lidhje e ndërveprim dhe konsiderojnë njëra-tjetrën. “Të transformojmë botën tonë: “Agjenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm”,<sup>7</sup> titullohet samiti i Kombeve të Bashkuara mbi zhvillimin e qëndrueshëm, i cili po zhvillon punimet këto ditë. Programi i projektuar nga ky samit përmban 17 objektiva dhe 167 detyrat specifike. Ato flasin më së miri për synimet e kësaj agjende universale, nëpërmjet së cilës synohet të arrihen sfidat e paplotësuara deri më tani të mijëvjeçarit. Objektivat në fjalë janë të integruara dhe të pandashme dhe ekuilibrojnë tre shtyllat e modelit të zhvillimit të qëndrueshëm: ekonominë, shoqërinë dhe mjedisin, të cilat vlerësohet se do të jenë tejet të rëndësishme për shoqërinë dhe planetin.

Agjenda e dalë nga ky samit, është një program veprimi për njerëzimin, planetin dhe të ardhmen e mirë të shoqërisë, nëpërmjet së cilës kërkohet forcimi i paqes së përgjithshme dhe më shumë liri. Çrrenjosja e varfërisë në të gjitha format dhe përmasat, duke përfshirë edhe varfërinë ekstreme, është sfida më e madhe globale dhe kërkesë e patjetërsueshme për modelin e zhvillimit të qëndrueshëm. Pasiguria e ushqimit bazë është shqetësim për rreth 1 miliardë persona, ashtu si në vitin 1970, pabarazia e të ardhurave është duke u rritur midis vendeve të ndryshme dhe brenda të së njëjtit vend, ndërsa luftërat dhe fatkeqësitë natyrore po zhvendosin njerëzit nga origjina.

Prandaj, edhe dimensionin social i shpërndarjes të së ardhurave nga burimet e përbashkëta natyrore dhe përkujdesja ndaj kategorive të dobëta në shoqëri, si edhe gjetja e mekanizmave të duhura të cilat rrisin solidaritetin, bashkëpunimin dhe partneritetin në shoqëri, do të jetë një sfidë e rëndësishme për shoqërinë e shekullit të XXI-të. Shumë tregues të cilët përcaktojnë zhvillimin e qëndrueshëm, duke filluar nga reduktimi i varfërisë, qasja në edukim, ngrohja globale dhe ndotja e atmosferës, ndodhin në nivele lokale e kombëtare dhe përcaktohen nga ligjet dhe aktet ligjore në fuqi.

Në shekullin e XX-të, i cilësuar si shekulli “i përshpejtimit”, ritmet e larta të rritjes së popullsisë u shoqëruan me rritjen 40 herë të prodhimit ekonomik dhe rritjen 16 herë të përdorimit të karburanteve, peshkimi me 35 herë, 9 herë përdorimi i ujit, emetimi i CO<sub>2</sub> u rrit 17 herë, i sulfurit 13 herë, ndërsa ndotësit e atmosferës po me të njëjtin ritëm.

Të gjithë ne humbasim, në se burimet natyrore shteren ose shkatërrohen. Për rrjedhojë, të gjitha veprimtaritë tona individuale dhe kombëtare duhet të vendosin për

**AKADEMIA  
E SIGURISIA**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

<sup>7</sup> Myers, N. 1996. *Ultimate Security: The Environmental Basis of Political Stability*. Norton, New York, USA.



ecurinë dhe të ardhmen e planetit tonë. Sikundër edhe u theksua në “Raportin Brundtland”, 25 vite më parë (1992)<sup>8</sup>, asnjë aktor nuk mund t’i përballojë sfidat i vetëm, prandaj edhe veprime të përbashkëta janë të domosdoshme. Angazhimi politik i dalë nga “Samiti i tokës” i vitit 1992, për tërësinë e arsyeve, kurrë nuk e arriti objektivin e vet. Nuk u arritën pritshmëritë e tij për eliminimin e varfërisë, reduktimin e pabarazive në standardet e jetesës, aplikimin e sjelljeve konsumatore e prodhuese të cilat konsiderojnë ekosistemet, menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.

Por, gjithashtu nuk u zbatuan as edhe mjetet e rrugët që u përcaktuan për të arritur pritshmëritë në fjalë. Gjithashtu, angazhimi i vitit 1992, nuk mundi të arrijë pritshmëritë edhe në zhvillimet gjeopolitike, të cilat i përjetojmë sot me shfaqjet më të dukshme zhvillimet në Lindjen e Mesme dhe azilin e qindra e mijërave personave drejt vendeve të BE-së. Për rrjedhojë, kërkohet një angazhim dhe premtim i ri, i cili ofron një vizion për të ecur përpara për komunitetin ndërkombëtar, qeveritë kombëtare, sektorin privat, shoqërinë civile, botën e dijes dhe aktorë të tjerë, për zhvillim të qëndrueshëm, sipas një mënyre të integruar.

Kërkohet një model i ri ndërtimi dhe përshtatjeje institucionesh, procesesh vendimmarrëse dhe menaxhimi të të mirave tona të përbashkëta lokale, kombëtare e globale për të reflektuar në mënyrë më të ndershme rendin e ri ekonomik dhe gjeopolitik. A mundet Shqipëria t’i bashkohet kësaj agjende globale? Vlerësoj se ne shqiptarët, së pari politikëbërësit e qeverisësit, e tok me ta edhe shoqëria, e kemi të lehtë nga t’ia fillojmë: të bëjmë shumicën e gjërave ndryshe nga më parë. Një paraqitje hapëse e konceptit të mësipërm, u konfirmua për herë të parë në fund të viteve 1970, nga arkitekti i fitores së Izraelit, të vitit 1967, në Luftën e Gjashtë Ditëve, gjenerali Moshe Dayan. “Ai më siguroi që një motiv kryesor për luftën, në krye të manovrimit të gjeneralit Nasser, ishte kërcënimi nga Siria dhe Jordania për sekuestrimin e një pjese të mirë të rrjedhave të lumit Jordan - një kërcënim që shihej nga Izraeli si një kusht i mjaftueshëm. Për rreth të njëjtën kohë, për më tepër, Etiopia po pohonte planin e saj për të devijuar pjesën më të madhe të Nilit Blu, për të ujitur sektorë të gjerë të malësive të saj. Egjipti menjëherë deklaroi se nëse kjo ndodhte, do të shpallte luftë”.<sup>9</sup>

### 3. Lidhje të tjera mjedisore, sigurie, në kuadër të sektorit të ujit e tokës

Uji ka shërbyer për një kohë të gjatë si një ilustrim kryesor i sigurisë mjedisore. Konflikti i parë i regjistruar, ishte 4500 vite më parë, kur dy qytetit mesopotamike u futën në luftë në atë që tani është Iraku i Jugut. Por, fenomeni i sigurisë mjedisore, në kuptimin e plotë të termit, është shumë më i ri, dhe shfaqet vetëm në dekadat e fundit e kryesisht, si rezultat i një rritjeje tërësisht të pashembullt të numrit njerëzor dhe veprimtarive njerëzore. Që nga viti 1950, furnizimi global i ujërave të ëmbla për person, ka rënë me 60%, pasi popullsia botërore është rritur me mbi 150% dhe konsumi i ujit në botë, është rritur me 180%; konsumi pritet të rritet me 40% të tjera brenda dy dekadave të ardhshme. Kështu, bota e sotme ka ndryshuar rrënjësisht nga gjithë botët e mëparshme dhe, është “e re dhe e ndryshme”, në një masë të tillë që zor se e kapim, le

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

<sup>8</sup> Raporti i Komisionit të Brundtland, 1987.

<sup>9</sup> Myers, N. 2001. “Environmental Refugees: Our Latest Understanding”. *Philosophical Transactions of the Royal Society B*: 356: 16.1-16.5.

The main objective of Inter-Institutional Group on Environmental Crime (IGEC) group is to strengthen the coordination and collaboration of law enforcement agencies to deter, prevent, and prosecute environmental crimes in Albania through information sharing. The IGEC and its multi-agency approach can play a critical role in this regard.

The Deputy Head of OSCE Presence in Albania highlights that “Its establishment recognises that the most effective way to tackle environmental crime is through partnership among all relevant stakeholders”<sup>13</sup>.

On 3 June 2015, the Minister of Environment issued the Order to establish IGEC, with the support of the OSCE Presence in Albania, which provided the legal ground for its structure, scope and functionalities. It specifies the tasks of IGEC:

- establishing a national system on identification, reporting and monitoring of the environmental crimes;
- assessment of gaps and needs for legal improvement and capacity building for further enforcement;
- identification of cooperation modalities among institutions at the national and local level;
- assessment of current level of implementation in coherence with the EU requirements.

The IGEC is composed of permanent members, who are representatives of Central Governmental Institutions and agencies such as: • Ministry of Tourism and Environment • National Environmental Agency • Environmental Inspectorate • Police • Prosecutor Office • National Agency for Protected Areas, Custom Office • State Health Inspectorate, Land Inspectorate and IMOC. To date, the representation of institutions has been through the appointed technical staff.

The IGEC Institutional Development Plan for 2016- 2020 (Jan. 2016) is the main document containing the strategic objectives and main working directions. This plan was prepared in close co-operation with all IGEC members with the assistance of an international contracted expert, financed by the Presence in Albania. The IGEC institutional development plan states that “IGEC partners will work together to examine current practices in terms of intelligence gathering and development, information sharing, joint coordination, resource implications, operational planning, joint objectives and delivery mechanisms.

In order to make the best use of resources and opportunities for taking forward the effective interventions, the IGEC acknowledges that intelligence and data held independently by individual IGEC members should be considered collectively”<sup>14</sup>.

## **7. Assessment of gaps and opportunities for future development**

Various challenges have emerged during the period of assessing the status of environmental crime and cooperation among institutions.

<sup>13</sup> Remarks from the Deputy Head of Presence at the local workshop of the Interinstitutional Group on Environmental Crime, 30 November 2017, Patos Municipality.

<sup>14</sup> IGEC (2016): Institutional Development Plan 2016-2020 pg. 12.

*Challenges no.1: The coherent leadership commitment to tackle environmental crime*

Apart from the verbal political commitment to address the environmental crimes seriously and at all levels and in all sectors, the progress of making institutions operational and effective in addressing the issue remain non-satisfactory in reality. The non-consistent priority set up for addressing different environmental concerns or problems by the government and/or local authorities limits the institutional capacities to take initiative for strategic action. Furthermore, the centralised approach to inter-institutional cooperation results in delayed decision-making processes, or inactivity at the expert level to make a commitment to sufficient data or intelligence sharing.

*Challenges no.2: The legal framework and institutional set up*

The relevant criminal provisions have not been scattered around in different pieces of environmental legislation. At first sight seems that the legal reform is easier as it concentrates on one single law. On the other hand, it is important to note that there is a need for coordination between the Criminal Code and the relevant administrative environmental protection laws and by-laws which have been further aligned with the EU *acquis* during these years. These have provided new administrative contraventions for many that in part should be made criminal after the expected reform in the criminal legislation. The recent Government's initiative to merge certain institutions and law enforcement agencies aims at higher efficiency and more communication that is non-bureaucratic. Nevertheless, for the structural changes there is a need to have a clear mandate and scope of work in order to achieve the desirable results.

*Challenges no.3: The data on the status of environmental crime in Albania*

Defining the boundaries of environmental crimes is difficult. Albania is encountering the lack of data on the status of the environmental crime. The measurement and analysis of damage to environmental resources caused by crimes or illegal activities are hampered by two main factors: the absence of a common definition of the terms "environmental crimes", "environmental-related crimes", "environmental security" and the absence of systematic data collection at the country level. There is no precise definition of environmental crimes.

Statistical data are often organized and categorized according to the legal provisions, such as articles in legal or penal codes, which are not always relevant from an analytical standpoint. A lack of database consisting of cases and information on the progress in the reported cases limits the level of interoperability among institutions, as well as the reference to precedents in dealing with specific cases.

*Challenge no.4: Cooperation among institutions at the national and local level*

Environment has no boundaries, thus the protection of the natural elements from harm, and the prevention of damage to human beings and the environment, should be approached in a consistent and coordinated way at the local, national and international level. Today, environmental security is weakened by gaps and loopholes in legislation, and unclear roles, frequently overlapping, for various institutions at the national and local level. It is even more evident when it comes to responsibilities and scope of work of various inspection and enforcement agencies at the local level. Furthermore, the

responsibilities among different central government institutions dealing with the natural resources management such as water and waste are being scattered, which then leads to different interpretation or no action taken in case of violations or actions with negative environmental impacts.

*Challenge no.5: The assessment of the threat and risk for environmental crime in Albania*

In assessing the threat and risk, there is an emerging need to quantify social and economic impacts, which then highlights the absence of research, analyses and reports. Good examples are construction of small hydropower stations along the rivers and streams in Albania and the moratorium on lodging.

There is lack of development of different scenarios to highlight risks and opportunities, which enable agencies and institutions, including law enforcement agencies, to prepare appropriate responses in the case where the identified phenomena is becoming a reality.

## **8. Conclusions and recommendations for future actions**

The Strategic Objectives 2016-2020 shows a clear progress in fulfilling the IGEC's mission. A number of opportunities might be further explored by IGEC in the upcoming three-year period 2018-2021:

- consolidating the achieved results on inter-institutional cooperation by expanding horizontally the focus of work related to environmental crimes, communicating with and contacting other institutions and agencies at national and local level;
- increasing the efficiency and providing an adequate timely and quality response in taking measures to prevent or prosecute offenses related to environmental crimes in different sectors;
- taking the concrete actions in addressing the legal gaps or clarifying the institutional roles at the central and local level in addressing the issues related to environmental crimes in Albania and;
- increasing the level of awareness, understanding, knowledge and support to various actors from decision makers, high executive authorities of IGEC institutions and/or other agencies, local authorities, to technical staff of institutions and agencies as well as to the CSOs and general public.

Based on the process of consultations and as a part of this paper, some recommended actions are summarized in the following section:

*IGEC & Legislator: Legal reform*

The proposed reform on the environmental criminal law, as part of the Criminal Code, pushes the needs to increase the level of protection of environment based on the experience of activities of the citizens and operators in Albania. It may be noted that the environmental criminal law focuses more on the consequences related to the traditional values, than on the environmental values per se. As such, the following should be considered:

- revision of fines and penalties for individuals and companies based on the scale of the environmental damage and environmental liability;
- revision of environmental permits, especially monitoring the compliance with the

set conditions, and enforcement, and;

- IGEC to take a more proactive role based on its mandate in proposing the legal adjustments/changes.

#### *IGEC and Central Government Institutions: Institutional set up and restructuring*

Although assessed as a positive and necessary step in addressing the issues related to environmental crimes, the current IGEC structure and set up has certain limitations to effective functioning as an inter-institutional body. For example, some of the limitations derive from the IGEC character with no decision-making mandate, no decision-making representation, overlaps in institution's roles, functions and field operations, etc. could be overcome by:

- upgrading the IGEC to a subordinate body under the Prime Minister's Office is perceived as strengthening the role, getting a stronger mandate and more efficient inter-institutional communication;

- furthering the clarification on the ways to increase the efficiency to coordinate the communication and exchange among the IGEC institutions. Due to the fact that environmental crime issues are more directly linked to enforcement agencies, it is considered that more efficient communication and cooperation might be achieved if the IGEC lead goes with State Inspectorate. It might not only help in knowledge sharing, but also in actions of support in preventing the illegal actions, prior to letting them become the environmental crimes, and;

- expanding the IGEC membership by inviting on *ad-hoc* basis other central government institutions and agencies, academic researchers/experts, and CSOs members.

#### *IGEC and different actors: Knowledge, capacities and skills*

To better combat these unlawful acts, prerequisites include notably advancing the existing knowledge on environmental crimes and raising the awareness of the public, legislators, authorities, judiciary, environmental experts from different sectors, carrying out a wide-range and systematic research on crimes against environment, and providing the strategic analysis of offences and threats related to environment in Albania by:

- having a joint action with other technical assistance programs and/or research institutions on expanding knowledge on the specific topics related to environmental crimes;

- developing specific knowledge and information on environmental monitoring indicators (air pollution, soil contamination, hygiene, and public health) provided by various inspectorates and monitoring institutions and agencies; and

- conducting training courses and/or expert workshops on the specific Action Plans and/or Standard Operation Procedures of various institutions, such as custom control procedures, emissions discharge monitoring, etc.

#### *IGEC: Research data and information management*

To carry out a wide-ranging and systematic research on crimes against water and providing the first strategic analysis of offences and threats related to the environment in Albania by:

- making an inventory of the various forms of crime that threaten this fundamental resource, its management, and related supply chains and infrastructure;

- analyzing the potential impact and risks of these crimes in Albania; and

- establishing a consolidated database of cases with information on the progress made in each case.

#### *IGEC, Local Institutions and Agencies: Cooperation and solutions to local environmental challenges to prevent environmental crimes*

As the meetings at the local level are highly appreciated for discussion on the concrete cases and identification of the practical solution, this practice is recommended to be maintained on the primary focus among IGEC activities by:

- organizing the inter-institutional meetings at the local level with a broad participation of regional and local authorities and agencies, covering those regions which haven't been visited in the previous years;

- collecting new topics, themes or environmental problems for local meeting such a disaster risk reduction, water supply and sanitation, pollution by food processing industry, impacts of the infrastructure on the environment and landscape, food quality control, etc.;

- sharing the local expertise by inviting the experts and specialists as guest speakers, aiming at enriching knowledge of the IGEC members and other participants, as well as obtaining the information on roles and functions of those institutions, and;

- promoting further the IGEC support at the local level by organizing field inspections and observations.

#### *IGEC and CSOs: Raising awareness and community mobilisation of the non-governmental sector and general public to achieve better enforcement*

The following to be considered:

- holding each year at least one forum of the IGEC and CSO representatives and independent experts in order to discuss challenges regarding illegal activities in environmental field;

- exchanging information with the CSOs on public perceptions regarding the efficiency of enforcement agencies on prosecuting the environmental crime cases;

- expanding the cooperation with the CSOs working on watchdogging, which could then report on community concerns and observed illegal activities.

## **Bibliography**

1. Crosett, Scott. 2016. *IGEC Institutional Development Plan 2015-2020*. Tirana: OSCE Presence in Albania.
2. Drejtësisë, Ministria e. 2019. *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*. Tirane: Qendra e Publikimeve Zyrtare.
3. EC. 2016. *Albania Progress Report*. Brussel: European Commission, 78.
4. EUROPOL. 2013. "Europol." 05 May. <https://www.europol.europa.eu/activities-services/main-reports/eu-serious-and-organised-crime-threat-assessment-socta-2013>.
5. INTERPOL, UNEP and. 2017. *The rise of Environmental Crimes: A Rapid Response Report*. Geneva: UNEP.
6. Përgjithëshme, Prokuroria e. 2019. *Raporti Vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm 2018*. Tiranë: PP.
7. RONA, UNEP and. 2017. *Recognizing the threat of environmental crime*. 15 June. [www.unenvironment.org/news-and-stories/story/environment-crime](http://www.unenvironment.org/news-and-stories/story/environment-crime).
8. Turkeshi, Enkelejda. 2015. *Crimes against Environment in Albania and the European Union's Approach to the Protection of Environment through Criminal Law*. Tirana: University of Tirana.



# Format e krimit mjedisor në Shqipëri dhe politikat e nevojshme



■ **Dr. (proc.) Gloria ÇARKAXHIU**  
Ministria e Drejtësisë  
[glorai@hotmail.com](mailto:glorai@hotmail.com)

## Abstrakt

*Për shkak të dëmtimit të pariparueshëm të natyrës, shkatërrimit të mjedisit dhe humbjes si rezultat i dëmtimit të tij të pakthyeshëm, i ngjashëm me efektin natyror domino, krimet mjedisore duhet të kenë vëmendjen e duhur. Individit dhe shoqëria duhet të kuptojnë domosdoshmërinë e mbrojtjes së natyrës, cilësisë dhe mungesës së burimeve si dhe nevojën për një qasje afatgjatë dhe të qëndrueshme të sigurisë mjedisore. Efektet e problemeve mjedisore në ekologji dhe ekonomi, më pas transmetohen në shoqëri dhe politikë. Për këtë arsye, duke ndjekur integrimin ndërkombëtar, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet shtetërore duhet të hartojnë politika që synojnë të gjitha shtresat dhe klasat e shoqërisë në mënyrë që të krijohet vetëdija mjedisore, duke filluar që nga individit. Këto duhet të rregullojnë masat parandaluese që siguria e mjedisit të jetë efektive dhe në nivelin më të lartë. Misioni i sigurisë mjedisore në zbatimin e ligjit duhet të ndahet dhe të ndiqet. Duhet të miratohen metoda dhe procese të luftimit ndërkombëtar ndaj shkeljeve. Metodat e luftimit duhet të përditësohen vazhdimisht. Sidoqoftë, beteja mjedisore duhet të bëhet pa e kufizuar konceptin e kufijve dhe të zonave. Forca e politikave kushtuar luftës mjedisore, e cila do të formohet nën një “çati” të vetme në të gjithë vendin, mund të veprojë më shpejt dhe të jetë më e kualifikuar në kuadrin mbarëkombëtar. Kjo temë do të trajtohet më në detaje nga autori në këtë punim.*

## Fjalëkyçe:

**mjedisit, siguria, shoqëria, krimi mjedisor, politika mjedisore.**

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

## 1. Problematika

Shqipëria si një vend në zhvillim, vitet e fundit, ka pasur një ndryshim rrënjësor jo vetëm në aspektin shoqëror e politik, por edhe në atë mjedisor. Zhvillimi urban dhe lëvizjet e shumta të popullsisë, kryesisht largimi nga zonat rurale dhe vendosja e pjesës më të madhe të popullsisë në zonat urbane, ka bërë që jo vetëm të kemi një ndryshim demografik, por të kemi dhe ndryshime të rëndësishme në mjedisin ku ne jetojmë. Zhvillimet e vrullshme urbane kanë sjellë një ndryshon rrënjësor në mjedis. Ndërtimet e shumta jo vetëm pa një plan, por madje edhe në zona të palejueshme, prerja e pakontrolluar e pyjeve, erozioni, ndotja industriale, derdhja e ujërave të zeza në dete apo lumenj, mbeturinat urbane apo inerte, çlirimi i gazrave, ndryshimet klimatike etj., kanë sjellë një situatë kaotike në Shqipëri.

Shqipëria edhe pse një vend i vogël nuk ka mundur t'i shpëtojë fenomenit të ndotjes dhe degradimit të mjedisit. Ka shumë institucione, por sidomos Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si një institucion qendror, kanë për mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave. Më saktësisht, kjo ministri ushtron veprimtarinë e saj të përgjegjësive shtetërore në politikën, standardet e trajtimit të mbetjeve dhe të efekteve që sjellin në drejtim të ajrit dhe mjedisit, cilësinë e ajrit, zhurmat, ndotjen industriale, kimikatet, ndryshimet klimatike dhe monitorimin e treguesve të mjedisit dhe të cilësisë së ujërave, si dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis. Ajo harton politika dhe merr masa për natyrën dhe biodiversitetin, përfshirë florën dhe faunën, mbrojtjen e tokës nga erozioni e degradimi, mbrojtjen e peizazhit natyror, mbrojtjen e faunës së egër e të

specieve të rrezikuara dhe zonat e mbrojtura; gjithashtu kontrollon sektorin e pyjeve dhe kullotave<sup>1</sup>.

Në një kohë ku teknologjia dhe industria kanë ecur me hapa galopi, fatkeqësisht mjedisi është në situatë vërtet alarmante. Shqipëria si një nga vendet në zhvillim, sidomos në vitet e pas-komunizmit, ka bërë përpjekje për një bum ekonomik, i cili është përkthyer edhe në prishje të ekosistemeve natyrore si dhe, në shfrytëzime të burimeve natyrore përtej masave të lejuara të ruajtjes së këtyre pasurive, duke sjellë si pasojë prishjen e balancave; duke harruar rëndësinë e pakthyeshme që ka mjedisi në jetën tonë. Megjithatë, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë hapash të rëndësishëm për sa i përket përmirësimit të kuadrit ligjor mjedisor, duke mbajtur në konsideratë edhe përafrimin e legjislacionit të saj të brendshëm me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

## 2. Përpjekjet ligjore në parandalimin dhe luftimin e krimit mjedisor

Në legjislacionin e brendshëm penal shqiptar, krimeve ndaj mjedisit, për shkak të rëndësisë dhe ndjeshmërisë që ato përfaqësojnë i është dedikuar një krë i veçantë në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Përkatesisht në kreun IV “Vepra penale kundër mjedisit”, fillimisht përfshiheshin nenet 201-207, që përfshinin sanksione për ndotjen e ajrit, transportimin e mbeturinave toksike, ndotjen e ujërave, peshkimin e ndaluar, prerja e paligjshme të pyjeve, prerjen e drurëve dekorativë dhe frutorë, shkeljen e karantinës së bimëve dhe kafshëve. Fillimisht shkelësit e këtyre veprave penale në varësi të shkeljes dënoheshin sipas rastit me gjobë ose edhe me burgim deri në pesëmbëdhjetë vite burg.

Me ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 ‘Kodi penal i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, janë shtuar në kreun IV, “Vepra penale kundër mjedisit”, dy vepra të reja penale, në nenet 206/a “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor”, dhe 206/b “Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor”, të cilët parashikojnë se sanksionet për këto dënime arrijnë përsëri deri në burgime me pesëmbëdhjetë vite.

Me ligjin nr. 44/2013, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 ‘Kodi penal i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, u amenduan dhe dy nenet e kreut IV, përkatesisht nenet 206/a dhe 206/b me qëllim heqjen e dënimit me gjobë dhe me dënim me burg duke hequr dënimin dhe me gjobë, dhe duke rritur dënimin me burgim deri në njëzet vite. Përkatesisht, ndryshimet e fundit legjislative, të miratuara me ligjin nr. 44/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 ‘Kodi penal i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, kreu IV “Vepra penale kundër mjedisit”, ka ndryshuar dhe ka shtuar numrin e veprave penale kundër mjedisit, dhe përfshin nenet 201 deri 207/ç. Me anë të këtyre ndryshimeve janë përmirësuar neni 201 “Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e

<sup>1</sup>Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. <http://www.mjedisi.gov.al/wp-content/uploads/2019/08/rregullore-e-brendshme.pdf>, konsultuar datë 31.10.2019.

tokës”, neni 202 “Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër” dhe neni 203 “Substancat ozonholluese”, ndërkohë që janë shtuar pas nenit 201, nenet: 201/a “Menaxhimi i mbetjeve”, 201/b “Transportimi i mbetjeve”, 201/c “Aktivitetet e rrezikshme” dhe 201/ç “Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme”; pas nenit 202: nenet 202/a “Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër” dhe 202/b “Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore”; pas nenit 207: nenet 207/a “Braktisja e kafshës të shoqërimit”, 207/b “Vrasja me dashje e kafshës së shoqërimit”, 207/c “Keqtrajtimi i kafshës” dhe 207/ç “Ndeshjet ndërmjet kafshëve”.

Sipas vetë legjislatorit në vetë relacionin shoqërues<sup>2</sup> të ligjit ndryshues këto ndryshime që propozohen në fushën e mbrojtjes së mjedisit kanë për qëllim të zhvendosin (transponojnë) plotësisht *Direktivën 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal*, (Raporti i Progresit për vitin 2016 thekson faktin se *Direktiva për krimin në mjedis* nuk është zhvendosur ende). Ligji përcakton dhe veprat penale të kryera nga persona fizikë a juridikë, me dashje apo nga pakujdesia, të cilat bien ndesh me legjislacionin specifik për mjedisin dhe për rrezatimet jonizuese apo me lejet/autorizimet që janë miratuar në zbatim të tyre dhe që rrezikojnë të shkaktojnë ose shkaktojnë dëm real mbi cilësinë e ajrit, të ujit, të tokës, mbi bimët, mbi kafshët, mbi shëndetin apo jetën e njeriut.

Legjislacioni në fushën e mjedisit dhe të rrezatimeve jonizuese ka avancuar mjaft kohët e fundit, duke zhvendosur në legjislacionin tematik/administrativ të vendit pjesë të rëndësishme të *acquis*-it të BE-së për mjedisin, të miratuar në përputhje me Traktatin e KE-së dhe aktet për rrezatimet jonizuese të miratuara në përputhje me Traktatin e Euratomit. Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për “Kodin penal”.

Ky i fundit, për veprat penale në fushën e mjedisit, mbetet ende thjesht me parashikimet kombëtare. Problematika e deri sotme në zbatimin dhe detyrimin e legjislacionit për mjedisin ka treguar se mjedisi nuk mund të mbrohet siç duhet vetëm përmes legjislacionit specifik/administrativ. Prandaj, ky legjislacion duhet të plotësohet edhe me veprat penale në fushën e mjedisit dhe sanksionet përkatëse të parashikuara në kodin penal. Për të siguruar një vazhdimësi dhe konsistencë midis kërkesave ligjore të legjislacionit specifik/sectorial për mjedisin dhe rrezatimet jonizuese të përafruara tashmë me ato të BE-së, me parashikimet e kodit penal, kërkohet që edhe ky i fundit të reflektojë kërkesat e legjislacionit evropian në fushën e mjedisit. Si pasojë e miratimit dhe zbatimit të këtyre amendimeve, synohet dhe pritët që të rritet shumë ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit, te të gjithë aktorët që veprojnë mbi mjedisin dhe që kanë potencial për ta rrezikuar atë, përmes aktiviteteve të tyre.

### 3. Statistika ndër vite për krimet ndaj mjedisit

Me ndryshimet e vazhdueshme të *Kodit penal të Republikës së Shqipërisë* në lidhje me kujdesin e treguar ndaj parandalimit si dhe marrjen e masave për ndëshkimin e shkelësve të tij, nëpërmjet zgjerimit të veprave penale kundër mjedisit si dhe me ashpërsimin e masave të marra për këto vepra, po sjellim një pasqyrë të statistikave mbi këto vepra:

<sup>2</sup> <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20190507095919Relacion%20Kodi%20Penal%20ndryshime.pdf>, konsultuar 31.10.2019.

### Vepra penale kundër mjedisit 2014-2018

Vepra Penale Kundër Mjedisit	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
	Dënuar	Dënuar	Dënuar	Dënuar	Dënuar	Dënuar
Neni 201, "Ndojta e ajrit"	0	4	7	19	11	40
Neni 202, "Transportimi i mbeturinave toksike"	0	0	0	0	0	0
Neni 203, "Ndojta e ujërave"	2	0	0	1	0	0
Neni 204, "Peshkim i ndaluar"	8	5	16	11	3	6
Neni 205, "Prerja e paligjshme e pyjeve"	22	39	32	36	17	20
Neni 206, "Prerja e drurëve dekorativ dhe frutorë"	1	1	4	5	1	5
Neni 206/a "Shkatërrimi me zjarr i pyjeve"	1	0	0	1	0	1
Neni 206/b, "Shkatërrimi nga pakujd. me zjarr i pyjeve"	0	1	0	0	0	1
Neni 207, "Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve"	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>34</b>	<b>50</b>	<b>59</b>	<b>73</b>	<b>32</b>	<b>73</b>

## 4. Tendencat ndër vite të dënimeve penale

Nga të dhënat statistikore, rezultojnë se në vitin 2014<sup>3</sup> ka një rritje prej 9.8% të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit, në krahasim me vitin 2013. Ndërkaq, kemi ulje prej 29% të procedimeve të dërguara në gjykatë, në krahasim me vitin 2013. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2013 prej 6%, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 13% dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 47% përkundrejt vitit 2013.

Nga të dhënat statistikore, rezultojnë se në vitin 2015<sup>4</sup> ka një ulje prej 16% të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit, në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 27% të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 13%, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

<sup>3</sup> Raporti vjetor mbi gjendjen e kriminalitetit, viti 2014.

<sup>4</sup> Raporti vjetor mbi gjendjen e kriminalitetit, viti 2015.

prej 17% dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 18% përkundrejt vitit 2014.

Nga të dhënat statistikore, rezulton se në vitin 2016<sup>5</sup> ka një ulje prej 19% të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit në krahasim me vitin 2015 dhe ulje prej 26.6 % të procedimeve të dërguara në gjykatë, në krahasim me vitin 2015. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2015 prej 21.7 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 24% dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 23.7% përkundrejt vitit 2015.

Nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2017<sup>6</sup> ka një rritje prej 13,7 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit, në krahasim me vitin 2016 dhe ulje prej 22.4% të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2016. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2016 prej 21 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 22,2 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 56 % përkundrejt vitit 2016.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018<sup>7</sup> ka një rritje prej 14.35% të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit në krahasim me vitin 2017 dhe rritje prej 73.33% të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar, përkundrejt këtij totali në vitin 2017, prej 54.64 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 82% dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata, me rreth 2.3 herë përkundrejt vitit 2017.

## 5. Konkluzione

Në lidhje me kuadrin ligjor penal, në vijim edhe të analizës së mësipërme vërejmë se në shtetin shqiptar vit pas viti fokusi penal i mbrojtjes së mjedisit është gjithmonë në rritje. Ndryshimet e shumta në “Kodin penal të Republikës së Shqipërisë” tregojnë se fokusi i shtetit shqiptar në luftën për mbrojtjen e mjedisit dhe të përbërësve të tij, ka për qëllim jo vetëm marrjen e masave ndaj shkelësve të tij, por kryesisht qëllimi është që të parandalohen fenomene të tilla. Në rritje ka qenë masa e dënimit, e cila me ashpërsinë e saj kërkon të frenojë këto fenomene keqdashëse dhe shkatërruese në mjedisin tonë, por edhe sensibilizimin e qytetarëve. Me rritjen e numrit të veprave penale, shoqëria duhet të ndërgjegjësohet se shkatërrimi i mjedisit, në një mënyrë apo në një tjetër, nuk do të na sillte asnjë të mirë jo vetëm neve, por sidomos brezave të ardhshëm. Fatmirësisht, mjedisi përfshin një sistem të tërë dhe dëmtimi i tij nuk sjell dëme të menjëhershme të kuptueshme nga ana e shoqërisë; mirëpo, fatkeqësisht, këto dëme janë të përhershme dhe të pariparueshme, dhe zgjidhja e vetme është parandalimi dhe ndalimi i këtyre fenomeneve.

Për këtë arsye Republika e Shqipërisë nëpërmjet institucioneve të saja ka marrë masat e nevojshme duke mbajtur dhe në konsideratë legjislacionin e huaj duke pasur

<sup>5</sup> Raporti vjetor mbi gjendjen e kriminalitetit, viti 2016.

<sup>6</sup> Raporti vjetor mbi gjendjen e kriminalitetit, viti 2017.

<sup>7</sup> Raporti vjetor mbi gjendjen e kriminalitetit, viti 2018.

një strukturë të gjerë dhe mjaft të mirë të ligjeve mjedisore. Mirëpo edhe pse mjedisi ka qenë në fokus sidomos vitet e fundit, problematikë kryesore e cila haset jo vetëm në fushën e mjedisit, por në përgjithësi është një problematikë për rastin e Shqipërisë, është zbatimi në praktikë i këtij kuadri ligjor. Sigurisht kur bëhet fjalë për krime në fushën e mjedisit, siç vumë re nga statistikat e mësipërme, ato janë më lehtësisht të dallueshme dhe të ndëshkueshme, mirëpo qëllimi i legjislatorit nuk është vetëm ndëshkimi, por është edhe parandalimi.

Parandalimi kërkon një angazhim më gjithëpërfshirës. Hartimi i politikave dhe i akteve ligjore dhe nënligjore në sektorin e mjedisit si dhe zbatimi i tyre është një prej sfidave të institucioneve shqiptare, jo vetëm për përmirësimin e gjendjes aktuale të mjedisit, por edhe për parandalimin e ndotjes së tij përmes vendosjes së rregullave, standardeve, parimeve, procedurave dhe normave mjedisore. Në gjitha fushat që përfshijnë mbrojtjen e mjedisit ka rregullime të posaçme me legjislacionin përkatës. Kemi ligje të posaçme për cilësinë e ajrit dhe ujit, për pyjet dhe shërbimin pyjor, për biodiversitetin, për kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës etj.

Me përpjekjet e Shqipërisë për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian një rëndësi e veçantë po i jepet edhe përafrimit me *acquis*-in, i cili deri diku është i pjesshëm dhe vazhdojnë përpjekjet për një përafrim të plotë me *acquis*-in mjedisor të BE-së. Në këtë kuadër, si dhe me qëllim përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, Shqipëria ka vijuar me hartimin dhe amendimin e disa ligjeve kryesore, si dhe me hartimin e akteve nënligjore në fushën e mjedisit. Gjithashtu, në funksion të zbatimit të ligjit dhe mbrojtjes së mjedisit janë ngritur struktura përkatëse për monitorimin e tyre.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) u krijua si ristrukturim i Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve në mbështetje, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe VKM-së nr 47, datë 29.1.2014 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të mjedisit e të agjencive rajonale të mjedisit". Agjencia Kombëtare e Mjedisit është një institucion qendror publik në varësi të ministrit, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës qendrore të AKM-së dhe degëve rajonale në qarqe, të cilat janë drejtoritë rajonale të mjedisit.<sup>8</sup>

Kjo agjenci ka funksion kryesor sigurimin e përbushjes mjedisore, kërkimin dhe dijen mjedisore, vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe licencimin, inspektimin e kontrollin tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.

Nëpërmjet strukturave të ngritura të inspektimit, në kontrollin e veprimtarive lidhur me sektorin e mjedisit dhe ujërave, merren masa për përgatitjen e raporteve periodike mbi vlerësimin e mjedisit; për përgatitjen dhe ndjekjen e "Programit kombëtar të monitorimit të mjedisit"; për sigurimin e kontrollit shtetëror të mbrojtjes së mjedisit siç parashikohet në legjislacionin në fuqi; për kryerjen e inspektimeve dhe kontrolleve përmes një programi tematik mbi bazë rrezikshmërie, të miratuar nga ministri përgjegjës për Mjedisin; për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore, siç parashikohet në ligj dhe në legjislacionin e posaçëm në fuqi; për sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit të mjedisit dhe ujërave; për shqyrtimin e ankesave për masat administrative dhe gjodat e vendosura ndaj subjekteve në kuadër të aplikimit të përgjegjësi

<sup>8</sup> Konsultuar faqja zyrtare e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, <http://akm.gov.al/kreu.html#struktura>

mjedisore, detyrimeve monetare të subjekteve të gjobitura etj.; për bashkëpunimin me inspektoratet e tjera kompetente, në rast se kërkohet prej tyre dhe për ushtrimin e çdo funksioni tjetër, të përcaktuar në ligje të tjera të posaçme, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, lejet e mjedisit dhe inspektimin.

Gjithashtu, një rëndësi e veçantë i është dhënë mundësisë së bashkëpunimit të institucioneve shtetërore përgjegjëse për mjedisin me shoqërinë civile, në ndërmarrjen e iniciativave dhe konsultimeve për çështje të rëndësishme siç është mjedisi. Me vendimet e Këshillit të Ministrave si ai nr. 247, datë 30.4.2014 “Për miratimin e rregullave, kërkesat dhe procedurat për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”, dhe ai nr. 219, datë 11.3.2015 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”, kryerja rregullisht e konsultimeve me publikun për planet e mjedisit, programet dhe legjislacionin, si dhe organizimin e tryezave me aktorët mjedisorë, kanë përmirësuar ndjeshëm situatën lidhur me ndërgjegjësimin e publikut dhe pjesëmarrjen e tij në vendimmarrjen mjedisore; po ashtu edhe aksesin e publikut për informacion mjedisor. Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka nënshkruar gjithashtu memorandume mirëkuptimi me secilën prej qendrave të Aarhusit në Shqipëri, të cilat synojnë rritjen e bashkëpunimit ndërmjet AKM-së dhe qendrave të Aarhusit si dhe risin pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje.

Përtej të gjithave sa u thanë më lart, është vetë “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, që sanksionon në nenin 56 të saj: “Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij”, ndërkohë që në kreun V të saj, në “Objektivat sociale”, parashikohet se “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm; dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm”.

Pra, gjithkush ka të drejtë që të informohet dhe të jetojë në një mjedis të përshtatshëm, të shëndetshëm dhe të mbrojtur. Mjedisi i përshtatshëm është një e drejtë që sanksionohet edhe nga kushtetuta.

Për sa më lart, me gjithë rregullimet ligjore, të drejtat dhe sanksionet për mbrojtjen e tyre, në thelb të gjithë kësaj lufte është vetëm individi. Nevojitet që të arrijmë një ndërgjegjësim më të lartë të publikut në lidhje me pasojat që do të sillnin në mjedis këto fenomene nëse nuk do t'i parandalonim në kohë, nevojitet edukimi i brezave, për ruajtjen e mjedisit dhe për angazhimin në luftën e përbashkët të përmirësimit së gjendjes aktuale mjedisore.



## Bibliografi

1. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*, e ndryshuar.
2. *Kodi penal i Republikës së Shqipërisë*, i ndryshuar.
3. Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011, *Për mbrojtjen e mjedisit*, i ndryshuar.
4. Ligji nr. 8897 datë 16.5.2002, *Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja*, i ndryshuar.
5. Ligji nr. 124/2015, *Për efikasitetin e energjisë*.
6. Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006, *Për mbrojtjen e biodiversitetit*, i ndryshuar.
7. Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002, *Për zonat e mbrojtura*, i ndryshuar.
8. Ligji nr. 10 440 datë 7.7.2011, *Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*, i ndryshuar.
9. Ligji nr. 91/2013 datë 28.2.2013, *Për vlerësimin strategjik mjedisor*.
10. Ligji nr. 5/2016 *Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë*.
11. Ligji nr. 7 2014 datë 30.1.2014 *Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë*.
12. Ligji nr. 68 2014 datë 3.7.2014 *Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 9587, datë 20.7.2006 për mbrojtjen e biodiversitetit*.
13. Ligji nr. 81 2017 datë 4.5.2017 *Për zonat e mbrojtura*.
14. Ligji nr. 9385, datë 4.5.2005 *Për pyjet dhe shërbimin pyjor*, i ndryshuar me ligjin nr. 15/2012 *Për një ndryshim dhe shtesa në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 Për pyjet dhe shërbimin pyjor*, të ndryshuar, si dhe me ligjin nr. 48/2016 *Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005, Për pyjet dhe shërbimin pyjor, të ndryshuar*.
15. Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007, *Për fondin kullosor*, i ndryshuar me ligjin nr. 49/2016 *Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007, Për fondin kullosor*, të ndryshuar.
16. Ligji nr. 10431, datë 9.06.2011 *Për Mbrojtjen e Mjedisit* i ndryshuar.
17. Ligji nr. 27/2016 *Për manaxhimin e kimikateve*.
18. VKM nr. 177, datë 31.3.2005 *Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse*. VKM nr. 435 datë 12.9.2002, *Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë*. VKM nr. 803, datë 4.12. 2003 *Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit*.
19. VKM nr. 247, datë 30.4.2014 *Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore*.
20. VKM nr. 219, datë 11.3.2015 *Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor*.
21. VKM nr. 13, datë 4.1.2013 *Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis*.
22. VKM nr. 419, datë 25.6.2014 *Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishe për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja*.
23. VKM nr. 16, datë 4.1.2012 *Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor*.
24. VKM nr. 313, datë 9.5.2012 *Për miratimin e rregullores për mbrojtjen e publikut nga shkarkimet në mjedis, përcaktimin e mostrave, rajoneve dhe frekuencës së matjeve*.
25. VKM nr. 594, datë 10.9.2014 *Për miratimin e strategjisë kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit*. VKM nr. 865, datë 10.12.2014 *Për reduktimin dhe stabilizimin e shkarkimeve të gazeve serrë të fluorinuara*.
26. VKM nr. 814, datë 31.12.2018 *Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019-2030*.
27. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1374, datë 10.10.2008, *Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 435, datë 8.6.2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor*.
28. *Strategic Document of Biodiversity Policy Albania*.
29. VKM nr. 57, datë 6.2.2019 *Për kriteret dhe mënyrën e zonimit të territorit të një zone të mbrojtur mjedisore*.
30. VKM nr. 414, datë 19.6.2019 *Për rregullat, kriteret dhe procedurat për përdorimin e shpellave për qëllime turistike*.
31. VKM nr. 302, datë 10.5.2019 *Për kriteret e ushtrimit, të miratimit e monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura mjedisore*.
32. VKM nr. 369, datë 29.5.2019 *Për miratimin e rregullave për shpalljen e zonave të veçanta të ruajtjes*.
33. VKM nr. 303, datë 10.5.2019 *Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës Shqiptare*.
34. VKM nr. 593, datë 9.10.2018 *Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve të Menaxhimit të zonave të mbrojtura mjedisore*.
35. *Raporte gjendja e mjedisit*, Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
36. *Konventa për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendim marrje dhe të drejtën për t'u i drejtuar gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin* (Konventa e Aarhusit 25 qershor 1998).



---

## **AKADEMIA E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »**

# Perceptimi publik shqiptar për krimin mjedisor dhe, proceset integruese të Shqipërisë, në Bashkimin Evropian



■ MSc. Enrik KECO

Koordinator zyre në Universitetin e Tiranës  
për projektin "CleanScore" (AADF)

## Abstrakt

Shqipëria ka hyrë në rrugën e integritit evropian dhe ka marrë angazhimin e vet institucional dhe politik në këtë kuadër. Anëtarësimi në BE kërkon përafrimin dhe përputhshmërinë e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian. Kapitulli 27 i BE-së ka të bëjë me fushën e mjedisit. Aktualisht politikat mjedisore janë të rregulluara me legjislacionin përkatës shqiptar dhe në momentin e hapjes të këtij kapitulli, do të duhet që ky legjislacion të jetë në përputhje me atë të BE-së. Mjedisit cilësohet si një nga kapitujt më të vështirë për t'u adoptuar duke qenë se rëndësia e tij në Shqipëri nuk ka pasur të njëjtën peshë si në vendet e BE-së. Shteti shqiptar është angazhuar për krijimin e një mjedisit të qëndrueshëm nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm mjedisor në të gjitha komponentët që ai përbëhet. Situata aktualë në fushën e mjedisit është përkeqësuar nga viti në vit dhe më e rëndësishmja është se ka një pandëshkueshmëri ndaj krimit mjedisor. Krimet mjedisore po rriten me 5-7% çdo vit, 2-3 herë sa raporti i rritjes së ekonomisë globale. Krimi mjedisor vlerësohet të jetë 91-258 miliardë dollarë në vit. Instrumentet institucionale dhe ligjore nuk kanë funksionuar sipas të dhënave statistikore në këtë fushë. Nga studimet e ndryshme të kryera për të parë perceptimin publik në lidhje me aspekte të ndryshme rezultojnë se shqiptarët e shikojnë anëtarësimin në BE si "shpëtimin" e vetëm dhe më eficient të mundshëm. Nga një studim i zhvilluar për të matur indikatorin e mjedisit në Shqipëri para dhe pas anëtarësimit të Shqipërisë në BE rezultojnë se 79.69% mendojnë se situata mjedisore do të ndryshojë pas integritit të Shqipërisë në BE.1

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

## Fjalëkyçe:

**mjedisit, siguria mjedisore, perceptimi publik, krimi mjedisor, siguria kombëtare.**

## 1. Hyrje

Agjenda e Shqipërisë pas rënies së sistemit komunist është orientuar drejt integritit evropian. Politikat kombëtare shkojnë paralel me rekomandimet e institucioneve të Bashkimit Evropian. Qasja evropiane nuk është vetëm një dëshirë dhe angazhim institucional por edhe një dëshirë e vetë qytetarëve të vendit. Në një studim të kryer nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, 92% e shqiptarëve mbështesin anëtarësimin e Shqipërisë në BE<sup>2</sup>.

Në këtë kuadër angazhimi institucional nga ana e Shqipërisë shtrihet në çdo fushë, duke përfshirë edhe mjedisin. Legjislacioni për mjedisin siguron mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.<sup>3</sup>

Krimi mjedisor është zgjeruar gjerësisht vitet e fundit, në rang global, duke rrezikuar një jetesë të qëndrueshme për të gjithë popullsinë. Aktivitetet e krimit mjedisor janë nga më të ndryshmet duke e bërë problemin me kompleks dhe më të vështirë për t'i dhënë një zgjidhje.

Të dhënat e nxjerra nga studimi i UNEF & INTERPOL, për rritjen e krimit mjedisor tregojnë se:<sup>4</sup>

<sup>1</sup> Gjetje e studimit.

<sup>2</sup> Perceptimi publik i shqiptarëve për BE-në, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri & IPSOS, Mars 2019, Tiranë.

<sup>3</sup> Ligji Nr.10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit".

<sup>4</sup> A UNEP—INTERPOL rapid response assessment, The Rise of Environmental Crime, 2017 <https://wedocs.unep.org/>

- tregtia e paligjshme e botës së egër vlerësohet në 7-23 miliardë dollarë në vit;
- krimi mjedisor vlerësohet të jetë 91-258 miliardë dollarë(2016) në vit, me një rritje prej 26% nga vlerësimi i fundit në 2014;
- krimet mjedisore po rriten me 5-7% çdo vit, 2-3 herë sa raporti i rritjes së ekonomisë globale;
- humbjet e të ardhurave për qeveritë përmes të ardhurave nga taksat për shkak të shfrytëzimit kriminal llogaritet të paktën 9-26 miliardë dollarë çdo vit;
- krimet në pyje dhe prerjet e paligjshme llogariten në 51-152 miliardë dollarë;
- peshkimi i paligjshëm në 11-24 miliardë dollarë;
- shfrytëzimi i minierave në mënyrë të paligjshme 12-48 miliardë dollarë;
- mbetjet në 10-12 miliardë dollarë.

Në Shqipëri krimi mjedisor është një çështje e trajtuar pak ose aspak. Kjo vihet re nga situata në të cilën abuzuesit me mjedisit kanë dorë të lirë në veprimtarinë e tyre. Shpyllëzimi mbetet një nga plagët më të dhimbshme për Shqipërinë e cila ka pasojë të drejtpërdrejta në jetesën e të gjithë popullsisë.

Në Shqipëri çështja e ujit është delikate: uji i pijshëm nuk sigurohet në të gjitha zonat urbane dhe rurale, standardi i ujit është poshtë standardit të BE-së, monitorimi në këtë fushë është i ulët dhe shpeshherë nuk ka rezultate. Në këtë kuadër edhe erozioni i tokave është i lartë, pasojë kjo e shpyllëzimeve në masë. Gjithashtu cilësia e ajrit nuk është në standardet e duhura, si pasojë e automjeteve jashtë standardeve në qarkullim dhe nga ndikimi i drejtpërdrejtë i njeriut. Ndotja përbën një nga problemet më të rrezikshme për popullsinë. Zhurmat janë të pakontrolluara dhe në një nivel të lartë. Zhvillimi urban ka sjellë ndërtime të shumta, të pastuduara duke krijuar pasojë të mëdha në mjedis. Të gjitha zhvillimet në fushën e turizmit, energjisë, transportit, bujqësi, zhvillim urban, industri etj., kanë ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë në ndikimin e mjedisit duke përkeqësuar kështu situatën mjedisore në Shqipëri.<sup>5</sup>

Vizioni në fushën e mjedisit është: *“Shqipëria një vend me një zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik, duke mbrojtur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi, nëpërmjet menaxhimit të integruar të tyre dhe duke promovuar vlerat mjedisore e duke i vendosur ato në përfitim të prosperitetit ekonomik”*<sup>6</sup>.

Në kuadër të integritimit evropian Shqipëria duhet që të përafrojë legjislacionin në fushën e mjedisit me atë të BE-së, parashikuar në kapitullin 27-të të *acqui-së* së BE-së. Politikat mjedisore të BE-së kanë për qëllim të promovojë një zhvillim të qëndrueshëm të mbrojtjes mjedisore duke parandaluar ndotjen, duke luftuar krimin mjedisor, ndëshkuar abuzuesit e mjedisit dhe duke hartuar politika integruese në mbrojtje të mjedisit. *Acqui-a* e BE-së parashikon më shumë se 200 akte për t’u përafuar duke imponuar kështu një angazhim qendror dhe lokal të institucioneve publike.<sup>7</sup>

## 2. Gjetjet e studimit<sup>8</sup>

### A. Faktorët që ndikojnë në përkeqësimin e situatës mjedisore në Shqipëri.<sup>9</sup>

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

<sup>5</sup> Strategjia Kombëtare e Mjedisit, 2015-2020.

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis_en)


<sup>8</sup> Studimi është bërë në muajin nëntor 2019 me studentët e universiteteve të ndryshme në Tiranë. Përpunimi i të dhënave është bërë në mënyrë të automatizuar me anë të projektit “CleanScore”, financiar nga AADF. Pjesë e anketimit janë bërë 270 studentët.

<sup>9</sup> Pyetja: Sa ndikojnë faktorët e mëposhtëm në përkeqësimin mjedisor në Shqipëri?


Ndër faktorët që ndikojnë në përkeqësimin e situatës mjedisore mund të renditen: Ndotja, zhvillimi urban, mbipopullimi dhe lëvizjet e popullsisë, ngrohja globale, ndikimi i njeriut, shpyllëzimi, menaxhimi i keq i burimeve tokësore etj.

Për një sërë faktorësh (ndryshimet klimaterike & ngrohja globale, gjeopolitika dhe politikat kombëtare, shfrytëzimi i burimeve natyrore/shpyllëzimi, organizatat në fushën e mjedisit, njeriu, institucionet publike dhe biznesi privat) të intervistuar janë pyetur për të dhënë opinionin e tyre në lidhje me shkallën e ndikimit që kanë disa nga faktorët për përkeqësimin e situatës mjedisore në Shqipëri.


**Ndryshimet klimaterike dhe ngrohja globale kombëtare**




**Gjeopolitika dhe politikat**




**Shfrytëzimi i burimeve natyrore/shpyllëzimi**




**Organizatrat në fushën e mjedisit**



**Njeriu**




**Institucionet publike**



**AKADEMIA E SIGURISË**

Konferencë shkencore ndërkombëtare:  
 « Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare »

### Biznesi privat



55.94% e të intervistuarve mendojnë se *njeriu* ka një ndikim të plotë në përkeqësimin e situatës mjedisore në Shqipëri. Në të njëjtën vijë 54.02 % mendojnë se ndikim të plotë ka edhe *shfrytëzimi i burimeve natyrore dhe shpyllëzimi*. Ndërsa ndikimin më të ulët në përkeqësimin e situatës mjedisore e kanë organizatat në fushën e mjedisit.


40.23% e të intervistuarve mendojnë se një ndikim mjaft të madh në përkeqësimin e situatës mjedisore në Shqipëri e ka gjeopolitika dhe politikat kombëtare që ndiqen. Më tepër se 50% mendojnë se efektet e ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimaterike reflektohen në një masë tepër të madhe ose plotësisht në situatën mjedisore në Shqipëri.

Për sa i përket institucioneve publike, 37.15% e të intervistuarve mendojnë se kanë një impakt mjaft të madh dhe 22.61% mendojnë se institucionet publike janë plotësisht përgjegjëse në përkeqësimin e situatës mjedisore në Shqipëri.

Në të njëjtin drejtim me institucionet publike shkon edhe biznesi privat. Sipas perceptimit të të intervistuarve, 32.18% mendojnë se biznesi privat ka ndikim të madh dhe 26.44% mendojnë se biznesi privat ka ndikim të plotë në përkeqësimin e situatës mjedisore në Shqipëri.

### B. Njohuri të përgjithshme për mjedisin.

Aktivizimi për çështje mjedisore<sup>10</sup>



Informacion për sigurinë mjedisore<sup>11</sup>



AKADEMIA  
E SIGURISË


Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »


<sup>10</sup>Pyetja: Jeni aktivizuar ndonjëherë për mjedisin?

<sup>11</sup>Pyetja: Keni informacion mbi sigurinë mjedisore?

Lëndë mësimore për mjedisin<sup>12</sup>



Raste të ndëshkimit të krimit mjedisor<sup>13</sup>



Çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin pavarësisht prioriteteve kombëtare zënë gjithmonë një peshë të rëndësishme në jetën e përditshme të çdo individi. 69.35% e të intervistuarve janë shprehur se janë aktivizuar të paktën një herë për çështje që kanë të bëjnë me mjedisin. Kjo tregon një shkallë të lartë përgjegjshmërie qytetare dhe vlerësimi që i bëhet çështjeve që kanë të bëjnë me këtë fushë. Për sa i përket sigurisë mjedisore, 63.60% e të intervistuarve deklarojnë se kanë informacion dhe 33.72% deklarojnë se nuk kanë informacion. Rreth 1/3 e të intervistuarve nuk kanë informacion mbi sigurinë mjedisore, çka tregon nevojën e një punë të madhe për ndërgjegjësimin publik mbi rëndësinë e çështjes.

Angazhimi institucional për të kultivuar kulturën mjedisore është i konsiderueshëm. 76.25% e të intervistuarve kanë deklaruar se minimalisht e kanë pasur një lëndë mësimore mbi mjedisin në kurrikulën e tyre akademike. Mjedisi nuk përbën një çështje sektoriale dhe që duhet të identifikohet domosdoshmërisht me një profil të caktuar. Kultura mjedisore duhet të jetë e përgjithshme dhe për çdo student. Kjo kërkon një angazhim dhe vullnet institucional të ministrisë përgjegjëse dhe universiteteve.

Situata e përgjithshme tregon se krimi mjedisor konsiderohet në një shkallë të lartë në Shqipëri. Shqetësues është fakti se vetëm 34.10% e të intervistuarve kanë hasur/dëgjuar për ndëshkim ndaj këtij fenomeni. 60.54% e të intervistuarve deklarojnë se nuk njohin raste të ndëshkimeve ligjore për krimin mjedisor. Kjo tregon një raport jo të drejtë midis shkallës së krimit mjedisor në raport me shkallën e ndëshkimit për abuzuesit me mjedisin.

### C. Situata mjedisore para anëtarësimit, dhe pas anëtarësimit të menduar, në Bashkimin Evropian<sup>14</sup>.

Qasja që kanë shqiptarët kundrejt Bashkimit Evropian është shumë pozitive. Shpeshherë BE-ja shikohet si “shpëtimi” i vetëm për përmirësimin e komponentëve të ndryshëm institucionalë, politikave, situatës socioekonomike, situatës politike, demokratizimit, institucionalizimit, etj. Të pyetur për gjendjen aktuale për disa çështje apo situata dhe perceptimin e tyre si do të jenë po të njëjtat çështje apo situata, pas anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, të intervistuarit janë shprehur si më poshtë vijon:


<sup>12</sup> Pyetja: Keni pasur lëndë mësimore mbi mjedisin?

<sup>13</sup> Pyetja: Njihni raste të ndëshkimit të krimit mjedisor?


<sup>14</sup> Pyetja: Si i vlerësoni çështjet e mëposhtme aktualisht në Shqipëri dhe si mendoni se do të jetë situata e tyre pas anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian?




### Situata mjedisore në Shqipëri




### Krimi mjedisor dhe efektet e tij në mjedis





### Zbatimi i legjislacionit në fushën e mjedisit




### Efienca e institucioneve përgjegjëse




### Politikat kombëtare dhe lokale për sigurinë mjedisore Mbrojtja e kafshëve dhe ekosistemit




### Shfrytëzimi i burimeve natyrore




### Ndikimi i njeriut në mjedis




**Ndëshkimi ndaj krimit mjedisor**



**Shfrytëzimi i pyjeve/shpyllëzimi**



**Grafik përmblidhës për të gjithë komponentët.**



Perceptimi publik shqiptar, edhe në rastin e mjedisit tregon se besueshmëria për përmirësimin e situatës mjedisore rregullohet dhe ndryshon në masë pozitive pas anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Dy problematikat kryesore sipas janë *shfrytëzimi i pyjeve* dhe *krimi mjedisor dhe efektet e tij në mjedis*. 59.39% e të intervistuarve mendojnë se situata aktuale e shfrytëzimit të pyjeve ose shpyllëzimit është shumë e keqe dhe 40.61% mendojnë se e njëjta situatë është edhe për krimin mjedisor dhe efektet e tij. Dy komponentët të cilat do të përmirësohen më tepër pas anëtarësimit të Shqipërisë në BE rezultojnë të jenë *politikat kombëtare dhe lokale për mjedisin dhe mbrojtja e kafshëve dhe ekosistemit*.

21.46% e të intervistuarve mendojnë se zbatimi i legjislacionit aktualisht në Shqipëri është neutral (as mirë, as keq). 23.75% mendojnë se situata do të jetë e njëjta edhe pas anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Kjo tregon se kjo mund të shikohet më tepër si një politikë ose çështje e brendshme, se sa një politikë e Bashkimit Evropian.

Edhe ndikimi i njeriut në mjedis, sipas të intervistuarve, ka një ndikim shumë të keq ose të keq në situatën aktuale të mjedisit. 42.91% e tyre mendojnë se ndikimi i njeriut është shumë negativ. Situata pas anëtarësimit në BE do të ketë një përmirësim të ndjeshëm.

**AKADEMIA E SIGURISË**

*Konferencë shkencore ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare »

Vetëm 3.83% e të intervistuarve mendojnë se ndikimi shumë negativ do të vazhdojë të jetë edhe pas anëtarësimit në BE. Kjo tregon ndikimin që vlerat evropiane mund të reflektojnë në ndërgjegjësimin e qytetarëve shqiptar por edhe një lloj frike nga rritja e zbatimit së legjislacionit dhe rritja e ndëshkimeve ndaj krimit mjedisor.

Thelbi i këtij studimi tregon se Bashkimi Evropian shikohet si “shpëtimtar” i domosdoshëm për ndryshimin e situatës mjedisore në Shqipëri duke shkuar edhe në rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të publikut për të ulur efektin e tij negativ në mjedis.

### 3. Konkluzione

Situata mjedisore në rang global është shqetësuese dhe ka një kosto ekonomike, njerëzore të lartë. Edhe në Shqipëri situata rezulton që të jetë kritike dhe shqetësuese. Angazhimi institucional për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian ka bërë që edhe politikat në fushën e mjedisit të drejtohen drejt një koherence me të. Kapitulli 27 i *acqui-së* së BE-së ka të bëjë më mjedisin çka imponon përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së.

Gjetjet e këtij studimi tregojnë se faktorët shqetësues që ndikojnë në përkeqësimin e situatës mjedisore në Shqipëri janë *shfrytëzimi i burimeve natyrore & shpyllëzimi dhe njeriu*. Ndikim negativ në situatën mjedisore konsiderohet dhe roli i institucioneve publike me veprimet/mosveprimet e tij si dhe veprimtaria e bizneseve private të cilat në shumicën e rasteve nuk shqetësohen për efektet që biznesi i tyre ka në mjedis.

Krimi mjedisor në Shqipëri është shqetësues. Akoma më shqetësues është fakti se krimet në fushën e mjedisit mbeten të pandëshkuara. Të dhënat e nxjerra nga studimi tregojnë së 60.54% e të intervistuarve nuk kanë njohuri ose nuk kanë dëgjuar për raste të ndëshkimeve nga institucionet përgjegjëse për krimet që i bëhen mjedisit.

Një qasje pozitive që rezulton nga studimi është fakti që shumica e të intervistuarve deklarojnë se kanë informacion për sigurinë mjedisore dhe se aktivizohen për çështje të ndryshme mjedisore. Rëndësia e mjedisit shikohet edhe në kurrikulën mësimore duke bërë që rreth 3/4 e të intervistuarve të kenë marrë njohuritë bazë mbi mjedisin sepse një lëndë e tyre i është dedikuar kësaj çështjeje. Mjedisi nuk duhet të shikohet si një qasje sektoriale apo e profilizuar. Institucionet përgjegjëse duhet të marrin angazhimin që në kurrikulën mësimore të shkollave/universiteteve të mësohet për edukatën mjedisore, sigurinë mjedisore dhe përmirësimin e situatës mjedisore.

Synimi i këtij studimi ishte të studionte perceptimin publik për situatën mjedisore aktuale në Shqipëri dhe ndryshimi që do të vijë pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ashtu si për çështje të tjera edhe për mjedisin, shqiptarët e shikojnë BE-në si “shpëtimtar” nga ajo që është duke ndodhur aktualisht. Për të gjitha çështjet/situatat e pyetura, të intervistuarit kanë deklaruar në masë se situata do të përmirësohet pas anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

## Bibliografi

1. Nellemann, C. (Editor in Chief); Henriksen, R., Kreilhuber, A., Stewart, D., Kotsovou, M., Raxter, P., Mrema, E., and Barrat, S. (Eds). 2016. *The Rise of Environmental Crime – A Growing Threat To Natural Resources Peace, Development And Security*. A UNEP-INTERPOL Rapid Response Assessment. United Nations Environment Programme and RHIPTO Rapid Response–Norwegian Center for Global Analyses, [www.rhipto.org](http://www.rhipto.org)
2. European Comission European, *Neighbourhood Policy And Enlargement*, “Negotiations Enlargement Conditions for membership, Chapters of the acquis”.
3. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis_en)
4. Ligji nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”.
5. *Perceptimi publik i shqiptarëve për BE-në*, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri & IPSOS, mars 2019, Tiranë.
6. *Strategjia kombëtare e mjedisit*, 2015-2020.

# Impakti social, i aktiviteteve dhe sjelljes njerëzore, te çështjet mjedisore



■ **MSc. Anisa AGASTRA**  
Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit,  
Akademia e Sigurisë  
[anisa.agastra@asp.gov.al](mailto:anisa.agastra@asp.gov.al)

## Abstrakt

Në ditët e sotme është sfidë bashkëkohore ruajtja e mjedisit përkundrejt tendencës për zhillim ekonomik, industrial e teknologjik. Stili i të jetuarit po përshtatet gjithnjë e më shumë me përparimin teknologjik, duke ndikuar në kulturën dhe mentalitetin e një komuniteti. Të gjithë ndryshimet që ndodhin në mjedis kanë impakt në jetën sociale të individit. Për këtë arsye është e domosdoshme hartimi dhe zbatimi i masave e politikave promjedisore dhe gjithëpërfshirja e komunitetit në këto të fundit. Qëllimi i këtij punimi është të paraqesë fakte dhe analiza sociale për impaktin reciprok të sjelljes dhe mendësisë së njerëzve në mjedis, si dhe efektin e parimeve të sjelljes njerëzore në kuadër të mbrojtjes së mjedisit. Për të përmbushur këtë qëllim është zbatuar metodë cilësore, ku është realizuar hulumtim në literaturë, shkrime analitike dhe studime vendase e të huaja, prej të cilave është grumbulluar e interpretuar në mënyrë cilësore informacioni. Në aspektin psikosocial, nisur nga këndvështrimi teorik, janë shumë të rëndësishëm të zbatohen tre parime që kanë impakt në psikologjinë dhe sjelljen e individit në procesin e mbrojtjes së mjedisit: njohja dhe ndërgjegjësimi me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm; veprimtaritë sociale të udhëhequra nga parimi “mendo globalisht, vepro lokalisht” dhe gjithëpërfshirja e komunitetit në politikat vendimmarrëse promjedisore. Në zbatim të këtyre parimeve janë hartuar baza rregullatore e ligjore që normojë sjelljen e individit në zbatim të demokracisë dhe mjedisit, siç është Konventa e Aarhusit, për një mjedis të sigurt fizik e social. Sa më i degraduar të jetë mjedisi aq më keq ndikon në shëndetin fizik e mendor të njeriut, si dhe në zhvillimin socio-ekonomik. Prandaj, në përfundim të punimit paraqiten rekomandime për një menaxhim sa më të mirë të mjedisit dhe aktiviteteve njerëzore lidhur me mjedisin, në funksion të mirëqenies së përbashkët.

## Fjalëkyçe:

**mjedis, zhvillim i qëndrueshëm, gjithëpërfshirje, sjellje sociale, mirëqenie.**

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

## 1. Hyrje

Shoqëria njerëzore është e orientuar për të ndërtuar një jetë me dinjitet brenda kufijve të planetit duke punuar për të realizuar efikasitetin ekonomik, gjithëpërfshirjen sociale dhe përgjegjësitë mjedisore. Planeti ku jetojmë është banesa e të gjithëve, dhe pavarësisht dëshirës dhe interesit për të zhvilluar ekonominë, industrinë, teknologjinë e të tjera fusha si këto, duhet menduar për mjedisin, në sensin e mbrojtjes dhe reduktimit të dëmtimit. Dukuri të dëmshme si ndotja e ajrit, rritja e nivelit të zhurmave akustike, menaxhimi i dobët i mbetjeve, ndotja e ujërave natyrorë, shpyllëzimi, ndryshimet klimaterike, shpërdorimi i hapësirave të tokës, e të tjera ndikojnë në hapësirat mjedisore dhe jetën e njeriut. Mjedisi është bashkësia e ndërveprimeve të përbërësve biotikë dhe jobiotikë që nxisin dhe ushqejnë jetën e gjallë në tokë, duke përfshirë: mjedisin biofizik, natyror të ajrit, tokës, ujërave, shëndetin e njeriut, vlerat, dhe trashëgiminë kulturore, shkencore, fetare dhe shoqërore<sup>1</sup>.

Pra, mjedisi është bashkëveprim i faktorëve natyrë dhe shoqërorë<sup>2</sup>. Mbrojtja e mjedisit është një përgjegjësi sa shoqërore, aq edhe individuale. Shëndeti fizik, mendor dhe psikoemocional është kusht themelor për mirëqenien e individit, dhe për ta pasur këtë nuk mjafton vetëm kujdesi për veten, por edhe kujdesi për një mjedis të shëndetshëm, të pastër dhe sa më të gjelbër. Aktivitetet tona ndikojnë drejtpërdrejt në mjedis, e dëmtojnë atë vazhdimisht, ashtu sikundër dëmtojnë edhe vetveten. Ndikime në mjedis do të quajmë mjedisin natyror ose të ndërtuar, që vijnë direkt nga një aktivitet

<sup>1</sup> Austria Kulturor Kontakt, *Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm*, Mësuesit e rrjetit mjedisor. (Tiranë: 2014), 6.

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Sustainable Mass Transit, *Human Activities Effects* (2017). Për më tepër shih linkun <https://www.sciencedirect.com/topics/social-sciences/human-activities-effects>

njerëzor që mund të ketë efekte të dëmshme në ajër, tokë, ujë, peshqit, kafshët e egra ose në gjithë banorët e ekosistemit<sup>3</sup>. Ndotja ose shkatërrimi që ndodh si pasojë e një veprimi njerëzor, që mund të ketë pasoja afatshkurtra ose afatgjata, konsiderohet një ndikim mjedisor. Shumica e ndikimeve të pafavorshme mjedisore kanë lidhje të drejtpërdrejta me shëndetin publik dhe cilësinë e jetës.

Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit përbëjnë përgjegjësi globale, për të gjitha shtetet, ashtu sikundër edhe për vendin tonë. Promovimi i qëndrueshmërisë mjedisore po përbën një prioritet të rëndësishëm nga vitet '70 e tutje. Edhe në Shqipëri janë ndërmarrë një sërë masash për të hartuar baza rregullatore e ligjore dhe përshtatje me konventat më të rëndësishme, si ajo e Aarhusit për një mjedis më të sigurt. Ashtu sikundër janë ndërtuar dhe institucione të posaçme si Qendra Rajonale e Mjedisit apo Agjencia Kombëtare e Mjedisit që normojnë zbatimin e rregullave e ligjeve për mbrojtjen e mjedisit, reduktimin e ndotjeve të formave të ndryshme si dhe informimin e ndërgjegjësimit e popullatës për çështjet mjedisore. Në vendin tonë kryhen vazhdimisht studime dhe anketime për të matur perceptime të popullatës për rrezikshmërinë e ndotjes së mjedisit. Nga një sondazh *online* që u krye me popullatën shqiptare rezultoi se një ndër shtatë sfidat më të mëdha të zhvillimit të vendit është mjedisi dhe ndryshimet klimatike<sup>4</sup>.

Për të menduar për mjedisin, u krijuar filozofia e “të menduarit globalisht dhe të vepruarit lokalisht” që i nxit njerëzit të marrin në konsideratë shëndetin e gjithë planetit dhe të ndërmarrin veprimtari në komunitetet dhe qytetet ku jetojnë. Kjo nxit që popullata dhe institucionet të mendojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe risitë e politikave mendimit ti zbatojnë në lokalitetet përkatëse në funksion të së mirës së përgjithshme mjedisore dhe jetësore. Për këtë është e nevojshme bashkëpunimi dhe gjithëpërfshirja e institucioneve me komunitetet e qytetarët, duke zbatuar parimet e demokracisë në këtë proces, të drejtat e njeriut, cilësinë e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit njerëzor.

## 2. Metodologjia

Qëllimi i këtij punimi është të paraqesë fakte dhe analiza sociale për impaktin reciprok të sjelljes dhe mendësisë së njerëzve në mjedis, si dhe efektin e parimeve të sjelljes njerëzore në kuadër të mbrojtjes së mjedisit.

Synimi i punimit është që të shërbejë si një model teorik ndërgjegjësues për ndërlidhjen direkte mes jetës shëndetësore e psikoemocionale të individit, me mjedisin dhe domosdoshmërinë e mbrojtjes dhe reduktimit të dëmeve në mjedis. Në përbushje të këtyre është zbatuar metodë cilësore, mbi bazën e të cilës është grumbulluar dhe interpretuar material teorik nga literaturë vendase dhe e huaj, nga raporte e shkrime analitike dhe studime. Pyetja kërkimore që shtrohet për diskutim është “çfarë impakti social kanë aktivitetet njerëzore në mjedis dhe ndryshimet në mjedis tek njeriu?”

Duke marrë shkasë nga kjo pyetje kërkimore, si dhe në kuadër të qëllimit, synimit

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare

<sup>4</sup> Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë & Organizata e Kombeve të Bashkuara, *Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021* (Tiranë, 24 tetor 2016), 10.

Për më tepër shih linkun [https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Albanian%20Version%20-%20GoA-UN%20Programme%20of%20Cooperation%20for%20Sustainable%20Development%202017-2021%20\(Final\).pdf](https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Albanian%20Version%20-%20GoA-UN%20Programme%20of%20Cooperation%20for%20Sustainable%20Development%202017-2021%20(Final).pdf)

<sup>5</sup> Për më tepër shih artikullin, *Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm*.

Linku: [http://www.erru.al/doc/Objektivat\\_e\\_Zhvillimit\\_te\\_Qendrueshem\\_2030.pdf](http://www.erru.al/doc/Objektivat_e_Zhvillimit_te_Qendrueshem_2030.pdf)

dhe metodës përkatëse, në këtë punim parashtrihen e sqarohen tre objektiva kryesore: njohja dhe ndërgjegjësimi me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm; veprimtaritë sociale të udhëhequra nga parimi “mendo globalisht, vepro lokalisht” dhe gjithëpërfshirja e komunitetit në politikat vendimmarrëse promjedisore. Në këtë punim zhvillimi i ideve, argumenteve dhe analizës së informacionit vihet në shërbim të këtyre objektivave, duke përdorur një analizë logjike të fakteve të grumbulluara.

### 3. Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm në aktivitetet sociale promjedisore

Në një këndvështrim të shkurtër kronologjik, me qëllim për të ulur varfërinë ekstreme, në vitin 2000, asambleja më e madhe e kryetarëve të shteteve në histori u mbledh në zyrat e Kombeve të Bashkuara në New York për të miratuar *Deklaratën e mijëvjeçarit*, duke angazhuar vendet e tyre në një partneritet të ri global. Rezultati ishte vendosja e tetë objektivave të zhvillimit, me afat implementimi vitin 2015, të njohur si *Objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit (OZHM)* ose në anglisht, *Millennium Development Goals (MDG)*<sup>5</sup>. Pas vitit 2015, ndryshuan objektivat, të cilat u përqendruan tek zhvillimi i qëndrueshëm dhe tek çështjet mjedisore, të konsideruara si ndër më shqetësueset e njerëzimit për vazhdueshmërinë. Më 25 shtator 2015 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi agjendën e re të zhvillimit të post-2015, duke vendosur shtatëmbëdhjetë objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm për 15 vitet e ardhshme (deri në vitin 2030). Këto objektiva synojnë:

- t'i japin fund varfërisë dhe urisë, duke arritur sigurinë ushqimore dhe duke promovuar bujqësinë e qëndrueshme, në mënyrë që të sigurojnë jetë të shëndetshme dhe të promovojnë mirëqenien për të gjitha moshat;
- të sigurojnë edukim cilësor dhe gjithëpërfshirës;
- të promovojnë barazinë gjinore;
- të menaxhojnë ujërat dhe kanalizimet, si dhe qasjen te burimet e energjisë;
- të ofrohet një infrastrukturë e cila mundëson zhvillim dhe inovacion;
- të reduktohet parabazia mes shtetesh;
- të mundësohet një jetë e sigurt në qytete të qëndrueshme, me konsum dhe prodhim të qëndrueshëm nga qytetarët dhe bizneset;
- të menaxhohen burimet e përbashkëta në mënyrë sa më të qëndrueshme;
- të ketë bashkëpunim global për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm;
- të ketë sa më pak dhunë e sa më shumë paqe<sup>6</sup>.

Për të përmbushur këto objektiva dhe për të plotësuar kriteret e zhvillimit të qëndrueshëm, ndër të tjera është e nevojshme zhvillimi i shumë aktiviteteve sociale me karakter veprues, zbatues, informues, ndërgjegjësuës e gjithëpërfshirës të komunitetit dhe intucioneve për të dëmtuar sa më pak dhe për të mbrojtur sa më shumë mjedisin

<sup>5</sup> Adela Llatja, *Vlerësimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm, konkurrueshmërisë, dhe kohezionit në nivel rajonal*, Disertacion doktrature (Tirane: 2015), 29.

Për më tepër shih linkun <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/09/Doktoratura-Adela-Llatja-Fakulteti-i-Ekonomise-Departamenti-Marketingut.pdf>

<sup>7</sup> Për më tepër lexo: Ishak Mohammed, Researchgate, *A critical evaluation of "Think globally, act locally" and think locally and act globally in the context of sustainable development* (January: 2015).

Marre nga:

[https://www.researchgate.net/publication/289125506\\_A\\_Critical\\_Evaluation\\_of\\_Think\\_Globally\\_Act\\_Locally\\_and\\_Think\\_Locally\\_Act\\_Globally\\_in\\_the\\_Context\\_of\\_Sustainable\\_Development](https://www.researchgate.net/publication/289125506_A_Critical_Evaluation_of_Think_Globally_Act_Locally_and_Think_Locally_Act_Globally_in_the_Context_of_Sustainable_Development)



ku jetojmë. Zona ku jetojmë përfaqëson shëndetin tonë fizik e mendor dhe të gjithë duhet të jemi të kujdesshëm si trajtojmë habitatin dhe veten. Edhe Bashkia e Tiranës operon në zbatim të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, duke pasur në fokus veprimtarinë dhe ndikimin e komunitetit në mjedis, si gur themeli i urës midis “të menduarit globalisht” e “të vepruarit lokalisht” në fushën e mjedisit<sup>7</sup>. Kjo do të thotë të mendohet në mënyrë bashkëkohore e gjithëpërfshirëse në rang botëror për ndryshimet klimatike, humbjen e biodiversitetit, ndotjen e ujërave, zhurmat akustike dhe mbetjet dhe impaktet e tyre në zonat përkatëse lokale, aty ku gjithsecili banon, duke respektuar kufijtë lokalë por edhe ato globalë në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

Në aspektin socio-mjedisor, zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit lidhet me mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet dhe dëmtimet dhe angazhimin në ruajtjen e sigurisë së qytetarëve për çështjet mjedisore. Në shtator të vitit 2015, Shqipëria miratoi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, së bashku me të gjitha shtetet e tjera anëtare të Kombeve të Bashkuara. Në këtë kuadër u hartua një program strategjik për periudhën 2017- 2021, i cili u përgjigjet përparësive të vendit. Ai përfshin katër rezultate të pritshme, të cilat janë identifikuar bashkërisht nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, Kombet e Bashkuara, shoqëria civile, sektori privat dhe partnerët e zhvillimit<sup>8</sup>. Një ndër to është pikërisht promovimi i qëndrueshmërisë mjedisore.

Është e vështirë të përcaktosh unifikimin e një përkufizimi për zhvillimin e qëndrueshëm. Ky i fundit është një koncept i gjithanshëm me kontekst ekonomik, social, mjedisor, ekologjik dhe filozofik, që në trajtën e kulturës dhe traditës duhet të përmbushë jo vetëm nevojat e brezit aktual, por edhe të atyre të ardhshëm.

Duke ndjekur këtë logjikë, një përkufizim që përdoret më së shumti është se “*zhvillimi i qëndrueshëm nuk është një gjendje statike, por një proces dinamik ndryshimesh në harmoni me njeri-tjetrin, që përforcojnë përmbushjen e nevojave dhe aspiratave si për brezin aktual ashtu edhe për brezat e ardhshëm*”<sup>9</sup>.

Të gjitha aktivitetet njerëzore, të kryera në bashkëpunim nga autoritetet vendore, Qendra Rajonale e Mjedisit, organizatat jofitimprurëse, shoqëria civile, të rinjtë dhe gjithë komuniteti duhet të orientohet drejt mbrojtjes së mjedisit, shfaqjes së shqetësimeve rreth problemeve mjedisore dhe kryerjes së aktiviteteve të tilla që të kenë një impakt pozitiv në mjedis. Kjo do të pasonte me impakte më të mira psikologjike, shëndetësore, fizike e sociale te komuniteti dhe individi.

## 4. Parimi “mendo globalisht, vepro lokalisht”

Për një periudhë të gjatë kohore në forma shumëdimensionale e në kontekste të

<sup>8</sup> Për më tepër shih: Keshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë & Organizata e Kombeve të Bashkuara, *Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021* (Tirane: 24 tetor 2016), 15-16.

Linku: [https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Albanian%20Version%20-%20GoA-UN%20Programme%20of%20Cooperation%20for%20Sustainable%20Development%202017-2021%20\(Final\).pdf](https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Albanian%20Version%20-%20GoA-UN%20Programme%20of%20Cooperation%20for%20Sustainable%20Development%202017-2021%20(Final).pdf)

<sup>9</sup> Adela Llatja, *Vlerësimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm, konkurrueshmërisë, dhe kohezionit në nivel rajonal*, Disertacion doktorature (Tirane, 2015), 30.

Për më tepër shih linkun <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/09/Doktoratura-Adela-Llatja-Fakulteti-i-Ekonomise-Departamenti-Marketingut.pdf>

<sup>10</sup> Sigmund Hagvar, *The way we think shapes our future: On the importance of fruitful concepts, well-founded attitudes and powerful rhetoric* (8 May 2013).

Marre nga <https://www.intechopen.com/books/environmental-change-and-sustainability/the-way-we-think-shapes-our-future-on-the-importance-of-fruitful-concepts-well-founded-attitudes-and>

ndryshme parimi “mendo globalisht, vepro lokalisht” ka udhëhequr veprimtari sociale, aktivitete mjedisore dhe rrymën globale narrative neoliberalë të të menduarit kritik. Qëllimi është që të unifikojnë e të realizojë përqsasjen e mendimeve, opinioneve e veprimtarive globale në komunitete sociale, për të zhvilluar më shumë këto komunitete dhe për të përforcuar të mirën e përbashkët. Në aspektin mjedisor dhe zhvillimit të qëndrueshëm, ky parim vlerësohet shumë i rëndësishëm për praktikat aktuale në mbrojtje të mjedisit dhe sigurisë së komunitetit në mjedis. Idetë globale kanë nevojën të përshtaten në mjediset lokale dhe kjo kërkon kohë, përshtatje të politikave, ligjeve, informimit, ndërgjegjes kolektive dhe kulturës e mendësisë qytetare.

Rreth 25 vjet më parë koncepti “Zhvillim i qëndrueshëm” ngacmoi ndërgjegjen globale dhe nxiti mënyra të reja të të menduarit. Ky koncept është zhvilluar dhe ka evoluar në disiplina të ndryshme akademike mënyrat e të menduarit për ndryshimet klimaterike. Kur flasim për zhvillim të qëndrueshëm nuk ka të bëjë vetëm me mjedisin fizik që na rrethon. Thelbësisht një element i rëndësishëm është mendimi i qëndrueshëm që është pjesë e sjelljes personale. Zhvillimi i sjelljes vjen si rrjedhojë e mendimit sistematik. Nisur nga kjo logjikë sjelljet tona në mjedis kushtëzohen e ndikohen nga niveli i fuqizimit të sjelljeve vetjake.

Në këtë linjë, formulimi “mendo globalisht, vepro lokalisht” përbën retorikë dhe koncept të mirë pasi ka lidhje me faktin se si të gjithë ne marrim pjesë e bashkëpunojmë për një të mirë të përbashkët, që në këtë rast është mjedisi<sup>10</sup>. Barrierat mentale, nëse ekzistojnë, ndikojnë drejtpërdrejt në vendosjen e barrierave fizike apo të dukshme në raportin mes njeriut e mjedisit. Individit, si qenie njerëzore, e mbart aftësinë për të shtypur, mohuar apo rënë pre e kërcënimeve mjedisore. Ky është një mekanizëm psikologjik<sup>11</sup> që orienton se shoqëria njerëzore zgjedh vetë, nëpërmjet mendimeve, veprimeve e sjelljeve, të dështojnë apo të kenë sukses.

Sa më i degraduar të jetë mjedisi aq më keq ndikon në shëndetin e njeriut dhe zhvillimin ekonomik-social. Prandaj duhet një menaxhim sa më mirë i mjedisit natyror në lidhje me aktivitetin njerëzor që po zhvillohet çdo ditë e më shumë. Nga studimet e dy shekujve të fundit, është konstatuar se cilësia e dobët e ajrit që thithim çdo ditë dhe rritja me norma të shpejta të temperaturës, po ndikon jo vetëm në dëme në mjedis, por po shkatërron ekosistemet delikate, duke çuar në rritjen e nivelit të astmës dhe kancerit tek njerëzit<sup>12</sup>.

Në Shqipëri, zhvillimi i veprimtarisë ekonomike dhe tranzicioni i vështirë drejt ekonomisë së tregut ka ushtruar trysni të fortë në mjedis duke ndikuar negativisht në të. Investimet e reja kanë sjellë ndikime në mjedis, por tashmë është arritur që shumë prej veprimtarive që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, t’i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis përpara miratimit dhe zbatimit të tyre si qëllim për të parandaluar krijimin e zonave të tjera të ndotura, ky qëllim është kaq i rëndësishëm saqë theksojmë që parandalimi është edhe më i mirë edhe më pak i kushtueshëm sesa kurimi (parimi i parandalimit)<sup>13</sup>.

<sup>11</sup> Po aty

<sup>12</sup> Asian Development Bank, *10 ways humans impact the environment* (2016).

Marrë nga <https://interestingengineering.com/10-ways-humans-impact-the-environment>

<sup>13</sup> *Raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis* (Qershor 2014) Marrë nga <http://www.akm.gov.al/assets/vnm-pienviis.pdf>

<sup>14</sup> Per më teper lexo Sigmund Hagvar, *The way we think shapes our future: On the importance of fruitful concepts, well-founded attitudes and powerful rhetoric* (8 May 2013).

Marrë nga <https://www.intechopen.com/books/environmental-change-and-sustainability/the-way-we-think-shapes-our-future-on-the-importance-of-fruitful-concepts-well-founded-attitudes-and>

Në kuadër të proceseve për demokratizimin e jetës së vendit dhe përmirësimin e qeverisjes, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm si në nivel kombëtar ashtu dhe në arenën ndërkombëtare. Një vëmendje e veçantë u është kushtuar çështjeve mjedisore, të cilat po marrin gjithnjë e më shumë rëndësi dhe për strukturat e pushtetit vendor.

Por, ndërgjegjja globale është një koncept i mjegullt për shoqërinë njerëzore. Parimi kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm është të mbajë ekosistemin në një gjendje të shëndetshme, prodhuese dhe të larmishme. Shumë studiues përdorin termin “kapital natyror” me anë të së cilit natyra na shërben ne. Burimet janë lëndët e para ose produkte të natyrës. Një prodhim i qëndrueshëm dhe një konsum i qëndrueshëm nënkuptojmë që jetojmë brenda kufizimeve të mjedisit biofizik ndërsa “mbikonsumi” lidhet me aftësitë e natyrës për të ofruar shërbime mjedisore<sup>14</sup>.

Studimet të ndryshme tregojnë se qëndrimi në natyrë ka efekte pozitive në shëndetin mendor dhe në sjelljen e njeriut. Në disa prej studimeve është shkruar se kontakti me natyrën, nga kopshtaria, parqet urbane e shkretëtira rrisin cilësinë e jetës së njerëzve.

## 5. Ndikimi reciprok mes natyrës dhe shëndetit mendor të njeriut

Njerëzit ndihen më të kënaqur me shtëpinë, punën dhe jetën e tyre nëse kanë kontakt më të madh me natyrën në zonën ku banojnë. Psikologët rekomandojnë njerëzit që ndihen të stresuar ose nën depresion, të kalojnë sa më shumë kohë në mjedise natyrore të gjelbra, pasi e gjelbra qetëson trurin, ose në mjedise të hapura me ujë (det, liqen, lumë) pasi era e ujit dhe ngjyra blu janë çlodhëse për vëmendjen dhe organizmin. E që të shkojmë në këto ambiente, duhet së pari që këto mjedise natyrore të ekzistojnë, të jenë të qasshme dhe të mirëmbajtura.

Përfaqësues nga *psikologjia e mjedisit* kanë pohuar se vetëm një shëtitje në pyll ose shëtitje në plazh në një mëngjes me diell zgjon ndjenjat më të thella të lumturisë dhe paqes<sup>15</sup>.

Sipas studiuesit Louv<sup>16</sup>, deficitet apo dëmtimet e natyrës nuk shkaktojnë drejtpërdrejtë anomali në tru, por është kontakti i njeriut me mjedisin e jashtëm apo natyrën që e shkakton. Sipas tij qëndrimi afër natyrës përmirëson mirëqenien fizike, mendore dhe shpirtërore. Kjo i bën njerëzit të ndihen gjallë dhe për këtë arsye nuk duhet kurrsesi të komprometohet në sajë të zhvillimeve të fundit si teknologjia, urbanizimi apo media sociale. Përfitimet e natyrës janë të larmishme dhe njerëzit mund të shijojnë efektet pozitive të lidhjes me mjedisin në të gjitha nivelet e mirëqenies individuale. Për këtë arsye njeriu duhet të kujdeset për çdo veprimtari që kryen në tokë.

Tendenca për zhvillimin urban e teknologjik po nxit shoqërinë njerëzore për të krijuar e ndërtuar sa më shumë objekte në tokë, të cilat dëmtojnë cilësinë e tokës, ndotin ajrin, ndotin ujërat, shtojnë zhurmat akustike, reduktojnë hapësirat e gjelbra, etj.

<sup>15</sup> Madhuleena Roy Chowdhury, *The positive effects of nature on your mental well-being* (2019).

<sup>16</sup> Për më shumë lexo Richard Louv, *Do our kids have nature-deficit disorder?* Health and Learning, Vol.67, Nr. 4 (2010).

Marrë nga <http://www.forestschoollportfolio.com/wp-content/uploads/2015/08/DoOurKidsHaveNature-DeficitDisorderLouv.pdf>

<sup>17</sup> Për më tepër lexo Zhou. Sh, Huang, Y, Yu. B, Wang, G, *Effects of human activities on the eco-environment in the middle Heihe River Basin based on an extended environmental Kuznets curve model*, Ecoeng. 2988 (2014).

Marrë nga:

[https://www.researchgate.net/publication/263316700\\_Effects\\_of\\_human\\_activities\\_on\\_the\\_eco-environment\\_in\\_the\\_middle\\_Heihe\\_River\\_Basin\\_based\\_on\\_an\\_extended\\_environmental\\_Kuznets\\_curve\\_model](https://www.researchgate.net/publication/263316700_Effects_of_human_activities_on_the_eco-environment_in_the_middle_Heihe_River_Basin_based_on_an_extended_environmental_Kuznets_curve_model)

Konkretisht ndotja e ajrit ka pasoja të drejtpërdrejta në sistemin respirator të njeriut dhe në krijimin e alergjive, si dhe në shëndetin mendor duke shkaktuar konfuzion, mungesë përqendrimi, etj. Për këtë arsye popullata dhe institucionet duhet të mendojnë dhe të kryejnë veprimtari, pasojat dhe kostot e të cilave, duhet ti përllogarisin në afatgjatë, duke vlerësuar përfitimet nga çdo veprimtari, ndikimet në mjedis dhe në shëndetin e gjithsecilit.

Në fundin e shekullit të 21, ndryshimet klimatike dhe të aktiviteteve njerëzore kanë bashkëvepruar në mënyrë sinergjike për të dhënë impakt në marrëdhënien mes sistemit social dhe ekologjik<sup>17</sup>. Për këtë është shumë e rëndësishme të njohim e të dallojmë impaktin e aktiviteteve njerëzore në ciklin ekologjik dhe zhvillimet mjedisore lokale në periudha të ndryshme, për të identifikuar e shpjeguar faktorë dhe procese që nxisin ndryshime apo dëmtime në mjedis, duke ofruar mbështetje për marrjen e vendimeve në terma afatgjatë për mbrojtjen e mjedisit. Në dy shekujt e fundit aktivitetet njerëzore kanë ndikuar në dëmtime apo zhdukje të përbërësve mjedisorë apo gjallesave, bimësisë, biodiversitetit në të. Kështu impakti i veprimtarive njerëzore në mjedis është bërë një ndër çështjet më të rëndësishme të diskutueshme në gjithë botën. Një pjesë e publiku duhet të informohet e të ndërgjegjësohet për këtë pjesë duke bërë pjesën që i takon. Disa nga faktorët kryesorë që përbëjnë ndikimin kryesor të veprimtarisë njerëzore në mjedis, duke e ndryshuar, dëmtuar apo ndotur këtë të fundit janë mbipopullimi, ndotja, ngrohja globale, ndryshimet klimatike, mutacioni gjenetik, acidifikimi i oqeanit, ndotja e ujit, shpyllëzimi, shiu acid, zhdukja e ozonit<sup>18</sup>. Nëpërmjet këtyre veprimtarive shkaktohen fenomene natyrore të tilla që dëmtojnë mjedisin nga njëra anë, dhe shëndetin njerëzor nga ana tjetër duke ulur cilësinë e jetës, duke shtuar sëmundjet dhe duke degraduar gjithë ekosistemin.

*Mbipopullimi* – vjen si nevojë e njerëzimit për mbijetesë. Njerëzit filluan të shtohen deri sa arritën në një sasi më të madhe sesa toka dhe mjedisi e përballon, duke ndikuar gradualisht në degradimin e mjedisit. Rritja e popullsisë kërkon hapësirë dhe kapacitet, ndërkohë që u dëmtua ekosistemi, biodiversiteti dhe vetë njerëzit.

*Ndotjet – e ajrit, tokës dhe gjithë ekosistemit* vijnë nga ndotjet dhe mbeturinat nga industrializimi, urbanizimi, zhvillimi i teknologjisë, pajisjet dhe makineritë. Ndotja është në nivele aq të larta sa që 2.4 miliardë njerëz në botë nuk kanë qasje për të pastruar burimet e ujit. Kjo ndotje kërkon miliona vjet për t'u rikuperuar.

*Ngrohja globale* – është impakti më i madh njerëzor në mjedis. Shkaqet më të mëdha ndodhin që nga nivelet të CO<sub>2</sub>-së, nga frymëmarrja, deri tek djegia e karburanteve e shpyllëzimi. Sipas studimeve, çdo vit rritet niveli i CO<sub>2</sub>-shit në ajër dhe rritja e emetimeve të CO<sub>2</sub>-shit ka ndikuar që temperatura mesatare e planetit të rritet pothuajse në një shkallë të tërë.

*Ndryshimet klimatike* – lidhen ngushtë me zhvillimin historik e kronologjik të industrisë dhe teknologjisë. Këto ndryshime ndikojnë në ndryshimin e stinëve e të motit, duke premtuar lindjen e stuhive të mëdha, intensifikimin e zgatjen e thatësisë, dhe të valëve të nxehtësisë.

*Mutacioni gjenetik* – Organizmat e modifikuar gjenetikisht kanë qenë një kontribuues i madh për mbijetesën dhe prosperitetin e njerëzve. Janë përdorur qëllimisht OMGJ në AND-të e të korrurave në mënyrë që të rriten më shpejt, të shumohen më shumë, të rriten me më pak ujitje, etj. Nga ana tjetër u mor vendimi që të korret, të

<sup>18</sup> Asian Development Bank, *10 ways humans impact the environment* (2016). Shih linkun <https://interestingengineering.com/10-ways-humans-impact-the-environment>

punohet dhe të prihen vazhdimisht bari në tokë, por kjo shkaktoi një dëm tjetër, tharjen e tokës ndikoi në mungesën e pjellorisë së saj, çka dëmtoi produktet natyrore bujqësore, dhe rrjedhimisht kjo ndikon edhe në shëndetin e njeriut.

*Acidifikimi i oqeanit* – kjo dukuri ndodh kur CO<sub>2</sub>-shi shpërndahet në lidhjen e oqeanit me ujin e detit duke krijuar acid karboni. Acidi zvogëlon nivelet e PH-it në ujë, duke ndryshuar aciditetin e oqeanit me 30% në 200 vitet e fundit, varfëron përqendrimit e kalciumit dhe dëmton shkëmbinjtë nënujorë koralë, duke shfaqur kërcënime serioze të tjera.

*Ndotja e ujit.* Studimet kanë treguar se çdo vit hidhen në oqean mbi 8 milionë tonë mbeturina. Një pjesë tjetër e konsiderueshme e mbeturinave hidhen vetvetiu aty nëpërmjet erës, shirave, etj. Këto plehra përmbajnë azot dhe varfërojnë trupat ujorë të oksigjenit, si dhe grumbullojnë helme e plastike në gjithë jetën ujore, duke përfshirë peshkun e zogjtë. Individidi ushqehet me prodhimet e detit dhe konsumi i prodhimeve të dëmtuara, të helmua apo të plastifikuara të detit dëmton e shkatërron organizmin njerëzor, duke shkaktuar helmime, prishje të organizmit deri në shfaqjen e sëmundjeve të ndryshme.

*Shpyllëzimi.* Në ditët e sotme njerëzimi ka shumë nevojë për materiale ushqimore dhe materiale strehimi dhe një pjesë e mirë e tyre po realizohen nëpërmjet shfrytëzimit të drurëve në pyje. Nga ana tjetër, konstruksioni dhe ndërtimi i rrugëve përbën prioritet njerëzor dhe kjo po realizohet në kurriz të shkatërrimit të mjedisve pyjore. Sipas të dhënave ndërkombëtare 18 milion hektarë pemë priten për nevoja materiale, ushqimore ose shkatërrohen për t'iu lënë hapësirë ndërtimit të rrugëve, asfalteve, ndërtesave e objekteve të ndryshme. Pemët janë një ndër prodhuesit e oksigjenit dhe duke prerë pemët, vrasim oksigjenin dhe dëmtojnë cilësinë e jetës sonë.

*Shiu acid.* Kur njerëzit djegin qymyr, lëshohet dyoksid sulfuri dhe oksid azoti, të cilat duke u lëshuar në atmosferë, ngrihen dhe grumbullohen në trajtë reje, retë ngopen me acide shiu, të cilat kur shkarkojnë, shkatërrojnë ujin, tokën dhe pyjet. Shiu acid gjithashtu dëmton edhe mikrogjallesat ujore e tokësore e në mënyrë indirekte dëmton cilësinë e jetës së njeriut.

*Zhdukja e ozonit.* Shtresa e ozonit ka aftësi për të thithur rrezet e dëmshme UV që janë të dëmshme për shëndetin në të gjitha sferat e jetës. Ozoni është i përbërë nga tre shtresa oksigjeni dhe substancat që e shkatërrojnë ozonin, të përbëra nga klori dhe bromi, zhveshin ozonin deri në stratosferë ose O<sub>3</sub>, duke shkatërruar aftësitë e tij për të thithur UV. Në këtë rast, ndikimi i njeriut është shkatërrues për bimët që janë jashtëzakonisht të ndjeshme ndaj dritës ultraviolett, përfshirë grurin dhe elbin. Me këto dëme, duhen 80 vjet për t'u rikuperuar dhe ndërkohë njeriu duhet të marrë masa mbrojtëse për lëkurën dhe shëndetin përkatës, që cenohet maksimalisht nga kjo dukuri.

Sa më shumë të kryejmë veprimtari që ndotin e dëmtojnë mjedisin, qoftë ajrin, ujin, tokën apo pyjet, aq më shumë ky dëm na kthehet dy-tre fish në dëmtimin e organizmit, shëndetit mendor dhe cilësisë së jetës. Natyra është jeta e individit dhe është e lidhur reciprokisht me të. Të gjithë duhet të ndërjegjësohemi për të mbajtur sa më pastër e sa më gjelbër mjedisin, si i vetmi investim afatgjatë për shëndetin e mirëqenien tonë.

Në funksion të mbrojtjes së mjedisit, në botë, sikundër edhe në Shqipëri janë hartuar e është punuar për përshtatjen dhe implementimin e shumë konventave dhe janë hartuar baza të posaçme rregullatore e ligjore që normojnë sjelljen e njerëzve dhe funksionimin e institucioneve publike e private në funksion të reduktimit të dëmeve në mjedis nga veprimtaritë e njerëzve dhe mbrojtjen e tij.

## 6. Konventa e Aarhusit për mjedis të sigurt fizik e social dhe institucione të tjera promjedisore

Të mirëmenaxhosh mjedisin, krahas konkurrencës së vazhdueshme për zhvillim ekonomik, është edhe një sfidë që u paraqitet të gjithë kombeve. Për të analizuar, mirëmbajtur dhe për të fituar siguri mjedisore është e rëndësishme të trajtohet gjendja e përbërësve mjedisorë dhe aspektet tematike të këtyre përbërësve siç janë: ajri, zhurmat, ndryshimet klimatike, uji, toka, biodiversiteti dhe mbetjet.

*Konventa e Aarhusit*<sup>19</sup> është një hap i madh përpara për mjedisin dhe demokracinë. Ajo rrit të drejtën e publikut për të marrë pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikave mjedisore. Për zbatimin e kësaj konvente është e nevojshme pjesëmarrja aktive qytetare, roli aktiv i publikut si “vëzhgues” dhe qeverisja e mirë pro mjedisore<sup>20</sup>. Tre tiparet themeltare të saj janë se ajo është një konventë:

– *konstitucionale*, – që orienton funksionimin e të drejtave themelore të publikut për mbrojtjen e mjedisit.

– *me theks të dukshëm politik*, – që inicion zhvillimin dhe konsolidimin e demokracisë

– *gjithëpërfshirëse*, – ku zbatimi i saj kërkon respektimin e kërkesave të dokumenteve ndërkombëtare dhe të konventave të tjera mjedisore.

Zbatimi i kësaj konvente vjen pas nevojës për të mbrojtur mjedisin dhe të drejtën e qytetarëve për t’u ndjerë të sigurt në mjedisin ku jetojnë. Sipas raporteve të shumta të publikuara, ashtu sikur referuar edhe raportit të fundit për gjendjen e mjedisit në 2018<sup>21</sup>, gjendja e mjedisit lë për të dëshiruar. Sipas vlerësimeve vërehet një tendencë e zhvillimeve të ndryshme ekonomike në kurriz të mjedisit, pavarësisht se janë duke u ndërmarrë hapa e iniciativa për të reduktuar ndotjen mjedisore dhe mbrojtjen e sigurisë së popullatës. Për këtë shihet e nevojshme një pjesëmarrje aktive e qeverisë, organizatave mjedisore dhe shoqërisë civile dhe vetë komuniteteve, për të ndërmarrë politika të zbatuara efektive duke ndikuar në rritjen e cilësisë së mjedisit, duke përfshirë ajrin, ujin, tokën, zhurmat, mbetjet e natyrave të ndryshme etj., një ndër pikat më të rëndësishme është roli aktiv i publikut, duke qenë vazhdimisht i informuar dhe vëzhgues i mirë i politikave dhe veprimtarive në mjedis.

Përshtatja dhe funksionimi i kësaj konvente në vendin tonë ndikon në ndërgjegjësimin e komunitetit dhe institucioneve për rregullat dhe domosdoshmërinë e mbrojtjes së mjedisit. Në zbatim të kësaj konvente çdo qytetar dhe çdo institucion ka përgjegjësinë për të mbrojtur mjedisin ku jeton e ku shkel në kuadër të mirëqenies së përgjithshme dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Me aspirimin për t’u bërë pjesë e Bashkimit Europian (vend kandidat që prej 27 qershorit 2014), Shqipëria ka bërë hapa për adresimin e çështjeve mjedisore sidomos me ndërrimin e legjisllacionit pas hyrjes në fuqi të *Marrëveshjes së stabilizim-asocimit* më 1 prill 2009 dhe miratimit të ligjit kuadër të mbrojtjes së mjedisit në vitin 2002.

<sup>19</sup> Për më tepër shih: Instituti i Politikave Mjedisore, *Projekti Zbatimi i Konventës së Aarhusit në Shqipëri: perpjekjet dhe zbatimi i politikave* (Tirane: 2014).

Marrë nga: <http://iep-al.org/test/wp-content/uploads/2015/02/Zbatimi-i-Konvent%C3%ABs-s%C3%AB-Aarhusit-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri-p%C3%ABrpjekjet-dhe-zbatimi-i-politikave.pdf>

<sup>20</sup> Po aty, 9.

<sup>21</sup> Për më tepër shih: Agjencia Kombëtare e Mjedisit, *Raport i gjendjes në mjedis 2018*.

Marrë nga: <http://akm.gov.al/assets/raporti-i-gjendjes-ne-mjedis-2018.pdf>

Ndërsa procesi i ndërrimit ka ecur shumë shpejt, zbatimi i ligjit ka mbetur hapa pas duke u përballur gjithmonë me vështirësi dhe ka reflektuar në radhë të parë kapacitetin administrativ në fushën e mjedisit<sup>22</sup>.

Në vendin tonë funksionojnë institucione dhe organizata përkatëse publike ose private që mbështesin dhe ushtrojnë kontroll në zbatimin e rregullave e ligjeve për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjes së sigurisë mjedisore për qytetarët. Një prej tyre është *Qendra Rajonale e Mjedisit (REC)*<sup>23</sup> me vendndodhje në Tiranë, që është përgjegjëse për një sërë detyrimesh si: edukimin mjedisor dhe ndërgjegjësimin e publikut, përgjegjësitë mjedisore të biznesit, klimën, pyjet, etj; shërbimesh si shërbime këshillimi, fushata ndërgjegjësimi, monitorim, shtyp-media, negocime, zbatime politikash, takime publike, etj.; burime financimesh si nga fondet e BE-së, fondet dypalëshe, mekanizmat kombëtare, agjencitë e Kombeve të Bashkuara, qeveria qendrore, etj. Kjo qendër ka vijuar mbështetjen e saj në kuadër të projektit “Përmirësimi i praktikave të pjesëmarrjes publike: hapa të mëtejshëm për zbatimin e Konventës së Aarhusit në Evropën Juglindore”, të financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta dhe i zbatuar në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kosovë, RIJ të Maqedonisë, Mal të Zi, Serbi<sup>24</sup>.

Ndërkohë në Shqipëri është hartuar dhe një paketë ligjesh, normash e rregullash që rregullojnë mbrojtjen e sigurinë mjedisore<sup>25</sup>. Kuadri ligjor për mjedisin është i bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe përbëhet nga ligjet dhe aktet normative, si vendimet e Këshillit të Ministrave, aktet ministrore, rregulloret, udhëzimet dhe standardet. Kushtetuta, e miratuar nga Parlamenti në 1998, kërkon nga institucionet përgjegjëse ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm, ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm<sup>26</sup>. Shumë ligje janë hartuar për çështjet e mjedisit dhe veprimtarinë njerëzore lidhur me mjedisin, si *Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis*<sup>27</sup> nr. 10 440, datë 7 korrik 2011, ka përafuar direktivën e Këshillit 85/337/EEC të 27 qershorit 1985 mbi vlerësimin e efekteve të projekteve publike dhe private në mjedis. Ky ligj ka për qëllim të mbrojë mjedisin përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve nga projektet e propozuara të cilat mund të shkaktojnë ndikime

<sup>22</sup> Për më tepër, shih: <http://documents.rec.org/publications/Perceptimi-mjedisit-nga-publiku-2015.pdf>

<sup>23</sup> Për më tepër, shih: <http://ecso-hub.albania.rec.org/>

<sup>24</sup> Qendra Rajonale e Mjedisit & Qendra EDEN, *E drejta e publikut për informacion mjedisor dhe pjesëmarrje në vendimmarrje – Zbatimi i Konventës së Aarhusit në Shqipëri* (Tiranë: REC, 2006), 7.

<sup>25</sup> Ligjet kryesore lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe vlerësimin e ndikimit: Ligj nr. 8897, datë 16.5.2002 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja; Ligj nr. 8934, datë 5.9.2002 për mbrojtjen e mjedisit; Ligj nr. 9108, datë 17.7.2003 për substancat dhe preparatet kimike; Ligj nr. 9115, datë 24.7.2003 për trajtimin mjedisor të ujerave të ndotura; Ligj nr. 9774, datë 12.7.2007 për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis; Ligj nr. 10431, datë 9.6.2011 për mbrojtjen e mjedisit; Ligj nr. 10440, datë 7.7.2011 për vlerësimin e ndikimit në mjedis; Ligj nr. 10448, datë 14.07.2011 për lejet e mjedisit; Ligj nr. 10463, datë 22.9.2011 për menaxhimin e integruar të mbetjeve; Udhëzim nr. 8, datë 27.11.2007 për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara; Udhëzim nr. 3, datë 19.11.2009 për metodologjinë e vlerësimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis; Udhëzim nr. 1037-1, datë 12.4.2011 për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore; VKM nr. 99, datë 18.2.2005 për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve; VKM nr. 100, datë 3.2.2008 për përcaktimin e substancave të rrezikshme; VKM nr. 177 datë 31.03.2005 për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore prirës; VKM nr. 177, datë 6.3.2012 për ambalazhet dhe mbetjet e tyre; VKM nr. 178, datë 6.3.2012 për incinerimin e mbetjeve; VKM nr. 435, datë 12.9.2002 për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë; VKM nr. 453, datë 23.6.2005 për miratimin e listës së pajisjeve që përdorin lëndë ozonholluese; VKM nr. 613, datë 7.9.2011 për miratimin e rregullit teknik “për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve në mjedis të hapura në lidhje me emetimin e zhurmave”; VKM nr. 803, datë 4.12.2003 për miratimin e normave të cilësisë së ajrit.

<sup>26</sup> OSCE, *Manual për menaxhimin e problemeve mjedisore në nivel vendor* (Tiranë, shtator 2006), 12.

Për më tepër shih: <https://www.osce.org/sq/albania/22652?download=true>

<sup>27</sup> Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis nr. 10 440, datë 7 korrik 2011

<sup>28</sup> Për më tepër shih në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, *Publikime dhe Raporte*, Linku: [http://akm.gov.al/cil%3%absia-e-mjedisit.html#raporte\\_publicime](http://akm.gov.al/cil%3%absia-e-mjedisit.html#raporte_publicime)

të mëdha direkte ose indirekte në mjedis për shkak të madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre para se të miratohen projektet. Ky ligj parashikon efektet mjedisore të bizneseve në kuadër të zhvillimit ekonomik duke marrë parasysh mjedisin dhe parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Institucion tjetër për çështjet mjedisore, që është *Agjencia Kombëtare e Mjedisit*, për vitin 2015, ka hartuar një program monitorues të treguesve kryesorë mjedisor duke ju referuar burimeve dhe kapaciteteve teknike aktuale dhe në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian për të dhënë një pasqyrë të gjendjes së mjedisit në Shqipëri. Bërja publike e të dhënave dhe shpërndarja e një informacioni të saktë të treguesve mbi gjendjen e mjedisit nga një burim zyrtar për publikun e interesuar do të ndihmojë në përfshirjen e më shumë subjekteve dhe individëve në vendimmarrjen mjedisore<sup>28</sup>.

## 7. Gjithëpërfshirja publike në vendimmarrje për çështjet mjedisore

Pjesëmarrja publike në vendimmarrje është jetësore. Ajo jo vetëm rrit numrin e personave që marrin pjesë në vendimmarrje, por edhe është tregues i demokracisë që ekziston në pushtetin vendor. Pjesëmarrja publike është një mjet i cili përdor njohuritë, aftësitë dhe entuziazmin e publikut për të ndihmuar procesin e vendimmarrjes, si dhe një rol në patjetërsueshëm të tij në këtë proces. Në të njëjtën kohë pjesëmarrja publike është një detyrim moral. Autoritetet vendore punojnë për publikun dhe, që ta realizojnë këtë detyrë në mënyrën që publiku do të dëshironte, ata së pari duhet që të njohin nevojat e publikut dhe sigurisht duhet ta përfshijnë atë në marrjen e vendimeve. Sa më shumë gjithëpërfshirje të ketë nga të interesuarit dhe sa më i hapur të jetë procesi i diskutimeve, aq më shumë alternative do të jepen për arritjen e përmirësimeve sociale, ekonomike dhe mjedisore. Ushtimi i pjesëmarrjes publike në vendimmarrjen mjedisore ndihmon në formimin e urave të besimit dhe konfidencës ndërmjet autoriteteve vendore dhe komunitetit dhe i tregon atyre që ndryshimi është i mundshëm.

Çështjet e mjedisit prekin drejtpërsëdrejti ose tërthorazi qytetarët e një kombi pasi ndikojnë në shëndetin e tyre mendor, fizik dhe emocional. Sipas pikës “c” në *Konventën për të drejtën e publikut për informacion*, gjendja e shëndetit të njeriut dhe sigurisë së tij, kushtet e jetës njerëzore, vendet kulturore dhe strukturat e ndërtuara nga njeriu, ndikohen ose mund të ndikohen nga gjendja e elementëve të mjedisit<sup>29</sup>.

Në kuadër të gjithëpërfshirjes në çështjet mjedisore, duhet të zbatohet parimi se “të gjithë, gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, veçanërisht ata që u përkasin grupeve të marginalizuara dhe të cenueshme, ushtrojnë të drejtat e tyre për shërbime të barabarta cilësore, në përputhje me të drejtat e njeriut; dhe më shumë investime efektive dhe efikase për burimet njerëzore dhe financiare në nivelin qendror dhe vendor për të siguruar përfshirjen dhe kohezionin social<sup>30</sup>.

<sup>29</sup> Konventa për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t’u drejtuar gjykatës për çështje që lidhen me mjedisin, Arhus, Danimarkë (25 qershor 1998), Neni 2. Marre nga <http://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Konventa-e-Aarhusit.pdf>

<sup>30</sup> Keshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë & Organizata e Kombeve të Bashkuara, *Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021* (Tiranë: 24 tetor 2016), 24.

Për më tepër shih linkun: [https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Albanian%20Version%20-%20GoA-UN%20Programme%20of%20Cooperation%20for%20Sustainable%20Development%202017-2021%20\(Final\).pdf](https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Albanian%20Version%20-%20GoA-UN%20Programme%20of%20Cooperation%20for%20Sustainable%20Development%202017-2021%20(Final).pdf)



Nga një studim i Organizatës Botërore të Shëndetit<sup>31</sup> u arrit në përfundimin se vetëm ndotja e ajrit ishte përgjegjëse për 200 vdekje në vit, në Shqipëri dhe shumica në Tiranë. Gjithashtu u evidentua se mbi 80% e makinave përdorin naftë, për rrjedhojë emetimi i dyoksidit të squfurit dhe karbonit, oksideve të azotit, monoksidit të karbonit dhe lëndëve në pezullim është i lartë. Në qytetet e mëdha niveli i ndotjes në pika të veçanta kapërcen 6 herë nivelin maksimal të lejuar nga normat e BE-së. Sipas këtij studimi, por edhe studimeve të tjera të kësaj natyre, djegia e plehrave, si në vendgrumbullimet ashtu edhe në qendrat e banimit (vënia e zjarreve në kazanë) përbën një rrezik shumë të madh pasi është i pashmangshëm prodhimi i dioksinave, lëndë me efekte toksike shumë të larta. Më të ndjeshëm janë veçanërisht fëmijët dhe të moshuarit. Ndërsa pluhurat e krijuar nga aktivitetet e ndërtimit, si dhe shtrimi i rrugëve janë një shqetësim për qytetarët. Nga monitorimi i zhurmave urbane për vitin 2016 rezulton se në të gjitha qytetet, kemi nivele të larta zhurmash për periudhën gjatë ditës. Ndërsa për natën vetëm në disa nga pikat e monitoruara të qyteteve të Korçës, Beratit dhe Sarandës rezulton me nivel zhurmash brenda standardit<sup>32</sup>.

Zhurmat ndikojnë psikologjikisht në sistemin nervor dhe psikoemocional të individit. Shpesh prania e zhurmave ndikon në moskuptimin ose keqinterpretimin e informacionit dhe ndikon në prodhimin e konflikteve. Nga ana tjetër prezenca e zhurmave prish qetësinë publike dhe ndikon që komuniteti të jetë i pakënaqur dhe i pezmatuar vazhdimisht. Pezmatimi dhe nervozizmi nxisin pasoja të ndryshme si rëndesë psikologjike, ndryshime të humorit, konflikte, aksidente, etj.

Në këtë shumësi problematikash mjedisore është e rëndësishme përfshirja e publikut në forma të ndryshme, duke nisur nga fushatat e prekshmërisë dhe informimit deri tek pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja në vendimmarrje. Studimet kanë treguar se publiku në vendin tonë nuk informohet për problematikën mjedisore në forma të përshtatshme për të<sup>33</sup>. Si rrjedhojë nuk zbatohet Konventa e Aarhus-it e cila përmban: “Të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës për çështje që lidhen me mjedisin”.

Veç të tjerash, ka edhe problem në mungesën e lidhjeve ndërmjet institucioneve monitoruese për të integruar rezultatet e monitorimit me synimin për të shërbyer si mekanizma parandalues dhe për të nxitur politika mjedisore për minimizimin e faktorëve ndotës. Ndërkohë hartohen vetëm politika konstatuese dhe ka një zvogëlim të hapësirave të gjelbra në zonat urbane, ku aktualisht ka një sipërfaqe të gjelbër 2m2 për banor nga 7m2 për banor që është në kufijtë e normës së Bashkimit Europian.

## 8. Publiku shqiptar për ndotjen e mjedisit: impakti i tërmetit

Shqipëria prej disa vitesh është përfshirë në zhvillime të vrullshme urbane dhe kjo ka ndikuar në cilësinë e mjedisit. Faktorë si zhvillimet sociale, ndryshimet në stilin e jetesës, niveli i përgjithshëm i konsumit dhe prodhimit, zhvillimet demografike dhe

<sup>31</sup> Shih <https://www.vezhguesirural.org/lidhje/konventa-e-aarhus>,

[http://eden-al.org/OldWeb/media/Ligi\\_8672\\_26\\_10\\_2000-%20Konventa%20e%20Aarhus-it\(1\).pdf](http://eden-al.org/OldWeb/media/Ligi_8672_26_10_2000-%20Konventa%20e%20Aarhus-it(1).pdf)

<sup>32</sup> Agjencia Kombëtare e Mjedisit & Ministria e Mjedisit, *Raport Gjendja e Mjedisit 2016* (Tiranë: Projekti EIMMS, 2017), 19.

<sup>33</sup> Shih: <https://www.vezhguesirural.org/lidhje/konventa-e-aarhus>,

[http://eden-al.org/OldWeb/media/Ligi\\_8672\\_26\\_10\\_2000-%20Konventa%20e%20Aarhus-it\(1\).pdf](http://eden-al.org/OldWeb/media/Ligi_8672_26_10_2000-%20Konventa%20e%20Aarhus-it(1).pdf)

ekonomike, janë shoqëruar me një faturë jo të vogël në planin mjedisor. Në konceptin e mbrojtjes së mjedisit, zhvillimet sociale, demografike dhe ekonomike në shoqëri dhe ndryshimet përkatëse në stilin e jetesës, nivelin e përgjithshëm të konsumit dhe prodhimit përshkruhen si forcat shtytëse, që ushtrojnë presion mbi mjedisin.

Rasti i dy tërmeteve të fuqishme që ndodhën në zonën Tiranë-Durrës më datë 21 shtator 2019 dhe 26 nëntor 2019; të dyja ishin tërmete shumë të fuqishme, sidomos ky i dyti, i cili pati amplitudë dhe kohëzgjatje më të madhe. Kjo katastrofë natyrore, ishte një rrjedhojë e lëvizjes së pllakave tektonike të tokës që është një fenomen natyror i parashikuar në harta sizmike, por edhe një dukuri ku ka ndikuar edhe dora e aktiviteteve njerëzore kryesisht në sferën e ndërtimeve. Pasojat e tërmetit qenë të rënda pasi pati: *dëme njerëzore*, – persona që humbën jetën, që u plagosën e që humbën të afërm, familjarë e miq; *dëme materiale*, – shumë personave u dëmtua shtëpia, pallati i banimit apo biznesi me dëme të riparueshme ose të pariparueshme; *dëme shëndetësore*, – shumë persona u plagosën dhe patën dëmtime shëndetësore fizike; *dëme psikologjike e sociale*, – i gjithë populli shqiptar, kryesisht ata të cilët banojnë në zonat e prekura nga tërmeti përjetuar gjendje të rënduar psikoemocionale, frikë nga e papritura dhe stres. Pas tërmetit të dytë e gjithë popullata përjetoi stres post-traumatik.

Të gjithë njerëzit shfaqën shqetësim në rrjete sociale, në biseda të afërta me njëri-tjetrin, në largimin nga banesa me orë të zgjatura, nga largimi nga banesat e tyre për ditë të tëra nga frika e përsëritjes së tërmetit, nga largimi nga vendet e punës në ditët pas tërmetit, sidomos prindërit me fëmijë të vegjël, nga mbyllja e shkollave dhe shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme nga qeveria shqiptare.

Këta indikatorë tregojnë për të një stres të përjetuar psikoemocional në nivelin e turmës, që ishte i përhapur në trajtë paniku në gjithë popullatën, sidomos në pjesën e popullatës që banon në zonën Tiranë-Durrës. Kategoria më e brishtë ishte ajo që u prek drejtpërdrejt dhe ndjeu pasojat më të mëdha të kësaj dukurie natyrore, si humbja e jetës, humbja e familjarëve apo humbja e banesës. Këta pësuan më shumë sesa thjesht stres post-traumatik.

Paniku social ishte gjithëpërfshirës dhe i rëndë për popullin në Shqipëri. Kjo vërtetoi se dukuritë natyrore vijnë si rrjedhojë e natyrës dhe e veprimtarisë njerëzore në të dhe pasojat janë të dhimbshme për shoqërinë njerëzore. Nuk mund t'i kontrollojmë dukuritë të tilla natyrore, por mund të përmirësojmë aktivitetet tona në mjedis, duke e mbrojtur dhe dëmtuar sa më pak, në mënyrë që ajo që na kthehet sërish prapa, të jetë me pasojat sa më të reduktuara. Kjo ngjarje natyrore ndikoi që të rishikohen e të rivlerësohen ndërtimet, cilësia e infrastruktura e tyre, që përbën një aktivitet njerëzor në mjedis, me ndikim jo të vogël në pasojat e “ngjarjes së tërmetit”. Në mënyrë që të menaxhohen sa më mirë dukuritë të tilla dhe të parandalohet nxitja e tyre, vijnë në kujtesë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor, veprimtaria lokale sipas koncepteve globale dhe gjithëpërfshirja qytetare në mënyrë që të gjithë së bashku të ndërgjegjësohemi dhe të kryejmë aktivitete promjedimore në kuadër të mirës sonë të përbashkët shëndetësore, psikosociale, emocionale, ekonomike e politike.

Nga një studim i realizuar me një kampion të anketuarish mbi çështjet mjedisore dhe ndjeshmërinë e sjelljen promjedimore<sup>34</sup>, rezultoi që përgjigjet e anketuesve janë unanimisht për të mbështetur parimin “Ndotësi paguan”. Mendimi i 90% të tyre ishte se

<sup>34</sup> Qendra për kërkim, bashkëpunim dhe zhvillim (CRCDD), *Perceptimi i mjedisit nga publiku në Shqipëri 2015* (Tiranë: REC 2015), 74. . Shih linkun <http://documents.rec.org/publications/Perceptimi-mjedisit-nga-publiku-2015.pdf>

të gjithë palët duhet të paguajnë dhe të luajnë një rol në mbrojtjen e mjedisit. Pavarësisht kësaj mbi 50% e tyre e konsiderojnë qytetarin, aktor të rëndësishëm të mbrojtjes mjedisore<sup>35</sup>. Ndërsa 68% e publikut mendojnë se mbrojtja e mjedisit është përparësi mbi zhvillimin ekonomik<sup>36</sup>.

## 9. Përfundime dhe rekomandime

Vlera e edukimit mjedisor qytetar është po aq e rëndësishme sa edhe masat ligjore dhe politike për të kontrolluar ndotësit industrial në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit<sup>37</sup>. Mbrojtja e mjedisit është një përgjegjësi e madhe si e ndotësve industrial, por edhe vetë individëve. “Individët luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit” dhe për këtë duhen hartuar politika gjithëpërfshirë bashkëpunuese mes institucioneve, Organeve të Pushtetit Vendor, agjencive të tjera publike e private dhe komunitetit në shërbim të mjedisit dhe ruajtjes së tij.

Në mbarë botën, ashtu sikundër në Shqipëri, vërtetohet nga analiza e informacioneve në këtë punim, se për të pasur një mjedis të sigurt e të shëndetshëm, duhet të zbatohet parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, gjithëpërfshirja e komunitetit në vendimmarrjet politike dhe zbatimet e masave përkatëse për çështjet mjedisore dhe zbatimi i parimit mendo globalisht e vepra lokalisht, në të mirë reciproke të mjedisit nga njëra anë, dhe shëndetit publik, mirëqenies dhe cilësisë së jetës nga ana tjetër. Veprimtaritë e njeriut kanë impakt të drejtpërdrejtë në mjedis, duke ndikuar vazhdimisht në dëmtimin e ujit, tokës, ajrit e pyjeve. Dëmtimi i tyre kthehet në mënyrë inverse tek shëndeti i njeriut, duke ndikuar në organizimin fizik e mendor të tijin, në mënyrën e të jetuarit dhe mirëqenien. Për këtë arsye duhet të ketë ndërgjegjësim të vazhdueshëm të politikave e komunitetit, për efektet e veprimtarisë së tyre në mjedis dhe tek jeta e shëndeti publik, në mënyrë që të zhvillohet një organizim i punës me orientim promjedisor.

<sup>35</sup> Po aty, 38.

<sup>36</sup> Po aty, 73.

<sup>37</sup> Po aty, 13.

## Bibliografi

1. *Konventa e Aarhus për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështje që lidhen me mjedisin*. Aarhus, Danimarkë, 25 qershor 1998. Linku: <http://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Konventa-e-Aarhusit.pdf>
2. Instituti i Politikave Mjedisore, *Zbatimi i Konventës se Aarhusit në Shqipëri: përpjekjet dhe zbatimi i politikave*. Tiranë: 2014. Linku: <http://iep-al.org/test/wp-content/uploads/2015/02/Zbatimi-i-Konvent%C3%ABs-s%C3%AB-Aarhusit-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri-p%C3%ABrpjekjet-dhe-zbatimi-i-politikave.pdf>
3. Qendra Rajonale e Mjedisit & Qendra EDEN, *E drejta e publikut për informacion mjedisor dhe pjesëmarrje në vendimmarrje – Zbatimi i Konventës se Aarhusit në Shqipëri*. Tirane: REC, 2006. Linku: <https://www.eden-al.org/OldWeb/media/E%20drejt%20ta%20e%20publiku%20p%C3%ABr%20informacion%20mjedisor%20dhe%20pjes%C3%ABmarrje%20n%C3%AB%20vendimmarrje.pdf>
4. *Konventa e Aarhusit*, Linku: <https://www.vezhguesirural.org/lidhje/konventa-e-aarhus>, [http://eden-al.org/OldWeb/media/Ligj\\_8672\\_26\\_10\\_2000-%20Konventa%20e%20Aarhus-it\(1\).pdf](http://eden-al.org/OldWeb/media/Ligj_8672_26_10_2000-%20Konventa%20e%20Aarhus-it(1).pdf)
5. Keshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë & Organizata e Kombeve të Bashkuara, *Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qendrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021*. Tiranë: 24 tetor 2016. Linku: [https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Albanian%20Version%20-%20GoA-UN%20Programme%20of%20Cooperation%20for%20Sustainable%20Development%202017-2021%20\(Final\).pdf](https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Albanian%20Version%20-%20GoA-UN%20Programme%20of%20Cooperation%20for%20Sustainable%20Development%202017-2021%20(Final).pdf)
6. OSCE, *Manual për menaxhimin e problemeve mjedisore në nivel vendor*. Tiranë: shtator 2006. Linku: <https://www.osce.org/sq/albania/22652?download=true>
7. Austria Kulturor Kontakt, "Mjedisit dhe zhvillimi i qendrueshëm", Mësuesit e rrjetit mjedisor, Tiranë 2014.
8. United Nation Development Program (UNDP), *Objektivat e zhvillimit të qendrueshëm*. Linku: [http://www.erru.al/doc/Objektivat\\_e\\_Zhvillimit\\_te\\_Qendrueshem\\_2030.pdf](http://www.erru.al/doc/Objektivat_e_Zhvillimit_te_Qendrueshem_2030.pdf)
9. Llatja, A, *Vlerësimi i Zhvillimit të Qendrueshëm, konkurrueshmërisë dhe kohezionit në nivel rajonal*. Disertacion doktore. Tiranë: 2015. Linku: <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/09/Doktoratura-Adela-Llatja-Fakulteti-i-Ekonomise-Departamenti-Marketingut.pdf>
10. Faqja zyrtare e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, *Publikime dhe Raporte* <http://akm.gov.al/cilic3%absiae-mjedisit.html#raporte-publikime>
11. Sustainable Mass Transit, *Human Activities Effects*. 2017. Linku: <https://www.sciencedirect.com/topics/social-sciences/human-activities-effects>
12. Mohammed. I, Research gate, *A critical evaluation of "Think Globally, act locally" and think locally and act globally in the context of sustainable development*. January 2015. Linku: [https://www.researchgate.net/publication/289125506\\_A\\_Critical\\_Evaluation\\_of\\_Think\\_Globally\\_Act\\_Locally\\_and\\_Think\\_Locally\\_Act\\_Globally\\_in\\_the\\_Context\\_of\\_Sustainable\\_Development](https://www.researchgate.net/publication/289125506_A_Critical_Evaluation_of_Think_Globally_Act_Locally_and_Think_Locally_Act_Globally_in_the_Context_of_Sustainable_Development)
13. Hagvar. S, *The way we think shapes our future: On the importance of fruitful concepts, well-founded attitudes and powerful rhetoric*. 8 May 2013. Linku: <https://www.intechopen.com/books/environmental-change-and-sustainability/the-way-we-think-shapes-our-future-on-the-importance-of-fruitful-concepts-well-founded-attitudes-and>
14. Chowdhury Roy M, *The positive effects of nature on your mental well-being*. 2019. Linku: <https://positivepsychology.com/positive-effects-of-nature/>
15. Asian Development Bank, *10 ways humans impact the environment*. 2016. Linku: <https://interestingengineering.com/10-ways-humans-impact-the-environment>
16. Louv. R, *Do our kids have nature-deficit disorder?*. Health and Learning, Vol.67, Nr. 4, 2010. Linku: <http://www.forestschoolportfolio.com/wp-content/uploads/2015/08/DoOurKidsHaveNature-DeficitDisorderLouv.pdf>
17. Zhou. Sh, Huang. Y, Yu. B, Wang. G, *Effects of human activities on the eco-environment in the middle Heihe River Basin based on an extended environmental Kuznets curve model*. Ecoeng. 2988, 2014. Linku: [https://www.researchgate.net/publication/263316700\\_Effects\\_of\\_human\\_activities\\_on\\_the\\_eco-environment\\_in\\_the\\_middle\\_Heihe\\_River\\_Basin\\_based\\_on\\_an\\_extended\\_environmental\\_Kuznets\\_curve\\_model](https://www.researchgate.net/publication/263316700_Effects_of_human_activities_on_the_eco-environment_in_the_middle_Heihe_River_Basin_based_on_an_extended_environmental_Kuznets_curve_model)
18. Website <http://documents.rec.org/publications/Perceptimi-mjedisit-nga-publiku-2015.pdf>
19. Website <http://ecso-hub.albania.rec.org/>
20. Raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis, linku: <http://www.akm.gov.al/assets/vnm-pienvis.pdf> qershor 2014.
21. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Ministria e Mjedisit, *Raport Gjendja e Mjedisit 2016*. Tiranë: Projekti EIMMS, 2017.
22. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, *Raport i gjendjes në mjedis 2018*, Linku: <http://akm.gov.al/assets/raporti-gjendjes-ne-mjedis-2018.pdf>

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

23. Qendra për kërkim, bashkëpunim dhe zhvillim (CRCD), *Perceptimi i mjedisit nga publiku në Shqipëri 2015*. Tiranë: REC 2015. Linku: <http://documents.rec.org/publications/Perceptimi-mjedisit-nga-publiku-2015.pdf>.

**24. LIGJE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NË SHQIPËRI.**

- Ligj nr. 8897, datë 16.5.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".
- Ligj nr. 8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit".
- Ligj nr. 9108, datë 17.7.2003 "Për substancat dhe preparatet kimike".
- Ligj nr. 9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura".
- Ligj nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis"
- Ligj nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".
- Ligj nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".
- Ligj nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit".
- Ligj nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".
- Udhëzim nr. 8, datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara".
- Udhëzim nr. 3, datë 19.11.2009 "Për metodologjinë e vlerësimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis".
- Udhëzim nr. 1037-1, datë 12.4.2011 "Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore".
- VKM nr. 99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve".
- VKM nr. 100, datë 3.2.2008 "Për përcaktimin e substancave të rrezikshme".
- VKM nr. 177 datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritës".
- VKM nr. 177, datë 6.3.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre".
- VKM nr. 178, datë 6.3.2012 "Për incinerimin e mbetjeve".
- VKM nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë".
- VKM nr. 453, datë 23.6.2005 "Për miratimin e listës së pajisjeve që përdorin lëndë ozonholluese".
- VKM nr. 613, datë 7.9.2011 "Për miratimin e rregullit teknik 'për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin konformitetit të pajisjeve në mjedis të hapura në lidhje me emetimin e zhurmave".
- VKM nr. 803, datë 4.12.2003 "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit".



**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »**

**197**

# Police and scientific activities for the cannabis contrast



■ **Prof. Carmine GAMBARDELLA\***  
*UNESCO Chair on Landscape, Cultural Heritage and Territorial Governance, CEO and President of the BENECON University Consortium*  
[presidente@benecon.it](mailto:presidente@benecon.it)

## Abstrakt

*The hyperspectral remote sensing activities in the Albanian territory carried out since 2012, and in progress to 2019, are focused on the discretization of illicit cannabis plantations, hidden due to environmental orography or inaccessibility of places, thanks to a Convention signed in 2011 - subsequently updated and still in force - among the SCIP of the Italian Ministry of the Interior, the General Command of the Guardia di Finanza (GdF) and the Benecon, with the participation of the Government and the Albanian Police. Specific and targeted hyperspectral aerial remote sensing campaigns with the ITRES CASI-1500 sensor, suitable for recording the electromagnetic 'responses' of the natural and built environment in segments of the electromagnetic spectrum ranging from 365 to 1050 nanometers. The appropriately processed data return 'deep' images of the natural and are constructed territory. From the geo-database, for each intercepted cannabis plantation, a registry file is extracted showing the unique ID, geographical coordinates, spectral and photographic data, areal extension, estimate of the growth status of the plants on the date. This form is then delivered to the local authority for the appropriate eradication actions on the field. The joint activity has led to a drastic reduction in the years of illicit cannabis cultivation.*

ACADEMY  
OF SECURITY

International  
Scientific  
Conference:

« Environmental  
crimes,  
environmental  
safety  
and national  
security »

## Fjalëkyçe:

**Police, scientific activities, hyperspectral remote sensing, cannabis contrast.**

\* Prof. Carmine Gambardella, *Policia dhe aktiviteti shkencor i zbulimit të kanabisit nga ajri.*

The Benecon University, UNESCO Chair on Landscape, Cultural Heritage and Territorial Governance, is formed by five Italian Universities (University of Campania 'Luigi Vanvitelli, University of Naples Federico II, Pegaso University, University of Salerno, University of Sannio), and it is equipped with innovative technological instruments worth over ten million euros, including a Tecnam P2006T Special Mission Platform 4-seat twin-engine aircraft.

The aircraft was designed to perform aerial remote sensing actions thanks to the presence of special trap doors for housing Benecon's hyperspectral, thermal and photographic sensors and for controlling environmental matrices (area-ground-water). The legal nature and the Benecon's Statute provide that all the Professors of the 5 Universities, belonging to the University Consortium, due to their specific disciplinary competences, can participate in scientific and operational projects. The hyperspectral remote sensing activities in the Albanian territory carried out since 2012, and in progress to 2019, are focused on the discretization of illicit cannabis plantations, hidden due to environmental orography or inaccessibility of places, thanks to a Convention signed in 2011 - subsequently updated and still in force - between the General Command of the Guardia di Finanza (GdF) and the Benecon, with the participation of the SCIP of the Italian Ministry of the Interior, the Government and the Albanian Police.

Specific and targeted hyperspectral aerial remote sensing campaigns with the ITRES CASI-1500 sensor, suitable for recording the electromagnetic 'responses' of the natural and built environment in segments of the electromagnetic spectrum ranging from 365 to 1050 nanometers. The appropriately processed data return 'deep' images of the natural and are constructed territory. These are structured by multiple spectral layers, which appropriately classified, return thematic maps such as land use, vegetative stress of plants and crops, geological botanical anomalies from pollution, artificial materials,

**ACADEMY  
OF SECURITY**

*International  
Scientific  
Conference:*  
« Environmental  
crimes,  
environmental  
safety  
and national  
security »



water pollution, just to mention the main critical applications.

To improve the surface characterization observed in the visible spectrum, the hyperspectral sensor is flanked in flight by a PhaseOneIXAnadiral camera of the GdF with a resolution of 80 Mpx. The acquisition platform - complete with GPS instrumentation, inertial unit and related hardware input / output devices - is installed on the Piaggio 166DP1 aircraft of the GdF, configured ad hoc for remote sensing activities.

The areas to be flown over are identified on the basis of the existing cartography, the critical analysis of the aerial patrol missions carried out in the early stages of the field operations and of the critical acquisitions already matured in previous years, as well as to the reports of the Albanian Police. The data is collected and systematized in a geo-database, recorded ex-ante or during the testing phases, intended as a digital 'platform' for managing remote sensing data, from flight planning to thematic data restitution. The acquired data are entered in the geo-database and processed for the production of likelihood maps with respect to a library of cannabis spectral signatures, realized through spectral measurements with ASD Fieldspec PRO FR spectroradiometer carried out on living plants thanks to the collaboration with the Institute for Agricultural and Forestry Systems, CNR in Italy.

The processing algorithm is the Spectral Angle Mapper. The areas characterized by a greater spectral similarity with the cultivation sought are displayed in the GIS environment along with the other cartographic information.

From the geo-database, for each intercepted cannabis plantation, a registry file is extracted showing the unique ID, geographical coordinates, spectral and photographic data, areal extension, estimate of the growth status of the plants on the date. This form is then delivered to the local authority for the appropriate eradication actions on the field.

The joint activity has led to a drastic reduction in the years of illicit cannabis cultivation. Additionally, the intervention safeguards the environmental and landscape matrices of the Albanian territory that are disfigured by the improper use of soils of valuable natural value.

The 2019 flight mission was based on the acquisition, processing and analysis of visible to near infrared hyperspectral radiance measurements and of optical high spatial resolution photography. Along with imaging data, additional recordings were performed by a GPS and an Inertial Measurement Unit (IMU) on board of the airplane.

The spectral configuration of the CASI-1500 sensor was used, to measure radiance data in 24 wavelengths from the visible to the near infrared. The flight parameters were adjusted to allow for a ground spatial resolution of 75 cm.

Acquired data was processed with a mix of open source, proprietary and in-house-developed solutions compliant with the Open Geospatial Consortium (OGC) standards. Ancillary data were collected and processed along acquired data. Relevant in this sense was the recent availability of 1 arc-second digital elevation model (DEM) from the Shuttle Radar Topographic Mission (SRTM), previously available at 3 arc-seconds resolution.

The flight mission started on 6 May 2019 and concluded on 31 October 2019: 66 remote sensing missions were performed, summing up to 205 hours and 30 minutes of flight. An area of 7.350,13Km<sup>2</sup> was surveyed, corresponding to 25,6% of the Albanian territory. 4,45 terabytes of hyperspectral data were collected; 151 suspected fields of Cannabis reported corresponding to an area of 5,22 ha (Tables from 1 to 6).

The mission produced 56 Plantation Reports: 22 out of this 56 Reports, survey 151 fields suspected of being cultivated as Cannabis. Each plantation was identified by alphanumeric code, geographic coordinates and estimated area.

Furthermore data from satellite sensors were used, not only in order to integrating scientific analysis, but also to provide a further contribution to the mission investigation.

In particular, the raw data from the sensors of the European Space Agency (ESA) Sentinel-2 A/B were used. Sentinel-2 is a mission developed by ESA within the Copernicus program to monitor the green areas of the planet and to provide support in the management of natural disasters.

The 2019 flight mission was based on the acquisition, processing and analysis of visible to near infrared hyperspectral radiance measurements and of optical high spatial resolution photography. Along with imaging data, additional recordings were performed by a GPS and an Inertial Measurement Unit (IMU) on board of the airplane.

The spectral configuration of the CASI-1500 sensor was used, to measure radiance data in 24 wavelengths from the visible to the near infrared. The flight parameters were adjusted to allow for a ground spatial resolution of 75 cm.

Acquired data was processed with a mix of open source, proprietary and in-house-developed solutions compliant with the Open Geospatial Consortium (OGC) standards. Ancillary data were collected and processed along acquired data. Relevant in this sense was the recent availability of 1 arc-second digital elevation model (DEM) from the Shuttle Radar Topographic Mission (SRTM), previously available at 3 arc-seconds resolution.

The flight mission started on 6 May 2019 and concluded on 31 October 2019: 66 remote sensing missions were performed, summing up to 205 hours and 30 minutes of flight. An area of 7.350,13Km<sup>2</sup> was surveyed, corresponding to 25,6% of the Albanian territory. 4,45 terabytes of hyperspectral data were collected; 151 suspected fields of Cannabis reported corresponding to an area of 5,22 ha (Tables from 1 to 6).

The mission produced 56 Plantation Reports: 22 out of this 56 Reports, survey 151 fields suspected of being cultivated as Cannabis. Each plantation was identified by alphanumeric code, geographic coordinates and estimated area.

Furthermore data from satellite sensors were used, not only in order to integrating scientific analysis, but also to provide a further contribution to the mission investigation.

In particular, the raw data from the sensors of the European Space Agency (ESA) Sentinel-2 A/B were used. Sentinel-2 is a mission developed by ESA within the Copernicus program to monitor the green areas of the planet and to provide support in the management of natural disasters.

To guarantee both a high frequency of overflows and a continuous availability of data, two identical satellites (Sentinel-2A and Sentinel-2B) operate simultaneously on the same heliosynchronous orbit, at 786 km of height, staggered by 180 degrees.

The first satellite, Sentinel-2A, was launched on June 23, 2015 at 1:52 UTC with a Vega shuttle. The Sentinel-2B, March 7, 2017 at 1:49 UTC, always on board of a Vega. The Sentinel-2 satellites have a multispectral (MSI) device capable of capturing images on 13 visible/infrared (VNIR) and short-wave infrared (SWIR) bands.


Based on what has just been described, it is evident that these data are placed within a well-defined framework: that is, complementary to the data provided by the CASI-1500 and PhaseOne airborne sensors, in terms of spectral bands, of adopted resolutions, and earth's surface covered.

<b>1</b>	Flight plan activities and hyperspectral mission	
	Numbers of flight plans designed	105
	Numbers of flightplans flown	60
	Numbers of flight plans not flown	45
	Numbers of flightmissions	66
	Multi-sensor scanning time	205 h 30 m
<b>2</b>	Geographic data	
	Reference area: Republic of Albania	28.731 Km <sup>2</sup>
	Overflowed and scanned area	7.350,13Km <sup>2</sup>
	Coveredpercentage of Albanianterritory	25,6 %
<b>3</b>	Cannabis detection data	
	Suspected Cannabis plantations reported	151
	Districts with suspected Cannabis plantations	12
	Municipals with suspected Cannabis plantations	32
<b>4</b>	Disk data	
	Number of CASI lines	508
	Storage of raw CASI files	656 GB
	Storage of processed CASI files	4,51 TB


## 5 Cannabis detection data per administrative unit

Disetrick	Municipal	Number of plantations
Gramshit	Sult	1
	Cudhi	18
Krujës	FushëKrujë	4
	KodërThumanë	4
	Krujë	9
	Nikël	4
Mallakastrës	Kutë	2
	Gurrë	1
Matit	Komsi	2
Përmetit	Ballaban	3
Pukës	Iballë	6
	Postrinë	1
	Pult	7
Shkodrës	Shalë	6
	Shllak	2
	Shosh	16
	Temal	3
Skraparit	Gjërbes	2
	Leshnjë	1
Tepelenës	Buz	2
	Krahës	3
	Shëngjergj	1
Tiranës	Zall Bastar	19
	ZallHerr	1
Tropojës	Fierzë	1
	Topojë	3
	Armen	5
	Brataj	1
Vlorës	Kotë	6
	Qendër	1
	Sevaster	1
	Vllahinë	15

**Airborne Remote Sensing data and Analysis data are collected and managed in the Geographic data-base**



**Hyperspectral and very high resolution photographic data comparison**



**Each plantation is identified by ID Code / Geographic coordinate / spectral signature / area / hyperspectral picture / photographic picture**



**ACADEMY OF SECURITY**

*International Scientific Conference:*


« Environmental crimes, environmental safety and national security »

Lazarat 2013, July 22th

Lazarat 2015, July 23th



Source: Guardia di Finanza / Benecon



**ACADEMY OF SECURITY**

*International Scientific Conference:*  
« Environmental crimes, environmental safety and national security »

# Parandalimi dhe luftimi i krimit në peshkim: roli i Policisë së Shtetit



■ **Dr. Blerta DERVISHI**  
*Drejtorja Vendore e Policisë Tiranë,  
Policia e Shtetit  
blerta.dervishi@asp.gov.al*



■ **Prof. Asc. Valbona KOLANECI**  
*Universiteti Bujqësor i Tiranës,  
Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Shefe e  
Departamentit të Akuakulturës dhe Peshkimit  
vkolaneci@ubt.edu.al*

## Abstrakt

*Krimi në peshkim është një term i përgjithshëm për të përshkruar krimin në sektorin e peshkimit përgjatë gjithë zinxhirit të vlerës, nga gjuetia e peshkut deri tek përpunimi i tij, përfshirë edhe mashtrimin e konsumatorit me prodhimet peshkore. Kësaj terminologjie i referohen edhe veprat penale që lidhen me shantazhet, ryshfetin, trafikimin e specieve të rralla dhe atyre në zhdukje, dëmtimin e ekosistemeve ujore, mashtrimet në etiketimin e produkteve, etj. Në Shqipëri, rregullimi i aktivitetit të peshkimit në ujërat detare dhe ato të brendshme është objekt i ligjit "Për peshkimin" (64/2012) dhe një numri vendimesh të Këshillit të Ministrave dhe rregulloresh në zbatim të këtij ligji. Zbatimi i ligjit të peshkimit në porte, në det dhe në ujërat e brendshme vazhdon të jetë i dobët. Kontrolli i kufizuar i peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP) për shkak të kapaciteteve të kufizuara njerëzore, buxhetit të kufizuar operacional dhe koordinimit të munguar me organet e tjera publike si Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), Roja Bregdetare, Policia Kufitare, Policia e Shtetit dhe ajo Bashkiake, kanë lejuar zhvillimin e aktiviteteve të paligjshme të peshkimit. Këto aktivitete të paligjshme mund të jenë çështje penale ose administrative, ose të dyja bashkë. Në këtë punim janë adresuar krimet kryesore në lidhje me peshkimin detar dhe atë në ujërat e brendshme, rolin e mundshëm të Policisë së Shtetit në zbatimin e legjislacionit kombëtar për peshkimin dhe menaxhimin e integruar të burimeve ujore, si dhe sigurimin e ruajtjes së ekosistemeve ujore dhe rezervave peshkore.*

## Fjalëkyçe:

**krimi në peshkim, peshkimi i paligjshëm, Policia e Shtetit.**

## 1. Hyrje

“Krimi në peshkim” është një term i përgjithshëm që përdoret për të specifikuar krimin në sektorin e peshkimit komercial, përgjatë gjithë zinxhirit të vlerës, nga gjuetia e peshkut deri tek përpunimi i tij, përfshirë edhe mashtrimin e konsumatorit me prodhimet peshkore. Në këtë terminologji referohen edhe veprat penale që lidhen me shantazhet, ryshfetin, trafikimin e llojeve të rralla dhe atyre në zhdukje, dëmtimin e ekosistemeve ujore, mashtrimet në etiketimin e produkteve, etj.. Në Shqipëri, rregullimi i aktivitetit të peshkimit në ujërat detare dhe ato të brendshme është objekti i *Ligjit për peshkimin* (64/2012) dhe një numri vendimesh të Këshillit të Ministrave dhe rregulloresh, në zbatim të këtij ligji. Zbatimi i *Ligjit të peshkimit* në porte, në det dhe në ujëra të brendshme vazhdon të jetë i dobët. Kontrolli i kufizuar i peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP) për shkakun e kapaciteteve të kufizuara njerëzore, buxhetit të kufizuar operacional dhe koordinimit të munguar me organet e tjera publike si Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), Roja Bregdetare, Policia Kufitare, Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake, kanë lejuar zhvillimin e aktiviteteve të paligjshme të peshkimit. Këto aktivitete të paligjshme mund të jenë çështje penale ose administrative, ose të dyja bashkë.

Në këtë punim janë pasqyruar disa nga krimet kryesore të kryera gjatë praktikimit të peshkimit profesional detar dhe në ujërat e brendshme, rolin e mundshëm të Policisë së Shtetit në zbatimin e legjislacionit kombëtar për peshkimin dhe menaxhimin e integruar të burimeve ujore, si dhe sigurimin e ruajtjes së ekosistemeve ujore dhe rezervave peshkore.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »



## 2. Rezultatet e vlerësimit

### 2.1. Situata aktuale e peshkimit detar në Shqipëri

Aktiviteti i peshkimit detar në Shqipëri zhvillohet përgjatë vijës bregdetare e cila ka gjatësi rreth 450 km.

Tabela nr.1. Zënia totale e peshkut (ton) ne Shqipëri për periudhën 2014-2018.

EMËRTIMI		2014	2015	2016	2017	2018
<b>Kategoritë ujore</b>						
<b>I</b>	<b>Total Peshkimi (1+2+3+4)</b>	<b>8722</b>	<b>7875</b>	<b>7884</b>	<b>8289</b>	<b>8629</b>
1	Detar	5211	5052	4646	4609	5537
2	Bregdeti	1312	614	952	1074	315
3	Laguna	536	550	598	599	350
4	Ujërat e brëndshme	1663	1659	1688	2007	2427
<b>II</b>	<b>Akuakultura</b>	<b>1500</b>	<b>3000</b>	<b>3200</b>	<b>4000</b>	<b>5138</b>
<b>III</b>	<b>Molusqe</b>	<b>800</b>	<b>295</b>	<b>1450</b>	<b>430</b>	<b>1108</b>
	<b>Total Zënie (I + II +III)</b>	<b>1102</b>				
		<b>2</b>	<b>11170</b>	<b>12534</b>	<b>12719</b>	<b>14875</b>

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Sipas informacioneve të siguruar prej Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZhr, 2018) frekuenca relative e produkteve iktike të prodhuara prej peshkimit detar, për periudhën 2014-2018 ka qenë nga 36.3% deri 47.3% të prodhimit të përgjithshëm të këtyre produkteve (tabela nr.1). Ndërkohë vlera mesatare e këtij treguesi për periudhën përkatëse ishte afërsisht 41%. Nëse krahasojmë me kontributin e burimeve të tjera të produkteve iktike atëherë mund të vlerësojmë se peshkimi detar mbetet përsëri burimi kryesor i furnizimit të tregut shqiptar me këto produkte ndërkohë që peshkimi në ujërat e brendshme, dhe sidomos akuakultura, kanë rol dytësor. Luhatjet që ka pësuar frekuenca relative e prodhimit me origjinë nga peshkimi detar ne raport me prodhimin prej zenieve në tërësi, gjate pese viteve te fundit, mund të kenë më tepër lidhje me luhatjet e vlerave të elementeve të sforcos së peshkimit (numri i ditëve aktive të gjuetisë, numri mesatar i kalatave në 24 orë, etj.) sesa me fluktuacionet e rezervave, megjithëse cenimi i këtyre të fundit ne rastin e ndonjë lloji shënjestre (p.sh. peshqit e familjes *Pleuronectidae* si dhe *toni*) mund të ketë vend për vlerësim.

Tabela nr.2 Shpërndarja e flotës detare të peshkimit Shqiptar, sipas porteve për periudhën 2014-2018.

Emërtimi	2014	2015	2016	2017	2018
<b>Shpërndarja e flotës sipas porteve</b>					
Durrës	219	209	209	204	233
Vlorë	210	183	184	181	198
Saranda	91	86	86	84	99
Shëngjin	52	65	65	73	78
Himara	4	11	11	10	12
Lushnje-Fier	5	10	10	7	12
<b>Gjithësej</b>	<b>581</b>	<b>564</b>	<b>565</b>	<b>559</b>	<b>632</b>

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Në tabelën nr. 2 kemi treguar shpërndarjen e motobarkave të peshkimit sipas katër porteve kryesore dhe disa qendrave të vogla në të cilat kryhet peshkim bregdetar. Sipas informacioneve të furnizuara prej MBZHR (2018) numri i përgjithshëm i mjeteve motorike të angazhuara në peshkimin profesional detar nga viti 2014 deri në vitin 2018 është rritur në masën 11%. Duke shfrytëzuar të dhënat e tabelës nr. 1 provojmë se gjatë këtij pesëvjeçari rritje ka pasur edhe zënia e peshkut në det, por me ritëm më të vogël (6%) në krahasim me ritmet e shtimit të flotës së peshkimit (11%). Ky mund të jetë një tregues i shfrytëzimit të kufizuar të kapaciteteve që ka flota Shqiptare e peshkimit, sidomos i ditëve aktive të gjuetisë, gjatë një viti të plotë kalendarik. Është e domosdoshme që të vëmë në dukje se kapacitetet zënë të motobarkave kufizohen edhe prej intervalit të kohës që ato janë në funksionim. Sipas një studimi rreth 25% e motopeshkarexhave tona kanë moshë mbi 25-vjeçare ndërsa 30% e tyre kanë moshe 30-vjeçare. Anijet që konsiderohen relativisht të reja janë prodhuar në Shqipëri gjatë viteve '80 (Rëmbeci, I. dhe bashkaut., 2006).

Në lidhje me fuqinë motorike rezultojnë këto të dhëna: 71% e motobarkave kanë fuqi motorike mbi 120 kw. Vetëm 14 anije kanë fuqi motorike më të vogël se 60 kw dhe këto janë përqendruar në nivelin e ulët të peshkimit. Në anën tjetër barkat e peshkimit kanë mesatarisht fuqi motorike 180 kw. Sipas disa llogaritjeve të kryera për portin e Durrësit, rendimenti ditor mesatar i zënies për një motobarkë, për vitin 2018, rezultonte 249 kg/ditë për motobarkë. Në këtë shifër përfshiheshin tre asortimente të peshkimit (peshk, karkaleca deti dhe molusqe cefalopodë). Ndërkohë vetëm për asortimentin peshk, vlera mesatare e rendimentit ditor ishte 184 kg/ditë për motobarkë. Për zënie tërëse rendimenti ditor mesatar për kalatë (vetëm për llojet demersale që peshkoheshin me trata koce) ishte 62.3 kg/kalatë.

## 2.2. Disa informacione mbi peshkimin në ujërat e brendshme

Basenet më kryesore natyrore në të cilat kryhet peshkim profesional në Shqipëri janë Liqeni i Ohrit, Liqeni i Shkodrës dhe dy liqenet e Prespës. Këto janë liqene kufitare kështu që rezervat peshkore të tyre shfrytëzohen prej vendit tonë dhe prej vendeve me të cilat ne kufizohemi. Liqeni i Ohrit ka sipërfaqe të përgjithshme rreth 348 km<sup>2</sup>. Nga kjo sipërfaqe Shqipëria administron 119 km<sup>2</sup>. Numri i peshkatarëve shqiptarë të licencuar që gjuajnë në Liqenin e Ohrit, sipas intervistës me inspektorin e peshkimit është 300 ndërsa numri i varkave (lundrave) është 150. Llojet e peshqve me vlera komerciale që peshkohen në Liqenin e Ohrit janë: korani (*Salmo letnica*), belushka (*Acantholingua ohridana*), kleni ose mlyshi (*Squalus cephalus*), cironka ose gjuhca (*Alburnus alborella*) dhe gurneci ose skorti i bardhë (*Rutilus sp.*).

Tabela nr.3.

Zënie të peshqve sipas llojeve, në kategorinë, "ujërat e brendshme".

Ujrat e brendshme/Inland waters					
Speciet	2014	2015	2016	2017	2018
Krap	434	480	460	530	572
Skortë	370	364	400	430	482
Karas	110	164	144	345	480
Ballgjer i bardhë	190	198	231	219	237
Qefull	193	205	230	209	217
Perka ose Sharmak	22	19	23	36	162
Gjucë	210	80	60	80	90
Troftë	52	50	52	58	64
Njalë	43	50	41	47	60
Kubla	14	16	14	15	18
Ballgjer laraman	10	16	15	14	17
Të pa specifikuar	0	2	4	10	9
Amur i bardhë	3	3	4	5	7
Luçiperka	7	7	6	5	7
Klen ose Mlysh	5	5	4	4	5
<b>Gjithësej</b>	<b>1663</b>	<b>1659</b>	<b>1688</b>	<b>2007</b>	<b>2427</b>

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare »

Liqeni i Shkodrës ka sipërfaqe të përgjithshme 391 km<sup>2</sup>, nga të cilat Shqipërisë i takojnë 148 km<sup>2</sup>. Peshkimi është aktivitet tradicional i komuniteteve që banojnë përreth liqenit. Në Liqenin e Shkodrës gjuajnë diçka më tepër se 70 peshkatarë shqiptarë të licencuar (Rëmbeci, I. dhe bashkaut., 2006), por edhe një numër peshkatarësh ilegale. Llojet kryesore të peshqve me vlera komerciale janë krapi, karasi i argjendtë (*Carassius carassius*), kubla (*Alosa falax*), qefujt (Mugilidae), ngjala (*Anguilla anguilla*), mlyshi, gjuhca dhe skorti i bardhë. Në vitet '80 prodhimi i peshkut prej zënieve në Liqenin e Shkodrës luhatej nga 650 t deri 815 t në vit ndërsa në fillimin e viteve 2000 zëniet vjetore nuk shkonin më tepër se 300 t (Flloko, A. 2003).

Liqeni i Prespës së Madhe ka sipërfaqe të përgjithshme 274 km<sup>2</sup>, nga të cilat Shqipërisë i takojnë 18% ose 49.4 km<sup>2</sup>. Peshkimi ushtrohet nga afërsisht 90 peshkatarë, nga të cilët shumica nuk janë të licencuar. Rëmbeci dhe bashkautorët e tij (2006) pohojnë se megjithëse këta peshkatarë nuk janë të licencuar aktiviteti i tyre nuk është konsideruar si ilegal. Zëniet bazohen tek shfrytëzimi i cyprinideve, prej të cilëve zihen me tepër krapi dhe cironka. Zëniet vjetore janë luhatur nga 300 deri 500 ton në vit (Flloko, A. 2003).

Aktivitet peshkimi zhvillohet edhe në disa kategori të tjera të ujërave të brendshme sikurse janë liqenet e hidrocentraleve dhe rezervuarët vaditës. Grupe të organizuara të peshkatarëve të licencuar operojnë në Liqenet e Fierzës, Vaut të Dejës, Ulzës, Thanës dhe Kurjanit. Në këto basene përveç cyprinideve lokale peshkohen edhe cyprinide aloktone (dy lloje të ballëgjerëve, amuri i bardhë dhe pllemza), të cilët peshkëzohen në mënyrë sistematike me rasate të prodhuara në impiantet e riprodhimit artificial. Në Liqenin e Fierzës dhe atë të Shkodrës peshkohen edhe dy percidet të ujërave të ëmbla, sharoku ose sharmaku (*Perca fluviatilis*) dhe lucioperka (*Sander lucioperca*).

Në tabelen nr. 3 kemi treguar kuotat e zënieve për llojet iktike të ujërave të brendshme në periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2018. Krahasuar me vitet 2014 dhe 2015 në tre vitet pasuese zëniet totale të peshkut në ujërat e brendshme kanë pësuar rritje. Në vitin 2018 sasia e prodhimit të marrë ka qenë 764 ton më e madhe krahasuar me vitin 2014 (ose afërsisht 31.5% më e lartë). Megjithatë duke parë tendencat e strukturës llojore të zënieve të bie në sy fakti se, një kontribut jo të vogël në garantimin e trendit rritës të prodhimit e ka dhënë karasi. Ky lloj alokton ka demonstruar një ritëm ekspansioni që nuk duhet të na entuziazmojë, pasi aftësitë e shquara të distribucionit të karasit mund të jenë një shkak për reduktimin e rezervave të disa llojeve, në det të cilët gjuhca është me kryesorja.

### 3. Problemet ligjore. Shkeljet e evidentuara të ligjit për peshkimin

Fillimisht e shikojmë të nevojshme që të sqarojmë se analiza jonë i është referuar *Ligjit për peshkimin* nr. 64/2012 dhe në mënyrë të veçantë nenet e kreu XVIII "Peshkimi i paligjshëm, i parregulluar dhe i paraportuar (PPP)". Burimet për vlerësim u siguruan në radhë të parë prej konstatimeve dhe raportimeve të medias së shkruar dhe asaj vizive, për periudhën nga viti 2012 kur u vu në zbatim ligji i sipërpërmendur deri në vitin në vazhdim, prej deklarimeve të funksionareve të organizatave të menaxhimit të peshkimit (OMP), prej publikimeve të autoreve shqiptarë dhe të huaj si dhe prej intervistave me peshkatarët profesionistë të licencuar. Nuk kemi mundur të gjejmë raporte zyrtare të përgatitura prej institucioneve përgjegjëse publike lidhur me gjendjen

e zbatimit të legjislacionit në ekonominë e peshkimit.

### 3.1. Situata e shkeljes së ligjit mbi peshkimin, në tre rajone të ushtrimit të aktivitetit të zënieve, për periudhën 2012-2019.

Bazuar tek shkalla e mundësive që lejonin informacionet e disponueshme (pra, jo tek pesha specifike që kanë zëniet totale të realizuara), analiza jonë u përqendrua në tre rajonet kryesore ku ushtrohet peshkim profesional, Liqeni i Shkodrës, Liqeni i Ohrit dhe bregdeti shqiptar në tërësi.




Figura 1. Diagrami i ndryshimit të numrit të rasteve të evidentuara mbi ushtrimin e aktivitetit të peshkimit të paligjshëm në Liqenin e Shkodrës, për periudhën 2012-2019.

Dy diagramet në figurat 1 dhe 2 paraqesin ndryshimet që ka pësuar numri i rasteve të evidentuara mbi shkeljet e ligjit për peshkimin, për periudhën 2012-2019, në liqenet e Shkodrës dhe Ohrit.




Figura 2. Diagrami i ndryshimit të numrit të rasteve të evidentuara mbi ushtrimin e aktivitetit të peshkimit të paligjshëm në Liqenin e Ohrit, për periudhën 2012-2019.

Fillimisht duhet të vëmë në dukje se luhatjet që ka pësuar numri i rasteve të peshkimit të paligjshëm, në basenet që analizojmë, nuk lejojnë që të nxirret një ligjshmëri e përcaktuar, prej të cilave mund të nxirrim përfundime që lidhen edhe me situatën e rendit në tërësi, në dy rajonet ku përqendrohen këto liqene. Në fakt, shifrat konfirmojnë rastësinë e “ndërhyrjeve” të kryera prej medias dhe diktojnë domosdoshmërinë e vlerësimeve sistematike dhe të institucionalizuar.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

Sidoqoftë një analizë biometrike me e specializuar, e bazuar tek rendi i shifrave që disponohen për numrin e shkeljeve në peshkim gjatë tetëvjeçarit 2012-2019, në Liqenet e Shkodrës dhe Ohrit, provon situatë të njëjtë të dinamikës së kësaj dukurie. Numri i shkeljeve ka qenë i lartë në fillimin e periudhës së vlerësimit, ka pësuar rënie deri në nivelet minimale në mesin e kësaj periudhe dhe është rritur përsëri, për të arritur vlera maksimale gjatë vitit 2019. Kësaj dinamike i përgjigjet ekuacioni polinomial i formës:

$$N = a(t^2) - b(t) + c$$

ku: N-numri i rasteve të shkeljeve në peshkim; t-viti përkatës




Figura 3. Numri i përgjithshëm (N) dhe frekuenca (F%, sipas numrit) për rastet e evidentuara të shkeljes së Ligjit mbi Peshkimin në tre rajone ku realizohet peshkim profesional në Republikën e Shqipërisë, për periudhën 2012-2019.

Shifrat që kemi vendosur në diagramin e figurës 2 tregojnë se numri i rasteve të evidentuara për peshkimin e paligjshëm në zonat kryesore të aktivitetit të peshkimit komercial shqiptar, për periudhën tetëvjeçare 2012-2018 ka qenë 32. Nga këto, 14 raste i takonin peshkimit në Liqenin e Shkodrës (43.8%), 13 raste peshkimit në Liqenin e Ohrit (40.6%) dhe 5 raste peshkimit detar (15.6%) në përgjithësi. Është e natyrshme, bazuar tek përmasat e këtyre tre sektorëve, që të hidhen dyshime lidhur me vërtetësinë e shifrave që përfaqësojnë frekuencat. Vlerat pothuajse të barabarta të frekuencave për shkeljet në peshkim në dy liqenet e mëdhenj të Shqipërisë janë të kuptueshme nëse analizojmë situatën ekonomike dhe atë të rendit në përgjithësi në komunitetet që popullojnë brigjet e këtyre dy liqeneve. Në fakt, kjo analizë duhet të bëhet veçmas dhe graviteti i peshkimit të paligjshëm mund të përdoret si argument për sqarimet përkatëse.

Për sa i takon peshkimit detar informacionet që kemi mundur të sigurojmë kanë qenë minimale dhe, si të tilla, të pamjaftueshme për të nxjerrë përfundimet që kërkohen nga kjo analizë. Nuk mund të entuziazmohemi prej numrit “tonë” të vogël mbi shkeljet e ligjit në peshkimin detar, përderisa vlera e këtij numri është subjektive. Kontrolli në bord, prej inspektoreve të peshkimit për praktikën e peshkimit detar (për

peshkimin fundor me trata koce, për peshkimin çift me trata pelagjike si dhe për peshkimin e disa llojeve të çmuara sikurse është toni i kuq), duket se është i munguar, përderisa nuk gjenden raporte dhe nuk bëhen analizat përkatëse. Në realitet disa dukuri negative të këtij peshkimi janë të njohura dhe disa prej tyre do t'i përmendim në vijim.




Fig. 4 Disa forma të ushtrimit të peshkimit të paligjshëm dhe frekuenca e tyre në peshkimin shqiptar, sipas vlerësimeve të medias dhe funksionareve të OMP-ve, për periudhën 2012-2019.



Figura Nr. 5. Raste të evidentuara: a) të peshkimit jashtë sezonit (sipër-krap) dhe, b) me përmasa më të vogla se ato që përcaktohen në nenin 3 të kreut II ("Dimensionet minimale të disa organizmave ujore") të ligjit 64/2012 (poshtë-sardelja) (sipas, Syriigjelber.info/peshkimi-jashte-sezonit).

Në figurën 4 kemi treguar numrin e rasteve dhe frekuencat përkatëse për kryerjen nga një ose disa persona të disa formave të peshkimit të cilat nuk përputhen me dispozitat e Ligjit 64/2012 Për Peshkimin në Republikën e Shqipërisë. Duhet të vëmë në dukje

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare »

faktin në një sërë rastesh janë provuar shkelje të renda pasi ushtrimi i aktivitetit të peshkimit të palicencuar mund të jetë shoqëruar edhe me peshkim me mjete shfarosëse të paligjshme (si p.sh. përdorimi i gjeneratorëve për peshkim me rrymë elektrike në Liqenin e Shkodrës: informacion ky, i funksionareve të OMP-ve), apo me kryerje të zënieve brenda periudhës së ndaluar për gjueti (si p.sh. në Liqenin e Pogradecit ku në mënyrë abuzive është peshkuar korani dhe belushka në sezonin e ndaluar.

Sipas pohimit të kryetari të OMP-Pogradec, konfirmuar prej gazetës Telegraf të datës 7.4.2017, janë mbi 600 varka të palicencuara (një shkelje e ligjit) që kryejnë gjueti të paligjshme të koranit. Këto 600 varka peshkojnë koran në kohën e shumimit (shkelja e dytë e ligjit) dhe kapin koranin e vogël që quhet *Stërf*, një koran nën peshë (shkelja e tretë e ligjit) që nuk arrin të lëshojë vezë për shumim. Konstatimi mbi shkeljen e ligjit për peshkimin, manifestuar me zënien e individëve me përmasa më të vogla se ato të lejuarat, ishte bërë edhe 4 vite më përpara prej specialisteve të Qendrës së Inkubimit dhe Prodhimit të Rasateve të Koranit (Lin-Pogradec). Sipas tyre një pjesë e koranëve të peshkuar janë rasate të matrikulluar në ketë qendër. Këta peshq me përmasa të vogla (me pak se 150 g), të peshkuar me rrjeta që kanë syze jo sipas rregulloreve të peshkimit, dërgohen për shitje në treg.

Informacione për shfrytëzimin e paligjshëm të rezervave peshkore ka edhe për Liqenin e Shkodrës. Në mënyrë të veçantë në periudhën 2012-2014 media e shkruar ka publikuar një sërë artikujsh, të shkruar prej autorëve shqiptarë dhe malazezë mbi ushtrimin e formave të paligjshme të zënies në liqen. Pohime të konfirmuara të peshkatarëve profesionistë kanë informuar se peshkimi me gjeneratorë ishte një fenomen i përhapur në zonën e Shkodrës, duke u shtrirë nga grykëderdhja e Bunës dhe deri në zonën e Malësisë së Madhe, në kufi me Malin e Zi. Kuptohet, zënies me rryme elektrike, nuk i shpëtojnë as të rriturit dhe as të vegjlit, fakt që dëmton riprodhuesit, rekrutët dhe të vegjlit, duke cenuar seriozisht rezervat e llojeve me vlera komerciale dhe duke dëmtuar biodiversitetin në tërësi. Në këtë aspekt, peshkimi me rrymë elektrike përbën një krim mjedisor të mirëfilltë.

Sikurse për numrin e rasteve të evidentuara edhe për kategoritë e shkeljeve ligjore peshkimi detar në analizën tonë rezulton me “i varfër” krahasuar me peshkimin në ujërat e brendshme. Moutopoulos dhe bashkautorët e tij (2015) kishin publikuar një rast interesant mbi peshkimin detar të paligjshëm të kryer prej tre motobarkave shqiptare që gjuanin me *njica drejftuese* (notuese). Autorët nuk sqarojnë se për cilat motobarka bëhet fjalë dhe nuk specifikojnë kategorinë (kategoritë) e shkeljes së ligjit mbi peshkimin. Ata përmendin vetëm faktin se njëra prej anijeve kishte vegla peshkimi me gjatësi “të pafund”. Ekziston mundësia që këto motobarka peshkonin në zona jo të lejuara ose u ishin afruar brigjeve më tepër nga sa lejohet prej rregulloreve të peshkimit. Sidoqoftë raste të tilla duhet të identifikohen dhe të analizohen në mënyrë që shkelësit të dënohen sipas dispozitave të ligjit për peshkimin.

#### **4. Sugjerime lidhur me mundësitë e përmirësimit të situatës së zbatimit të ligjshmërisë në peshkim**

Një analizë e bërë prej Korkuti, R. (2009), bazuar tek disa vlerësime të institucioneve Ndërkombëtare, ka vënë në dukje se Shqipëria është ndër vendet më problematike në Europë për sa i përket peshkimit të paligjshëm dhe të parregulluar. Indeksi më i fundit i peshkimit të paligjshëm (Macfadyen, G. dhe bashkaut., 2019) na rendit në vendin e shtatë në Europë, ndër 31 shtete, çka sinjalizon se vendi ynë përballet me një problem serioz.

Situata që rezultoi prej analizës sonë, e cila për pamjaftueshmërinë e të dhënave është e pjesshme, si dhe vërejtjet e organizmave ndërkombëtare, diktojnë nevojën e iniciativave ligjore dhe administrative për përmirësimin e cilësisë së zbatimit të ligjit në ekonominë e peshkimit në Shqipëri.

Sfida për luftimin dhe reduktimin maksimal të shkeljeve në kushtet e ekzistencës së peshkimit të paligjshëm është:

- për të garantuar njohjen e përgjegjshme prej peshkatarëve të detyrimeve të tyre; për këtë rekomandohet ngritja e kapaciteteve nëpërmjet fushatave informuese dhe trajnimeve specifike nga strukturat përgjegjëse;

- të përmirësohen mundësitë ligjore, administrative dhe infrastrukturore për të mundësuar gjurmimin dhe identifikimin e shkeljeve dhe mospërputhjeve me aspektet ligjore;

- të krijohen mekanizmat e zbatimit për të adresuar mosrespektimin; mekanizma të tillë, ato veprojnë si nxitje për pajtueshmëri me ligjet;

- të miratohen dhe vihen në zbatim sisteme që inkurajojnë sjelljen në pajtueshmëri me ligjet.

Sugjerojmë që institucionet qendrore, përgjegjëse për peshkimin komercial në Shqipëri të ndërmarin disa iniciativa administrative dhe ligjore për të garantuar zbatimin e ligjshmërisë në shfrytëzimin e përgjegjshëm dhe racional të rezervave të detit dhe ujërave të brendshme. Midis tyre përmendim:

- rishikimin e ligjit për peshkimin 64/2012 në aspektet e diferencimit juridik të kategorive të veçanta të shkeljes së ligjit, me qëllimin që të përcaktohet më qartë graviteti i dëmeve, shkeljeve administrative apo krimeve mjedisore, në mënyrë që masat administrative dhe gjobat të mos jenë kufiri i fundit i dënimeve për shkelësit e ligjit;

- të institucionalizohen bashkëveprimet e organizmave administrative përgjegjëse për peshkimin në MBZHR me Ministrinë e Brendshme, në mënyrë që kjo e fundit të mbështesë ndërhyrjet e drejtorisë së politikave të peshkimit për zbatimin e ligjshmërisë;

- të riorganizohet Inspektorati i Peshkimit dhe Akuakulturës duke përmirësuar performancën e përgjithshme të këtij institucioni (përgatitjen profesionale dhe juridike të inspektorëve, specifikimin e kompetencave të tyre, pajisjen me uniformë të veçantë dhe krijimin e mundësive reale për realizimin efikas të detyrës në kushtet kur hapësirat fizike të kontrollit janë përgjithësisht mjaft të gjëra.

## Literatura

1. Alimenaj, J. 2017, Peshkatarët e paligjshëm po "spastrojnë" Liqenin e Shkodrës nga peshku. *Shekulli*;11.12.2017.
2. Filoko, A. 2003, *A short overview of the status of aquaculture in Albania. Report of the AdriMed Expert Consultation*, "Tnteractions between aquaculture and capture fisheries". Rome (Italy) 5-7 November 2003.
3. Shqiptarja.com, 2013, "Korani, peshku unikal i liqenit të Ohrit shkon drejt zhdukjes", *Shqiptarja.com* (Redaksia);17.5.2013.
4. Korkuti, R. 2019, "Peshkimi i paligjshëm, Shqipëria dominon: në vendin e 7-të në Europë, reagimi i autoriteteve na rendit në fund të globit", *SCAN*, 22.04.2019.
5. Macfadyen, G. dhe Hosch, G., Kaysser, N., Tagziria, L., 2019, *The IUU Fishing Index, 2019*. Poseidon Aquatic Resource Management Limited and the Global Initiative Against Transnational Organized Crime.
6. Moutopoulos, D. K., dhe B. Bradshaw, D. Pauly 2015, "Reconstruction of Albania fishery catches by fishing gear". Fisheries centre of the University of British Columbia. *Working Paper Series* 12;1-12.
7. MBZHR 2012-2018, *Statistika të zënive në ujërat detare dhe të brendshme*. Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit.
8. Mrdak, D. 2017, "Investigimi: Si po shfaroset krapi në Liqenin e Shkodrës", *LAPSI.al*. 10.12.2017.
9. Rembeci, I., J. dhe Dhimarko, R. Lami, D. Sinani, 2006, *Studim tregu për industrinë e përpunimit të peshkut në Shqipëri*. Agjencia Rajonale e Zhvillimit (SME), Tiranë.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »



# Material and spiritual culture as indicators of the ecological environment



■Prof. Asc. Dr. Lavdosh AHMETAJ  
"Aleksandër Moisiu" University, Durrës  
Faculty of Political Science  
lavdoshahmetaj@gmail.com]

## Abstrakt

*Material and immaterial culture is already subject to the attention of national and global institutions and this cultural institutionalizing aspect is achieved by building relevant laws system of particular states and international conventions that refers to the global sphere and returning to a legal obligation of the state's parties to such agreement. The purpose why these cultural values are taken under protection of the international institutions such as UNESCO, and which are further reflected in the obligations of the local parties involved in the relevant conventions, is that it has been noted that cultural and natural heritage is increasingly threatened not only by destruction, but also by changing social and economic conditions, which exacerbate the situation even with more serious damages or destructions. Looking at this context and in order to avoid ever more expansion of destruction, it has become possible to define what is called cultural and natural heritage.*

## Fjalëkyçe:

**intercessor, convention, material culture, oral culture, destruction, convention, institutionalization.**

## 1. Conceptuality of the values of material and spiritual heritage

The main attention should be noted to the fact and at the same time to the Convention on Protection of the World Cultural and Natural Heritage, held in Paris on November 16, 1972, which entered into force in December 1975 and in respect of the preservation of the material and spiritual cultural heritage, where the Albanian state ratified it on July 10, 1989<sup>1</sup>.

This Convention defines as cultural and natural heritage these elements:

- “monuments”, which are architectural works, monumental works of art and sculpture, elements or structures of an archaeological nature, inscriptions, cave dwellings and combinations of elements that are of universal value in the history, art or science;

- “building blocks” that may be connected or separated from each other due to their architecture, homogeneity, or placement in a landscape, and which are universally valuable in terms of history, art or science;

- “locations”, which are human works or combined works of nature and man, and areas involving archeological locations that are of an unusual value from the historical, aesthetic, ethnological or anthropological point of view.

And further:

- natural elements composed of physical and biological formations or groups of these formations, which are of a very special universal value from aesthetic or scientific point of view;

---

<sup>1</sup> Convention on the Protection of the World Cultural and Natural Heritage, Paris, 16 November 1972, in UNESCO Legislation Summary, Tirana, 2007, pp. 1.

- geological and physiological formations and accurately defined areas which constitute the habitat of threatened species of animals and plants of a rare universal value from the standpoint of science or conservation;
- natural locations or natural areas precisely defined with a rare universal value from the point of view of science, conservation or natural beauty.

## 2. The purpose and mechanisms why cultural values are taken in defense

The purpose why these values are taken under protection of the international institutions such as UNESCO, and which are further reflected in the obligations of the local parties involved in the relevant conventions, is that has been noted that cultural and natural heritage is increasingly threatened by destruction only by traditional causes of destruction, but also by changing social and economic conditions, which exacerbate the situation even with more serious damages or destructions. Also, since the destruction or disappearance of any cultural or natural heritage property constitutes a pernicious depletion of the legacy of all the nations of the world, and that the protection of this legacy at the national level often remains unattainable due to the scale of resources that it also seeks the inadequate economic, scientific and technical resources of the country in which the property to be protected is located. It is therefore essential to adopt appropriate provisions in the form of a convention to establish an effective system of collective protection of the cultural and natural heritage of an extraordinary world value, organized on a permanent basis and in accordance with modern scientific methods, turning this issue into the subject of an international convention.

While in the new state created after the turnaround of the twenty and twenty-first century, raising the attention of international institutions in the context of the globalization of society, in recent years, the United Nations Educational and Cultural Organization, UNESCO General Conference gathered in Paris from September 29 to October 17, 2003, at its 32<sup>nd</sup> session, referred to the existing international human rights instruments and intangible culture<sup>2</sup>. Through these instruments are considered the importance of cultural heritage, which synthesizes the cultural diversity as a guarantee of long-term development, as considered in the UNESCO's recommendation protection of traditional and popular culture.

This philosophy has helped to achieve to a more scientific conception of the interdependence between material cultural and natural oral heritage. Realizing that processes of globalization and social diversity, in addition to the terrain created for a renewed dialogue among the subjects, also cause the phenomenon of intolerance, threats of degradation, destruction and disappearance of cultural heritage. This phenomenon is acute in terms of non-recognition of institutions and the legal system, which are aimed at cultivating and developing this wealth with unique values.

The Convention on the Conservation of Cultural Heritage of 17 October 2003 underlined the importance of proclaiming the masterpieces of oral and material heritage of humanity with the idea of an invaluable role of this heritage as a factor of

<sup>2</sup> The Universal Declaration of Human Rights of 1948; International Covenant on Intellectual, Special and Cultural Rights of 1966; International Covenant on Civil and Political Rights of 1966; UNESCO Universal Declaration of Cultural Diversity of 2001; The Istanbul Declaration of 2002 at the third table of culture ministers.

rapprochement, exchange and understanding between different ethnicities, which bear not only cultural but also integrating values among the nations that have had in their history problems, which are minimized through the recognition and exchange of regional material and oral culture.

In this respect, it is useful to present the institutional mechanisms of this convention:

- preservation of material and non-material cultural heritage;
- respect for the intangible cultural heritage of affected communities, groups and individuals.
- sensitization at the local and national level, on the importance of intangible cultural heritage and mutual evaluation;
- international cooperation and assistance in conceptualizing cultural heritage, practices, representations, expressions, knowledge and savoir-faire, as well as the instruments, objects, artifacts and cultural spaces that accompany the communities, groups and, where appropriate, individuals accept as an integral part of their cultural heritage;
- this cultural heritage is followed by generations and groups, in the function of environment and interaction with their nature and history, giving them a sense of identity and continuity, in promoting respect for cultural diversity and creativity human.

### 3. The Convention Entities

The General Assembly of the States Parties is a sovereign body of this Convention. This Assembly convenes in ordinary sessions every two years. It may convene in an extraordinary session if it so decides, or if it has been addressed by the Intergovernmental Committee for the Conservation of Intangible Cultural Heritage.

An intergovernmental committee has been set up at UNESCO for the preservation of intangible cultural heritage. It is composed of 18 States Parties selected by States Parties convened in the General Assembly, with effect from the entry into force of this Convention in accordance with Article 34<sup>3</sup>.

### 4. What mandate has member states of the committee?

- a. the selection of member states of the Committee should respect the principles of geographic distribution and regular rotation.
- b. the number of states of the Committee shall be 24, with 50 States having reached the Convention.
- c. the member states of the Committee should respect the principles of geographic distribution and regular rotation. While the member states of the Committee are elected for a four-year term by States Parties to the Convention convened in General Assembly.
- d. the mandate of half of the members of the Committee elected during the first

<sup>3</sup> This Convention shall enter into force three months after the date of deposit of the thirty instrument of ratification, acceptance, approval or accession, but only to States which have deposited their respective instruments of ratification, acceptance, approval or accession on this date or earlier. It shall enter into force for any other State Party, three months after the deposit of its instrument of ratification, acceptance or accession. Article 34, pp. 260.

election is limited to two years. These states are defined by a shortlist cast during the first election.

e. every two years the General Assembly shall renew half of the members of the Committee. It selects so many member states of the Committee that it needs to fill vacancies.

f. a member state of the Committee cannot be elected for two consecutive terms. The members of the Committee choose to represent qualified persons in different cultural heritage areas.

## 5. What are the functions of this committee?

They are about to promote and guarantee the continuity of implementing, giving advices on best practices, and formulating recommendations for measures in favor of preserving non-material cultural heritage. These summarized functions are:

- Preparing and submitting for approval to the General Assembly projects for the use of the Fund's resources.

- Efforts to find the means to increase its resources and to take the necessary measures to that end, in accordance with Article 25<sup>4</sup>.

- Preparation and submission for approval to the General Assembly of the operational guidelines for the implementation of the Convention.

- Review in accordance with Article 29<sup>5</sup>, of States Parties' reports, and making a summary to present to the General Assembly.

- Review of requests submitted by States Parties and decision-making in accordance with objective selection criteria established by the General Assembly, which explicitly presented two basic ideas:

  - first*, listing the proposals referred to in Articles 16<sup>6</sup>, 17<sup>7</sup> and 18<sup>8</sup>.

  - Secondly*, granting international support in accordance with Article 22<sup>9</sup>.

The working methods of the Committee are defined on the basics of accountability before the General Assembly. It accounts for all activities and decisions. This is sanc-

---

<sup>4</sup> See Article 25 (Nature and Resources of the Fund; a Fund for the Safekeeping of Intangible Cultural Heritage, called the "Fund", has been established and shows the potential sources of this fund, sanctioned in ten points). UNESCO General Legislation, pp. 257: Nature and Resources of the Fund.

<sup>5</sup> See Article 29 (Reports of States Parties: States Parties shall submit to the Committee, in the format and periodicals specified by the latter, reports on the legal, regulatory and other provisions adopted for the implementation of this Convention). Legislation etc. pp. 259.

<sup>6</sup> See Article 16 (Introductory List of Intangible Cultural Heritage of Humanity: To ensure a better visibility of cultural heritage and better awareness of its importance, as well as to favor dialogue by respecting cultural diversity, the Committee, upon proposal of the States Parties concerned, designs, updates and publishes an introductory list of the intangible cultural heritage of mankind). Legislation etc. there, pp. 255.

<sup>7</sup> See Article 17 (List of intangible cultural heritage needs urgent conservation: In order to take appropriate conservation measures, the Committee compiles, updates and publishes a list of intangible cultural heritage that needs urgent conservation and records this inheritance in list required by the State Party concerned). Legislation etc., pp. 255

<sup>8</sup> See Article 18 (Programs and Projects, Activities for the Safekeeping of Intangible Cultural Heritage: On the basis of proposals submitted by States Parties and in accordance with the criteria it sets out and approved by the General Assembly, the Committee periodically selects and promotes programs, projects and cultural activities of a national, regional, subregional character, for the preservation of heritage that it deems to better reflect the principles and objectives of this Convention, bearing in mind the particular needs of developing countries). Legislation etc., pp. 255.

<sup>9</sup> Article 22 (Conditions for International Support: The Committee drafts the procedures for reviewing the requests for international support and defines the elements of the request, such as the measures envisaged, the necessary interventions and their cost estimate). Legislation etc. pp. 255.

tioned on the basis of an internal regulation by a majority of two-thirds of its members. This Committee may temporarily establish advisory bodies which it deems necessary for the performance of its duties.

He may invite public or private bodies, as well as natural persons with well-known competences in different areas of intangible cultural heritage to attend meetings, to consult with them on specific issues. It also proposes to the General Assembly the accreditation of non-governmental organizations with well-known competences in the field of cultural heritage, and these organizations have advisory functions within the Committee.

This Committee also proposes to the General Assembly the criteria and modalities of this accreditation. For all these, the Committee is supported by the UNESCO Secretary and the latter prepares the documentation of the General Assembly and the Committee, as well as the draft agenda of the meeting and ensures the implementation of their decisions.

## 6. The function of states through the Convention

The Convention has defined the role of States, referring to the relevant Articles, to the possibility of preserving the material cultural heritage, forcing them to undertake the measures provided for in Article 2, paragraph 3<sup>10</sup>. This is done in order to identify and determine the different elements of cultural heritage presented in political territory, integrating in this process the possibility of non-governmental organizations, groups and individuals that are interested in such field. To ensure identification with the intent to preserve (each State Party), in accordance with its condition, designs one or more inventories of intangible cultural heritage present in its territory. These inventories are subject to a regular update.

Each State Party shall periodically submit the report to the Committee in accordance with Article 29<sup>11</sup>, provides the relevant information, accompanied by an appropriate inventory. But the concrete work of each country would be lacking if it were not accompanied by a general policy aimed at the deployment of intangible cultural heritage in society and to integrate the preservation of this inheritance into planning programs.

This, according to the Convention, is perfected through the competent provisions for the preservation of culture, particularly of that culture at risk, which seeks to be identified and then planned to be institutionally and legally protected; coupled with the adoption of concrete administrative measures through the promotion of scientific, technical and artistic studies, as well as research methodologies for effective conservation of the intangible cultural heritage.

This should be accompanied by appropriate legal, technical, administrative and financial measures, with a view to favoring and establishing or strengthening institutions, for the formation of the administration of the cultural heritage material, and the transmission of this inheritance through forums and spaces intended for filing and their expression.

<sup>10</sup> Safeguarding means measures aimed at the durability of intangible cultural heritage, including identifying, documenting, researching, preserving, protecting, promoting, evaluating, following mainly through formal and informal education, and revitalizing the various aspects of this inheritance. See Article 2, pp. 250.

<sup>11</sup> The reports of the States Parties shall submit to the Committee, in the format and periodicals determined by latter reports on legal, regulatory and other provisions adopted for the implementation of this Convention. (See Article 29 of the Convention, pp. 259).

Guaranteeing and utilizing cultural material heritage is realized by respecting customary practices that regulate the use in some specific aspects of this inheritance. But it would be without product all this work when these measures would not be associated with the establishment of documentary institutions for the material cultural heritage and the possibility of their exploitation. But to ensure better visibility of the intangible cultural heritage, better awareness, and to promote dialogue and respect cultural diversity, the Committee, with the proposals of the States Parties concerned, designs and publishes an introductory list of inheritance cultural heritage of humanity. The Committee drafts and submits for approval to the General Assembly the main criteria for the compilation and publication of this introductory list. Once the list compilation criteria have been identified and approved, the Committee drafts and publish a list of cultural heritage that needs urgent conservation and records this inheritance on the list required by the State Party concerned.

This is accompanied by the adoption, by the General Assembly, of the main criteria for the compilation and publication of this list. In the case of extreme urgency, for which the material criteria have been approved by the General Assembly on a proposal from the Committee, the latter may register an element of the inheritance in question on the list presented to the Assembly, advising the state interested parties<sup>12</sup>.

The work of the Committee is permanent, based on proposals submitted by States Parties, and in accordance with the criteria it sets out and approved by the General Assembly. It selects periodically and promotes programs, projects and activities with national, sub-regional or regional criteria for the preservation of heritage which it considers to best reflect the principles and objectives of this Convention, bearing in mind special needs of developing countries. In the end, it shall receive, examine and approve the requests for international support formulated by the States Parties for the drafting of these proposals.

The Committee accompanies the implementation of these programs, projects and activities with the dissemination of best practices according to the modalities defined by it. For the purposes of the Convention, international cooperation includes in particular the exchange of information and experience, joint initiatives, and the establishment of a mechanism to support States Parties in their efforts to preserve intangible cultural heritage; but always without prejudice to the provisions of their national legislation and their customary rights and practices. While the states parties work to preserve the intangible cultural heritage in the general interest of mankind and pledge, for this purpose, to cooperate at bilateral, sub-regional, regional and international levels.

While looking from the standpoint of international support, insists on the preservation of the legacy registered in the cultural heritage list, which needs urgent conservation. Associated with the preparation of inventories in the sense of Articles 11 and 12<sup>13</sup>, and support through national, sub-regional and regional programs, projects

<sup>12</sup> See Article 17 of the Convention in question, in the UNESCO Legislation (List of Intangible Cultural Heritage Required for Preservation, pp 255).

<sup>13</sup> Each State Party shall take the necessary measures to ensure the preservation of the intangible cultural heritage present in its territory. To undertake the conservation measures described in Article 2, paragraph 3 to identify and determine the various elements of intangible cultural heritage present in its territory, with the participation of relevant communities, groups and non-governmental organizations. UNESCO General Legislation. In order to secure the identification with the intent to preserve, each State Party, in accordance with its status, compiles one or more inventories of intangible cultural heritage present in its territory. These inventions are subject to regular generalization. Each State Party shall periodically submit to the Committee a report, in accordance with Articles 29, and shall provide relevant information on such inventories. (See Articles 11 and 12 of this Convention, p. 253).

and activities aimed at preserving cultural heritage and all other objectives the Committee may have in order to institutionalize this problem

## 7. Look at it from the point of view of the form of international support

The Committee should regulate the relations with the States Parties to the Operational Guidelines set forth in Article 7 and the Agreement referred to in Article 24 through these fundamental ideas:

- making available to experts and practitioners, fostering relevant studies and evaluations;
- the formation of all necessary staff, as well as the drafting of normative measures;
- creation and utilization of infrastructure, equipment and low interest donations and donations;
- on the basis of UNESCO's lawfulness, each State Party may submit to the Committee a request for international support regarding the preservation of the intangible cultural heritage present in its territory;
- this requirement should contain the information elements provided for in Article 22, paragraph 1, and the necessary documents<sup>14</sup>. Whereas, on the other hand, it defines the role of States Parties in accordance with the provisions of the Convention, the international support provided shall be governed by agreement between the Beneficiary State Party and the Committee;
- as a general rule, the beneficiary State Party should participate, within its means, in the cost of safeguards for which international support is provided. At the same time, it submits to the Committee a report on the use of the support provided in favor of the preservation of intangible cultural heritage.

The Committee includes on the Introductory List of Intangible Cultural Heritage of Humanity the elements proclaimed: "Masterpieces of the Cultural Heritage of Humanity" and the inclusion of these elements in the introductory list of intangible cultural heritage of humankind does not in any way prejudice the criteria set out in Article 16 paragraph 2, which states that the Committee compiles and submits for approval to the General Assembly the main criteria for design, updating and publication of this introductory list.

This means that from the legal point of view no other announcement will be made after the entry into force of this Convention. The Convention is open to accession to any non-member UNESCO country invited to adhere to it by the General Conference of the Organization. This Convention is open to accession to territories that enjoy full internal autonomy, recognized as such by the United Nations, but which have not achieved full independence in accordance with Resolution no. 1514 of the General Assembly, and which are attributive to the field covered by this Convention, including the competences recognized to complete treaties in this field.

Under UNESCO's general law, each State Party is granted the right to denounce this

---

<sup>14</sup> The committee draws up the procedure for reviewing requests for international support and defines the elements of the request, such as the measures envisaged, the necessary interventions and their cost estimate. In the event of an emergency, the request for support shall be considered by the Committee. In order to make a decision, the Committee conducts the studies and consultations it deems necessary.



Convention, and this is done by means of a written instrument deposited with the General Director of UNESCO. This denunciation assumes legal attributes twelve months after receiving the instruments of denunciation and does not change the financial obligations which the denouncing State Party is obliged to settle until the date when the withdrawal becomes effective.



**ACADEMY  
OF SECURITY**

*International  
Scientific  
Conference:*

« Environmental  
crimes,  
environmental  
safety  
and national  
security »



**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

~ *Sesioni IV* ~

Kuptimi, veçoritë, specifikat dhe metodat e hetimit  
të veprave penale kundër mjedisit

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*  
« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

**227**

# Harmonizimi i kodit penal të Kosovës me «Konventën penale kundër korrupsionit», nevojë për garantimin e sigurisë nacionale dhe luftimin e krimeve mjedisore



■ **Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI**  
Akademia e Kosovës për Siguri Publike,  
Fakulteti i Sigurisë Publike  
bejtushg2002@yahoo.com



■ **Dr. (proc.) Adrianit IBRAHIMI**  
Inspektorati Policor i Kosovës  
adrianniti@live.com

## Abstrakt

*Korrupsioni sot është një nga shqetësimet i përmasave globale andaj këtu as Kosova nuk përbën përjashtim. Pasojat e korrupsionit janë evidente në të gjitha sferat shoqërore duke përfshirë edhe dëmet që mund të shkaktohen te mjedisi dhe natyra përmes korrupsionit! Sidoqoftë një luftë më efektive kundër këtij fenomeni nuk është thjesht nevojë e shtetit dhe e shoqërisë, por është kusht themelor për funksionimin e shtetit ligjor dhe demokratik. Padyshim që për të arritur rezultatet e dëshiruara të luftës kundër korrupsionit, ndër të tjera nevojitet një infrastrukturë ligjore efektive dhe efektive. Në këtë drejtim mund të thuhet se e drejta penale evropiane ka arritur që të ndërtojë, deri në një masë, disa standarde të përgjithshme. Për të qenë në hap me prijet evropiane të luftës kundër korrupsionit, “Kodi penal i Kosovës” duhet të jetë në pajtim me parimet e “Konventës penale kundër korrupsionit”, pavarësisht se Kosova nuk është nënshkruese e saj. Prandaj, qëllimi i këtij punimi është studimi i parimeve të kësaj konvente dhe raporti i tyre me kodin penal të Kosovës. Ky punim, po ashtu, bën edhe identifikimin e disa prej pasojave kryesore të korrupsionit në përgjithësi, si cenim i sigurisë nacionale dhe të pasojave që mund të shkaktohen në mjedis dhe natyrë, në veçanti. Pas përfundimit të luftës në Kosovë ka ekzistuar një situatë kaotike jo vetëm në sistemin e drejtësisë, por pothuajse në të gjitha sferat sociale. Andaj punimi fillon me trajtimin historik të korrupsionit në Kosovë. Vëmendje kryesore i është kushtuar veprave penale të korrupsionit sipas kodit penal të Kosovës dhe studimit të raportit të tyre me “Konventën penale kundër korrupsionit”.*

## Fjalëkyçe:

**korrupsioni, Konventa penale kundër korrupsionit, kodi penal i Kosovës.**

## 1. “Konventa penale kundër korrupsionit”

Korrupsioni si formë e kriminalitetit ka arritur dimensione ndërkombëtare, prandaj, luftimi i suksesshëm i korrupsionit, ndër të tjera kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërkombëtar në këtë fushë.<sup>1</sup> Në fund të viteve nëntëdhjetë, KE konstaton që mbrojtja e shoqërisë nga korrupsioni duhet të bëhet prioritet i saj.<sup>2</sup> Për t’u arritur kjo mbrojtje në atë kohë, si fillim ka qenë e domosdoshme të bëhet një unifikim i legjislacioneve të shteteve anëtare të KE-së mbi korrupsionin.<sup>3</sup> Përpjekjet për unifikimin respektivisht harmonizimin e legjislacioneve nacionale u manifestua me mbajtjen e disa konferencave dhe nxjerrjen e disa rezolutave<sup>4</sup> të cilat në instancë të fundit kishin për rezultat miratimin e *Konventës penale kundër korrupsionit*.

Padyshim që *Konventa penale kundër korrupsionit* sot përbën një prej shtyllave kryesore të së drejtës ndërkombëtare në fushën e luftimit të korrupsionit. Prandaj para se të studiohet roli dhe rëndësia e saj, punimi në vijim prezanton disa rrethana historike me rëndësi për këtë konventë.

### 1.1. Disa rrethana historike rreth “Konventës penale për korrupsionin”

Mendohet që korrupsioni si dukuri ekziston që nga antikiteti.<sup>5</sup> Natyrisht që përgjatë

<sup>1</sup> Këshilli i Evropës, “Konventa Penale kundër Korrupsionit”, Strasburg, 1999, Preambula. Shih: [https://rm.coe.int/168007f3f5\[05.09.2019\]](https://rm.coe.int/168007f3f5[05.09.2019]).

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Këshilli i Evropës, “Raporti Shpjegues për Konventën Penale për Korrupsionin” Strasburg, 1999, faqe 2. Shih: [https://rm.coe.int/16800cce44\[05.09.2019\]](https://rm.coe.int/16800cce44[05.09.2019]).

<sup>4</sup> Lidhur me aktivitetet që i kanë paraprirë Konventës do të flitet në vijim të punimit (shih faqen 5 dhe 6). Prandaj në këtë pjesë të punimit vetëm konstatohet që miratimit të Konventës natyrshëm i kanë paraprirë disa konferenca dhe resoluta ndërkombëtare të sponsorizuara kryesisht nga KE, UE dhe OKB.

<sup>5</sup> Raporti Shpjegues për Konventën, i cituar, faqe. 1.

periudhave të ndryshme, format dhe trajtat e korrupsionit kanë qenë të ndryshme, në vende të ndryshme. Megjithatë, mund të konstatohet se luftimi i korrupsionit ka marrë hov vetëm në fund të shekullit XIX. Në kontinentin evropian, si pikë referimi konsiderohet “Kodi francez” i Napoleonit, i vitit 1810, i cili si premierë prezantoi disa sanksione penale për luftimin e korrupsionit në jetën publike.<sup>6</sup> Që nga kjo periudhë interesimi i shteteve për luftimin më efikas të korrupsionit shënoi rritje të vazhdueshme. Rrjedhimisht mendohet që vëmendja ndaj korrupsionit arriti kulmin e vet në vitet ‘90-të të shekullit XIX.<sup>7</sup> Kjo, sepse që nga kjo periudhë lufta ndaj korrupsionit përfundimisht tejkaloi të drejtat e brendshme dhe morri përmasa ndërkombëtare.

Në vitin 1994 ministrat evropian të drejtësisë (KM) mbajtën konferencën e tyre të 19-të në qytetin e Valletës (Maltë). Ndër të tjera, në këtë konferencë u arrit konstatimi se korrupsioni paraqet një kërcënim serioz për të gjitha shtetet duke sulmuar kështu demokracinë, të drejtat e njeriut, ekonominë si dhe vlerat e tjera themelore të shtetit dhe shoqërisë.<sup>8</sup> Rrjedhimisht lufta kundër korrupsionit duhet të tejkalojë qasjet tradicionale dhe individuale të shteteve deri atëherë dhe të zgjerohet përtej kufijve të shteteve. Prandaj duhet intensifikuar bashkëpunimi ndërkombëtar, jo vetëm mes shteteve, por edhe mes organizatave ndërkombëtare, në mënyrë që të ndërtohet sa më shpejt një infrastrukturë ligjore për këtë fushë.<sup>9</sup> Si rezultate konkrete të kësaj konference, ministrat evropianë të Drejtësisë i rekomanduan KM-së krijimin e një grupi shumëdisiplinor kundër korrupsionit, i cili do të ishte nën përgjegjësinë e Komitetit Evropian për Problemin e Krimeve (KEPK) dhe të Komitetit Evropian për Bashkëpunim Ligjor (KEBL).<sup>10</sup> Qëllimi i këtij grupi do të ishte hulumtimi i të gjitha masave të përshtatshme përfshirë bazës ligjore në fuqi kundër korrupsionit, me qëllim të krijimit të një plani veprues në nivel ndërkombëtar për luftimin e kësaj dukurie.<sup>11</sup> Bazuar në këto rekomandime, KM-ja në shtator të vitit 1994 krijoi të ashtuquajturin *Grup Shumëdisiplinor për Korrupsion (GMK)*.<sup>12</sup> Ky i fundit, në mars të 1995 përgatiti “*Planin e veprimit kundër korrupsionit*” i cili u adoptua nga KM-ja në fund të vitit 1996. Ky dokument ambicioz mund të konsiderohet përndryshe, si hap i parë konkret drejt miratimit të *Konventës* me që kishte për qëllim pikërisht stimulimin e shteteve për të bashkëpunuar në miratimin e një baze ligjore ndërkombëtare kundër korrupsionit.<sup>13</sup>

Më 6 nëntor 1997, KM-ja në sesionin e saj nr. 101, miratoi “*20 parimet udhërrëfyese për luftën kundër korrupsionit*”. Këto parime kishin kryesisht për qëllim harmonizimin e legjislacioneve nacionale në fushën e luftës kundër korrupsionit.<sup>14</sup> Në këtë mënyrë do

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Po aty, faqe 2.

<sup>8</sup> Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, Raporti i Sekretarit Gjeneral të Këshillit të Evropës për Konferencën e 19-të të Ministrave Evropian të Drejtësisë, Strasburg, 3 Gusht 1994, faqe 2. Shih: [https://rm.coe.int/16804ead6d\[06.09.2019\]](https://rm.coe.int/16804ead6d[06.09.2019]).

<sup>9</sup> Po aty, faqe 4.

<sup>10</sup> KEPK dhe KEBL janë agjencione të KE. Për më shumë shih, për KEPK <https://www.coe.int/en/web/cdpc/home> dhe për KEBL [https://www.coe.int/en/web/cdcj/home\[07.09.2019\]](https://www.coe.int/en/web/cdcj/home[07.09.2019]).

<sup>11</sup> Raporti i Sekretarit Gjeneral të KE, i cituar, faqe 20.

<sup>12</sup> Raporti Shpjegues për Konventën, i cituar, faqe 2.

<sup>13</sup> Këshilli i Evropës - Grupi Multidisiplinor për Korrupsion, “*Plani i Veprimit kundër Korrupsionit*”, Versioni i shkurtuar CM (96)133, Strasburg, 1996, faqe 8.

Shih: [https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstraneImage=539992&SecMode=1&DocId=550744&Usage=2\[07.09.2019\]](https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstraneImage=539992&SecMode=1&DocId=550744&Usage=2[07.09.2019]).

<sup>14</sup> Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, Resoluta nr. (97)24, “*Njëzet Parimet Udhëheqëse për Luftën kundër Korrupsionit*”, Strasburg, 1997, Parimet nr. 2, 4 dhe 20. Shih: [https://www.kpk-rs.si/upload/datotekte/ResCM\\_97\\_24E\\_01\(1\).pdf\[08.09.2019\]](https://www.kpk-rs.si/upload/datotekte/ResCM_97_24E_01(1).pdf[08.09.2019]).

të avancohej fronti antikorrupsion dhe do të përafroheshin politikat e shteteve në këtë fushë. Më 5 maj 1998, KM-ja në sesionin e saj nr. 102 përmes rezolutës nr. (98)7 miratoi krijimin e “Grupit të shteteve kundër korrupsionit” (GSHK).<sup>15</sup> Ky trup i krijuar nga KM-ja kishte për qëllim monitorimin dhe observimin e zbatimit të *Parimeve udhërrëfyese për luftën kundër korrupsionit* si dhe implementimin e *Planit të veprimit kundër korrupsionit*.<sup>16</sup> Me falje të tjera, GSHK-ja ka qenë një mekanizëm mbështetës për të rritur dinamikën dhe efikasitetin e luftës kundër korrupsionit.

Si rrjedhojë e të gjithë këtyre zhvillimeve, në shkurt të 1998-s, GMK-ja finalizoi draftin e parë të *Konventës*. Ndërsa në nëntor të po të njëjtit vit, KM-ja, në sesionin nr. 103 të saj miratoi “Konventën penale kundër korrupsionit” dhe autorizoi publikimin e një raporti shpjegues (komentar) për të.<sup>17</sup>

### 1.2. Qëllimi dhe fushëveprimi i “Konventës penale për korrupsionin”

Pavarësisht historisë së gjatë të korrupsionit në shoqëri, ende nuk është arritur një pajtueshmëri e plotë lidhur me definicionin e korrupsionit! As *Konventa penale kundër korrupsionit* nuk ka arritur të përcaktojë një definicion përfundimtar të korrupsionit. Megjithatë, konventa ka arritur të përcaktojë disa parime standarde në fushën e luftimit të korrupsionit. Këto parime i referohen si të drejtës materiale ashtu edhe asaj procedurale, por gjithnjë me qëllim të avancimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë.

Raporti shpjegues i konventës konstaton që lufta ndërkombëtare kundër korrupsionit sot ballafaqohet me të paktë dy sfida të mëdha. E para, ka të bëjë me përcaktimin e një definicioni unik të pranuar në mënyrë universale, pavarësisht dallimeve që mund të ekzistojnë ndërmjet të drejtave të brendshme. E dyta ka të bëjë me bashkëpunimin juridik ndërkombëtar i cili jo rrallëherë është peng jo vetëm i pengesave burokratike, por edhe i ndërhyrjeve politike.<sup>18</sup> Pasur parasysh këto, mund të thuhet që fushëveprimi i konventës është mjaft i gjerë, duke reflektuar kështu sa më shumë prej dallimeve që mund të ekzistojnë ndërmjet shteteve sa i përket luftës kundër korrupsionit.<sup>19</sup> Pra, qëllimi është që përmes përcaktimit të parimeve bazë lidhur me çështjet materiale dhe formale të korrupsionit, të avancohet drejt një definicioni universal të korrupsionit si dhe drejt një bashkëpunimi ndërkombëtar efikas kundër korrupsionit.

### 1.3. Përmbajtja e “Konventës penale për korrupsionin”

Përmbajtja e *Konventës* është e sistemuar në pesë (5) kapituj të cilët janë: I. *Përkufizimi i termave*, II. *Masat që duhet ndërmarrë në nivel të brendshëm*, III. *Monitorimi i zbatimit*, IV. *Bashkëpunimi ndërkombëtar*, V. *Dispozitat përfundimtare*.

Për shkak të qëllimeve të këtij punimi për të studiuar raportin e *Konventës* me KPRK, fokusin do ta vendosim kryesisht në kapitullin II: “Masat që duhet ndërmarrë në nivel të brendshëm”. Së këndejmi, karakteristikë kryesore e këtij kapitulli të konventës është qëllimi për harmonizimin e legjislacioneve të brendshme drejt një përcaktimi universal të korrupsionit. Për këtë qëllim konventa ka përcaktuar disa forma të

<sup>15</sup> Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, Resoluta nr. (98)7, “Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit”. Strasburg, 1998. Shih: [http://www.bak.gv.at/en/Downloads/files/GRECO/GRECO\\_Statut.pdf\[08.09.2019\]](http://www.bak.gv.at/en/Downloads/files/GRECO/GRECO_Statut.pdf[08.09.2019]).

<sup>16</sup> Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, Anexi i Resolutës nr. (99)5, “Statuti i Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit”, Strasburg, 1999, neni 1 dhe 2. Shih: [http://www.bak.gv.at/en/Downloads/files/GRECO/GRECO\\_Statut.pdf\[08.09.2019\]](http://www.bak.gv.at/en/Downloads/files/GRECO/GRECO_Statut.pdf[08.09.2019]).

<sup>17</sup> Raporti Shpjegues për Konventën, i cituar, faqe 5.

<sup>18</sup> Po aty.

<sup>19</sup> Po aty, faqe 6.



korrupsionit dhe disa masa që duhet ndërmarrë shtetet në kuadër të legjislacioneve të tyre të brendshme.

Format e korrupsionit të cilat i parashih konventa janë: “korrupsioni aktiv dhe pasiv i zyrtarëve publik kombëtar; korrupsioni aktiv dhe pasiv në sektorin privat; korrupsioni i anëtarëve të kuvendeve të brendshme publike; korrupsioni i anëtarëve të kuvendeve parlamentare ndërkombëtare; korrupsioni i zyrtarëve publik të huaj; ushtrimi i ndikimit; korrupsioni i anëtarëve të asambleve publike të huaja; korrupsioni i zyrtarëve të organizatave ndërkombëtare; korrupsioni i gjyqtarëve dhe zyrtarëve të gjykatave ndërkombëtare; pastrimi i parave nga veprat e korrupsionit; veprat e llogarive (kontove)”.<sup>20</sup>

Karakteristike e këtyre formave të korrupsionit është klasifikimi në *korrupsion aktiv* dhe në *korrupsion pasiv*. Si duket kriter për këtë klasifikim është ndërmarrja e iniciativës për kryerjen e korrupsionit! Kjo, sepse konventa, si veprime që e karakterizojnë korrupsionin aktiv përcakton “ofrimin”, “premtimin”, “dhënien direkte” dhe “dhënien indirekte”. Ndërsa si veprime që e karakterizojnë korrupsionin pasiv, përcakton: “pranimin”, “kërkimin”, “marrjen direkte” dhe “marrjen indirekte”. Mbi këtë bazë, konventa, në nenin 2, përcakton korrupsionin aktiv të zyrtarëve publik të brendshëm si vijon: “premtimin, ofrimin ose dhënien direkt ose indirekt të çfarëdolloj avantazhi, që nuk i takon cilitdo zyrtari publik për vete ose për dikë tjetër, ndaj tij/saj, për të vepruar ose mosvepruar në ushtrim të funksioneve të tij/saj”.

Tutje, konventa, në nenin 3 përcakton korrupsionin pasiv të zyrtarëve publik të brendshëm si: “kërkimin ose marrjen nga cilitdo prej zyrtarëve publikë direkt ose indirekt, të çfarëdolloj avantazhi që nuk i takon, për vete ose për të tjerë, ose pranimi i një oferte ose premtimi apo avantazhi të tillë, për të vepruar ose mosvepruar në ushtrim të funksioneve të tij/saj”. Përveç klasifikimit në korrupsion “aktiv” dhe “pasiv”, karakteristikë tjetër e kapitullit II të konventës është edhe tendenca për harmonizimin e legjislacioneve të brendshme të shteteve. Kështu, pothuajse çdo dispozitë brenda këtij kapitulli fillon me përcaktimin se “secila palë do të miratojë masa legjislative apo masa të tjera që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepër penale ...”.<sup>21</sup> Si shembull, kur bëhet fjalë për një formë të caktuar të korrupsionit që e parashih konventa, siç është “ushtrimi i ndikimit” në nenin 12, konventa përcakton që *secila palë do të miratojë masa legjislative apo masa të tjera që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepër penale ushtrimin e ndikimit*. Për më shumë, konventa përcakton edhe elementet e domosdoshme që duhet të përmbajë një inkriminim i tillë. Si shembull, neni 7 i konventës, lidhur me korrupsionin aktiv në sektorin privat, përcakton se: “Secila palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera që janë të nevojshme për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj të brendshëm, kur kryhen me qëllim gjatë veprimtarisë ekonomike (biznesit) premtimin, ofrimin ose dhënien direkt ose indirekt, të çfarëdolloj avantazhi që nuk i takon, cilitdo personi që drejton ose punon, në çfarëdo cilësie, në entitete të sektorit privat, për vete apo për të tjerë që ata të veprojnë ose të mos veprojnë, në kundërshtim me detyrat e tyre”.

Pra si konstatim mund të themi që për çdo formë konkrete të korrupsionit që përcakton Konventa, dispozitivi i dispozitës përkatëse përmban dy elemente kryesore:

<sup>20</sup> Konventa Penale kundër Korrupsionit, e cituar, nenet 2 deri 15.

<sup>21</sup> Versioni zyrtar në gjuhën angleze: “Each Party shall adopt such legislative and other measures as may be necessary to establish as criminal offences under its domestic law ...”. Shih: Konventën Penale kundër Korrupsionit, e cituar, nenet 2 deri 23.

1. Detyrimin që shteti përmes masave përkatëse të inkriminov veprimin e caktuar me legjislacionin të brendshëm dhe 2. Elementet e domosdoshme që duhet të përfshij ai inkriminim (vepër penale) e caktuar. Megjithatë, mund të thuhet që Konventa u ka lënë shteteve mjaft hapësirë diskrecionale. Kjo, sepse për formën përkatëse të korrupsionit, konventa kushtëzon vetëm elementet e përgjithshme që domosdoshmërisht duhet inkorporuar me rastin e inkriminimit të veprimit të caktuar në nivel të brendshëm. Ndërsa elementet tjera që e përbëjnë figurën penale konkrete të korrupsionit siç janë faji, kryesi, pastaj formën e cilësuar, formën e privilegjuar apo elemente të tjera eventuale, shteti përkatës i përcakton në mënyrë vetjake. Tutje, konventa u jep shteteve mundësi që për pjesë të caktuara të konventës, shtetet, në përputhje me nenet 36 dhe 37 të shfrytëzojnë dy institute të cilat janë deklarimet dhe rezervat. Natyrisht që këto dy instituteve janë në favor harmonizimit të legjislacioneve të brendshme dhe tejkalimit të dallimeve eventuale ndërmjet shteteve.

Duhet cekur se konventa përcakton edhe përgjegjësi (penale ose jopenale) për personat juridik. Megjithatë konventa parasheh vetëm tri forma të korrupsionit për të cilat personat juridik duhet të mbahen përgjegjës sipas legjislacioneve të brendshme.<sup>22</sup> Këto forma janë: korrupsioni aktiv, ushtrimi i ndikimit dhe pastrimi i parave. Për dallim prej dispozitave paraprahe, në nenin 18 të konventës ku parashihet përgjegjësia e personave juridik, nuk kërkohet nga shtetet të përcaktojnë domosdoshmërisht sanksione penale. Këtu shtetet përmes legjislacionit të brendshëm mund të përcaktojnë edhe masa jopenale përfshirë edhe masa monetare (dënime me gjobë), por të cilat duhet të jenë efektive, proporcionale dhe shtrënguese.<sup>23</sup>

Nenet 20 deri 23 të konventës, u referohen kryesisht masave që shtetet duhet të ndër marrin jo për inkriminimin e formave të caktuara të korrupsionit, por për mbrojtjen dhe ndjekjen e shkeljeve atyre veprave penale. Kështu për shembull neni 20 përcakton krijimin e autoriteteve të specializuara për luftimin e korrupsionit brenda shteteve. Këto autoritete si të tilla duhet të jenë profesionale, të pavarura dhe të funksionojnë në përputhje me parimet e përcaktuara me konventës.<sup>24</sup>

Përndryshe sa i përket luftimit të korrupsionit në nivel të brendshëm, konventa përcakton edhe që shtetet duhet të miratojnë procedura penale. Kështu, në nenet 21 deri 23 parashihet që shtetet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e bashkëpunëtorëve dhe të dëshmitarëve, bashkëpunimin ndërmjet institucioneve shtetërore si dhe përcaktimin e masave për lehtësimin e marrjes së provave dhe konfiskimin e produkteve që dalin nga veprat penale të korrupsionit.

## 2. Korrupsioni në Republikën e Kosovës

Korrupsioni si fenomen historik, mbetet një nga sfidat më të mëdha të demokracisë dhe sundimit të ligjit. Si i tillë, korrupsioni është prezent pothuajse në të gjitha shtetet, diku më pak dhe diku më shumë. Natyrisht që as shteti i Kosovës nuk përbën ndonjë përjashtim në këtë aspekt.

Luftimi efikas kundër korrupsionit është një *conditio sine qua non* (kusht pa të cilin nuk bën) për çdo shtet demokratik dhe ligjor. Në rastin e shtetit të Kosovës, rezultatet

<sup>22</sup> Po aty, neni 18.

<sup>23</sup> Po aty, neni 19.

<sup>24</sup> Po aty, neni 20.

konkrete të luftimit të këtij fenomeni janë edhe objektiva që duhet përmbushur në rrugën e integritit të plotë në strukturat euro-atlantike! Megjithatë korrupsioni mbetet ende sfidë e qytetarëve dhe e institucioneve të Republikës së Kosovës. Kjo konfirmohet edhe nga institucionet të besueshme ndërkombëtare, siç është *Transparency International* i cili në indeksin e matjes së perceptimit të korrupsionit për vitin 2018, Kosovën e radhit në vendin numër 93 nga 180 shtetet e shënjuara.

Në aspektin penalo-juridik, karakteristikë themelore e korrupsionit konsiderohet cenimi i detyrës zyrtare. Rrjedhimisht, objekti i mbrojtur përmes veprave penale kundër korrupsionit, në kuptimin formal, është ushtrimi i ligjshëm i autorizimeve zyrtare dhe personave përgjegjës. Ndërsa në kuptimin material, objekti i mbrojtur mund të përkufizohet si interes i përgjithshëm i shoqërisë për një funksionim të ndershëm dhe të ligjshëm të organeve shtetërore si dhe shërbimeve të tjera me interes publik. Jo rrallëherë, dëmet dhe pasojat që shkakton korrupsioni në shoqëri, janë të mëdha apo të pariparueshme për viktimat e kësaj forme të kriminalitetit. Në fakt, pasojat e korrupsionit mund të evidentohen në çdo sferë të shoqërisë, përfshirë këtu dëmet që korrupsioni mund të shkaktojë në mjedis dhe natyrë! Si shembull për këtë, mund të shërbejë korrupsioni në administratën komunale si rezultat i të cilit mund të vijë deri dhënia e lejeve të ndërtimit, me qëllim që të ndërtohen objekte në vendndodhje që mund të dëmtojnë natyrën dhe mjedisin, duke qenë kështu në kundërshtim të plotë me rregullat e pranueshme për infrastrukturën e qyteteve respektive. Po ashtu, përmes korrupsionit në administratë si dhe korrupsionit në procedurat e prokurimit publik, mund të vijë deri ndërtimi i rrugëve, hidrocentraleve, fabrikave, qendrave tregtare, hekurishteve apo qendrave për mbledhjen e mbeturinave, të cilat jo vetëm që janë në kundërshtim me normat juridike në fuqi, por që mund të dëmtojnë seriozisht mjedisin, natyrën si dhe shëndetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Duke pasur parasysh kontekstin dhe tematikën e hulumtimit, në këtë pjesë të punimit janë përmbledhur shkurtimisht disa nga karakteristikat e korrupsionit si dhe pasojave që kjo formë e kriminalitetit manifeston në të gjitha sferat e shoqërisë, duke përfshirë edhe dëmet që mund të shkaktohen në natyrë, mjedis dhe te shëndeti i qytetarëve të Republikës së Kosovës. Pjesa tjetër e punimit, trajton aspekte historike të korrupsionit në Kosovë si dhe përmban një analizë të thukët të kornizës juridiko-penale në fuqi, për luftimin e këtij fenomeni.

## 2.1. Disa rrethana historike me rëndësi për korrupsionin në Kosovë

Më 10 qershor 1999, në mbledhjen nr. 4011 Këshilli i Sigurimit të OKB-së, miratoi rezolutën nr. 1244, përmes të cilës, ndër të tjera, u adresua nevoja e vendosjes së një pranie civile ndërkombëtare në Kosovë nën mbikëqyrjen e OKB-së.<sup>25</sup> Kështu, në vitin 1999 në Kosovë filloi *Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë* (UNMIK), mandati i së cilës ishte që të siguronte një administrim kalimtar gjersa të themeloheshin dhe zhvilloheshin institucionet demokratike vetëqeverisëse, që do të siguronin kushtet për një jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës.<sup>26</sup>

<sup>25</sup> Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Rezoluta nr. 1244 S/RES/1244, New York, 1999, pikat 5-12. Shih: <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Res1244ALB.pdf> [14.09.2019].

<sup>26</sup> Po aty, pika 10.

Në krye të këtij misioni qëndronte PSSP i cili kishte pushtet pothuajse të plotë ekzekutiv dhe ligjvënës.

Baza ligjore me të cilën është inkriminuar korrupsioni në Kosovë deri në vitin 2004, ka qenë “Ligji penal” i Kosovës, i vitit 1977.<sup>27</sup> Megjithatë kur kemi parasysh rrethanat e asaj kohe, mund të konstatojmë se prej gjysmës së dytë të vitit 1999 deri në vitin 2004 ekziston një “kaos ligjor i përgjithshëm” në Kosovë. Ky kaos nuk ka përjashtuar as fushën e korrupsionit, për faktin se LPK-ja është konsideruar si bazë ligjore e pamjaftueshme dhe joadekuate për rregullimin e korrupsionit në atë kohë.<sup>28</sup>

Avokati i Popullit të Kosovës, në vitin 2003, në raportin e tij vjetor, drejtuar PSSP-së shpreh shqetësimet e tij për konfuzitetin e institucioneve të atëhershme se cilat ligje janë të aplikueshme në Kosovë!<sup>29</sup> Me fjalë të tjera, kjo periudhë, në kontekstin e sundimit të ligjit është mjaft kaotike. Si e tillë, krijohet hapësirë e mjaftueshme për të dyshuar se ekziston një “numër i errët” mjaft i madh i korrupsionit në Kosovë gjatë kësaj periudhe.<sup>30</sup> Për më tepër, ekziston supozimi se në veprat e caktuara korruptive të asaj kohe, mund të kenë qenë të përfshirë edhe zyrtarë të caktuar të UNMIK-ut!<sup>31</sup>

Konsiderohet se lufta kundër korrupsionit në Kosovë fillon të intensifikohet në vitin 2004.<sup>32</sup> Kështu më 6 prill 2004, kishte hyrë në fuqi “Kodi i përkohshëm penal i Kosovës”.<sup>33</sup> Ky i fundit edhe pse nuk përcakton një definicion të korrupsionit, në kapitullin e tij XXIX (nenet 339-351) sistemon disa vepra penale kundër detyrës zyrtare, përmes të cilave inkriminohen veprime të caktuara korruptuese. Vlen të theksohet se në vitin 2004 kanë hyrë në fuqi edhe disa ligje të tjera të cilat kanë qenë të mirëseardhura në luftën kundër korrupsionit. Kështu, më 9 shkurt 2004 hyn në fuqi ligji për prokurimin publik.<sup>34</sup> Tutje më 12 maj 2005 hyn në fuqi edhe ligji për zhdukjen e korrupsionit.<sup>35</sup> Ky i fundit ndër të tjera përcakton edhe themelimin e *Agjencionit Kosovar Kundërkorrupsionit* i cili në petkun e një agjencie të pavarur do të bashkëpunonte me prokurorinë dhe institucionet tjera për një luftë më efikase kundër korrupsionit.<sup>36</sup> Megjithatë, AKK-ja nuk është institucioni i vetëm i themeluar për luftimin e korrupsionit në Kosovë. Përgjithësisht, mund të thuhet se periudha 2004-2013, në Kosovë, nga

<sup>27</sup>Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nr. 25/77, Ligji Penal i Kosovës, Prishtinë, 01 Korrik 1977.

<sup>28</sup>Autorë të ndryshëm kanë dhënë mjaft argumente për deficitet sa i përket bazës ligjore të korrupsionit në Kosovë deri në vitin 2004. Për më shumë shih: Azem Hajdari, “Veprat penale me natyrë korrupsioni me një vështrim të posaçëm në Kosovë”, Prishtinë, 2003, faqet 29-31.

<sup>29</sup>Institucioni i Ombuspersonit në Kosovë, Raporti i tretë vjetor 2002-2003, Prishtinë, 2003, faqe 4. Shih: [http://www.ombudpersonkosovo.org/repository/docs/A6030630a\\_970208.pdf](http://www.ombudpersonkosovo.org/repository/docs/A6030630a_970208.pdf) [14.09.2019].

<sup>30</sup>Azem Hajdari, vep. e cituar, faqet 63-64.

<sup>31</sup>Lidhur me këtë supozim shih: Organized Crime and Corruption Reporting Project, Web Faqja Zyrtare, “UNMIK corruption”, 2008. Link: <https://www.occrp.org/en/daily/46-unmik-corruption> [14.09.2019]. Poashtu: Marco Prelec, South East Europe Sustainable Energy Policy, “Fituesit dhe Humbësit”, Kosovë: Afera UNMIK-KEK, Strasburg, 2014, faqe 31. Link: [http://www.advocacy-center.org/wp-content/uploads/2015/10/Fituesit\\_dhe\\_Humbesit.pdf](http://www.advocacy-center.org/wp-content/uploads/2015/10/Fituesit_dhe_Humbesit.pdf) [14.09.2019].

<sup>32</sup>OSCE – Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit, “Implementimi i ligjeve të Kuvendit të Kosovës – Raporti III”, Prishtinë, 2007, faqe 27. Shih: <http://www.osce.org/sq/kosovo/23824?download=true> [15.09.2019].

<sup>33</sup>Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, Prishtinë, 06 Prill 2004. Shih: [http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/O3albanian/A2003regs/RA2003\\_25\\_CCintranet.pdf](http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/O3albanian/A2003regs/RA2003_25_CCintranet.pdf) [15.09.2019].

<sup>34</sup>Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/3, Ligji mbi Prokurimin Publik nr. 2003/17, Prishtinë, 09 Shkurt 2004. Shih: [http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/O3albanian/A2004regs/RA2004\\_03.pdf](http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/O3albanian/A2004regs/RA2004_03.pdf) [15.09.2019].

<sup>35</sup>Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/26, Ligji për Zhdukjen e Korrupsionit nr. 2004/34, Prishtinë, 12 Maj 2005. Shih: [http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/O3albanian/A2005regs/RA2005\\_26\\_ALA2004\\_34.pdf](http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/O3albanian/A2005regs/RA2005_26_ALA2004_34.pdf) [15.09.2019].

<sup>36</sup>Po aty, neni 8 paragrafi 1 dhe neni 23.

këndvështrimi i luftës kundër korrupsionit, karakterizohet me themelimin e shumë mekanizmave antikorrupsion. Kështu, mund të numërohen *Task Forca Speciale Anti-Korrupsion (2010)*<sup>37</sup>, *Koordinatori Kombëtar për Luftën Kundër Korrupsionit – Zyra e Prokurorisë së Shtetit (2010)*<sup>38</sup>, *Këshilli Kombëtar kundër Korrupsionit (2012)*<sup>39</sup>, etj. Mirëpo përkundër numrit të madh të mekanizmave antikorrupsion, monitorimet e bëra nga shoqëria civile, konstatojnë se “numri i trupave dhe agjencive të krijuara për të luftuar korrupsionin janë në disproporcion të lartë me rezultatet e pritura”.<sup>40</sup> Për më tepër, gjatë këtij hulumtimi kemi identifikuar edhe raste kur pikërisht udhëheqësit e këtyre institucioneve janë përfshirë në vepra penale korruptuese.<sup>41</sup>

Në dhjetor të vitit 2008 u vu në funksion EULEX-i, në RKS, me mandat të forcimit të drejtësisë në Kosovë.<sup>42</sup> Megjithatë, edhe misioni EULEX është kritikuar vazhdimisht për dështimin e saj që të luftojë korrupsionin në nivelet e larta në Kosovë.<sup>43</sup> Aq më tepër, edhe këtu kemi identifikuar disa dyshime për afëra korruptuese ku janë të përfshirë zyrtarë të caktuar të EULEX-it. Rasti më i njohur është rasti M. Bamieh vs F. Flori!<sup>44</sup>

Përkundër zhvillimeve të lartëcekura, lufta kundër korrupsionit në Kosovë ende ballafaqohet me ngecje të caktuara edhe pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008. Kështu, Kuvendi i RKS-së, miratoi “Kodin penal të Republikës së Kosovës”, nr. 04/L-082<sup>45</sup>, i cili hyri në fuqi në vitin 2013. Megjithatë as ky kod penal nuk qëndroi për kohë të gjatë në fuqi pasi që në vitin 2019 u shfuqizua nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 06/L-074 i cili edhe aktualisht është në fuqi. Prandaj inkriminimet që përcakton ky kod për fushën e korrupsionit dhe në përgjithësi raportin e këtij kodi me Konventën do ta trajtojmë në vijim të këtij punimi.

<sup>37</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimi nr. 02/110 për themelimin e Departamentit Special Antikorrupsion, Prishtinë, 26 Shkurt 2010. Shih: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_se\\_110\\_te\\_te\\_Qeverise\\_2010.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_110_te_te_Qeverise_2010.pdf) [16.09.2019].

<sup>38</sup> Themelimi i këtij mekanizmi në vitin 2012 paraqitet edhe si detyrim i përcaktuar me udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave për Kosovën. Shih: Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Vendimi nr. A.nr.131/2012 për caktimin e koordinatorëve të KPK, Prishtinë, 20.07.2012. Link: [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.835.2012\\_Vendim\\_.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.835.2012_Vendim_.pdf) [16.09.2019].

<sup>39</sup> Zyra e Presidentit të RKS, Web Faqja Zyrtare, Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit. Shih: <http://www.president-kgov.net/?page=1,132> [16.09.2019].

<sup>40</sup> Instituti Riinvest, “Vlerësimi i Korrupsionit në Kosovë”, Prishtinë, 2016, faqe 22. Shih: [http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/September/15/Vleresimi\\_i\\_korrupsionit\\_ne\\_kosove\\_1473932044.pdf](http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/September/15/Vleresimi_i_korrupsionit_ne_kosove_1473932044.pdf) [16.09.2019].

<sup>41</sup> Në Prill të vitit 2012 kreu i Task Forcës Kundër Korrupsionit, Nazmi Mustafi u arrestua nga policia e EULEX-it, nën akuzat për veprën penale të kërkim rryshfeti. Ai u shpall fajtor dhe u dënua me 5 vite burgim nga Gjykata Themelore e Pejës. Shih: <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0444.php> [16.09.2019].

<sup>42</sup> EULEX, Web Faqja Zyrtare, Short History of EULEX. Link: <http://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,44,197> [16.09.2019].

<sup>43</sup> Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED), “Lufta kundër korrupsionit: Analizë krahasuese mes Kosovës dhe Kroacisë”, Analizë e Politikave nr. 1/14, Prishtinë, 2014, faqe 11. Shih: [http://www.kipred.org/repository/docs/Lufta\\_Kund%C3%ABr\\_Korrupsionit\\_Analiz%C3%AB\\_Krahasuese\\_Mes\\_Kosov%C3%ABs\\_Dhe\\_Kroaci%C3%AB\\_164083.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/Lufta_Kund%C3%ABr_Korrupsionit_Analiz%C3%AB_Krahasuese_Mes_Kosov%C3%ABs_Dhe_Kroaci%C3%AB_164083.pdf) [16.09.2019].

<sup>44</sup> Raporto Korrupsionin! Kallzo.com, Web Faqja, BamiehFletpërMbyllyjen e HetimeveNdajAkuzavepërKorrupsionë EULEX, 2016.

Link:<http://kallzo.com/bamieh-flet-per-mbyllyjen-e-hetimeve-ndaj-akuzave-per-korrupsion-ne-eulex/> [16.09.2019]. Shih poashtu: The Guardian, Web Faqja, “EU accused over its Kosovo mission: Corruption has grown exponentially”, 2014. Link:<https://www.theguardian.com/world/2014/nov/06/eu-accused-over-kosovo-mission-failings> [16.09.2019].

<sup>45</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 19/2012, Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 04/L-082, Prishtinë, 2012. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834> [17.09.2019].

<sup>46</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 02/2019, 14 Janar 2019, “Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 06/L-074”, Prishtinë, 2019. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413> [14.09.2019].

<sup>47</sup> Ismet Salihu & Hilmi Zhitija & Fejzullah Hasani, “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës”, Botimi i, Prishtinë, 2014, faqe 1204. Shih: <http://jus.igjk.rks-gov.net/485/1/Komentari%20-%20Kodi%20Penal%20i%20Kosoves.pdf> [16.09.2019].

## 2.2. Veprat penale të korrupsionit sipas “Kodit penal të Republikës së Kosovës”

Më 16 prill 2019 ka hyrë në fuqi “Kodi penal i Republikës së Kosovës”, nr. 06/L-074 (në vijim si: “KPRK”).<sup>46</sup> Megjithëse KPRK nuk jep ndonjë definicion të korrupsionit, veprat penale të korrupsionit kryesisht i sistemon në kuadër të kapitullit XXXIV “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare”. Në esencë veprat penale të këtij kapitulli i referohen detyrës zyrtare dhe personave zyrtar. Rrjedhimisht, objekt primar i mbrojtur (në kuptimin formal) është ushtrimi i ligjshëm, i drejtë dhe me ndërgjegje i detyrës dhe i autorizimeve zyrtare.<sup>47</sup> Megjithatë një administratë e pakorruptuar është parakusht për një shtet demokratik, shtet ligjor dhe mirëqenie të qytetarëve. Prandaj mund të thuhet që objekt i mbrojtur (në kuptimin material) është po ashtu edhe interesi i përgjithshëm i shoqërisë që të ketë një administratë të ligjshme, të drejtë dhe të ndërgjegjshme.<sup>48</sup>

Disa nga veprat penale korruptuese më përfaqësuese të këtij kapitulli janë: *Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, Keqpërdorimi i informatës zyrtare, Konflikti i interesit, Përvetësimi në detyrë, Mashtrimi në detyrë, Marrja e ryshfetit, Dhënia e ryshfetit, Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj, Ushtrimi i ndikimit, Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, etj.*<sup>49</sup>

Një nga karakteristikat themelore të këtyre veprave penale është se në numrin më të madh të rasteve, kryesor është personi zyrtar.<sup>50</sup> Megjithatë përpos personave zyrtarë veprat penale të korrupsionit mund t'i kryejnë edhe personat e tjerë që për kohë të caktuar ushtrojnë një detyrë të caktuar publike (komisionerët në qendrat e votimit, vëzhguesit në qendrat e votimit, etj).<sup>51</sup>

Tutje, karakteristikë e radhës është se veprat penale të korrupsionit mund të kryhet vetëm me dashje. Kjo rezulton nga natyra e këtyre veprave penale, te të cilat më së shpeshti bëhet fjalë për veprimin e vullnetshëm dhe të pandërgjegjshëm gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, shpesh me qëllim të përfitimi të dobisë së caktuar. Përfundim bën vepra penale e zbulimit të sekreteve zyrtare, për të cilën është parashikuar përgjegjësia penale edhe për pakujdesi.<sup>52</sup>

Ligjvënësi me rastin e inkriminimit të korrupsionit, theks të veçantë i kushton korrupsionit në fushën e prokurimit dhe ankandeve publike. Kjo sepse për shumë prej veprave penale të korrupsionit, KPRK përcakton edhe formën e kualifikuar e cila rëndom realizohet atëherë kur vepra penale përkatëse kryhet në fushën e prokurimit, ankandit publik apo kur në pyetje është një shumë e caktuar e të hollave (si p.sh.: 5000 Euro, 15000 Euro apo 50000 Euro).

Karakteristikë e radhës e veprave penale të korrupsionit, të përcaktuara me KPRK, është se veprimi i kryerjes rëndom konsiston në keqpërdorimin, shpërdorimin, shfrytëzimin e pozitës apo autoritetit zyrtar nga personi zyrtar në kundërshtim me ligjin me qëllim të arritjes së një përfitimi të caktuar për vete apo për personin tjetër.

Kështu p.sh. vepra penale e “keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar” sipas nenit 414 të KPRK realizohet atëherë kur: “Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar

<sup>46</sup> Po aty, faqe 1205.

<sup>49</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, i cituar, nenet 414-430.

<sup>50</sup> Lidhur me definicionin e “personit zyrtarë”, shih: Po aty, neni 113, paragrafi 2, pikat 1-5.

<sup>51</sup> Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i cituar, faqe 1206.

<sup>52</sup> Po aty, faqe 1208.

detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër". Shembull tjetër mund të jetë edhe vepra penale e "keqpërdorimit të informatës zyrtare" e cila sipas nenit 416 të KPRK kryhet atëherë kur "personi zyrtar i cili keqpërdor informatën zyrtare me qëllim që për vete apo për personin tjetër të përfitojë ndonjë përparësi që nuk i takon".

Kur flasim për veprimin e kryerjes si element të figurës penale të veprave penale të korrupsionit, duhet theksuar që veprat penale të marrjes së ryshfetit dhe dhënies së ryshfetit janë ndër veprat më përfaqësuese të korrupsionit në përgjithësi. Vepra penale e marrjes së ryshfetit sipas nenit 421 të KPRK realizohet atëherë kur "personi zyrtar i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare". Pra këtu kemi të bëjmë me të ashtuquajturin korrupsion aktiv të personave zyrtarë, i cili konsiston në kërkimin apo pranimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të ndonjë dhurate, përfitimi, oferte apo premtimi për vete apo tjetrin. Në anën tjetër vepra penale e dhënies së ryshfetit sipas nenit 422 të KPRK konsumohet atëherë kur: "kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premtton, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar, në mënyrë që ai person të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare". Pra mund të konstatojmë se kjo vepër penale e njohur edhe me emërtim si korrupsion pasiv, në fakt është komplementare me veprën penale të marrjes së ryshfetit. Kjo sepse përderisa veprime të kryerjes tek marrja e ryshfetit janë kërkimi apo pranimi, vepra penale e dhënies së ryshfetit konsumohet me rastin e kryerjes së veprimeve të premtimit, ofrimit apo dhënies së drejtpërdrejtë apo të tërthortë të ndonjë dhurate apo përfitimi personit zyrtar për qëllime të caktuara.

Duhet theksuar po ashtu që jo të gjitha veprat penale të korrupsionit kryhen domosdoshmërisht nga personat zyrtar respektivisht nga personat që bartin një pozitë apo kryejnë një shërbim të caktuar publik. Disa forma të korrupsionit mund t'i kryejnë edhe personat e thjeshtë (jo zyrtar). Kështu përveç veprave penale të dhënies së ryshfetit dhe dhënies së ryshfetit zyrtarit publik të huaj<sup>53</sup>, KPRK në nenin 424 përcakton edhe që veprën penale të "ushtrimit të ndikimit" kryes mund të jetë "kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që të ushtrojë ndikim të padrejtë mbi vendimmarrjen e personit zyrtar apo zyrtarit publik të huaj, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar".

Po ashtu edhe veprën penale të "përdorimit të paautorizuar të pasurisë" sipas KPRK mund ta kryej parimisht "kushdo që pa autorizim përdor paratë, letrat me vlerë apo pasurinë tjetër të luajtshme e cila i është besuar atij në detyrë ose në përgjithësi në vendin e punës apo në të cilat ka qasje për shkak të shërbimit apo punës së tij...".<sup>54</sup> Megjithatë për dallim nga ushtrimi i ndikimit, mund të shohim se këtu megjithatë pasuria e përdorur (në mënyrë të paautorizuar) i është besuar kryesisht për shkak të pozitës apo detyrës që ai ka apo për shkak të punës ku ai punon.

<sup>53</sup> Kodi Penal i RKS, cituar, neni 430.

<sup>54</sup> Po aty, neni 427.

### 3. Raporti i Konventës me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës dhe ndikimi i tyre në sigurinë nacionale e mbrojtjen e mjedisit

Korrupsioni si fenomen historik, mbetet një nga sfidat më të mëdha të demokracisë dhe sundimit të ligjit. Si i tillë, korrupsioni është prezent pothuajse në të gjitha shtetet, diku më pak dhe diku më shumë. Natyrisht që as shteti i Kosovës nuk përbën ndonjë përjashtim në këtë aspekt. Luftimi efikas kundër korrupsionit është një *conditio sine qua non* (“kusht pa të cilin nuk bën”) për çdo shtet demokratik dhe ligjor. Në rastin e shtetit të Kosovës, rezultatet konkrete të luftimit të këtij fenomeni janë edhe objektiva që duhen përmbushur në rrugën e integritetit të plotë në strukturat euro-atlantike!

Megjithatë korrupsioni ende mbetet sfidë e qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës. Kjo konfirmohet edhe nga institucionet të besueshme ndërkombëtare siç është *Transparency International* i cili në indeksin e matjes së perceptimit të korrupsionit për vitin 2018, Kosovën e radhit në vendin numër 93 nga 180 shtetet e shënjuara. Një nga dilemat që shtrohen nga interpretimi logjik i kësaj renditje të Kosovës nga *Transparency International* është pikërisht çështja e sigurisë nacionale. Me fjalë tjera, një nivel i tillë mjaft i lartë i perceptimit të korrupsionit në Kosovë, mund konsiderohet si pasiguri e qytetarëve të Kosovës dhe anasjelltas.

Një shtet i korruptuar është ndër të tjera, manifestim edhe i një administrate të korruptuar, i një sistemin gjyqësor të korruptuar dhe i një sistemi ekzekutiv të korruptuar. Rrjedhimisht pasojat e korrupsionit janë shumëdimensionale duke vendosur në qendër të vëmendjes shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të së drejtave të njeriut, por duke mos u kufizuar edhe në dëmtimin e sistemit shëndetësor, edukativo-arsimor, pastaj në dëmtimin e sigurisë, rendit, ligjit dhe mjedisit.

Sidoqoftë për të qenë në hap me prirjet evropiane të luftës kundër korrupsionit, kodi penal i Kosovës duhet të jetë në pajtim me parimet e *Konventës penale kundër korrupsionit*, pavarësisht se Kosova nuk është nënshkruese e saj.

#### 3.1. Raporti i “Konventës” me “Kushtetutën e Republikës së Kosovës”

Kosova nuk është nënshkruese e “Konventës penale kundër korrupsionit”.<sup>55</sup> Nga ky këndvështrim, RKS parimisht nuk ka ndonjë obligim juridik për implementimin e kësaj konvente. Megjithatë KRK përcakton se “Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare”.<sup>56</sup> KRK po ashtu përcakton edhe obligimin që “Republika e Kosovës të merr pjesë në bashkëpunim ndërkombëtar për promovimin dhe mbrojtjen e paqes, sigurisë dhe të drejtave të njeriut”.<sup>57</sup>

Këto dispozita janë mjaft ekstensive në kuptim të interpretimit. Ndonëse kjo është karakteristikë për pothuajse të gjitha dispozitat e KRK-së për shkak të natyrës së saj, është mjaft vështirë të përcaktojmë se çka nënkuptohet me respektim të së drejtës

<sup>55</sup> Këshilli i Evropës, Web Faqja Zyrtare, Lista e shteteve nënshkruese të Konventës Penale kundër Korrupsionit. Shih: [https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/173/signatures?p\\_auth=BzSabCR1](https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/173/signatures?p_auth=BzSabCR1) [13.09.2019].

<sup>56</sup> Gazeta zyrtare e RKS Nr. 09042008, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 09 Prill 2008, Prishtinë, neni 16 paragrafi 3. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702> [13.09.2019].

<sup>57</sup> Po aty, neni 17 paragrafi 2.



ndërkombëtare?! Paqartësi e ngjashme mbetet edhe çështja bashkëpunimit ndërkombëtar?! Megjithatë duhet theksuar se kushtetuta është akti më i lartë juridik në Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht ligjet dhe aktet e tjera juridike (përfshirë këtu edhe KPRK) duhet të jenë në pajtim me të.<sup>58</sup> Pasur parasysh epërsinë juridike të KRK si dhe përcaktimet e lartëcekura të saj se RKS duhet të respektojë të drejtën ndërkombëtare si dhe të marrë pjesë në bashkëpunimin ndërkombëtar, mund të konstatojmë se “Kodi penal i Republikës së Kosovës” duhet të jetë në harmoni me “Konventën penale për korrupsionin”!

Natyrisht që një interpretim i tillë i dispozitave të KRK-së, lidhur me raportin mes KPRK-së dhe Konventës, është thjesht një interpretim logjik dhe qëllimor.<sup>59</sup> Me fjalë të tjera, kolizionet eventuale mes KPRK-së dhe konventës nuk mund të interpretohen si shkelje kushtetuese. Aq më pak, këto kolizione eventuale nuk mund të përdoren si bazë për akuzimin apo mosakuzimin e personave, pasi kjo, ndër të tjera do të ishte edhe shkelje flagrante e parimit të ligjshmërisë. Një situatë tjetër do të kishim në qoftë se RKS-ja do të kishte nënshkruar dhe ratifikuar Konventën. Padyshim që atëherë do të gjente zbatim neni 19 i KRK-së, ku përcaktohet se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga RKS-ja zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kanë epërsi ndaj ligjeve në fuqi.<sup>60</sup> Andaj, përderisa RKS-ja të mos jetë nënshkruese e Konventës, për qëllim të luftimit të korrupsionit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për qëllim të harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me atë evropian në kuadër të synimeve për integrim euro-atlantik, si konstatim mbetet që KPRK duhet të jetë në harmoni me konventën. Mirëpo, kolizionet eventuale nuk janë të sanksionuara as në aspektin kushtetues e as nga e drejta ndërkombëtare.

### 3.2. Raporti i “Konventës” me “Kodin penal të Republikës së Kosovës”

Përgjithësisht mund të themi që KPRK është në harmoni me parimet që ka përcaktuar konventa. Kështu p.sh., nenet 2 dhe 3 të konventës përcaktojnë që shtetet duhet të inkriminojnë korrupsionin aktiv dhe korrupsionin pasiv të zyrtarëve publik. Në anën tjetër, nenet 421 dhe 422 të KPRK-së, përcaktojnë veprat penale të marrjes së ryshfetit dhe dhënies së ryshfetit. Me përjashtim të dallimeve në emërtim, figura penale e korrupsionit aktiv në Konventë është në përputhje me figurën penale të marrjes së ryshfetit në KPRK dhe që konsiston në *kërkimin apo pranimin direkt apo indirekt të ndonjë dhurate, oferte apo premtimi në mënyrë që personi zyrtar të mos veprojë në përputhje me detyrën e tij zyrtare*.

Ngjashëm, edhe figura penale e korrupsionit pasiv në konventë është në përputhje me figurën penale të dhënies së ryshfetit në KPRK dhe që konsiston në *premtimin, ofrimin apo dhënien direkte apo indirekte të ndonjë dhurate, oferte apo premtimi në mënyrë që personi zyrtar të mos veprojë në përputhje me detyrën e tij zyrtare*.

Po ashtu, edhe figura penale e ushtrimit të ndikimit e përcaktuar me nenin 12 të konventës është në përputhje me figurën penale të ushtrimit të ndikimit të përcaktuar me nenin 424 të KPRK-së dhe konsiston në *“kërkimin apo pranimin direkt apo indirekt të ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër në mënyrë që të*

<sup>58</sup> Po aty, neni 16 paragrafi 1.

<sup>59</sup> Interpretimi logjik dhe qëllimor në rastin konkret nisët nga fakti i përcaktimit të RKS për integrimin e plotë Euro-Atlantik. Kjo konfirmohet ndër të tjera edhe në preambulën e KRK ku thuhet “Me synimin që shteti i Kosovës të përfshihet në proceset integruuese Euro-Atlantike”. Natyrisht që harmonizimi i KPRK me Konventën është një obligim i domosdoshëm për arritjen e këtyresynimeve integruuese dhe luftimin e korrupsionit në veçanti.

<sup>60</sup> Po aty, neni 19 paragrafi 1 dhe 2.

ushtrojë ndikim të padrejtë mbi vendimmarrjen e personit zyrtar apo zyrtarit publik të huaj, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar”.

Tutje, nenet 7 dhe 8 të konventës përcaktojnë se shtetet duhet të inkriminojnë korrupsionin aktiv dhe korrupsionin pasiv në sektorin privat. Sipas konventës, me korrupsion aktiv në sektorin privat nënkuptojmë veprimet “*gjatë veprimtarisë ekonomike (biznesore) që konsistojnë në premtimin, ofrimin ose dhënien direkt ose indirekt, të çfarëdolloj avantazhi që nuk i takon, cilitdo personi që drejton ose punon, në çfarëdo cilësie, në entitete të sektorit privat, për vete apo për të tjerë që ata të veprojnë ose të mosveprojnë, në kundërshtim me detyrat e tyre*”. Ngjashëm, konventa përcakton edhe korrupsionin pasiv në sektorin privat me të vetmin dallim se këtu në vend të premtimit, ofrimit apo dhënies, kemi të bëjmë me *kërkimin, marrjen apo pranimin direkt ose indirekt*.

Në anën tjetër ligjvënësi kosovar përmes nenit 309 të kodit të ri penal ka përcaktuar veprën penale “pranimi i ryshfetit në sektorin privat” si në vijim: “kushdo që drejton ose punon në cilësinë e një subjekti të sektorit privat ose që punon si person i vetëpunësuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë kërkon ose merr ndonjë dhuratë të pamerituar ose keqpërdor pozitën ose premtimin nga dikush ose pranon një ofertë ose premtim për një dhuratë apo shpërblim të tillë, për vete ose për një person tjetër, me qëllim që të veprojë ose të mos veprojë në shkelje të detyrës ose të funksionit të tij gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, financiare ose tregtare”.<sup>61</sup> Konsideroj se kjo risi në legjislacionin penal jo vetëm që është në harmoni të plotë me konventën, por ka qenë edhe e domosdoshme për një luftë më efikase kundër korrupsionit në Kosovë.

Konventa, në nenin 5, përcakton po ashtu që shtetet përmes legjislacionit të brendshëm duhet të inkriminojnë edhe korrupsionin e personave zyrtarë të huaj. Në anën tjetër kjo formë e korrupsionit është vetëm pjesërisht e njohur me KPRK. Kështu KPRK, me nenin 423, përcakton veprën penale të *dhënies së ryshfetit zyrtarit publik të huaj*. Mirëpo, ngjashëm, nuk përcaktohet edhe korrupsioni aktiv, respektivisht marrja e ryshfetit, nga zyrtari publik i huaj.

Duhet cekur se në Kosovë që nga paslufta ekziston një prezencë e madhe e faktorit ndërkombëtar. Në anën tjetër, po në këtë punim, më sipër, kemi konfirmuar se ka dyshime për disa afera korrupsioni ku persona të caktuar zyrtarë të huaj, kanë qenë të përfshirë. Marrë parasysh këtë, mund të konstatojmë që është e pakuptueshme se si mund të dënohet për vepër penale, ai që i jep ryshfet personit zyrtar të huaj, ndërsa të mos përcaktohet fare si vepër penale marrja e ryshfetit, nga po ai person zyrtar i huaj! Pra, të mos inkriminohet korrupsioni aktiv, respektivisht marrja e ryshfetit nga zyrtari publik i huaj, jo vetëm që është në shpërputhje me principet e konventës, por është edhe e palogjikshme.

Një nga masat tjera që sipas konventës duhet të ndërmarrin shtetet është themelimi i autoriteteve të specializuara të cilat janë të afta dhe të pavarura në luftimin (efikas) të korrupsionit.<sup>62</sup> Në Kosovë që nga paslufta janë themeluar disa autoritete në emër të luftimit të korrupsionit. Kështu sot mund të numërojmë: *Agjencionin Kundër Korrupsionit, Task Forca Speciale Anti-Korrupsion, Koordinatorin Kombëtar për Luftën Kundër Korrupsionit – Zyra e Prokurorisë së Shtetit, Këshilli Kombëtar kundër*

<sup>61</sup> Kodi (i ri) Penal, cit., neni 309.

<sup>62</sup> Konventa Penale kundër Korrupsionit, cituar, neni 20.

*Korrupsionit, Prokuroria Speciale e RKS*, etj. Megjithatë, në rastin e Kosovës, numri i madh i agjencive antikorrupsion, rezultoi të mos jetë zgjidhja më e mirë në luftën kundër korrupsionit. Ndonëse kjo çështje parimisht nuk ka rëndësi për raportin “Konventë” – KPRK, mendoj që themelimi i një autoriteti profesional, të aftë dhe të pavarur në luftën kundër korrupsionit, është jetik për zbatimin efikas të dispozitave të KPRK-së për fushën e korrupsionit.

Kur kemi parasysh numrin e madh të autoriteteve antikorrupsion në Kosovë, është e nevojshme të fillojmë të merremi më shumë me aspektin kualitativ sesa me aspektin kuantitativ. Me fjalë të tjera, ato autoritete që nuk kanë relevancë në luftën kundër korrupsionit duhet të pushojnë së funksionuari për të lëshuar rrugë atyre që luftën kundër korrupsionit do ta zhvillojnë në mënyrë efikase dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Lufta kundër korrupsionit nuk mjafton të bëhet thjesht në mënyrë deklarative. Duhet filluar nga ndryshimet e KPRK me model *Konventën*, deri te themelimi i autoriteteve të pavarura, të afta dhe efikase për luftimin e korrupsionit në RKS.

#### 4. Përfundimi

Korrupsioni si formë e kriminalitetit sot ka arritur të tërheqë vëmendjen e shumë organizatave ndërkombëtare përfshirë, këtu KE-në. Kjo argumentohet me faktin se përderisa pasojat e korrupsionit dëmtojnë vlerat e të gjitha shteteve, atëherë edhe luftimi i korrupsionit nuk mjafton të bëhet vetëm brenda sovraniteteve përkatëse, por duhet zhvendosur në domenin ndërkombëtar.

Kur flasim për luftimin e korrupsionit në të drejtën evropiane, padyshim që *Konventa* përbën iniciativën më serioze në këtë fushë. Kjo për shkak të numrit të konsiderueshëm të shteteve nënshkruese (50 shtete), por edhe për shkak të parimeve të përcaktuara në emër të luftimit efikas të korrupsionit. Ndonëse konventa nuk arriti që të nxjerrë një definicion unik të korrupsionit, ajo arriti që të bëjë një hap të madh drejt harmonizimit të së drejtave të brendshme të shteteve brenda vetes si dhe të konsolidojë mekanizma seriozë ndërkombëtarë për luftimin e korrupsionit, siç është GSHKK.

Duhet theksuar që edhe afër 20 vite pas luftës, perceptimi për korrupsionin në Kosovë është mjaft i lartë. Kjo, konfirmohet edhe nga *Transparency International* duke e vendosur kështu Kosovën për vitin 2018 në vendin 93 prej 180 vendeve më të korruptuara në botë.<sup>63</sup>

Në anën tjetër shteti dhe shoqëria e Kosovës janë të përcaktuara për rrugën e tyre drejt integriteteve euro-atlantike. Mirëpo për arritjen e këtyre synimeve është e domosdoshme që ndër të tjera të luftohet në mënyrë korrupsioni në Kosovë. Rrjedhimisht mendoj që është e domosdoshme që RKS të zbatojë në tërësi standardet evropiane që ka konsoliduar konventa.

Në bazë të hulumtimit të bërë, rezulton që KPRK përgjithësisht ka zbatuar masat që sipas konventës është kërkuar të ndërmerren nga shtetet, ndonëse RKS nuk është nënshkruese e kësaj konvente. Konsideroj që ky konstatim është pozitiv, për faktin që harmonizimi i tillë i KPRK-së me konventën është në pajtim me kushtetutën e Kosovës

<sup>63</sup> Transparency International, Web Faqja Zyrtare, “Corruption Perceptions Index 2018”, [https://www.transparency.org/news/feature/corruption\\_perceptions\\_index\\_2016?gclid=EAlalQobChMlyuKPO8qi2AIVFZ4bChOBnQD8EAAYASAAEgJrFPD\\_BwE](https://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2016?gclid=EAlalQobChMlyuKPO8qi2AIVFZ4bChOBnQD8EAAYASAAEgJrFPD_BwE) [14.09.2019].

dhe përcaktimet e saj integruese për RKS-në.

Një nga masat e radhës që përcaktohen nga konventa, është inkriminimi i korrupsionit aktiv dhe korrupsionit pasiv nga personat zyrtar të shteteve të huaja. Pasur parasysh dyshimet për përfshirje të zyrtarëve të huaj në afëra korruptuese në Kosovë, konsideroj që një inkriminimin i tillë është jo vetëm i logjikshëm, por edhe i domosdoshëm. Megjithatë KPRK-ja në nenin 430 përcakton si vepër penale vetëm dhënien e ryshfetit zyrtarit publik të huaj, ndërsa nuk inkriminohet fare korrupsioni aktiv, respektivisht marrja e ryshfetit, nga zyrtari i huaj publik.

Megjithëse ndjekja penale e kryesve të korrupsionit dhe institucionet kompetente për të bërë këtë ndjekje nuk bien në domenin e KPRK, hulumtimi nxjerr në pah edhe këtë aspekt. Konkretisht, konventa në nenin 20 përcakton se shtetet, me masa legjislative të brendshme të themelojnë një autoritet profesional, të pavarur dhe efikas për luftimin e korrupsionit. Është evidentuar se RKS-ja nuk ka arritur ta zbatojë këtë masë në mënyrë efektive. Kjo për faktin se janë themeluar një numër i madh i institucioneve në emër të luftimit të korrupsionit megjithatë rezultatet kanë lënë mjaft për të dëshiruar!

Siç është sqaruar edhe më sipër në këtë punim, RKS-ja nuk është nënshkruese e konventës. Nën dritën e kësaj, kolizionet eventuale ndërmjet saj dhe KPRK-ja nuk mund të interpretohen as si shkelje e të drejtës ndërkombëtare e as si shkelje e kushtetutës së Kosovës. Megjithatë bazuar në hulumtimin e bërë dhe konstatimet e nxjerra, konsiderojmë që me rastin e amendamentimit të KPRK-së apo me rastin e nxjerrjes së KPRK të ri, duhet të merren për bazë këto rekomandime:

- Në përputhje me nenet 5, 6 dhe 9 të konventës, të përcaktohet si vepër penale korrupsioni aktiv nga personat publik të huaj respektivisht marrja e ryshfetit nga personat publik të huaj.

- Në përputhje me nenin 20 të konventës, të themelohet apo njëri nga autoritetet ekzistuese të përcaktohet si autoritet profesional, i pavarur dhe efikas për luftimin e korrupsionit në Kosovë. Njëkohësisht të autoritetet tjera të panevojshme të pushojnë së vepruari për shkak të konfuzionit që kanë krijuar dhe mosefikasitetit të tyre.

- Të shqyrtohen seriozisht të gjitha mjetet ligjore dhe politike për aderimin e RKS sa më shpejt në konventë, në emër të bashkëpunimit ndërkombëtar për luftimin e korrupsionit në përgjithësi dhe luftimit të korrupsionit në RKS në veçanti.

## Bibliografi

1. Azem Hajdari, "Veprat penale me natyrë korrupsioni me një vështrim të posaçëm në Kosovë", Prishtinë, 2003.
2. EULEX, Web Faqja Zyrtare, Short History of EULEX. Link: <http://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,44,197> [16.09.2019]. Shih poashtu: <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0444.php> [16.09.2019].
3. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 02/2019, 14 Janar 2019, "Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 06/L-074", Prishtinë, 2019. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413> [14.09.2019].
4. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 19/2012, Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 04/L-082, Prishtinë, 2012. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834> [17.09.2019].
5. Gazeta zyrtare e RKS Nr. 09042008, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 09 Prill 2008, Prishtinë. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702> [13.09.2019].
6. Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nr. 25/77, Ligji Penal i Kosovës, Prishtinë, 01 Korrik 1977.
7. Institucioni i Ombuspersonit në Kosovë, Raporti i tretë vjetor 2002-2003, Prishtinë, 2003. Shih: <http://>

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

- [www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/A6030630a\\_970208.pdf](http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/A6030630a_970208.pdf) [14.09.2019].
8. *Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED)*, "Lufta kundër korrupsionit: Analizë krahasuese mes Kosovës dhe Kroacisë", Analizë e Politikave nr. 1/14, Prishtinë, 2014. Shih:
  9. [http://www.kipred.org/repository/docs/Lufta\\_Kund%C3%ABr\\_Korrupsionit\\_Analiz%C3%AB\\_Krahasuese\\_Mes\\_Kosov%C3%ABs\\_Dhe\\_Kroacis%C3%AB\\_164083.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/Lufta_Kund%C3%ABr_Korrupsionit_Analiz%C3%AB_Krahasuese_Mes_Kosov%C3%ABs_Dhe_Kroacis%C3%AB_164083.pdf) [16.09.2019].
  10. *Instituti Riinvest*, "Vlerësimi i Korrupsionit në Kosovë", Prishtinë, 2016, faqe 22. Shih: [http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/September/15/Vleresimi\\_i\\_korrupsionit\\_ne\\_Kosove\\_1473932044.pdf](http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/September/15/Vleresimi_i_korrupsionit_ne_Kosove_1473932044.pdf) [16.09.2019].
  11. *Ismet Salihu & Hilmi Zhitija & Fejzullah Hasani*, "Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës", Botimi I, Prishtinë, 2014. Shih: <http://jus.igjk.rks-gov.net/485/1/Komentari%20-%20Kodi%20Penal%20i%20Kosoves.pdf> [16.09.2019].
  12. *Këshilli i Evropës - Grupi Multidisciplinar për Korrupsion*, "Plani i Veprimit kundër Korrupsionit", Versioni i shkurtuar CM (96)133, Strasburg, 1996. Shih: [https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlo\\_bGet&InstranetImage=539992&SecMode=1&DocId=550744&Usage=2](https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlo_bGet&InstranetImage=539992&SecMode=1&DocId=550744&Usage=2) [07.09.2019].
  13. *Këshilli i Evropës*, "Raporti Shpjegues për Konventën Penale për Korrupsionin" Strasburg, 1999. Shih: <https://rm.coe.int/16800ce44> [05.09.2019].
  14. *Këshilli i Evropës*, "Konventa Penale kundër Korrupsionit", Strasburg, 1999. Shih: <https://rm.coe.int/168007f3f5> [05.09.2019].
  15. *Këshilli i Evropës*, Web Faqja Zyrtare, Lista e shteteve nënshkruese të Konventës Penale kundër Korrupsionit. Shih: [https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/173/signatures?p\\_auth=BzSabCR1](https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/173/signatures?p_auth=BzSabCR1) [13.09.2019].
  16. *Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara*, Rezoluta nr. 1244 S/RES/1244, New York, 1999, pikat 5-12. Shih: <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Res1244ALB.pdf> [14.09.2019].
  17. *Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës*, Anexi i Resolutës nr. (99)5, "Statuti i Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit", Strasburg, 1999. Shih: [http://www.bak.gv.at/en/Downloads/files/GRECO/GRECO\\_Statut.pdf](http://www.bak.gv.at/en/Downloads/files/GRECO/GRECO_Statut.pdf) [08.09.2019].
  18. *Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës*, Raporti i Sekretarit Gjeneral të Këshillit të Evropës për Konferencën e 19-të të Ministrave Evropian të Drejtësisë, Strasburg, 3 Gusht 1994. Shih: <https://rm.coe.int/16804ead6d> [06.09.2019].
  19. *Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës*, Resoluta nr. (97)24, "Njëzet Parimet Udhëheqëse për Luftën kundër Korrupsionit", Strasburg, 1997. Shih: [https://www.kpk-rs.si/upload/datoteke/ResCM\\_97\\_24E\\_01\(1\).pdf](https://www.kpk-rs.si/upload/datoteke/ResCM_97_24E_01(1).pdf) [08.09.2019].
  20. *Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës*, Resoluta nr. (98)7, "Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit". Strasburg, 1998. Shih: [http://www.bak.gv.at/en/Downloads/files/GRECO/GRECO\\_Statut.pdf](http://www.bak.gv.at/en/Downloads/files/GRECO/GRECO_Statut.pdf) [08.09.2019].
  21. *Marco Prelec*, South East Europe Sustainable Energy Policy, "Fituesit dhe Humbësit", Kosovë: Afera UNMIK-KEK, Strasburg, 2014. Link: [http://www.advocacy-center.org/wp-content/uploads/2015/10/Fituesit\\_dhe\\_Humbesit.pdf](http://www.advocacy-center.org/wp-content/uploads/2015/10/Fituesit_dhe_Humbesit.pdf) [14.09.2019].
  22. *Organized Crime and Corruption Reporting Project*, Web Faqja Zyrtare, "UNMIK corruption", 2008. Link: <https://www.occrp.org/en/daily/46-unmik-corruption> [14.09.2019].
  23. *OSCE – Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit*, "Implementimi i ligjeve të Kuvendit të Kosovës – Raporti III", Prishtinë, 2007. Shih: <http://www.osce.org/sq/kosovo/23824?download=true> [15.09.2019].
  24. *Qeveria e Republikës së Kosovës*, Vendimi nr. 02/110 për themelimin e Departamentit Special Antikorrupsion, Prishtinë, 26 Shkurt 2010. Shih: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_se\\_110\\_te\\_te\\_Qeverise\\_2010.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_110_te_te_Qeverise_2010.pdf) [16.09.2019].
  25. *Raporto Korrupsionin! Kallzo.com*, Web Faqja, "Bamieh Flet për Mbylljen e Hetimeve Ndaj Akuzave për Korrupsion në EULEX", 2016. Link: <http://kallxo.com/bamieh-flet-per-mbylljen-e-hetimeve-ndaj-akuzave-per-korrupsion-ne-eulex/> [16.09.2019].
  26. *Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25*, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, Prishtinë, 06 Prill 2004. Shih: [http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2003regs/RA2003\\_25\\_CCintranet.pdf](http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2003regs/RA2003_25_CCintranet.pdf) [15.09.2019].
  27. *Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/3*, Ligji mbi Prokurimin Publik nr. 2003/17, Prishtinë, 09 Shkurt 2004. Shih: [http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2004regs/RA2004\\_03.pdf](http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2004regs/RA2004_03.pdf) [15.09.2019].
  28. *Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/26*, Ligji për Zhdukjen e Korrupsionit nr. 2004/34, Prishtinë, 12 Maj 2005. Shih: [http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2005regs/RA2005\\_26\\_ALA2004\\_34.pdf](http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2005regs/RA2005_26_ALA2004_34.pdf) [15.09.2019].
  29. *The Guardian, Web Faqja*, "EU accused over its Kosovo mission: Corruption has grown exponentially", 2014. Link: <https://www.theguardian.com/world/2014/nov/06/eu-accused-over-kosovo-mission-failings> [16.09.2019].
  30. *Transparency International*, Web Faqja Zyrtare, "Corruption Perceptions Index 2018", [https://www.transparency.org/news/feature/corruption\\_perceptions\\_index\\_2016?gclid=EAlaIqobChMlyuKPO8qi2AIVF74bChObnQD8EAAYASAAEgJrFPD\\_BwE](https://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2016?gclid=EAlaIqobChMlyuKPO8qi2AIVF74bChObnQD8EAAYASAAEgJrFPD_BwE) [14.09.2019].

36. *Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit*, Vendimi nr. A.nr.131/2012 për caktimin e koordinatorëve të KPK, Prishtinë, 20.07.2012. Link: [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.835.2012-\\_Vendim\\_.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.835.2012-_Vendim_.pdf) [16.09.2019].
37. *Zyra e Presidentit të RKS, Web Faqja Zyrtare*, Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit. Shih: <http://www.president-ks.gov.net/?page=1,132> [16.09.2019].

# Ndikimi i «Direktivës 2008/99/EC», për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal, në kornizën ligjore penale të Republikës së Kosovës



■Prof. Asc. Dr. Vilard BYTYQI  
Akademia e Kosovës për Siguri Publike,  
Fakulteti i Sigurisë Publike  
[vilard.bytyqi@rks-gov.net](mailto:vilard.bytyqi@rks-gov.net)

## Abstrakt

*Punimi ka qëllim kryesor evidentimin e ndikimit që ka Direktiva 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal në kornizën ligjore penale të Republikës së Kosovës. Punimi trajton mbrojtjen ligjore penale që gëzon mjedisi në Kosovë, si dhe në mënyrë të veçantë analizon legjislacionin penal primar dhe sekondar të mbrojtjes së mjedisit. Punimi promovon qasjen metodologjike analitike nga perspektiva e mbrojtjes ndërkombëtare, veçanërisht të së drejtës penale mjedisore të BE-së. Gjithashtu në punim janë analizuar një mori instrumentesh nacionale dhe ndërkombëtare, si dhe është shfletuar një numër i madh i raporteve, buletineve, punimeve hulumtuese dhe dokumenteve tjera të rëndësishme për këtë fushë. Nga rezultatet përfundimtare të punimit, mund të shohim se mbrojtja ligjore penale e mjedisit në Kosovë është e konceptuar dhe e shpërndarë në një mori aktesh ligjore. Krahasuar me të drejtën penale mjedisore që promovon BE-janë për mes *acquis communautaire*, shihet se Kosova ka përafuar në masë të madhe rregullat ligjore penale dhe ka ndërtuar mekanizma të rëndësishëm që mbrojnë mjedisin jetësor, megjithatë evidentohen mangësi të tjera të natyrës normative dhe organizative. Për shkak të kufizimeve të punimit nuk trajtohet çështja e efikasitetit të zbatimit të rregullave ligjore penale dhe administrative në mbrojtjen e mjedisit edhe pse këto aspekte vazhdojnë të mbeten një nga sfidat më domethënëse në Kosovë.*

## Fjalëkyçe:

**krimi mjedisor, mbrojtje ligjore penale, harmonizim i legjislacionit, *acquis communautaire*.**

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

# 1. Hyrje

## 1.1. Sfondi dhe korniza teorike

Përpjekjet e deritanishme për mbrojtjen e mjedisit vetëm me masa administrative është bërë i pamundur. Në vazhden e përpjekjeve për të mbrojtur mjedisin që dita ditës po degradohet edhe më shumë, ligji penal është duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në dëmet e shkaktuara mjedisore. Burimet ligjore të brendshme dhe ndërkombëtare janë duke dhënë një kontribut të çmueshëm në drejtim të ruajtjes dhe parandalimit të degradimit të mëtejshëm të mjedisit. Zhvillimi i rregullave penale të mbrojtjes së mjedisit jetësor i takojnë kohës së vonshme, kjo pasi fillimisht mbrojtja e mjedisit jetësor kryesisht është bërë me rregulla administrative, ndërsa me rritjen e pasojave të dëmshme, shumë herë edhe të pariparueshme ndaj mjedisit, nga shkak i zhvillimit të hovshëm industrial, është parë e pashmangshme që veprimet e dëmshme ndaj mjedisit të sanksionohen si vepra penale. Në këtë kontekst, edhe në Evropë rregullat ligjore penale të mbrojtjes së mjedisit kanë kaluar një zhvillimi i veçantë në 30 vitet e fundit. Në shumicën e vendeve, legjislacioni penal-mjedisor ka filluar si një shtojcë e ligjeve, kryesisht administrative. Pra, instrumentet relevante ligjore për mbrojtjen e mjedisit ishin të pakta, apo ato mungonin dhe se kjo gjendjeje e tillë nuk përkonte me realitetin e përditshëm ku po degradonte mjedisi.<sup>1</sup> Rregullat penale për mbrojtjen e mjedisit kryesisht janë paraparë në ligje të veçanta, gjë që vështirësoi edhe më shumë zbatimin praktik të këtyre rregullave përderisa të njëjtat nuk ishin përfshirë në ligjin themelor penal. Lidhur me këtë, në kongresin ndërkombëtar të së drejtës penale të

<sup>1</sup> Faure, M. (2017). The Development of Environmental Criminal Law in the EU and its Member States. *Review of European Community & International Environmental Law*, 26 (2) , f. 139.



mbajtur në vitin 1994, në rekomandimin 21 është paraparë që veprat penale kundër mjedisit, si vepra penale *sui generis* dhe nuk varen nga ligje të tjera për përmbajtjen e tyre, duhet të specifikohen në kodet penale kombëtare.<sup>2</sup>

Paralelisht me zhvillimin e rregullave të së drejtës mjedisore të brendshme, disa organizata të rëndësishme ndërkombëtare, sikurse është OKB, Këshilli i Evropës apo Bashkimi Evropian kanë nxjerrë një mori instrumente të rëndësishme që kanë rëndësi të madhe në zhvillimin e rregullave penale për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Me këto instrumente janë përcaktuar standardet për mbrojtjen e mjedisit jetësor, duke i obliguar secilin shtet anëtar të këtyre organizmave që këto standarde t'i zhvendosin në legjislacionet nacionale. Në kuadër të Këshillit të Evropës, në vitin 1998 është aprovuar konventa e posaçme për mbrojtjen penale juridike të mjedisit, ndërsa Bashkimi Evropian ka nxjerrë mbi dyqind akte juridike që në përmasa të gjera mbrojnë mjedisin jetësor, duke përfshirë mbrojtjen e ajrit dhe ujit, menaxhimin e mbeturinave dhe materialeve kimike, bioteknologjinë, mbrojtjen nga rrezatimi dhe rreziku bërthamor, si dhe mbrojtjen e natyrës.<sup>3</sup> Instrumenti më i rëndësishëm i Bashkimit Evropian për mbrojtjen penale të mjedisit është Direktiva 2008/99/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 19 nëntor 2008, për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal. Kjo direktivë përcakton masa në lidhje me ligjin penal në mënyrë që të mbrojë mjedisin në mënyrë më efektive.

Edhe Kosova përballet me sfidat e përgjithshme mjedisore në realitetin e saj të përditshëm. Sipas *Strategjisë së Kosovës për mjedisin 2013-2022* (2013) theksohet se gjendja faktike e mjedisit në Kosovë nuk është e kënaqshme, njëkohësisht edhe përmirësimi të saj nuk i kushtohet vëmendje e duhur. Sipas këtij dokumenti, mjedisi paraqet sfidën më të madhe që përballet shoqëria kosovare në synimin e përgjithshëm strategjik drejt integritimit evropian dhe implementimit të standardeve që duhet përmbushur në sektorin e mjedisit.<sup>4</sup> Lidhur me këtë, është më se e domosdoshme përgatitja dhe ndërmarrja e masave konkrete dhe efektive nëpërmjet ligjit penal për parandalimin dhe luftimin e dëmeve mjedisore në Kosovë, në përputhje me kriteret dhe standardet e përcaktuara nga Bashkimi Evropian. Detyrimet e Kosovës për t'i harmonizuar politikat e saja në fushëveprimin përkatës me BE-në, përfshirë edhe përafrimin e legjislacionit të saj mjedisor me *acquis*, burojnë nga kriteret e Kopenhagës për anëtarësim në Bashkimin Evropian, si dhe nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit<sup>5</sup> e nënshkruar në vitin 2015 ndërmjet BE-së dhe Kosovës.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet të dyja palëve ka synime të qarta që janë të shpërndara në shumë fusha, e të cilat kryesisht parashohin forcimin e shtetit të së drejtës, stabilitetin politik, ekonomik e institucional, me një strukturë të qëndrueshme politike, duke paraparë që BE-ja në mënyrë të vazhdueshme të kontribuojë në mbështetjen konkrete ekonomike dhe politike. Gjithashtu parashihet që Kosova të

<sup>2</sup> *Ibid.*, f. 140-141.

<sup>3</sup> Salihu, I. (2014). *E drejta penale - pjesa e posaçme*. Prishtinë: FAMA, f. 505.

<sup>4</sup> Strategjia e Kosovës për Mjedisin (2013-2022). Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) në bashkëpunim me SËECO, Suedi dhe EPTISA Internacional, Spanjë. Një projekt i financuar nga ASZHNS, Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar.

<sup>5</sup> Kosova dhe BE-ja nënshkruan Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit më 27 tetor 2015, në Strasburg. Kjo marrëveshje u miratua nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 30 tetor 2015 me miratimin e vendimit nr. 01/55 për miratimin e Projektligjit për ratifikim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe BE-së dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, dhe u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës më 2 nëntor 2015, me miratimin e Ligjit nr. 05/L-069 për ratifikim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe BE-së dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër.

përafrojnë legjislacionin e saj me *acquis*-in, duke bërë përpjekje të vazhdueshme për t'i promovuar vlerat e tregtisë së lirë, zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm, dhe të nxisë bashkëpunimin rajonal në këto fusha.<sup>6</sup> Në dispozitat vijuese të marrëveshjes parashihen detyrime të dyanshme në fushat konkrete të interesit, ku parashihen edhe politikat në fushën e mjedisit, përfshirë përafrimin e legjislacionit mjedisor. Sipas marrëveshjes parashihet që palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në fushën e mjedisit me detyrën shumë të rëndësishme të ndalimit të degradimit të mëtejshëm mjedisor dhe fillimin e përmirësimit të gjendjes mjedisore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë. Sipas kësaj dispozite, gjithashtu parashihet që palët do të krijojnë bashkëpunim me qëllim të fuqizimit të strukturave dhe procedurave administrative të Kosovës për të siguruar planifikimin strategjik të çështjeve mjedisore dhe koordinimit midis aktorëve relevantë dhe do të përqendrohet në përafrimin gradual të legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së.<sup>7</sup>

## 1.2. Objektivat e punimit

Punimi ka për objektiv vlerësimin dhe analizimin e ndikimit që ka Direktiva 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal në kornizën ligjore penale për mbrojtjen e mjedisit të Republikës së Kosovës. Për më tepër, punimi analizon zhvillimin e legjislacionit penal mjedisor në BE dhe në disa shtete anëtare. Në mënyrë të veçantë, analizohet zhvendosja e standardeve ligjore që parasheh direktiva e BE-së për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal, në legjislacionin penal të mjedisit në Kosovë, në këto fusha: vepra penale, përgjegjësia penale e personave juridik dhe sanksionet penale. Punimi do të kufizohet në trajtimin e standardeve ligjore që proklamoi Direktiva 2008/99/EC e BE-së për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal, si dhe masën e harmonizimit nominal apo normativ që ka arritur Kosova karshi standardeve që përmban ky instrument i rëndësishëm ndërkombëtar. Hulumtimi nuk do të zgjerohet në trajtimin e efektivitetit dhe rolit që ka kjo direktivë në praktikë dhe ky aspekt mbetet për tu vazhduar në fazat e mëtejshme.

## 1.3 Metodologjia

Punimi promovon qasjen metodologjike analitike që gërshetohet ndërmjet shfletimit të literaturës dhe rishikimit të kornizës ligjore. Literatura e shqyrtuar është përqendruar në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal në BE, në disa shtete anëtare dhe në Republikën e Kosovës. Më tutje, punimi shqyrton shembuj krahasues të mbrojtjes së mjedisit nëpërmjet ligjit penal në disa vende tjera, shtete këto që në njëfarë mase kanë ngjashmëri me Kosovën. Gjatë analizës së kornizës ligjore, një vështrim i detajuar i është kushtuar dispozitave ligjore të Direktivës 2008/99/EC e BE-së për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal dhe dispozitave ligjore të “Kodit penal të Kosovës”, si ligj bazë penal. Në përgjithësi janë analizuar edhe të gjitha aktet tjera pozitive me fuqi ligjore dhe nënligjore që influencojnë kryesisht çështjet penale të mbrojtjes së mjedisit në Kosovë.

<sup>6</sup>Ibid., neni 1.

<sup>7</sup>Ibid., neni 115.

## 2. Korniza ligjore penale e BE-së për mbrojtjen e mjedisit

### 2.1. Ideja e krijimit të kornizës ligjore për krimin mjedisor në BE

Ishin disa arsye themelore që quan institucionet e BE-së që të bëjnë përpjekje për ndërtimin e legjislacionit penal në kuadër të organizatës. E para, brendapërbrenda shteteve anëtare të BE-së ekzistonin divergjenca të mëdha lidhur me politikën penale ndaj mjedisit dhe se divergjencat e tilla ishte në kundërshtim me frymën dhe parimet e përgjithshme që proklamohen vet BE-ja për përafrim dhe harmonizim të legjislacionit. E dyta, legjislacioni i zbatueshëm i shteteve anëtare ishte tepër i butë dhe nuk garantonte efikasitet përball rrezikshmërisë shoqërore që paraqiste tanimë krimi mjedisor dhe se ishte e domosdoshme të ndërtohej një korpus rregullash penale që do të ishin të përshtatshme dhe efektive në gjeografinë evropiane.

Përpjekjet për krijimin e kuadrit ligjor penal brenda BE-së për krimin mjedisor ishte i hershëm dhe daton 10 vjet përpara miratimit të *Direktivës për krimin mjedisor* në vitin 2008. Fillimisht në janar 2003, Këshilli i BE-së prezantoi një vendim kornizë që rendiste një numër të veprave penale kundër mjedisit që u kërkohej shteteve anëtare t'i parashihnin në ligjet penale si vepra penale.

Komisioni, i mbështetur nga Parlamenti i BE-së, filloi ta sfidojë ligjshmërinë e "Vendimit kornizë" në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë. Në çështjen *Komisioni vs. Këshilli* (C-176/03), gjykata vlerësoi se Komuniteti ishte kompetent për t'i kërkuar shteteve anëtare të vendosin dënime penale për veprime kundër mjedisit sipas ish-nenit 175 Traktatit të Bashkimit Evropian (tani 192 Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian). Për shkak se kjo fuqi i ishte rezervuar Komunitetit, Këshilli nuk ishte kompetent të kalonte një instrument të tillë me të njëjtin efekt. Kështu që gjykata hodhi poshtë *Vendimin kornizë*, duke i hapur rrugën direktivës së sotme të krimi mjedisor.<sup>8</sup> Me nxjerrjen e këtij vendimi, u hap rruga e ndërtimit të rregullave ligjore të një direktive sikurse është kjo për mjedisin.

### 2.2. Standardet ligjore të Direktivës 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal

Direktiva 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal, e miratuar më 19 nëntor 2008, ishte direktiva e parë e BE-së që përmbante dispozita në lidhje me ligjin penal. Me këtë direktivë, BE-ja synonte të sigurojë harmonizimin minimal të sistemeve kombëtare të së drejtës penale që kanë të bëjnë me veprat penale kundër legjislacionit mjedisor brenda shteteve të BE-së.<sup>9</sup> Direktiva 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit numëron disa motive të bazuara të cilat kanë shtyrë aktorët vendimmarrës të ndërtojnë rregulla penale që kanë për qëllim sanksionimin e veprimeve dhe mosveprimeve karshi dëmeve që po i shkaktohen mjedisit jetësor. Nga shumë arsye që numërohen në këtë direktivë, fillimisht përmendet shqetësimi i rritjes së pasojave të veprimeve kundër mjedisit, me tejkalimin e kufijve nacionalë të këtyre dëmeve mjedisore; gjithashtu

<sup>8</sup> Keene, E. (2015). Compliance with the EU Environmental Crime Directive in the Countries of Southeast Europe and Moldova. Themis network.

<sup>9</sup> Handbook on the Implementation of EU Environmental Legislation. (2015-2016). Hulla & Co Human Dynamics, f. 51 dhe 181.

numërohet pamjaftueshmëria dhe joefikasiteti i normave administrative dhe civile për t'i bërë ballë këtyre dëmeve dhe, se duhet parë si i paalternativë ndërtimi i rregullave mbrojtës penalë, e rrjedhimisht sanksioneve penale.

Ky instrument kërkon nga shtetet që të inkriminohen veprimet apo mosveprimet e dëmshme ndaj mjedisit, duke e konsideruar këtë, veprim penal në të gjithë Komunitetin, qoftë ky, i përfunduar në mënyrë të qëllimshme, ose me pakujdesi të rëndë. Kjo ka për qëllim para së gjithash për të siguruar që rregullat për mbrojtjen e mjedisit të jenë plotësisht efektive ndaj veprimtarive të dëmshme, të cilat shkaktojnë ose ka të ngjarë të shkaktojnë dëme të konsiderueshme në ajër, – përfshirë stratosferën, – në tokë, në ujë, te kafshët ose te bimët; përfshirë këtu edhe ruajtjen e specieve.

Direktiva parasheh dhe përcakton masa minimale në drejtim të mbrojtjes së mjedisit nëpërmes rregullave penale. Shtetet nuk janë të kufizuara të ndërtojnë legjislacion penal më të ashpër dhe më gjithëpërfshirës në këtë drejtim dhe se në aspektet e rregullimit të brendshëm të çështjeve të caktuara ku ka direktivë të nxjerrë nga BE-ja, duhet të kihet parasysh vetëpërmbytja nga shkelja e detyrimeve të përgjithshme që kanë shtetet ndaj *acquis* dhe kolizionit eventual të rregullave juridike për situata konkrete.

Kjo direktivë përmban rregulla materiale penale të mbrojtjes së mjedisit dhe është e strukturuar në disa pjesë, ku përfshihet përcaktimi i llojeve të veprave penale, çështja e ndihmës, shtytjes dhe mbështetjes në kryerjen e këtyre veprave penale, sanksionet penale, përgjegjësia penale e personave juridik, si dhe sanksionet penale për personat juridik. Instrumenti parasheh procedurat dhe afatin kohor të zhvendosjes [ang. *trans-pose*] së këtij dokumenti nga shtetet anëtare të BE-së.

Sipas nenit 3 të direktivës përcaktohet një listë të veprave penale që duhet paraparë si vepra penale nga shtetet anëtare të BE-së që kryhen me dashje apo nga pakujdesia e rëndë. Këto vepra penale janë sikurse në vijim:<sup>10</sup>

- (a) kryerjen, emetimin ose futjen e një sasive të materialeve ose rrezatimit jonizues në ajër tokë ose ujë, që shkakton ose ka gjasë të shkaktojë dëmtime të rënda apo vdekje të ndonjë personi ose dëmtimin serioz të cilësisë së ajrit, cilësisë së tokës ose cilësisë së ujit, ose të kafshëve ose bimëve;

- (b) grumbullimin, transportin, rikthimin apo depozitimin e mbeturinave, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e veprimtarive të tilla dhe përkujdesjen e mëtejshme të vendeve të depozitimeve, duke përfshirë edhe veprimet e ndërmarra me marrëveshje si tregtar ose ndërmjetës (të menaxhimit të mbeturinave), i cili shkakton ose ka gjasë të shkaktojë vdekjen ose lëndimin e rëndë trupor të ndonjë personi ose të dëmtimit të konsiderueshëm të cilësisë së ajrit, cilësisë së tokës ose të cilësisë së ujit, ose kafshëve apo bimëve;

- (c) transportin e mbeturinave,<sup>11</sup> i cili është kryer në një transport të vetëm ose në disa të tillë, të lidhur me njëri-tjetrin.

- (d) veprimtarinë e një fabrike, në të cilën kryhet një aktivitet i rrezikshëm dhe në të cilën ruhen ose përdoren substanca të rrezikshme ose përgatitje, të cilat shkaktojnë ose kanë gjasë të shkaktojë lëndime serioze apo vdekje të ndonjë personi ose dëmtimin serioz të cilësisë së ajrit, cilësisë së tokës ose cilësisë së ujit, apo kafshëve e bimëve;

- (e) prodhimin, përpunimin, trajtimin, përdorimin, mbajtjen, magazinimin,

<sup>10</sup> Neni 3, Direktiva 2008/99/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal, dt. 19 nëntorit 2008.

<sup>11</sup> Kur kjo veprimtari hyn në fushën e nenit 2 (35) të Rregullores (KE) nr. 1013/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për transportin e mbeturinave

transportin, importin, eksportin ose asgjësimin e materialeve bërthamore ose substancave të tjera të rrezikshme radioaktive që shkaktojnë ose ka gjasë të shkaktojnë vdekjen ose lëndimin e rëndë trupor të ndonjë personi ose dëme të konsiderueshme të cilësisë së ajrit, cilësisë së tokës apo cilësisë së ujit, ose të kafshëve e bimëve;

- (f) vrasjen, shkatërrimin, posedimin ose marrjen e mostrave të specieve të mbrojtura të faunës së egër apo të florës, përveç rasteve kur ka të bëjë me një sasi të papërfillshme të ekzemplarëve të tillë, dhe kur ka një ndikim të papërfillshëm mbi ruajtjen e specieve;

- (g) tregtimin e ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të faunës së egër ose florës apo të pjesëve ose derivatet e saj, përveç rasteve kur ka të bëjë me një sasi të papërfillshme të mostrave të tilla dhe ka një ndikim të papërfillshëm mbi statusin dhe ruajtjen e specieve;

- (h) çdo sjellje e cila shkakton përkeqësim të ndjeshëm të një habitati në një zonë të mbrojtur;

- (i) prodhimin, importimin, eksportimin, hedhjen në një treg ose përdorimin e substancave që hollojnë shtresën e ozonit.

Në nenin 4 të direktivës është paraparë që shtetet të detyrohen që në legjislacionet e tyre të parashohin që ndihma, mbështetja dhe shtytja në drejtim të kryerjes apo moskryerjes së këtyre veprave penale, që parashihen me nenin 3, të sanksionohen si vepra penale.<sup>12</sup> Ndërsa në nenin 5, ky instrument parashihet që dënimet për këto vepra penale të jenë efektive, bindëse dhe në proporcion me pasojat shoqërore të këtyre veprave.<sup>13</sup> Përkundër përshkrimit të veprave që duhet inkriminuar, ky instrument nuk parashihet një kriter minimal që do të duhej t'i obligonte shtetet përderisa vendosin dënimet me burgim apo me gjobë për këto vepra. Përderisa direktiva nuk specifikon llojin ose shkallën e dënimit, në këtë mënyrë lloji dhe lartësia e dënimit mbetet në liri të shteteve, sipas gjykimit të ligjvënësit kombëtar.<sup>14</sup>

Lidhur me këto vepra, sipas nenit 5 të këtij instrumenti parashihet që shtetet duhet t'i ngarkojnë me përgjegjësi penale edhe personat juridik, vepra këto që kanë mundur të kryhen për përfitim individual apo grupor brenda për brenda personit juridik, e të cilat janë kryer me lejen apo dijeninë e personit që udhëheq apo kontrollon një person juridik të tillë. Ndërsa sipas nenit 6 parashihet që shtetet duhet të përcaktojnë qartë sanksione penale edhe për personat juridik që gjenden në shkelje të tilla.

Direktiva nuk përcakton masa në lidhje me pjesën procedurale të ligjit penal dhe as nuk kërkon në mënyrë specifike nga shtetet anëtare të caktojnë një autoritet kompetent të veçantë për ndjekjen dhe gjykimin e këtyre veprave penale, pasi supozon se në shumicën e shteteve anëtare procedurat e rregullta penale dhe autoritetet ligjzbatuese mund të sigurojnë zbatimin e direktivës. Sidoqoftë, disa shtete anëtare, siç është Suedia, kanë ndërtuar sisteme të veçanta brenda për brenda institucioneve të tanishme të ndjekjes dhe gjykimit për veprat e kundërligjshme mjedisore, sikurse janë prokurorët e mjedisit.<sup>15</sup>

<sup>12</sup> *Ibid.*, neni 4.

<sup>13</sup> *Ibid.*, neni 5.

<sup>14</sup> Perini, C. (2014). The Influence of Directive 2008/99/EC on the Harmonization and Renewal of the Lexicon of Environmental Criminal Law. F. Ruggieri, Criminal Proceedings, Languages and the European Union (f. 236). Berlin, Heidelberg: Springer, f. 148.

<sup>15</sup> Handbook on the Implementation of EU Environmental Legislation. (2015-2016). Hulla & Co Human Dynamics, f. 64.

### 3. Ndikimi i standardeve ligjore të “Direktivës 2008/99/EC” për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal në kornizën ligjore penale për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë

#### 3.1. Karakteristikat e kornizës ligjore të Kosovës për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit në Kosovë gëzon mbrojtje të zgjeruar ligjore dhe është e sanksionuar në një mori të akteve juridike të niveleve dhe natyrave të ndryshme, varësisht nga përmbajtja e tyre dhe e institucioneve që kanë nxjerrë të njëjtat. Në përgjithësi, rregullat ligjore që sanksionojnë veprat penale kundër mjedisit të parapara në kodin penal nuk janë të vetëzbatueshme dhe se për konsumimin e këtyre veprave duhet që subjekti paraprakisht të bie ndesh me rregullat ligjore që konkretisht rregullojnë sjelljen e subjektit ndaj mjedisit.

Për nga përmbajtja e rregullave ligjore, legjislacioni i Kosovës për mbrojtjen e mjedisit bazohet kryesisht në legjislacionin e BE-së për këtë fushë. Ndërsa për nga forma dhe organizimi i akteve që parashohin mbrojtjen e mjedisit dhe sanksionimin e shkeljeve të ligjeve mjedisore, reflektohet ndërthurje e karakteristikave të të dy modeleve të mbrojtjes së mjedisit në Evropë dhe SHBA, përkatësisht të filozofisë së sistemit ligjor civil (evropian-kontinental) dhe sistemit të *Common Law* (anglo-sakson). Pra, sipas këtyre karakteristikave që përmban sistemi ligjor për këtë fushë, nuk ka një ligj të vetëm apo kod të përgjithshëm për mbrojtjen e mjedisit, por ka një laramani ligjesh për mbrojtjen e mjedisit të nxjerra nga bartës të ndryshëm, që parashohin sanksione për shkeljet ligjore përkatëse dhe gjithashtu u referohet hetimeve penale dhe procedurave që mund të iniciohen nga autoriteti administrative, përkatësisht nga Inspektorati i Mjedisit.<sup>16</sup>

Nëse i referohemi veprave penale kundër mjedisit që ka paraparë “Kodi penal i Kosovës”, kryesisht këto vepra penale janë të karakterit *blanket*, ngase shumica e çështjeve që i referohen mbrojtjes së mjedisit në kuptimin më të gjerë janë të përcaktuara me dispozita përkatëse të ligjeve tjera, kështu që në rastet e caktuara mosrespektimi i tyre konsiderohet vepër penale.<sup>17</sup> Për t’i zhvilluar karakteristikat e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit që i theksuam, mjafton të përmendim se vetëm legjislacioni primar i mbrojtjes së mjedisit ndahet në 5 kategori ligjesh nga kjo fushë, përkatësisht në ligjet e mjedisit,<sup>18</sup> ligjet e ujërave, ligjet e planifikimit hapësinor<sup>19</sup>, ligjet e ndërtimit<sup>20</sup> dhe ligjet e banimit.<sup>21</sup> Përveç nxjerrjes së legjislacionit primar të mjedisit, ekzistojnë edhe një mori dispozitash tjera ligjore që janë të shpërndara në legjislacionin sekondar, përgjegjës për nxjerrjen e të cilave është niveli ekzekutiv, përkatësisht qeveria dhe ministrinë përgjegjëse.

Kjo larmi rregullash në fushën e mbrojtjes së mjedisit, qofshin ato rregulla penale apo administrative, kanë krijuar ambient konfuz në zbatimin korrekt të ligjit. Edhe

<sup>16</sup> Fajardo, T. (2015). The EU’s promotion of environmental protection in Kosovo. A Case Study on the Protection of the Environment through Criminal Law in Kosovo. A study compiled as part of the EFFACE project. Granada: University of Granada, f. 25.

<sup>17</sup> Salihu, I. *vepra e cit.*, f. 504.

<sup>18</sup> Tek kjo kategori e ligjeve hyjnë: Ligji për kimikate; Ligji për mbrojtjen e natyrës; Ligji për mbeturina; Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis; Ligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes; Ligji për mbrojtjen nga zhurma; Ligji për mbrojtjen e mjedisit; Ligji për produktet biocide; Ligji për vlerësimin strategjik mjedisor; Ligji për veprimtaritë hidrometeorologjike; Ligji për mbrojtje nga rezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare dhe Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

<sup>19</sup> Tek kjo kategori e ligjeve hyjnë: Ligji për planifikimin hapësinor dhe Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura

<sup>20</sup> Tek kjo kategori e ligjeve hyjnë: Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje; Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe Ligji për ndërtim

<sup>21</sup> Tek kjo kategori e ligjeve hyjnë: Ligji për ndërtesat e banimit n , bashkëpronësi, Ligji për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore dhe Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit

përkundër ekzistencës së shumë rregullave të zbatueshme, ende nevojitet plotësim i legjislacionit sekondar, në mënyrë që legjislacioni primar i mbrojtjes së mjedisit të jetë i zbatueshëm dhe efektiv. Kjo vlen edhe për plotësimin e kërkesave që dalin nga direktiva e BE-së për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale, në mënyrë që rregullat e këtij instrumenti të përvetësohen në kuadër të rendit të brendshëm juridik.

Një çështje tjetër problematike që mund të identifikohet në fushën e mbrojtjes së mjedisit, është edhe shpërndarja dhe mossaktësimi i kompetencave ndërmjet bartësve të nivelit administrativ dhe bartësve të procedurës penale. Deri më tani, ende nuk është vendosur kufiri i qartë ndërmjet shkeljeve administrative dhe shkeljeve penale në fushën e mjedisit. Mungesa e vendosjes së një pragu ndarës ndërmjet të dyja niveleve të zbatimit të ligjit, *inter alia* është në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike që do të duhej të gëzonte secili subjekt në një shtet të së drejtës, pasi kjo gjendjeje u jep një liri veprimi të gjerë zbatuesve të ligjit, e që mund të jetë objekt i arbitraritetit të vazhdueshëm përgjatë ushtrimeve të kompetencave dhe autorizimeve të tyre ligjore.

### 3.2. Masa e ndikimit të standardeve ligjore të “Direktivës 2008/99/EC” në kornizën ligjore të Kosovës për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal

Me kodin e parë penal të pasluftës, të emërtuar “Kodi i përkohshëm penal i Kosovës”<sup>22</sup>, për herë të parë në Kosovë janë paraparë një mori veprash penale kundër mjedisit të emërtuara “Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore” (kapitulli XXIV). Me nxjerrjen e “Kodit penal”<sup>23</sup>, në vitin 2012, është zgjeruar lista e veprave penale kundër mjedisit dhe është plotësuar cilësisht përmbajtja e vepra penale. Kodi penal<sup>24</sup> tani i zbatueshëm në Kosovë, është version i ngjashëm me kodin pararendës sa i përket trajtimit juridik të veprave penale kundër mjedisit dhe se në fushën e mbrojtjes së mjedisit nëpërmjet ligjit penal ka përsëritur standardet ligjore të proklamuar nga kodi penal i mëparshëm. Kapitulli XXVII i KPK-së i emërtuar “Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore”, përmban 18 lloje të veprave penale që janë të sistemuara sipas karakteristikave të veçanta, e që përveç karakteristikave mjedisore, janë të lidhura edhe me karakteristikat e kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore. Në vijim po e pasqyrojmë në formë tabelore emërtimet e këtyre veprave:

Tabela nr. 1: Kapitulli XXVII i KPK-së - Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore <sup>25</sup>	
Neni	Përshkrimi i veprës penale
Neni 338	Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit
Neni 339	Mbajtja e paligjshme e substancave dhe e mbeturinave të rrezikshme
Neni 340	Lejimi i kundërligjshëm i ndërtimit apo drejtimit të fabrikave dhe instalimeve që ndotin mjedisin
Neni 341	Dëmtimi i objekteve dhe pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit
Neni 342	Prodhimi, shitja dhe vënia në qarkullim e materieve të dëmshme për mjekimin e shtazëve
Neni 343	Dhënia e ndihmës veterinarë në mënyrë të pandërgjegjshme
Neni 344	Ushtrimi i kundërligjshëm i shërbimeve veterinarë
Neni 345	Moszbatimi i urdhrave për luftimin e sëmundjeve të shtazëve dhe të bimëve
Neni 346	Keqtrajtimi i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe e ujit të shtazëve
Neni 347	Shkatërrimi i botës bimore me materie të dëmshme
Neni 348	Shkretimi i pyjeve
Neni 349	Vjedhja e pyllit
Neni 350	Gjuetia e kundërligjshme
Neni 351	Shitja ose nxjerrja e trofeve të kafshëve të egra jashtë Republikës së Kosovës
Neni 352	Shitja ose nxjerrja e të mirave natyrore, bimëve ose kafshëve posaçërisht të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës
Neni 353	Peshkimi i kundërligjshëm
Neni 354	Dëmtimi, shkatërrimi dhe nxjerrja e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës
Neni 355	Punimet e paautorizuara dhe përvetësimi i monumenteve kulturore

Krahasuar, dispozitat e KPK-së i përgjigjen dispozitave të Direktivës 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal sikurse në vijim:

Tabela nr. 2: Përputhshmëria e neneve të Direktivës 2008/99/EC me nenet e KPK-së	
Nenet e Direktivës 2008/99/EC	Nenet e KPK-së
3 (a)	Neni 338
3 (b)	Neni 339
3 (c)	Neni 339
3 (d)	Neni 340
3 (e)	Neni 170
3 (f)	Neni 350
3 (g)	Neni 352
3 (h)	-
3 (i)	-

Nga aspekti i analizës nominale apo tekstuale të përputhshmërisë ndërmjet dispozitave të KPK-së ndaj Direktivës 2008/99/EC, vërejmë se Republika e Kosovës nuk ka përvetësuar në mënyrë identike dispozitat që përmban kjo direktivë. Shihet mirë se është përvetësuar teknika e zhvendosjes me riformulim të dispozitave të këtij instrumenti, ndërsa është përjashtuar teknika e zhvendosjes fjalë për fjalë, apo zhvendosjes me referencë.

Neni 338 (ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit) i KPK-së i përgjigjet në mënyrë të zgjeruar neni 3 (a) të direktivës. Dispozita<sup>27</sup> e KPK-së është më e zgjeruar se sa kërkesat që ka direktiva, gjithashtu në këtë dispozitë shprehimisht parashihet që konsumimi i kësaj vepre duhet të kalojë nëpërmjet shkeljes së ligjit të veçantë që është tipike për veprat penale blankete.

Neni 339 (mbajtja e paligjshme e substancave dhe e mbeturinave të rrezikshme) i KPK-së i përgjigjet në mënyrë të zgjeruar neni 3 (b) dhe (c) të direktivës. Dispozita<sup>28</sup> e KPK-së është me e zgjeruar se sa kërkesat që ka Direktiva, këtu përveç hedhjes, trajtimit, depozitimit, transportimit, eksportimit ose importimit të substanca të rrezikshme apo mbeturina përfshihen edhe substancat apo mbeturinat radioaktive. Sipas këtij neni, duhet të ndodhë shkelja e ligjit të veçantë nga subjekti si parakusht i konsumimit të kësaj vepre.

Neni 340 (lejimi i kundërligjshëm i ndërtimit apo drejtimit të fabrikave dhe instalimeve që ndotin mjedisin) i KPK-së i përgjigjet në mënyrë të zgjeruar neni 3 (d) të direktivës. Tek kjo dispozitë<sup>29</sup> e KPK-së ekziston zhvendosja me riformulim të zgjeruar e neni përkatës të direktivës. KPK shprehimisht parasheh që për t'u konsumuar kjo veper duhet që subjekti ta shkelë ligjin mbi mbrojtjen e mjedisit.

<sup>22</sup> Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës është nxjerr me Rregulloren e UNMIK nr. 2003/25 të miratuar PSSP më datë 6 korrik 2003, ndërsa ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004.

<sup>23</sup> Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 20 prill 2012, ndërsa është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 19, me dt. 13 korrik 2012.

<sup>24</sup> Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 23 nëntor 2018, ndërsa është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 2, me dt. 14 janar 2019.

<sup>25</sup> Kapitulli XXVII (veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore), Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës.

<sup>26</sup> Neni 3, Direktiva e BE-së 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal dhe neni 338, neni 339, neni 340, neni 170, neni 350 dhe neni 352, Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës.

<sup>27</sup> Neni 338, Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës.

<sup>28</sup> *Ibid.*, neni 339.

<sup>29</sup> *Ibid.*, neni 340.



Neni 170 (përvetësimi i paligjshëm, shfrytëzimi, transferimi dhe vendosja e materialeve nukleare) i KPK-së i përgjigjet në mënyrë të zgjeruar nenit 3 (e) të direktivës. Kjo dispozitë<sup>30</sup> e KPK-së nuk është e sistemuar tek grupi i veprave penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore (kapitulli XXVII), por gjendet tek grupi i veprave penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare (kapitulli XV). Për dallim nga kodi i mëparshëm, kodi penal i tanishëm ka zgjeruar fushën e inkriminimit dhe ka tejkaluar standardet që kërkohen me Direktivën 2088/99/EC. Kjo vepër si legjislacioni blanket parasheh një numër të instrumenteve ndërkombëtare që gjejnë zbatimin nëpërmes kodit penal, sikurse është *Konventa për mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore* të datës 3 mars 1980 me ndryshimet e datës 8 korrik 2005, si dhe *Konventa ndërkombëtare për shtytjen e veprave të terrorizmit bërthamor* të datës 13 prill 2005.

Neni 350 (gjuetia e kundërligjshme) i KPK-së i përgjigjet në mënyrë të pjesshme nenit 3 (f) të direktivës. Kjo dispozitë<sup>31</sup> e KPK-së parasheh vetëm inkriminimin e gjuetisë së kundërligjshme kundër kafshëve. Kjo dispozitë parasheh si vepër penale gjuetinë e ndaluar, pa leje ose autorizim përkatës sikurse e parasheh ligji. Mirëpo nuk inkriminon edhe shkatërrimin e specieve të mbrojtura të florës apo posedimin ose marrjen e mostrave të specieve të mbrojtura të faunës së egër apo të florës.

Neni 352 (shitja ose nxjerrja e të mirave natyrore, bimëve ose kafshëve posaçërisht të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës) i KPK-së i përgjigjet në mënyrë të pjesshme nenit 3 (g) të direktivës. Tek kjo dispozitë<sup>32</sup> e KPK-së ekziston zhvendosja me riformulim shumë të ngushtuar e nenit përkatës të direktivës, pasi kjo dispozitë mbulon vetëm shitjen ose nxjerrjen e trofeve të kafshëve të egra jashtë Kosovës, ndërsa nuk përfshin as florën krahas faunës së egër. Ndërsa direktiva parasheh të gjitha llojet e tregtisë, si dhe përfshin edhe tregtimin e ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të faunës së egër, ose florës, apo të pjesëve ose derivatet e saj, – që KPK nuk e rregullon këtë aspekt në mënyrë të zgjeruar sikurse e parasheh direktiva në fjalë.

Dispozitat e nenit 3 (h) dhe (i) të Direktivës 2008/99/EC nuk janë përfshirë në asnjë dispozitë të KPK-së. Ndërsa kapitulli XXIX i KPK-së përmban shumë vepra tjera të cilat nuk parashihen me Direktivën 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal, të cilat nuk janë vepra penale tipike që të kenë objekt mbrojtës mjedisin, pasi shumica e tyre objekt mbrojtës kanë kafshët, bimët dhe objektet kulturore.

Referuar standardeve që kërkohen me direktivën e BE-së lidhur me sanksionet penale ndaj subjekteve që kryejnë veprat penale kundër mjedisit, KPK ka paraparë dy lloje sanksionesh penale, përkatësisht dënimin me burgim dhe dënimin me gjobë. Mesatarja e maksimumit të përgjithshëm të dënimit me burgim për këto vepra penale është 3 deri 5 vite, ndërsa për veprat penale të veçanta maksimumi i dënimit mund të shkojë edhe 12 vite dënim me burg.<sup>33</sup> Ndërsa, për personat fizikë mund të shqiptohet gjithashtu edhe dënimi me gjobë. Ky lloj dënimi nuk vlen për të gjitha veprat, por tek disa vepra penale të caktuara, ku edhe parashihet mundësia e shqiptimit të dënimit me gjobë deri në 10 000 mijë euro.

Referuar nenit 5 të direktivës, kërkohet që të mbahen përgjegjës personat juridik

<sup>30</sup> *Ibid.*, neni 170.

<sup>31</sup> *Ibid.*, neni 350.

<sup>32</sup> *Ibid.*, neni 352.

<sup>33</sup> Shih: P.sh., tek neni 339, paragr. 5 i veprës penale "Mbajtja e paligjshme e substancave dhe e mbeturinave të rrezikshme parashihet dënim me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

për veprat penale kundër mjedisit. Sikurse kemi theksuar, ky instrument nuk përcakton specifikisht metodat e përvetësimit të udhëzimeve të saj dhe as nuk detajon të njëjtat, por në mënyrë parimore vendos standardet minimale që duhet respektuar. Në parime të përgjithshme instrumenti përmbledh disa detyrime që duhet paraparë në kuadër të rendit juridik nacional.

Legjislacioni penal i Kosovës parasheh përgjegjësinë penale të personave juridik dhe kjo çështjeje rregullohet me dispozitat e kodit penal dhe ligjit “Për përgjegjësinë e personave juridik për veprë penale”. Sipas nenit 37 të KPK, parashihet përgjegjësi penale edhe për personat juridik përderisa do të vërtetohet përgjegjësia penale për veprën penale të personit përgjegjës në kuadër të personit juridik.<sup>34</sup> Sipas nenit 112 të KPK parashihet që përgjegjësia penale e personit juridik, sanksionet penale të cilat mund të zbatohen ndaj personit juridik dhe dispozitat e posaçme që rregullojnë procedurën penale të zbatueshme ndaj personit juridik parashihen me kod ose me ligj të veçantë.<sup>35</sup> Referuar kësaj baze juridike, sipas ligjit për përgjegjësinë e personave juridikë për veprë penale parashihet që ndaj personave juridikë aplikohen dispozitat e KPK-së dhe të KPPK-së. Personat juridikë mund të përgjigjen për vepra penale nga pjesa e veçantë e KPK-së edhe për vepra tjera penale që parashihen me ligje te veçanta, nëse janë plotësuar kushtet për përgjegjësinë e personit juridik.<sup>36</sup> Sipas nenit 8, ligji parasheh që personit juridik për vepra penale mund t’i shqiptohen këto sanksione: dënimet, dënimet me kusht dhe masat e sigurisë, ndërsa llojet e dënimeve që mund të shqiptohen për vepra penale të personit juridik janë: dënimi me gjobë dhe pushimi i personit juridik.<sup>37</sup> Tek dënimi me gjobë, ligji parasheh dënime të përshkallëzuara, ku përcaktohet që minimumi i dënimit me gjobë nuk mund të jetë më i vogël se njëmijë (1 000) Euro dhe më i lartë se njëqindmijë (100 000) Euro.<sup>38</sup> Tek dënimi me kusht parashihet mosekzekutimi i dënimit për një periudhë një deri në dy vite, me kusht që gjatë periudhës së verifikimit personi juridik të mos kryejë veprë tjetër penale.<sup>39</sup> Lidhur me shqiptimin e masave të sigurisë, ligji parasheh që për vepra penale për të cilat janë përgjegjës personat juridik mund të caktohen këto masa të sigurisë: ndalimi i kryerjes së veprimtarive dhe punëve të caktuara; marrja e sendit; konfiskimi e dobisë pasuror dhe shpallja publikisht e aktgjykimit.<sup>40</sup>

## 4. Përfundime

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit nëpërmjet ligjit penal, “Kodi penal i Kosovës” ka marrë në konsideratë standardet ligjore të shpallura nga Direktiva 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal, ku kapitulli XXVII i KPK-së i emërtuar “Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore” përmban 18 lloje të veprave penale që janë të sistemuara sipas karakteristikave të veçanta, e që përveç karakteristikave mjedisore, janë të lidhura edhe karakteristikat e kafshëve, bimëve dhe

<sup>34</sup> Neni 37, KPK.

<sup>35</sup> *Ibid.*, neni 112.

<sup>36</sup> Neni 3, Ligji Nr. 04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për veprë penale. Ky ligj është miratuar më 21 gusht 2011, ndërsa është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 14 shtator 2011. Ligji ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013 dhe ka shfuqizuar Ligji për deliktet ekonomike (Teksti i spastuar) (“Gazeta Zyrtare e RSFJ” nr. 10/86).

<sup>37</sup> *Ibid.*, neni 8.

<sup>38</sup> *Ibid.*, neni 9, paragr. 1.

<sup>39</sup> *Ibid.*, neni 12.

<sup>40</sup> *Ibid.*, neni 13.

objekteve kulturore.

Nga analiza nominale apo tekstuale e përputhshmërisë ndërmjet dispozitave të KPK-së dhe standardeve që shtrohen nga Direktiva 2008/99/EC, vërejmë se gjatë hartimit të dispozitave të KPK-së është përvetësuar teknika e zhvendosjes me riformulim të dispozitave të këtij instrumenti dhe se nga analiza e përmbajtjes ndërmjet dispozitave të Direktivës 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal dhe atyre të KPK-së, mund të shohim se masa e nivelit të përputhshmërisë ndërmjet njëra-tjetrës ndryshon nga dispozita në dispozitë. Dispozitat e veçanta të KPK-së, sikurse është neni 338 (ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit), neni 339 (mbajtja e paligjshme e substancave dhe e mbeturinave të rrezikshme), neni 340 (lejimi i kundërligjshëm i ndërtimit apo drejtimit të fabrikave dhe instalimeve që ndotin mjedisin) dhe neni 170 (përvetësimi, pranimi, shfrytëzimi, prodhimi, posedimi, transferimi, ndryshimi, asgjësimi, shpërndarja ose dëmtimi i paautorizuar i materialeve nukleare apo radioaktive), i përgjigjen në mënyrë të zgjeruar standardeve që parashtrihen në Direktivën 2008/99/EC. Ndërsa neni 350 (gjuetia e kundërligjshme) dhe neni 352 (shitja ose nxjerrja e të mirave natyrore, bimëve ose kafshëve posaçërisht të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës) i KPK-së i përgjigjet në mënyrë të pjesshme standardeve që parashtrihen në Direktivën 2008/99/EC. Kurse dispozitat e nenit 3 (h) dhe (i) të Direktivës 2008/99/EC nuk janë përfshirë në asnjë dispozitë të KPK-së. Pavarësisht këtyre mungesave thelbësore, në kapitullin XXVII të KPK-së parashihen shumë vepra tjera të cilat nuk parashihen me Direktivën 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal. KPK ka inkriminuar plotësisht ndihmën, mbështetjen dhe shtytjen që kontribuojnë në kryerjen apo moskryerjen e veprave penale, sikurse parashihet me nenin 3 të direktivës. KPK në mënyrë autonome ka paraparë politikën ndëshkimore ndaj këtyre veprave penale, e që ndryshon nga vepra në vepër, e që në masë relative i përgjigjen standardeve nga ku kërkohen që dënimet për këto vepra penale të jenë efektive, bindëse dhe në proporcion me pasojat shoqërore të këtyre veprave. Megjithatë, mungesa e një standardi kërkues minimal i përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit që burojnë nga ky instrument për veprat penale kundër mjedisit, mund të shkaktoj konfuzion tek gjykimi i efektivitetit dhe proporcionalitetit të sanksioneve penale.

Në përputhje me standardet e Direktivës 2008/99/EC, legjislacioni penal i Kosovës parashihet përgjegjësinë penale të personave juridik dhe kjo çështjeje rregullohet me dispozitat e kodit penal dhe ligjit për përgjegjësinë e personave juridikë për vepër penale. Sipas nenit 37, KPK parashihet përgjegjësi penale edhe për personat juridikë, nëse do të vërtetohet përgjegjësia penale për veprën penale të personit përgjegjës, në kuadër të personit juridik. Personat juridikë mund të përgjigjen për vepra penale nga pjesa e veçantë e KPK-së, përfshirë veprat penale nga kapitulli XXVII (veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore), si dhe për vepra tjera penale që parashihen me ligje të veçanta, nëse janë plotësuar kushtet për përgjegjësinë e personit juridik. Ligji parashihet që personit juridik për vepra penale mund t'i shqiptohen këto sanksione: dënimet, dënimet me kusht dhe masat e sigurisë, ndërsa llojet e dënimeve që mund të shqiptohen për vepra penale të personit juridik janë: dënimi me gjobë dhe pushimi i personit juridik.

Mbrojtja e mjedisit në Kosovë gëzon mbrojtje të zgjeruar ligjore të karakterit administrativ dhe penal dhe është e sanksionuar në një mori të akteve juridike të niveleve dhe natyrave të ndryshme. Për nga përmbajtja e rregullave ligjore, legjislacioni i Kosovës për mbrojtjen e mjedisit bazohet kryesisht në legjislacionin e BE-së për këtë fushë, ndërsa sistemi ligjor është gërshetim i karakteristikave të filozofisë së sistemit ligjor civil (evropian-kontinental) dhe sistemit të *Common Law* (anglo-sakson), pasi veprat penale

kundër mjedisit që parashih KPK kryesisht janë vepra penale të karakterit blanket. Kjo larmi rregullash në fushën e mbrojtjes së mjedisit, qofshin ato rregulla penale apo administrative, ka krijuar ambient konfuz në zbatimin korrekt të ligjit. Edhe përkundër ekzistencës së shumë rregullave të zbatueshme, ende nevojitet plotësim i legjislacionit sekondar, në mënyrë që legjislacioni primar i mbrojtjes së mjedisit të jetë i zbatueshëm dhe efektiv. Kjo vlen edhe për plotësimin e kërkesave që dalin nga direktiva e BE-së për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet së drejtës penale, në mënyrë që rregullat e këtij instrumenti të përvetësohen në kuadër të rendit të brendshëm juridik.

Një çështje tjetër problematike që mund të identifikohet në fushën e mbrojtjes së mjedisit, është edhe shpërndarja dhe mossaktësimi i kompetencave ndërmjet bartësve të nivelit administrativ e bartësve të procedurës penale. Deri më tani, nuk është vendosur ende kufiri i qartë ndërmjet shkëlqeve administrative dhe shkëlqeve penale në fushën e mjedisit. Mungesa e vendosjes së një pragu ndarës ndërmjet të dy niveleve të zbatimit të ligjit, *interalia*, është në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike që do të duhej të gëzonte secili subjekt në një shtet të së drejtës, pasi kjo gjendjeje, zbatuesve të ligjit u jep një liri të gjerë veprimi, e që kjo mund të jetë objekt i arbitraritetit të vazhdueshëm përgjatë ushtrimeve të kompetencave dhe autorizimeve të tyre ligjore.

## Bibliografia

### LIBRA DHE ARTIKUJ SHKENCORË

1. Fajardo, T. (2015). *The EU's promotion of environmental protection in Kosovo. A Case Study on the Protection of the Environment through Criminal Law in Kosovo. A study compiled as part of the EFFACE project.* Granada: University of Granada.
2. Faure, M. (2017). The Development of Environmental Criminal Law in the EU and its Member States. *Review of European Community & International Environmental Law*, 26(2), 139-146.
3. Handbook on the Implementation of EU Environmental Legislation. (2015-2016). Hulla & Co Human Dynamics.
4. Keene, E. (2015). *Compliance with the EU Environmental Crime Directive in the Countries of Southeast Europe and Moldova.* Themis network.
5. Perini, C. (2014). The Influence of Directive 2008/99/EC on the Harmonization and Renewal of the Lexicon of Environmental Criminal Law. F. Ruggieri, *Criminal Proceedings, Languages and the European Union* (f. 236). Berlin, Heidelberg: Springer.
6. Salihu, I. (2014). *E drejtapes penale - pjesa e posaçme.* Prishtinë: FAMA.

### BURIME LIGJORE DHE BURIME TJERA

7. Direktiva 2008/99/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 19 nëntorit 2008 për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal.
8. Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës është nxjerr me Rregulloren e UNMIK nr. 2003/25 të miratuar PSSP më datë 6 korrik 2003, ndërsa ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004.
9. Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 20 prill 2012, ndërsa është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 19, me dt. 13 Korrik 2012.
10. Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 23 nëntor 2018, ndërsa është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 2, me dt. 14 janar 2019.
11. Ligji Nr. 04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale, i miratuar më 21 gusht 2011, ndërsa është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 14 shtator 2011. Ligji ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013 dhe ka shfuqizuar Ligjin për deliktet ekonomike (Teksti i spastruar) ("Gazeta Zyrtare e RSFJ" nr. 10/86).
12. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, nënshkruar më 27 tetor 2015 ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës, në Strasburg. Marrëveshja u miratua nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 30 tetor 2015 me miratimin e vendimit nr. 01/55 për miratimin e Projektligjit për ratifikim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe BE-së dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, dhe u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës më 2 nëntor 2015, me miratimin e Ligjit nr. 05/L-069 për ratifikim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe BE-së dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër.
13. Strategjia e Kosovës për Mjedisin (2013-2022). Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) në bashkëpunim me SWECCO, Suedi dhe EPTISA Internacional, Spanjë. Një projekt i financuar nga ASZHNS, Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

259

# Krimi mjedisor dhe roli i informacionit e sensibilizimit publik, në Shqipëri



■ **Prof. Dr. Luljeta BUZA**  
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës,  
Fakulteti i Drejtësisë  
luljetabuza@yahoo.com



■ **Dr. Briseida MEMA**  
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës,  
Fakulteti i Drejtësisë  
briseida.mema@afp.com

## Abstrakt

*Ky punim tenton të trajtojë krimin mjedisor, rolin e drejtësisë dhe informacionin nëpërmjet bazës historike ligjore mjedisore të problemeve shqiptare në raport me realizimin e standardeve të BE-së, OKB-së të cilat janë të përfaqësuara me mjedisin, kulturën dhe mentalitetin shqiptar. Konceptet "krim mjedisor", "organe shtetërore përgjegjëse", përdorur në punim janë konceptuar sipas përkufizimit të dhënë në "Konventën e Aarhusit".<sup>1</sup> Diskutime të shumta në shkallë të gjerë janë organizuar për ndotjen e lumenjve dhe deteve, për florën dhe faunën, por ne këtu do të analizojmë krimin mjedisor nga një këndvështrim më i veçantë. Ky punim ofron një tërësi vlerësimesh cilësore dhe sasiore për çështjet e poshtëshënuara: 1) ofron një panoramë të detajuar rreth zhvillimeve në fushën e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit dhe analizën e krimit mjedisor; 2) analizon nenet e kodit penal nga 201-207 për krimet mjedisore, dhe 3) thekson rolin e rëndësishëm parandalues të informacionit mjedisor dhe sensibilizimit publik në Shqipëri. Gjetjet tregojnë se legjislacioni është bërë më i ashpër ndaj krimeve mjedisore por rezultatet nuk janë aq pozitive. Çfarë nuk shkon? Si e perceptojnë studentët informacionin dhe sensibilizimin publik për krimin mjedisor? Është informacioni mjedisor i qartë dhe i vërtetë? Si përfundim kërkojmë t'i adresohemi dhe të tërheqim vëmendjen se ekziston një lidhje e ngushtë midis drejtësisë dhe informacionit mjedisor. Konkluzionet janë të bazuara në të dhënat e gjykatave të shkallës parë, raportet e prokurorisë dhe analizat e pyetësorëve sipas parimit të ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanësisë.*

## Fjalëkyçe:

**e drejtë, informacion, krim mjedisor, ligj, zhvillim i qëndrueshëm.**

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

## 1. Hyrje

Problemet mjedisore janë probleme shumëdisiplinore që kërkojnë një përkushtim të veçantë dhe hulumtim profesional. Ardhja e mijëvjeçarit të ri na ofron ne të gjithëve, një mundësi për reflektim mbi arritjet dhe dështimet e njerëzimit gjatë mijëvjeçarëve të shkuar dhe parashtron sfidat me të cilat do të përballemi në epokën e re të historisë së njerëzimit që është bërë edhe me e ndërvarur. Ndërkohë, në një perspektivë të tillë afatgjatë, shumë nga shqetësimet tona të tanishme mund të duken të parëndësishme por synimi për një zhvillim të qëndrueshëm, të barabartë dhe të shëndoshë nga ana mjedisore merr një rëndësi edhe më të madhe, pasi ai ka të bëjë pikërisht me mbijetesën e jetës në tokë.<sup>2</sup>

*Mjedisi* siguron zhvillim të qëndrueshëm për shëndetin, sigurinë ushqimore dhe ekonominë tonë ndërsa *ekosistemet* sigurojnë furnizimet me ujë dhe sigurinë fizike edhe atë mendore. *Burimet natyrore* janë burime të mirëqenies, punësimit dhe shërbejnë për të ardhurat për arsimin dhe shëndetësinë, zhvillimin dhe modelet e biznesit të qëndrueshëm, të cilat janë të pranuar ndërkombëtarisht dhe të njohura në rang botëror si shtatëmbëdhjetë zhvillime të qëndrueshme.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> The United Nations Economic Commission for Europe (UNECE) Convention on Access to information, Public Participation in Decision – Making and Access to Justice was adopted on 25 June 1998 in the Danish city of Aarhus at the Fourth Ministerial Conference as part of the “Environment for Europe” process.

<sup>2</sup> Fjalimi i përshëndetjes nga Koffi Anan (Sekretar i Përgjithshëm I OKB-së) në Konventën e Aarhusit (Danimarkë, 25 qershor, 1998).

<sup>3</sup> <https://wedocs.unep.org/>. The rise of Environmental Crime: A growing threat to Natural Resources Peace, Development and Security. 2016.

<sup>3</sup> <https://www.transparency.org/Report>. Published on 23 April 2012.

Mjedisi si baza e zhvillimit të qëndrueshëm për paqen dhe sigurinë gjithmonë është në rrezik për shkak të përhapjes dhe shtrirjes të krimit mjedisor. Këtu nuk përfshihet vetëm mbrojtja për rrezikun ndaj florës dhe faunës, por i gjithë ekosistemi dhe strategjitë e zhvillimit mbarë botërorë.

Sipas parashikimeve dhe studimeve popullosia do të rritet në nëntë miliardë banorë në vitin 2050 dhe natyrisht përkufizimi i zhvillimit të qëndrueshëm duhet të shikohet si një çështje e rëndësishme tepër e veçantë sigurie për popujt dhe planetin tonë. Faktikisht, meqenëse mjedisi është një nga fushat për të cilat politika dhe shoqëria janë ndërgjegjësuar relativisht vonë, madje këtu mund të thuhet, se pakësimi i burimeve natyrore ka shërbyer edhe si katalizator në rolin direkt për sensibilizimin global në raport me këto probleme.

Me të drejtë këtu mund të shtrojmë pyetjen: *Çfarë kuptojmë me krimin mjedisor? Cilat janë krimet mjedisore? Cili është roli që luan informacioni mjedisor dhe sensibilizimi publik?*

Krimi mjedisor sipas disa përkufizimeve përfshin të gjitha aktivitetet ilegale, veprimtaritë që ndikojnë në hollimin e shtresës së ozonit, transportet e paligjshme të mbetjeve toksike si dhe peshkimin e paraportuar ndërkufitar i cili siguron përfitime të mëdha.<sup>4</sup>

Sipas kodit tonë penal krimi mjedisor përkufizohet si shkelje e kuadrit ligjor mjedisor pra si veprime të ndaluara nga ligji aktual. Ekzistojnë mendime dhe përkufizime të ndryshme sipas të cilave ky përkufizim duhet të shtrihet edhe në veprimtaritë e tjera të cilat ligji i klasifikon si të paligjshme, por jo kriminale dhe sugjerohet edhe përfshirjen e sanksioneve administrative<sup>5</sup>.

Gjithashtu, këtu duhen përfshirë edhe shkeljet që ndikojnë në ndryshimet klimatike të cilat janë klasifikuar si krime mjedisore dhe kanë një ndikim mbarë botëror në mjedisi. Krimet mjedisore nuk janë kufizuar vetëm në botën e egër dhe speciet në zhdukje por ato janë zgjeruar edhe në rrjetet e krimit të organizuar mjedisor. Ato përfshijnë edhe krimet në sektorin e pyjeve, në shfrytëzimin e paligjshëm të burimeve natyrore, shitjen e mineraleve, peshkimin e paligjshëm, trafikimin e mbetjeve të rrezikshme (kimikatet), kërcënimin financiar dhe gjenerimin e gjithë pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme nga burimet natyrore të cilat mbështesin financiarisht grupet e armatosura dhe terrorizmin.<sup>6</sup>

“Një problem që duhet të trajtohet me shumë kujdes dhe vëmendje në të ardhmen është se grupet e organizuara tradicionale që kanë qenë të përfshira në aktivitete ilegale si në trafikimin e qenieve njerëzore, drogave dhe armëve kanë filluar të përfshijnë aktivitetet e tyre edhe në veprimtaritë kriminale mjedisore. Ekzistojnë të dhëna se grupet terroriste janë të përfshira në krimet ndërkufitare me qëllim që të gjenerojnë fondet e tyre në aktivitetet e tjera kriminale” (Elliott, 2011)<sup>7</sup>.

Kështu, njohja e problemeve, bashkëpunimet kombëtare dhe ndërkombëtare ndihmojnë jo vetëm në përcaktimin dhe përkufizimin e kundërvajtjeve penale të reja si krime mjedisore, por ato kanë luajtur një rol të padiskutueshëm edhe në ato aktivitete të

<sup>4</sup> Eileen Skinnider -Victims of Environmental Crime-Mapping the issues. Director of Human Rights and Research, International Centre for Criminal Law Reform and Criminal Justice Policy. March 2011. Pg 16.

<sup>5</sup> <https://wedocs.unep.org/>. The rise of Environmental Crime: A growing threat to Natural Resources Peace, Development and Security. 2016.

<sup>6</sup> Elliott, L., 2011. Transnational Environmental Crime: Applying network theory to an investigation of illegal trade, criminal activity and law enforcement responses. Transnational Environmental Crime Project. Working paper 1/ 2011. [http://ips.cap.anu.edu.au/ir/tec/publications/TEC\\_Working\\_Paper\\_1\\_2011.pdf](http://ips.cap.anu.edu.au/ir/tec/publications/TEC_Working_Paper_1_2011.pdf).

<sup>7</sup> Konventa e Aarhus “Për të drejtën për informacion, pjesëmarrjen publike në vendimmarrje dhe aksesin në Drejtësi për çështje mjedisore” u mbajt qytetin Danez, Aarhus, më 25 qershor 1998.

përbashkëta që kanë pasur si objektiv parandalimin, mbrojtjen mjedisore dhe ndëshkimin e krimeve mjedisore. Për të arritur rezultate pozitive në objektivat e zhvillimit mendojmë se duhet të vlerësohen efektet e ndërhyrjeve në menaxhimin mjedisor duke pasur si udhërrëfytes të rëndësishëm legjislacionin dhe zbatimin rigoroz të tij.

### **1.1. Metodologjia dhe proceset e përdorura në përgatitjen e punimit**

Megjithëse punimi është në fushën e krimit mjedisor ai njëkohësisht analizon edhe çështjet që kanë të bëjnë me politikën dhe demokracinë duke u bazuar jo vetëm në tendencat e zhvillimit, por edhe në praktikat më të mira të zbatimit të standardeve ndërkombëtare si p.sh, “Kodin penal të Republikës të Shqipërisë”, “Konventën e Aarhusit”<sup>8</sup>, direktivat e OKB-së dhe BE-së për mjedisin si udhërrëfytes dhe kontribuues të mbrojtjes mjedisore. Mendimi aktual i shoqërisë është parë gjatë procesit të informimit të tij dhe të politikave mjedisore për t’i përafuar ato me ligjet evropiane dhe konventat ndërkombëtare. Punimi mbështetet në:

- 1) analizën për të gjetur ndikimin e veçantë të krimit mjedisor në grupet e ndryshme të interesit dhe në sfidat e tjera gjatë zhvillimit të qëndrueshëm;
- 2) veprat penale të kryera gjatë vitit 2018 duke i krahasuar me të dhënat e vitin 2017;
- 3) analizën e nivelit arsimor të personave që kanë kryer vepra penale në mjedis;
- 4) kapërcimin e hendekut midis dëshirave për cilësinë e jetës dhe detyrave që duhet të realizojnë në respekt të ligjeve mjedisore.

5) shkallën e njohurive të studentëve për problemet mjedisore dhe krimin mjedisor.

Në punim vihen në dukje gjithashtu, vlerësimet e prioriteteve të çështjeve më të rëndësishme të integritetit mjedisor në fushën ekonomike, legjislative dhe atë të integritetit social. Metodologjia e ndjekur përfshin gjithashtu një paketë të detajuar të informacionit si dhe analizën e 100 pyetësorëve për të matur shkallën e ndikimit dhe ndërgjegjësimin e studentëve në lidhje me çështjet mjedisore në përgjithësi dhe me krimin mjedisor në veçanti. Mbledhja e të dhënave është kryer nëpërmjet: 1) intervistës dhe 2) sondazhit e realizuar me dy kategori studentësh, a. me studentë të fakultetit juridik si zbatues të ardhshëm të ligjit, dhe b. studentë të shkencave politike si nëpunës civil të ardhshëm të komunikimit dhe administratës publike. Një pjesë e konsiderueshme e të dhënave janë marrë nga pyetësorët e fakultetit të drejtësisë të Universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës. Dy tipa të dhënash u mblodhën dhe u përpunuan dhe procesi i shqyrtimit të dhënave të nxjerra u bazua në disa çështje tematike duke përdorur metodën e analizës të parë në këndvështrimin e informacionit mjedisor dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje.

## **2. Kodi penal dhe krimi mjedisor gjatë viteve 2017-2018**

Aktualisht, në shumicën e rasteve, shkelësit e ligjit mjedisor ndëshkohen me gjoja të cilat janë shumë të ulëta, por natyrisht këto shkelje janë serioze dhe madje të rrezikshme. Ndryshimi i kodit penal dhe përfshirja e tyre në kreun e IV të “Kodit penal të Republikës së Shqipërisë” nga neni 201 deri në nenin 207 tregon se krimet mjedisore po marrin

<sup>8</sup> Kodi penal i përditësuar, prill 2016, kreu IV, nenet 201-207, f. 129.




vëmendjen e duhur. Ky kapitull rregullon dhe standardizon veprat penale në fushën e mjedisit si “ndotjen e ajrit”, transportin e mbeturinave toksike”, “ndotjen e ujërave, peshkimin e ndaluar”, “prerjen e paligjshme të pyjeve”, “prerjen e drurëve dekorativë dhe frutorë”, “shkatërrimin me zjarr të pyjeve dhe mjedisit pyjor”, “shkatërrimin nga pakujdesia me zjarr të pyjeve dhe të mjedisit pyjor”, si dhe në fund “shkeljen e karantinës së bimëve dhe kafshëve”.<sup>9</sup>

Tipari dallues i krimeve mjedisore në vendin tonë është ndikimi i tij në natyrë; si rritja e nivelit të ndotjes degradimi i botës së egër, reduktimi i biodiversitetit prishja e balancës ekologjike etj. Krimi mjedisor shkakton viktima si në përhapjen e sëmundjeve, në ndotjen ushqimore por edhe në vdekjen e qenieve njerëzore. Referimi i statistikave të shëndetit publik paraqet një situatë të zymtë ku mbi 60 persona vdesin në Tiranë nga mushkëritë për shkak të grimcave të ndotura të ajrit.

Veprat e kryera penale gjatë vitit 2018 krahasuar me numrin total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi ka qenë 0.79%, ndërkohë që për vitin 2017 është 0.69% koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2018 ka qenë 8.60%, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 7.5%.<sup>10</sup>

Por po të vëzhgojmë me kujdes gjendjen mjedisore rezulton se ka shumë vepra penale që nuk janë finalizuar në gjykata dhe nuk janë dërguar për rekurs në Gjykatën e Lartë ose në atë Kushtetuese (shkak reforma në drejtësi që ka çuar në mosfunksionimin e këtyre institucioneve). Vepra penale, sipas raporteve neni 201 (*ndotja e ajrit*) zë 25.10% në krahasim me vitin 2017 që ishte 9.3%. Neni 202 (*Transportimi i mbeturinave toksike*) nuk ka asnjë vepër penale të regjistruar kur ne jemi dëshmitar të ndotjeve të lumenjve me ndotje të spitalore etj. Neni 203, (*Ndotja e ujërave*) janë vetëm 5 raste, Neni 204 (*Peshkim i ndaluar*) vetëm me 8 raste të regjistruara, dhe pesë të dërguara në gjykatë. Neni 205 (*Prerja e paligjshme e pyjeve*) ka 105 denoncime dhe vetëm 20 të regjistruara në gjykatë. Neni 206 (*Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë*) ka 20 raste të regjistruara dhe katër raste të gjykuara në gjykatë. Neni 206/a (*Shkatërrimi me zjarr i pyjeve*) 45 raste dhe asnjë i dërguar në gjykatë. Neni 206/b (*Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve*) 13 raste dhe vetëm dy janë regjistruar në gjykatë. Neni 207 (*Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve*) nuk ka asnjë krim të regjistruar dhe natyrisht asnjë të dërguar në gjykatë<sup>11</sup>.

II. Tabela 1 Denoncimet mjedisore sipas neneve



<sup>9</sup> Raport. Prokuroria e Përgjithshme: Raport i prokurorit të përgjithshëm mbi gjëndjen e kriminalitetit për vitin 2018.


<sup>10</sup> Po aty.

<sup>11</sup> Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011“Për mbrojtjen e mjedisit”, e sheh garantimin e të drejtës për informim për çështjet e mjedisit si një e drejtë e përgjithshme e mbrojtur nga ligji Nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën për informim për dokumentet zyrtare”.

Sikurse vihet re edhe nga grafiku, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një rritje prej 14.35% të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit në krahasim me vitin 2017 dhe një rritje prej 73.33% të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Vihet re një nivel i ulët i denoncimeve dhe natyrisht, një nga arsyt kryesore mendojmë se është: a) mungesa e informacionit dhe b) ndërgjegjësimi i një shkalle të ulët të publikut.

Në realitet, në këto vepra penale, vihet re një rritje e numrit të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2017 prej 54.64%, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë është 82% dhe rritja e numrit të pandehurve të dënuar nga gjykata është me rreth 2.3 herë përkundrejt vitit 2017.

**II. Grafiku 2. Numri i të pandehurve ne vitet 2017-2018**




Përsëri shifrat paraqesin një numër të vogël të pandehurish në krahasim me rritjen e krimit mjedisor. Shkelësit e ligjit zotërojnë të ardhura të fuqishme dhe për pasojë e thyejnë ligjin pa problem dhe korruptojnë jo vetëm administratën lokale dhe shtetërore por edhe vetë shoqërinë shqiptare. Faktet kanë evidentuar se vendi ynë është në fillimet e një grupi të strukturuar kriminal ndaj pasurive mjedisore si p.sh. prerja e pyjeve, nxjerrja ilegale e mineraleve, (rasti i Bulqizës, etj.), nxjerrja pa kriter e gurëve dekorativë të Beratit dhe e gurëve gëlqerorë, nxjerrja e paligjshme e inerteve dhe shfrytëzimi pa kriter i shtretërve të lumenjve etj., ndërhyrja me ndërtime të paligjshme në zonat e mbrojtura dhe turistike p.sh. dhënia e lejeve pa kriter për ndërtimin e HEC-ve, p.sh. rastet e lumenjve të Vjosës dhe Valbonës.

Sipas të dhënave të paraqitura në grafikun e poshtë shënuar numri i padive në gjykatë është i një niveli shumë të ulët në një kohë kur numri i krimeve mjedisore sidomos në zonat rurale është në rritje. Ky qëndrim nxjerr në pah jo vetëm rolin e dobët të organeve shtetërore dhe lokale, por evidenton edhe një nivel tepër të ulët të ndërgjegjësimit publik të shoqërisë shqiptare në përgjithësi.

Në bazë të statistikave të gjithë të pandehurit janë meshkuj ku 56.25% janë me arsim 8-9 vjeçar, nga të cilët 38.39% janë me arsim të mesëm dhe 5.36% janë me arsim të lartë. Sipas grafikut, rezulton se në vitin 2018 është rritur numri i krimeve në krahasim me vitin 2017, por vihet re një ulje në përqindje e numrit të pandehurve me arsim të lartë dhe një rritje e numrit të atyre me arsim të ulët 8-9 vjeçar dhe të mesëm. Vendbanimet e këtyre të pandehurve rezultojnë se 36.36% e tyre e kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 63.64% prej tyre në fshat. Shkelësit e veprimtarive kriminale mund të

grupohen në pesë kategori tipologjie: individë, grupe, qeveritare, biznese, dhe korporata të përkrahura nga shteti. Por, vëmë re se në raportin e prokurorisë nuk ka klasifikime të tilla të kësaj natyre, pa dyshim, kjo lë shteg për abuzime shtetërore/lokale dhe administrative.

## II. Grafiku 3 Të dhënat sipas arsimit të pandehurve që kanë kryer shkelje mjedisore



Qytetet më problematike për krimet mjedisore janë Elbasani, Berati, Durrësi Lezha, Vlora, Tirana. Treguesit shprehin qartë mentalitetin e tyre; mjedisi i përbashkët nuk është problemi im dhe niveli arsimor konsiderohen se janë faktorë të papërgjegjshmërisë së tyre ndaj mjedisit. Prandaj, nevoja për një fushatë sensibilizuese për ligjet mjedisore dhe ndërgjegjësimin publik duhet të jetë e qartë dhe e kuptueshme nga publiku për arsye të nivelit të ulët arsimor të pandehurve.

Gjithashtu shkalla e ndërgjegjësimit dhe njohja e ligjit për problemet mjedisore nga shkelësit e tij është në nivele tepër të ulëta. Faktet tregojnë gjithashtu, se vetëm krimet e bujshme si p.sh. vrasjet në familje, larjet e hesapeve midis bandave, vrasjet për pronën pasqyrohen gjerësisht në media duke lënë disi në hije pasqyrimin e veprave kriminale në mjedis. Dobësitë e institucioneve përkatëse dhe të shoqërisë civile vërehen kryesisht në:

1) mosnjohjen sa duhet të ligjit; 2) në mungesën e dhënies së informacionit dhe 3) në ndërgjegjësimin e shoqërisë.

Meqenëse çdo individ e ka të trashëguar me ligj të drejtën për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm dhe të sigurt, parandalimi i kundërvajtjeve dhe krimeve mjedisore duhet të trajtohen si probleme kyçe jo vetëm në analizat e përshkrimit të krimit, por së pari në ndërtimin e strategjive të parandalimit të tij.

Forcimi i sundimit të ligjit në të gjitha nivelet, vendosja e sanksione, bashkëpunimi për një zhvillimin të qëndrueshëm, mbështetja me teknologji, ndërtimi i kapaciteteve konsiderohen një mbështetje e fortë në luftën kundër krimit mjedisor.

### 3. E drejta për informacion mjet parandalues për krimet mjedisore

E gjithë shoqëria shqiptare duhet të informohet për të gjitha llojet e krimeve sepse vihet në pikëpyetje jo vetëm zhvillimi i qëndrueshëm por vetë ekzistenca e jetës.

Problemet e mjedisit tashmë janë një problem jo vetëm kombëtar, por edhe ndërkombëtar, për arsye se mjedisi nuk ka kufi. Me gjithë diskutimet e shumta dhe aktivitetet e ndryshme për këto probleme, çështjet janë akoma të paqarta dhe deri diku publiku është i painformuar se çfarë ndodh pranë tij. Punimi është një përpjekje që synon të analizojë dhe krahasojë legjislacionin duke e parë në kuadrin e zhvillimit të demokracisë dhe duke e konsideruar të drejtën mjedisore për t'u informuar, të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrje si një detyrim ligjor i së drejtës themelore.

Detyrimet e lartpërmendura dhe ato që dalin nga "Konventa e Aarhusit", konsiderohen edhe si një barometër për të matur funksionimin e elementeve bazë të demokracisë. Zbatimet praktike të legjislacionit për mbrojtjen mjedisore dhe e drejta e publikut për t'u informuar janë elementë të rëndësishëm balancues të aktorëve kryesorë që veprojnë në këtë fushë dhe padyshim luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin e krimeve mjedisore. Ato, njëherazi janë edhe amortizues të trysnive të vazhdueshme që ushtrojnë bizneset, investimet dhe grupet e interesit mbi mjedisin; duke mundësuar kështu zbatimet praktike të kërkesave të legjislacionit shqiptar dhe parimet që shtrun parimi i zhvillimit të qëndrueshëm. Marrja e shpejtë e informacionit mjedisor për të parandaluar dëmet dhe krimet mjedisore me legjislacion jo vetëm për brezat e tanishëm, por edhe për ata që do të vinë është një masë shumë e rëndësishme për parandalimin dhe mbrojtjen e mjedisit. Kjo pasqyrohet edhe në nenin 56 të "Kushtetutës së Republikës", që mbron të drejtën e çdo personi për informim për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij. Natyrisht, mbrojtja vjen më e plotë kur i referohet legjislacionit shqiptar."<sup>12</sup>

Legjislacioni shqiptar e konsideron median si subjekt i lirisë së informimit. Ky pozicion i medias është theksuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila në një vendim të sajën thekson se: Pozicioni "*i privilegjuar*" i medias në shtetin demokratik garantohej për shkak se është pikërisht ajo që e bën pushtetin shtetëror më të prekshëm për njerëzit, më të kontrollueshëm dhe më transparent. Media është gjithashtu një bazë e rëndësishme për të kontrolluar dhe gjykuar se si funksionarët e veshur me pushtet e ushtrojnë autoritetin publik dhe si ato i menaxhojnë fondet publike.<sup>13</sup>

Informacioni mjedisor është i rëndësishëm për të vlerësuar edhe indeksin e aktivitetit njerëzor në mjedis dhe ndihmon gjithashtu, në menaxhimin e burime natyrore dhe të atyre të krijuara nga dora e njeriut në mënyrë të qëndrueshme. Prandaj parandalimi i degradimit mjedisor mund të realizohet vetëm nëpërmjet vendimeve të sakta, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Ky rol është i rëndësishëm për të plotësuar edhe një detyrim të parashtruar në nenin 3, që u ngarkon palëve "për të ndërmarrë masat legjislative dhe masa të tjera që do të siguronin tre objektivat e kësaj konvente pa u diskriminuar, nëpërmjet edukimit mjedisor të publikut dhe mbështetjes së shoqatave" (Konventa e Aarhus-it 1998).

### 3.1 Roli i "Konventës së Aarhusit" dhe media

I gjithë studimi karakterizohet nga fryma e një shoqërie të lirë ku demokracia nuk është thjeshtë arenë ku individët luftojnë për realizimin e qëllimeve të tyre vetjake, por ajo lulëzon atëherë kur për të kujdesen qytetarë të cilët janë të gatshëm që me lirinë e fituar me sakrificat të marrin pjesë në jetën shoqërore dhe politike duke e realizuar nëpërmjet informacionit të duhur mjedisor të marrë jo vetëm nga institucionet përkatëse,

<sup>12</sup> Vendimi nr. 16 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, datë 11.11.2004.

<sup>13</sup> L. Buza, *Monografi, e drejta për informacion dhe mjedisi, vështrim historik dhe analizë krahasuese* 2010, f. 26.

por edhe nga biznesi. Problemet kyçe të mjedisit janë përcaktuar në përshtatje me zbatimin e legjislacionit si dhe me institucionet e ndara sipas shkallës së hierarkisë.

“Ndryshe nga shumë dokumente, protokolle dhe akte normative, që janë të mbushura me ndalime dhe detyrime për individin, qytetarin dhe grupet shoqërore, Konventa e Aarhusit është një dokument i një lloji të veçantë, ajo përfaqëson një tërësi të drejtash që u jepen këtyre subjekteve; e vlerësuar kështu, kjo konventë mund të cilësohet si *Karta e të drejtave themelore të publikut në fushën e mjedisit*”<sup>14</sup>.

Si dokument juridik ndërkombëtar, konventa përfaqëson një tërësi të drejtash, detyrimesh, rregullash e procedurash të detyrueshme për zbatim, kërkesat e konventës, të drejtat dhe detyrimet që ajo përmban janë orientuar në tre detyrime për të përmbushur një detyrë madhore, si rruga e domosdoshme e ardhmërisë dhe ekzistencës së komunitetit njerëzor. Objektivi i kësaj konvente përcaktohet që në nenin 1 të saj, ku palëve u kërkohet të garantojnë të drejtën e informimit me qëllim që të kontribuohet në mbrojtjen e të drejtës tek çdo person “*të brezit të sotëm dhe të ardhshëm*” për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për mirëqenien e tij.

Konventa *pranon* se kemi një detyrim ndaj brezave të ardhshëm, ajo *përcakton* se zhvillimi i qëndrueshëm mund të arrihet nëpërmjet pjesëmarrjes së publikut, ajo *lidh* përgjegjshmërinë e qeverisë me mbrojtjen e mjedisit. Ajo *përqendrohet* në veprimet mes publikut dhe autoriteteve në një kontekst demokratik dhe i jep *formë* një procesi të ri së drejtës dhe pjesëmarrjes të publikut për informacion.

Analiza e gjendjes aktuale përqendrohet tek mentaliteti dhe opinioni i përgjithshëm shoqëror dhe pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e grupeve të ndryshme në formulimin e politikave mjedisore.

I hartuar me këto kërkesa e synime, mendohet se ky studim do të ndihmojë në përmirësimin e disa të metave si në fushën e legjislacionit ashtu edhe në zbatimin e tij në kuadrin e problemeve mjedisore.

### 3.2 Mendimet e studentëve

Nga opinionet e studentëve të vitit të parë (2018-2019), në përgjithësi, vihet re se ata janë pak të informuar për krimet mjedisore. Nga anketimi dhe pyetësi i organizuar me studentë të Shkencave Politike dega komunikim rezulton se 60% e studentëve kanë dijeni për krimin mjedisor dhe e identifikojnë atë vetëm me *prerjen e paligjshme të pyjeve, shkatërrimin me zjarr të pyjeve, transportimin e mbeturinave toksike etj.* Studentët e juridikut kanë një përjasje më të lartë prej 85%; *Arsyeja(?)*: sepse kanë marrë pjesë në lëvizjen për mbrojtjen e mjedisit të organizuar nga vetë ata për problemet e ndotjes në Porto Romano. Gjithashtu, vihet re se studentët nuk kanë aspak njohuri për ndotjen akustike.

Mungesa e informacionit dhe e sensibilizimit publik për probleme të tilla ka ulur interesin e studentëve dhe publikut për këto probleme. Nga intervistat e realizuara vihet re se në disa raste ata e shikojnë veten si spektator dhe fare pak si aktor të këtyre problemeve dhe *arsyeja* padyshim që është mungesa e njohurive të mbartura edhe nga shkollat e mesme.

## 4. Përfundime

Krimi dhe kundërvajtjet mjedisore mendojmë se duhet të analizojnë jo vetëm pjesëmarrjen e personave në aktivitetet kriminale mjedisore por ato duhet të fokusohen

herë pas here edhe në disa kategori të tjera krimesh mjedisore për t'i bërë ato më të kuptueshme për publikun. Këto kundërvajtje dhe krime mjedisore kërkojnë një vëmendje serioze dhe të veçantë edhe për arsyen e mentalitetit shoqëror që ekziston se kundërvajtjet mjedisore nuk janë krime të “vërteta”.

Krimi dhe sidomos ndotja mjedisore duhet të trajtohet edhe për dëmet që shkaktojnë direkt në shëndetin njerëzor me qëllim sensibilizimin e publikut dhe mbrojtjen e jetës. Bashkëpunimi dhe hartimi i strategjive, ndërtimi i rrjeteve me organizata si OKB-ja, INTERPOLI dhe Policia e Shtetit, si dhe me institucione të tjera përkatëse që merren me luftën kundër grupeve të organizuara kriminale të krimeve mjedisore, janë të një rëndësie të veçantë për parandalimin e krimeve, mbrojtjen mjedisore, zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e jetës.

Kontrolli i rreptë dhe i vazhdueshëm, është i një rëndësie të madhe dhe kërkon të ndërmerren një sërë masash për t'i detyruar individët e organizatat që të veprojnë në bazë të ligjit, duke filluar që nga çështjet e vogla deri tek ato më të mëdhatë.

Mbledhja, analiza dhe shpërndarja e informacionit midis individëve organizatave e sektorëve si dhe sanksionet, masat ndëshkimore kundër krimeve konsolidojnë zhvillimin e qëndrueshëm, sigurinë kombëtare dhe mbrojtjen mjedisore.

Për të arritur objektivat akademike në mbrojtjen mjedisore, shkëmbimi i ideve dhe informacionit, studimet krahasuese të përbashkëta marrin një rëndësi të veçantë. Edukimi mjedisor duhet të jetë teorikisht i saktë, realist dhe i kuptueshëm me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve me ndjesitë, vlerat dhe pasojat në lidhje me këto çështje.

Konsiderohet si element shumë i rëndësishëm që media të jetë në gjendje të njohë mirë dhe të përdorë legjislacionin, për të informuar vetveten dhe në këtë mënyrë të mbajë të mirë informuar publikun. Shpërndarja e informacionit sipas niveleve dhe aktorëve përkatës është çelësi i informacionit i një sistemi efikas në mjedis.

Media luan një rol tepër të rëndësishëm në ndërgjegjësimin e publikut për të drejtat dhe liritë e tij për t'u informuar nga dokumentet zyrtare të garantuar Kushtetuta e Republikës.

## Bibliografi

1. Atkins, A. (2010). A complicated environment: the problem with extending victims' rights to victims of environmental crimes. *Washington and Lee Law Review*, 67(4), 1623–1658.
2. Buza, L. (2010) E drejta për Informacion dhe Mjedisi (Vështrim Historik dhe Analizë Krahasuese. ISBN 978-99956-88-57-8.
3. Campbell-Mohn, C., Breen, B., & Futrell, J. W. (1993). *Sustainable environmental law*. St. Paul: West.
4. Council of Europe. (2000). *Common European Framework of Reference: Learning, Teaching, Assessment*. Council for Cultural Education. Cambridge University Press.UK.
5. Elliott, L., 2011. *Transnational Environmental Crime: Applying network theory to an investigation of illegal trade, criminal activity and law enforcement responses*.
6. [www. http://ips.cap.anu.edu.au/ir/tec/publications/TEC\\_Working\\_Paper\\_1\\_2011.pdf](http://ips.cap.anu.edu.au/ir/tec/publications/TEC_Working_Paper_1_2011.pdf)
7. Matthew Greife., Paul B. Stretesky, Tara O'Connor Shelley, and Mark Pogrebin. *Criminal Justice Policy Review* 2015 28:4, 327-346.
8. Situ, Yinyi, Emmons David. (2000). *White Collar & Corporate Crime, Green/ Environmental Sociology*.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

# Siguria mjedisore dhe problemet shëndetësore të banorëve të Porto Romanos, pas viteve '90-të, si rezultat i transformimit nga zonë industriale, në zonë periferike urbane



■ **Dr. Mirela TASE**  
Fakulteti i Biznesit,  
Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës  
mirelatase@hotmail.com



■ **Dr. (proc.) Violeta ALIAJ**  
Fakulteti i Biznesit,  
Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës  
v\_aliaj@hotmail.com

## Abstrakt

*Porto Romano është një zonë e rëndësishme e bashkisë së Durrësit. Kjo zonë ndodhet 7 km në veri të qytetit të Durrësit, përballë me detin Adriatik. Deri në vitet '90 kjo zonë ishte e njohur si zonë e depozitimit të pesticideve që përdorej për bujqësi kryesisht në Ultësirën Perëndimore të vendit dhe sodës kaustike që përdorej për ngjyrosjen e lëkurës. Pas rënies së komunizmit kjo zonë pësoi një transformim të menjëhershëm. Si rezultat i lëvizjeve të brendshme migruese popullsia në këtë zonë u rrit gjatë lëvizjes së lirë të popullsisë kryesisht të ardhur nga zonat veriore të Shqipërisë. Shumë familje u vendosën këtu, në një zonë të kontaminuar. Qeveria dhe sidomos pushteti lokal nuk ishin të përgatitur për këtë lëvizje masive në vitet '90 ku nga zonë industriale u ktheu në një zonë suburbane. Gjatë vitit 2009 u krijua parku energjetik duke sjellë ndotjen e ajrit i cili erdhi si rezultat i vendosjes së: termocentralit elektrik, instalimit të depozitave të naftës, instalimit të depozitave të gazit. Në vitin 2012 u ngrit dhe kampusi i universitetit "Aleksandër Moisiu" i cili gjithmonë është kontestuar nga grupet e interesit dhe vetë akademikët se ky nuk është vendi i duhur. Për të pëmbushur qëllimet dhe objektivat e këtij studimi, gjithashtu edhe për të adresuar pyetësorin e këtij studimi, kam zgjedhur metodologjinë e gërshetuar nëpërmjet përdorimit të pyetjeve sasiore dhe cilësore. Qëllimi i këtij punimi është studimi i sigurisë mjedisore dhe cilësisë së ajrit në shëndetin e komunitetit. Gjithashtu kërkimi do të fokusohet në gjetjen e strategjive për largimin e mbetjeve i cili është një problem i madh jo vetëm për komunitetin, por edhe për vetë stafin akademik dhe studentët gjithashtu. Po kështu lind pyetja: "A duhet të jetë zonë e banueshme apo të kthehet prapë në zonë industriale?"*

## Fjalëkyçe:

**ndikim, cilësia e ajrit, zhvendosja e mbeturinave, migrim.**

## 1. Hyrje

Hapësira bregdetare e Porto Romanos, shtrihet në rrethin dhe qarkun e Durrësit duke u vendosur në pjesën qendrore të bregdetit të Adriatikut. Pozicioni gjeografik i kësaj zone, sigurisht që del edhe në periudhat më të hershme historike. Kjo zonë mendohet se ka përfaqësuar një zonë-port që në periudhën e antikitetit. Tregtia si një nga treguesit kryesor të marrëdhënieve me vendet fqinje ka përbërë dhe bazën ekonomike për shekuj me radhë. Por, kjo traditë ndryshoi gjatë periudhës së sistemit komunist, kur pushteti vendosi që këtë zonë ta kthente në një zonë industriale duke i ndryshuar funksionin që kishte për shumë shekuj me radhë. Kjo zonë zë pjesën e ulët bregdetare përbëhet nga mjaft depozitime detare (lagunore dhe kënetore)<sup>1</sup>, duke zënë një sipërfaqe prej 859 ha në tokat e ish-kënetës. Zona e Porto Romanos përbën pjesën veriperëndimore të fushës së ish-kënetës së Durrësit. Kjo e fundit, me shtrirje prej shkëmbit të Kavajës e Shkozetit në juglindje dhe deri në Bishtin e Pallës në veriperëndim, ndodhet afërsisht në kuotë të njëjtë me nivelin e detit. Në pjesët anësore të fushës kuota ngrihet deri në 1.40 m, ndërsa në pjesët qendrore të saj kjo kuotë ulet deri në 0.44 m. Në pjesën veriore-verilindore dhe jugore, fusha e Durrësit kufizohet nga vija bregdetare e detit Adriatik; ajo është e hapur nga ana e detit dhe në këto drejtime ka pasur lidhje direkt me atë, ndërmjet dy kanaleve komunikues: Gjirit të Durrësit dhe Porto Romanos.<sup>2</sup>

Ujërat e reshjeve që zbresin nga faqet e kodrave përvijuese të rajonit, së bashku me ujërat e kripura detare, kanë qarkulluar lirisht nëpërmjet këtyre dy kanaleve

<sup>1</sup> Qiriazi, P. Sala, S. (1994). "Veçoritë gjeomorfologjike të vargut kodrinor gryka e Vorës-Kepi i Rodonit". *Studime Gjeografike* 5.

<sup>2</sup> *Informacion mbi ndërveprimin në mjedis*, Pularia OVVITAL Sh.P.K.



duke krijuar një rrjedhje të rregullt ujore nga Porto Romano deri në grykëderdhjen e vendit të quajtur Ura e Dajlanit. Sot, të dy këto kanale komunikues janë mbushur me aluvione detare e kontinentale. Është një zonë komplekse ku krahas terminalit bregdetar të import-eksportit të produkteve të hidrokarbureve planifikohet dhe ndërtimi i TEC-ëve, një impiant pastrimi, një minirafineri, si dhe objekte të tjera industriale. Në kuadrin e ZEIPR (“Zona energjetike dhe industriale Porto Romano”, e cila është përcaktuar me VKM nr. 105, datë 9.2.2011) është parashikuar transferimi nga porti i Durrësit drejt Porto Romanos i disa aktiviteteve ekonomike të sektorit energjetik (depozitat janë transferuar tashmë). Duke marrë parasysh potencialin e Porto Romanos, në zhvillimin e infrastrukturës së import-eksportit të hidrokarbureve si dhe kërkesat në rritje të tregut vendas dhe rajonal për energji, është i domosdoshëm zhvillimi tërësor i kësaj zone si një park kompleks industrialo-energjetik. Por, e parë nga ky këndvështrim kjo zonë pas viteve ‘90 ka pësuar dhe një transformim në aspektin demografik, ku popullsia e ardhur nga zonat veriore dhe verilindore, është vendosur këtu dhe kanë ndërtuar banesat e tyre duke transformuar edhe funksionin ekonomik, për të cilën shquhej kjo zonë.



Fig 1. Zona e Porto Romanos

## 2. Metodologjia e punimit

Për realizimin e këtij punimi janë përdorur një sërë metodash sa teorike aq edhe praktike. Metoda teorike është e bazuar në identifikimin e faktorëve natyror dhe atyre humanë të cilët kanë ndikuar në zhvillimin social-ekonomik të hapësirës në studim. Metodat praktike janë të shprehura në analizat, krahasimet si dhe vëzhgimet direkte në terren.

*Metoda e hulumtimit* ose e mbledhjes së të dhënave është realizuar nëpërmjet shfrytëzimit të një literature të gjerë mbi faktorët natyrorë dhe ato humanë të cilat kanë ndikuar dhe në zhvillimin social-ekonomik të hapësirës në studim.

*Metoda e intervistimit* përbën një ndër format kryesore të metodologjisë së punës së përdorur në kuadrin e këtij punimi. Kjo metodë ka shërbyer si një mënyrë shumë efikase për vjeljen e mendimeve rreth mundësive të mbrojtjes së mjedisit bazuar në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

Të gjitha intervistat e realizuara u bazuan në dhënien përgjigje pyetjeve të tilla, si: Si është situata në veçanti në zonën tuaj për sa i përket menaxhimit të mbetjeve solide? A ka rreziqe të mëdha në lidhje me mjedisin, shëndetin e njerëzve dhe sigurinë lidhur me hedhjen e mbeturinave? Toka, a mund të përdoret për produkte bujqësore apo është e kontaminuar? Si vepron pushteti lokal për mënyrën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në këtë zonë? Po komuniteti si ka reaguar kundër indiferentizmit të pushtetit lokal? U realizuan 50 intervista me banorë të zonës dhe të grupmoshave të ndryshme. Kjo na dha mundësinë e marrjes së një informacioni të mjaftueshëm dhe të domosdoshëm për të realizuar analizën e zonës së Porto Romanos. Mbi bazën e këtyre intervistave kemi ndërtuar edhe grafikët, duke na dhënë një panoramë të qartë të situatës mjedisore.

*Metoda e vëzhgimit* të drejtpërdrejtë në terren është realizuar nëpërmjet ekspeditave me studentë të realizuara në zonën e marrë në studim. Kjo metodë na ka ndihmuar për të evidentuar problematikat aktuale, si problemet mjedisore ashtu dhe ato social-ekonomike me të cilat përballet popullsia vendase.

*Metoda statistikore* është përdorur për analizimin e disa të dhënave statistikore mbi problemet mjedisore dhe ato shëndetësore. Ato janë analizuar dhe interpretuar nëpërmjet përpilimit të tabelave, grafikëve, etj.

### 2.1 Ndryshimet demografike të zonës së Porto Romanos

Në aspektin demografik kjo zonë hyn në grupin e atyre zonave që kanë pësuar ndryshime demografike pas viteve 90. Në periudhën komuniste Porto Romano shërbeu si kamp internimi për kundërshtarët e sistemit komunist. Në disa godina dykatëshe u vendosën të internuarit e të dekluarit, dhe tashmë nga lagjja me ato godina të dikurshme ka mbetur një geto e kohëve moderne. Kjo zonë ka qenë e izoluar nga pjesa tjetër e qytetit të Durrësit. Mbas vitit '90-të, hapësira e marrë në studim, u përfshi nga transformime të mëdha demografike me ndikime social-ekonomike. E pozicionuar në afërsi të dy qyteteve më të rëndësishme në vend, Tiranës dhe Durrësit, hapësira bregdetare e Porto Romanos ishte një destinacion tërheqës për imigrantët e brendshëm, kryesisht familjet nga zonat më të varfra siç ishin veriu dhe verilindja e Shqipërisë duke filluar nga viti 1990.<sup>3</sup> Migrimi i brendshëm, nga viti 1991 vijoi me ritme të shpejta deri

<sup>3</sup> Shkëlqim Sirika, *Alternativat e zhvillimit të qëndrueshëm të hapësirës bregdetare Ishëm-Porto Romano*, (Disertacion)

në 2009, ku banorë të rinj të ardhur kryesisht nga Dibra, Kukësi, Tropoja, Mirdita etj., u vendosën në këtë zonë.

## 2.2 Situata mjedisore e Porto Romanos

### *Gjendja e përgjithshme mjedisore.*

Gjendja e shëndetit mjedisor para viteve 1990, në zonën e Porto Romanos, duke qenë si një nga pikat “Hot spot” nuk vlerësohej me rëndësinë e duhur nga sistemi politik-ekonomik i ngritur gjatë asaj periudhe. Industria e vjetruar në teknologji e cila bazohej mbi shfrytëzimin e resurseve natyrore, zhvillimi i saj pa kritere mjedisore, mungesa e një legjislacioni dhe institucioneve të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit si dhe moslejimi i lëvizjeve mjedisore patën ndikimin e tyre në ndotjen e dëmtrimin e mjedisit. Mjedisi shfaqej me këto tregues si më poshtë, referuar Majlinda Mukës<sup>4</sup>:

a. Mbatja në këmbë nëpërmjet subvencioneve shtetërore e industrive me teknologji të vjetruar, të cilat shkaktonin veç të tjerave ndotje të mëdha të mjedisit si: industrinë kimike, të pesticideve, gomës, plastikës, të prodhimit të cigareve, regjia e lëkurëve, të përqendruara kryesisht si në zonën urbane të qytetit ashtu dhe në afërsitë periferike urbane (zona industriale e Porto Romanos).

b. Nënvlëftësimi deri në neglizhim i problemeve të përpunimit të mbeturinave urbane (sidomos atyre të lëngëta, ujërave të përdorura) si dhe shqetësimi i furnizimit me ujë. Ky problem aktualisht është prezent edhe sot ku vetë personeli akademik i universitetit të UAMD ka bërë peticion drejtuar bashkisë dhe pushtetit qendror lidhur me zhvendosjen e mbetjeve urbane nga kjo zonë.

c. Shkallë e ulët e ndërgjegjësimit qytetar për problemet e mjedisit: kjo e ka burimin në mungesën e plotë të informacionit, niveli ulët i edukimit ekologjik në sistemin shkollor. Zona e Porto Romanos mbas viteve ‘90 pati një ardhje masive nga pjesa veriore dhe verilindore e vendit. Problemet e mjedisit gjatë reformës ekonomike u vendosën në kuadrin e një krize të thellë bashkëshoqëruar me ndryshime të rëndësishme të ekonomisë me tipare drejt liberalizimit të tregut.

d. Lënia për një kohë të gjatë, pa menaxhuar sasitë e produkteve kimike të pesticideve e materialeve të tjera toksike në “Hot spot” të Porto Romanos, përbën krim ndaj shëndetit të komunitetit që banon në këtë zonë, dhe jo vetëm të tij, me efekte shëndetësore të shtrira në terma afatgjatë kohore. Rritja e konsiderueshme e numrit të popullsisë nga lëvizjet migruese vendosur pranë kësaj zone periferike urbane të rrethit të Durrësit, ka bërë që një pjesë e popullsisë në zonën informale të jetojë në kushte të vështira higjienike, pasojë e mungesës së infrastrukturës së nevojshme (mungesa e sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza, të ujit të pijshëm etj.), situata të cilat kanë ndikim jo të vogël në shpërhapjen e sëmundjeve të llojeve të ndryshme, kryesisht të atyre infektiveve. “Problemet shëndetësore janë të shumta, duke përfshirë dhe çrregullime të rënda mendore dhe depresion. Nga kërkimi në terren dhe anketat e bëra me studentët, më të shpeshta ishin problemet me mushkëritë, astmën, aparatën tretës dhe veshkat.

e. Mungesat në kuadrin ligjor të masave administrative dhe kompetencave organizative institucionale për ndjekjen dhe zbatimin e ligjeve, rregullave për mjedisin përbënte në vetvete një handicap. Lëvizjet migruese pas viteve ‘90 të cilat ishin të vrullshme u shoqëruan me vendosjen në këto zona të një popullsie të re. Ky urbanizim

<sup>4</sup> Majlinda Muka, *Gjendja e shëndetit mjedisor në bashkinë Durrës, studim gjeomjeksor*, (Diseratacion, 2015).

spontan u bashkëshoqërua me problematika të mëdha sociale së bashku me vështirësi higjieno-sanitare, si dhe probleme me infrastrukturën etj.

Ndotja e mjedisit në Porto Palermo ka dy burime kryesore:

- burimet e trashëguara të mbetjeve të ndërmarrjeve të para viteve '90;

- burime të reja mbasi në "Planin lokal të menaxhimit të mbetjeve" për Bashkinë e Durrësit 2010-2025,<sup>5</sup> Porto Romano është caktuar si vendhedhje dhe vendasgjësimi i të gjitha mbetjeve të qytetit të Durrësit. Po sipas këtij plani, si burime përfshihen: a) porti për ndotjen në det; b) mbetjet urbane dhe pesticidet/nitratet për ndotjen në plazhet dhe lumenjtë, përfshire edhe derdhjen e tyre në det; c) vendet e pasigurta të hedhjes së mbeturinave si për sa i përket ujërave nëntokësore dhe zonave akuifere. Ujërat e cektë nëntokësorë në zonën e Durrësit vijnë nga basenet e Ishmit dhe Erzenit. Këto ujëra kanë një përmbajtje të pH prej 7 deri 9 dhe janë të pijshëm. Rrjedhjet e mundshme nga depozita e Porto Romanos përbejnë një kërcënim të vërtetë edhe për komunitetin që jeton aty.<sup>6</sup> Depozitimi i mbetjeve të ngurta është një nga çështjet me kritike të kësaj zone. Përveç amortizimit të vendgrumbullimit të Porto Romanos (zonë që është përdorur me parë për veprimtari kimike me rrezik të lartë, tre NjA depozitojnë mbetjet në vendndodhje të "përkohshme".

Depozita e Porto Romanos është kthyer në një bombë me sahat jo vetëm për shkak të saturimit të kapacitetit maksimal, por mbi të gjitha nga rrjedhjet dhe ndotja e napës freatike. Në këtë kontekst zgjidhja e depozitës së re të mbetjeve të ngurta është urgjente dhe strategjike.

### 3. Ndotja e tokës dhe ajrit

Në Porto Romano, sistemi i kanalizimeve është një burim i përhershëm ndotjeje. Në këtë zonë, kanalizimet mbledhin njëkohësisht si ujërat e shirave, ashtu edhe ujërat e zeza të qytetit të Durrësit dhe fshatrave për rreth. Të gjitha këto ujëra mblidhen në një kanal të hapur, i cili derdhet në det, nëpërmjet hidrovorit të Porto Romanos. Dërdhja në det bëhet pa kaluar më parë në asnjë lloj trajtimi për pastrim, duke pasur si pasojë edhe ndotjen e ujit të detit. Një problem i mprehtë për zonën e Porto Romanos, mbetet ish-uzina kimike me mbetjet e lëndëve të para dhe mbetjeve teknologjike, të braktisura në qiell të hapur që shkaktojnë probleme mjedisore edhe në shëndetin e njeriut.

Ky problem është bërë më i mprehtë, sidomos pas migrimit të popullsisë, gjatë viteve '90-të, ku sipërfaqe të tëra toke, të ndotura nga lëndët kimike, janë populluar në kushte jo të përshtatshme, mjedisore, urbanistike dhe higjieno-sanitare duke shkaktuar probleme mjaft serioze për popullsinë. Në Porto Romano impakti më i madh në cilësinë e ajrit është i lidhur me erën e fortë të kimikateve dhe pluhurave të ndotur me kimikate të ish-ndërmarrjes kimike. Cilësi jo shumë e mirë e ajrit konstatohet edhe në zonën energjetike të Porto Romanos, nga era e fortë e hidrokarbureve dhe gazrat e çliruara nga autobotet që transportojnë produkte naftë. Edhe pas realizimit të një projekti (projekt i cili u finalizua me rehabilitimin e 3 pikave të nxehta të kësaj zone në vitin 2010) fizibiliteti për pastrimin dhe rehabilitimin nga mbetjet kimike, mbështetur nga qeveria holandeze dhe Banka Botërore, kjo tokë është përcaktuar nga UNEP si zonë e nxehtë mjedisore e vendit. Në pamundësi për zhvillimin si zonë urbane, zona e Porto

<sup>5</sup> Planin lokal i menaxhimit të mbetjeve për Bashkinë e Durrësit 2010-2025, f. 26-30, paragrafi 3. 4. 7.

<sup>6</sup> Strategjia e zhvillimit territorial 2015-2030, Bashkia Durrëse në bashkëpunim me CDI, 2016.

Romanos po i nënshtrahet restaurimit nëpërmjet projekteve të planifikimit territorial dhe orientimin e këtij territori drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Nëpërmjet përdorimit të këtij territori për aktivitete industriale dhe tregtare në fushën e hidrokarbureve, realizohet shfrytëzimi optimal dhe me efikasitet, në interes të komunitetit të kësaj zone, pasi nuk mund të rekomandohet për zhvillimin e turizmit, bujqësisë ose aktiviteteve të tjera.<sup>7</sup>

Po kështu edhe nga intervistat e realizuara me banorët e zonës ngrihet si shqetësim problemi i ndotjes së zonës jo vetëm si rezultat i ndotjes së trashëguar nga sistemi komunist, por edhe pas viteve '90 ku ky problem është bërë më evident. Legjislacioni direkt shprehet se:

*Zona industriale Porto Romano*, tashmë ka një status të veçantë juridik duke u quajtur “*Park energjetik*”, i cili nënkupton zhvillimin energjetik dhe industrial të Porto Romanos, deri tashmë vetëm si një vendhedhje mbetjesh nga i gjithë rajoni i Durrësit. Kjo zonë ka rreth 810 ha tokë (VKM nr. 703, datë 23.4.2008). Në bazë të ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe të VKM-së nr. 703, në zonën e Porto Romanos po zhvillohen aktivitete ekonomike me karakter energjetik, si instalimi i depozitave të gazit, naftës, ndërkohë që një pjesë e sipërfaqes është parë si zonë e lirë doganore dhe gjithashtu janë parashikuar edhe dy termocentrale, duke krijuar edhe infrastrukturën industriale në favor të këtij zhvillimi. Nga vëzhgimi i legjislacionit në tërësi, aktet ligjore dhe nënligjore, strategjitë e pushtetit qendror dhe lokal, shohim se flasin për perspektivën e zhvillimit të kësaj zone, e konsiderojnë zonë me intensitet të lartë ndotjeje, por nuk shohim asnjë strategji konkrete me pastrimin e mbetjeve të trashëguara të para viteve '90. Zhvillimi i idesë së *inceneratorit* ka mbetur vetëm një ide në letra, kur në fakt nuk ka asnjë lëvizje konkrete për eliminimin e ndotjeve të trashëguara dhe të krijuara mbas viteve '90.

### 3.1 Impakti i ndotjes së ajrit në shëndet

Përqendrimi i grimcave PM10 dhe NO2 në Durrës, i kalon standardet kombëtare dhe ato të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Helmet toksike që lëshohen nga asgjësimi i mbetjeve urbane në zonën e Porto Romanos, apo edhe ndotja masive e tokës, në vendin ku grumbullohen pa e kuptuar, po vrasin në “heshtje” banorët e kësaj zone si dhe ata të qytetit të Durrësit. Djegia çliron substanca nga më të rrezikshmet që mund të diskutohet, që janë dioksinat të cilat sjellin probleme si sëmundjet kardiorespiratore deri në sëmundjen e shekullit që është kanceri.

Praktikisht aty digjet çdo gjë, që nga plehrat e konsumimit të përditshëm, deri tek ato industriale si goma makina, vajra makinash, fuçi me acide. Banorët e zonës së Porto Romanos janë të ekspozuar nga sëmundje infektive, apo kancerogjene. Agjencia Kombëtare e Mjedisit në zbatim të “Programit kombëtar të monitorimit” realizon monitorimin e përvitshëm të ndikimit të shkarkimeve urbane në cilësinë e ujërave sipërfaqësore. Ujërat urbanë të shkarkuar nga hidrovorit në Porto Romano, sipas analizave të kryera nga AKM nga parametrat e vlerave mesatare të tregueseve të matur rezultojnë me përmbajtje të lartë të lëndëve organike të shprehur nëpërmjet NBO5, madje vlerat kalojnë dhe normën kufi. Në zonën e Porto Romanos vijon kanali që nis që nga Spitala dhe mbledh ujërat e zeza të lagjeve, duke i shkarkuar në bregdetin e Porto Romanos, ku shkarkohen nëpërmjet hidrovorit edhe një pjesë e ujërave të zeza të zonës së ish-kënetës.

<sup>7</sup> Po aty.

“Problemi tek ne është përmytja nga kanali kur bien shirat e jashtëzakonshëm. Izolohemi se nuk mund të kalojmë rrugët”, - thonë banorët e zonës së Porto Romanos. Nga monitorimi i ynë, në qershor të 2019 dhe dëshmitë e banorëve, si pasojë e mungesës së një tubacioni qendror për ujin e pijshëm në zonën e Porto Romanos dhe ish-kënetës, rezultoi se ata detyrohen ta marrin ujin e pijshëm me tuba plastike që qëndrojnë mbi sipërfaqe dhe shpesh kalojnë mbi kanalin e ujërave të zeza. Po kështu asgjësimi i mbetjeve të ngurta bëhet në Porto Romano.

Ai është funksional që prej vitit 1994 dhe është pronë shtetërore nën zotërimin e Ministrisë së Ekonomisë, dhe administrohet nga Bashkia e Durrësit, megjithëse ajo ende nuk është e regjistruar në regjistrin themelor të pronave-hipotekë.<sup>8</sup> Vendhedhja e Porto Romanos është e vetmja vendhedhje për zonën e Durrësit dhe e gjithë sasia e mbetjeve bashkiake të pa ndara, një përzierje e mbetjeve të rrezikshme me mbetjet e parrezikshme, mbetjet spitalore dhe mbetjet industriale së bashku me mbetjet inerte, përfundojnë në këtë vendhedhje, duke mos ndjekur asnjë standard mjedisor. Vendhedhja e Porto Romanos përfshin tre parcela me një sipërfaqe totale prej 22.2 ha. Një prej parcelave është e mbushur me mbetje dhe dy të tjerat janë të mbushura në masën 50%.



**Foto 2. Vendhedhja e Porto Romanos – zona e hedhjes dhe kufiri.**  
Burimi: Bashkia Durrës.




**Foto 3. Vendhedhja e Porto Romanos–zona e kullimit.**  
Burimi: Bashkia Durrës.<sup>9</sup>

<sup>8</sup> Plani Lokal i menaxhimit të mbetjeve për Bashkinë e Durrësit, 2010-2025.


<sup>9</sup> Po aty, f. 27.

Pyetësorët e realizuar me banorët e kësaj zone në qershor të 2019 janë tregues të grafikëve si më poshtë:




Grafiku 1. Paraqitja grafike e situatës së menaxhimit të mbetjeve.  
Burimi: Realizuar nga intervistat me banorët nga Mirela Tase.

### Toka a mund te perdoret per produkte bujqesore apo eshte e kontaminuar




### Si vepron pushteti lokal per menyren e menaxhimit te mbetjeve ne zonen e Porto-Romanos



Grafiku 2,3 Paraqitja grafike lidhur me përdorimin e tokës bujqësore si dhe puna e pushtetit lokal për menaxhimin e mbetjeve.  
Burimi: Mirela Tase.

## Si ka reaguar komuniteti kunder indiferentizmit te pushtetit lokal



**Grafiku 4:** Paraqitja grafike e opinionëve të komunitetit lidhur me indiferentizmin e pushtetit lokal për zonën e Porto Romanos  
Burimi: Mirela Tase.

### 4. Konkluzione dhe rekomandime

Problemi me urgjent mjedisor në zonë është depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta. Depozita e Porto Romanos është kthyer në një bombë me sahat jo vetëm për shkak të saturimit të kapacitetit maksimal, por mbi të gjitha nga rrjedhjet dhe ndotja e napës freatike. Në këtë kontekst zgjidhja e depozitës së re të mbetjeve të ngurta është urgjente dhe strategjike. Rreziqet më të mëdha në lidhje me mjedisin, shëndetin e njerëzve dhe sigurinë janë si më poshtë:

- ndotja e tokës dhe e sipërfaqes rrezikon florën dhe faunën në ligatina;
- problemet e higjenes shkaktojnë sëmundje tek gërmuesit e mbetjeve, stafi, shpërndarësit privatë të mbetjeve, dhe te vizitorët e padëshiruar; në fakt, stafi që punon në vendhedhje nuk përdor asnjë pajisje personale për mbrojtje;
- rreziqet për shëndetin nga zinxhiri ushqimor (kafshë shtëpiake të infektuara) dhe kafshë të tjera (qen, zogj);
- tymi nga zjarret në vendgroposje (*landfill*) është i rrezikshëm si rezultat i dioksinave dhe përmbajtjes së ndotësve të tjerë duke sjellë probleme jo vetëm për komunitetin e banorëve të Porto Romanos, por edhe për studentët dhe stafin akademik që prej 2012 janë pjesë e kësaj zone.

Vendhedhja e Porto Romanos është konsideruar si rrezik mjedisor (“hot spot”) dhe megjithëse ajo ka kapacitet edhe për rreth 5 vjet të tjerë, është rekomanduar që të braktiset dhe të mbyllet sa më shpejt që të jetë e mundur. Kjo për arsye se landfilli i Porto Romanos nuk i plotëson kushtet teknike për të qenë kusht për sigurinë e shëndetit të banorëve të kësaj zone. Po t’i referohemi legjislacioni mjedisor në Shqipëri, ai udhëhiqet nga parimet kryesore të legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushën e mjedisit. Kështu, ligji “Për mbrojtjen e mjedisit” nr. 10431, datë 9.6.2011, në kapitullin e II thekson se: “Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien, apo minimizimin e efekteve negative në mjedis”.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »



Ligji “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, nr. 10440, datë 7.7.2011 ka si qëllim kryesor parandalimin e ndotjes së mjedisit nga aktiviteti human nëpërmjet realizimit të raportit të vlerësimit mjedisor të aktivitetit që do të kryhet.

Ligji nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, ka për qëllim ndër të tjera të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm të territorit nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe burimeve natyrore, si edhe sigurimin e mbrojtjes së burimeve natyrore: tokës, ajrit, ujit, pyjet, flora, fauna, peizazhet etj. Nga vëzhgimi i legjislacionit në tërësi, akteve ligjore dhe nënligjore, strategjitë e pushtetit qendror dhe lokal, shohim se flasin për perspektivën e zhvillimit të kësaj zone, e konsiderojnë zonë me intensitet të lartë ndotjeje, por nuk shohim asnjë strategji konkrete për pastrimin e mbetjeve të trashëguara të para viteve ‘90. Zhvillimi i idesë së *inceneratorit* ka mbetur vetëm një ide në letra, kur në fakt nuk ka asnjë lëvizje konkrete për eliminimin e ndotjeve të trashëguara dhe të krijuara mbas viteve ‘90. Prandaj mendoj se bashkëpunimi midis komunitetit, shoqërisë civile, pushtetit lokal dhe atij qendror duhet të jetë në koherencë me legjislacionin ndërkombëtar për sigurinë e shëndetit të popullatës. Lind pyetja: kur do të marrë zgjidhje përfundimtare kjo çështje?

## Bibliografia

1. Agjencia Rajonale Qarku Durrës
2. Bashkia Durrës, *Plani lokal i menaxhimit të mbetjeve për Bashkinë e Durrësit*, 2010-2025, faqe 26-30, paragrafi 3.4.7.
3. Bashkia Durrës në bashkëpunim me CDI, *Strategjia e zhvillimit territorial 2015-2030*, 2016.
4. Qiriazi, P. Sala, S. Veçoritë *gjeomorfologjike të vargut kodrinor gryka e Vorës-Kepi i Rodonit*. Studime Gjeografike 5(1994).
5. Pularia ovvital Sh.P.K, *Informacion mbi ndërveprimin në mjedis*.
6. Shkëlqim Sirika, *Alternativat e zhvillimit të qëndrueshëm të hapësirës bregdetare Ishëm - Porto Romano*, Disertacion, 2015.
7. Majlinda Muka, *Gjendja e shëndetit mjedisor në bashkinë Durrës studim gjeomjekësor*, Disertacion, 2015.
8. Lala, S., Zajmi, M., “ *Mjedisi dhe impakti i tij në shëndetin e qytetareve durrsakë*”, Durrës, 2011.
9. *Master plan Porto Romano Bay, Albania*, project 2015.



---

## **AKADEMIA E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »**

# Inspektimi në fondin pyjor e kullosor, problematika dhe sfida: rast studimor qarku i Dibrës



■ **Prof. Asc. Dr. Nehat ÇOLLAKU**  
*Universiteti Bujqësor i Tiranës  
Fakulteti i Shkencave Pyjore,  
nehatcollaku@ubt.edu.al*

■ **Dr. Elvin TOROMANI**  
*Universiteti Bujqësor i Tiranës  
Fakulteti i Shkencave Pyjore,  
elvintoromani@ubt.edu.al*

■ **Prof. Asc. Dr. Dritan AJDINAJ**  
*Universiteti Bujqësor i Tiranës  
Fakulteti i Shkencave Pyjore,  
dritan.ajdinaj@gmail.com*

■ **Inxh. Lutfi MIFTARI**  
*Kryeinspektor i Mjedisit, Pyjeve,  
Ujërave dhe Turizmit, Qarku Dibër,  
lut\_miftari@yahoo.com*

## Abstrakt

*Inspektimi në fondin pyjor e kullosor përbën një nga instrumentet kryesor në drejtim të mbarështimit të qëndrueshëm të burimeve pyjore dhe kullosore. Gjatë 15 viteve të fundit, sektori i pyjeve ka kaluar nëpër një proces transformimi që ka synuar reformimin dhe zhvillimin institucional të sektorit pyjor duke sjellë ndryshime thelbësore në rolin, mandatin dhe marrëdhëniet midis shtetit, bashkive dhe sektorit privat. Pjesë e reformës së ndërmarrë në sektorin e pyjeve, ka qenë edhe ndarja e funksioneve kontrolluese nga funksionet menaxhuese, ku prej disa vitesh funksioni kontrollues është tërësisht i ndarë dhe i organizuar në kuadër të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit (ISHMPUT). Drejtoria e Inspektimit të Policisë Pyjore, pjesë e ISHMPUT-së, në nivel qarku, kontribuon në monitorimin dhe identifikimin e entiteteve që kryejnë aktivitete ilegale në pyje, kullota e gjueti, si dhe luan një rol të rëndësishëm në koordinimin me Policinë e Shtetit, policinë rugore, inspektoratet dhe institucionet e tjera shtetërore për të forcuar zbatimin e ligjit në fushën e pyjeve, kullotave dhe gjuetisë. Nëpërmjet këtij studimi synojmë të analizojmë vetëm inspektimin që kryhet në fondin pyjor e kullosor të qarkut të Dibrës, duke identifikuar problematikën me të cilat përballet ISHMPUT-i, performancën e tij, koordinimin me aktorët e tjerë. Rezultatet e studimit tregojnë se akoma struktura e inspektimit në pyje rezultojnë me problematika të theksuara nga pikëpamja logjistike, burimeve njerëzore dhe ekspertizës etj. Përmes evidentimit të problematikave të inspektimit në pyje dhe kullota në qarkun e Dibrës - si rast studimor, synojmë të përgjithësojmë problematikën me të cilat përballet inspektimi në pyje dhe kullota në nivel kombëtar, duke adresuar edhe zgjidhjet e mundshme për këtë sektor.*

## Fjalëkyçe:

**inspektim, funksion kontrollues, fond pyjor e kullosor, zhvillim institucional, problematika, sfida.**

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

## 1. Hyrje

Gjatë pesëmbëdhjetëve viteve të fundit, sektori i pyjeve në Shqipëri, ka kaluar nëpër një proces transformimi me qëllim reformimin e tij çka ka sjellë ndryshime thelbësore për sa i përket roleve, mandateve dhe marrëdhënieve midis sektorit shtetëror, bashkiak dhe privat. Ndryshimet e kanë bazën në reformën e sektorit pyjor, të cilat kanë për qëllim ndryshimin e mënyrës së funksionimit të këtij sektori dhe marrëdhënieve me aktorët me qëllim mbështetjen e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe zbatimin e strategjisë së sektorit të pyjeve. Politika e qeverisë e ndjekur gjatë kësaj periudhe ka synuar që të decentralizojë mbarëshkrimin e burimeve natyrore.

Në kuadër të decentralizimit të administrimit të pyjeve dhe kullotave, u mbështet edhe reforma institucionale dhe ligjore e sektorit të pyjeve dhe kullotave. Reforma institucionale ka synuar që të bëjë një ndarje të funksioneve menaxhuese nga ato kontrolluese. Si rezultat i kësaj reforme, u arrit që në vitin 2015 të realizohej ndarja e plotë e funksionit kontrollues nga funksionet menaxhuese, ku policia pyjore u integrua brenda strukturës së Inspektoratit të Mjedisit, të quajtur në vijim si Inspektorati Shtetëror për Pyjet, Mjedisin, Ujërat dhe Turizmit (ISHMPUT). “Inspektor i Policisë Pyjore është punonjësi me arsimin përkatës pyjor, me uniformë, i armatosur, i pajisur me kartë identifikimi, që ka atributet e njohura me këtë ligj, i inspektoratit shtetëror përgjegjës për pyjet, i cili ka për detyrë zbatimin e ligjit, administrimin, mbrojtjen, parandalimin e dëmtimeve, zbulimin e veprimtarive kriminale dhe mbikëqyrjen e fondit pyjor kombëtar<sup>1</sup>”. Drejtorja e Inspektimit të Policisë Pyjore pjesë e ISHMPUT-së, në nivel qarku, ka si detyrë të saj, inspektimin në sektorin e pyjeve dhe kullotave,

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

<sup>1</sup> QBZ: Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr. 84, 2016, 4665.

zbatimimin e ligjeve aktuale në pyje, kullota, gjueti, si dhe masat për vendosjen dhe mbledhjen gjobave ndaj enteve që operojnë duke shkelur dispozitat ligjore, janë prioritetet e këtij sektori.

Gjobat janë të natyrave të ndryshme dhe variojnë në shuma të ndryshme, ku zakonisht kemi rritje të gjobave për kundërvajtjet e përsëritura<sup>2</sup>. Gjobat variojnë sipas natyrës së kundërvajtjes, ku kodi ligjor parashikon rrjedhojat për kundërvajtësit<sup>3</sup> (Cubbage, et al, 1980). Që nga viti 2018, ISHMPUT-ja po aplikon procedimin me procesverbale *on-line*, si një mjet drejt përmirësimit të kontrollit dhe inspektimit në pyje. Nga vlerësimi i rolit dhe funksionimit të Drejtorisë së Inspektimit të Policisë Pyjore, rezulton se kjo drejtori pjesë e ISHMPUT-së, Dibër, ka mungesa në uniforma, mjete lëvizëse dhe pajisje të tjera për të kryer detyrat dhe misionin e tij.

Me ndarjen e re territoriale dhe krijimin e 61 bashkive, qeveria vendosi t'u delegojë bashkive disa kompetenca, ku një prej tyre ishte edhe delegimi i kompetencës së menaxhimit të pyjeve dhe kullotave. Një tjetër moment i rëndësishëm lidhur me përpjekjet në drejtim të një menaxhimi më të mirë të faunës së egër dhe pyjeve është edhe miratimi i moratoriumit të gjuetisë (ligji nr. 61/2016) si dhe moratoriumit në pyje (ligji nr. 5/2016), ku nëpërmjet këtij të fundit ndërpriten të gjitha prerjet me qëllim tregtar me përjashtim të shfrytëzimeve për plotësimin e nevojave të banorëve me dru zjarri<sup>4</sup>.

Krijimi i Agjencisë Kombëtare për Pyjet (AKP) synon të monitorojë dhe kontrollojë veprimtarinë e strukturave të administrimit e të inspektimit pyjor, ku nënvizohet se AKP "monitoron-kontrollon veprimtarinë e strukturave të administrimit e të inspektimit pyjor në njësitë e vetëqeverisjes vendore, për sa i përket zbatimit dhe respektimit të legjislacionit në fuqi e të planeve të miratuara, të cilat ndërhyjnë për marrjen e masave të detyrueshme në rastet kur evidentohen shkelje apo shmangie nga përmbajtja dhe kërkesat e tyre"<sup>5</sup>.

Një ndryshim i rëndësishëm lidhur me funksionin kontrollues pritet të vijë me ligjin e ri "Për pyje dhe kullotat" që po përgatitet nga MTM, ku parashikohet një përshkallëzim i dënimeve dhe masave ndaj kundërvajtësve, si: pezullim/bllokim të aktivitetit, heqjen e licencës, sekuestrimin dhe gjoba ndaj punonjësve të institucioneve në rast shkeljesh/mozbatimi të përgjegjësive ligjore". Sipas ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, perifrazohet se: "Inspektim është çdo formë kontrolli që organi publik kryen për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit"<sup>6</sup>.

Nëpërmjet këtij studimi synojmë të analizojmë problemet dhe sfidat me të cilat përballet procesi i inspektimit në pyje dhe kullota në Drejtorinë e Inspektimit të Policisë Pyjore në qarkun Dibër, dukë synuar të përgjithësojmë situatën e inspektimit në shkallë kombëtare.

## 2. Materiali dhe metoda

### 2.1 Zona e studimit

Zona e studimit shtrihet në territorin administrativ të qarkut të Dibrës, i cili shtrihet

<sup>2</sup> Hickman, Clifford A. et al., *Forest practice regulatory developments in the East*. 1991, 331.


<sup>3</sup> Cubbage and Ellefson, *State forest practice laws: A major policy force unique to the natural resources community*. 1980, 428.

<sup>4</sup> QBZ: *Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr. 20, 2016, 2059.

<sup>5</sup> QBZ: *Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr. 121, 2019, 8932.

<sup>6</sup> QBZ: *Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr. 90, 2011, 3715.

në pjesën verilindore të vendit tonë. Ai është një nga 12 qarqet e Shqipërisë dhe ka një sipërfaqe prej 2 586 km<sup>2</sup>. Sipas ndarjes së re territoriale, qarku i Dibrës përfshin 4 bashki, e përkatësisht, bashkitë: Dibër, Bulqizë, Mat dhe Klos<sup>7</sup>. Qarku i Dibrës kufizohet në lindje me Maqedoninë e Veriut. Qarku kufizohet në veri me qarkun e Kukësit, në perëndim me qarkun e Tiranës, në veriperëndim me qarkun e Lezhës dhe në jug me qarkun e Elbasanit. Qarku i Dibrës ka një popullsi prej 125 579 banorë (regjistrimi i popullsisë në vitin 2017). Sipërfaqja e fondit pyjor e kullësor në nivel qarku është 121 978.8 ha<sup>8</sup>.



**Qarku i Dibrës**

## 2.2. Dokumentacioni bazë

Për analizimin e inspektimit në fondin pyjor dhe kullësor në qarkun e Dibrës, jemi mbështetur në dokumentacionin e shkruar si kuadri ligjor ekzistues lidhur me inspektimin në pyje, publikimet e INSTAT, raportet dhe evidencat e hartuara nga vetë inspektorati i qarkut Dibër, raportet (*Aide Memoire*) të misioneve të Bankës Botërore gjatë monitorimit të projektit për shërbimet mjedisore si dhe ecurisë së reformave në sektorin e pyjeve dhe kullotave etj.

## 2.3 Intervistat e thelluara

Një burim i dytë për vlerësimin e rolit të inspektoratit të pyjeve është informacioni i mbledhur në intervistat e thelluara, një instrument listë-kontrolli me pyetje dhe çështje të ndryshme, ku një grup pyetjesh kishte të bënte me rolin e inspektoratit, performancën dhe problematikat me të cilat përballet inspektorati. Në kuadër të intervistave të thelluara ishin ftuar për të marrë pjesë 50 persona nga grupet: përfaqësues të stafit të menaxhimit të pyjeve në bashki, inspektoratit të pyjeve, ekspertë të lirë pyjesh, profesorë nga Fakulteti i Shkencave Pyjore (UBT), CNVP, stafi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, “Shoqata kombëtare e pyjeve dhe kullotave”, federatat rajonale të pyjeve dhe kullotave.

<sup>7</sup> QBZ: Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr. 137, 2014, 6367.

<sup>8</sup> INSTAT, 2018. www.instat.gov.al. http://databaza.instat.gov.al/

Kërkesës për intervistë të thelluar, iu përgjigjen 37 persona nga grupet e mësipërme.

### 3. Rezultatet dhe diskutime i tyre

Diskutimi i rezultateve të inspektimit në fondin pyjor dhe kullor do të bëhet në disa drejtime:

#### *a. Roli dhe funksionimi i Inspektoratit të Pyjeve, të integruar në ISHMPUT*

“Inspektorët e Policisë Pyjore kanë të gjitha të drejtat për të hyrë, kontrolluar, inspektuar dhe për të marrë masat përkatëse të procedimit, si dhe të bllokimit apo sekuestrimit, në rastet e shkeljes së ligjit<sup>9</sup>”.

Funksioni i kontrollit është plotësisht i ndarë nga funksioni menaxhues dhe është në linjë me VKM nr. 223 datë 3.13.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mjedisor Shtetëror, Pyjeve dhe Ujërave”, ku përcakton ndarjen e shërbimeve të kontrollit në dy nivele: qendror dhe rajonal. Inspektorati i Pyjeve i qarkut Dibër përfaqëson ISHMPU-në në nivel rajonal për qarkun Dibër. Reformimi i funksionit të kontrollit është bazuar në ligjin nr. 10433 datë 15.6.2011 “Për inspektoratet në Republikën e Shqipërisë”.

Lidhur me zbatimin e legjislacionit për punonjësit e policisë pyjore konstatohet se: policia pyjore ushtron funksionet e saj mbështetur në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005: “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, VKM nr. 103, datë 4.2.2015: “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave”, të ndryshuar dhe legjislacionit që rregullon funksionet inspektuese.

Nga analizimi i situatës së funksionimit rezulton se inspektorati i qarkut Dibër, por edhe në nivel vendi se ka kapacitete të ulëta për të përballuar misionin e tij, gjë e cila shprehet me mungesa të theksuara logjistike (si hartat, të dhënat e përshkrimit parcelë, baza e të dhënave për ekonominë pyjore dhe ngastrat përkatëse, GPS, mjete sinjalizuese për rastet e zjarreve apo të komunikimit me radio etj.) infrastrukturë dhe mjete lëvizëse shumë të pakta.

#### *b. Struktura e inspektoratit të qarkut Dibër dhe arsimimi përkatës*

Struktura e Inspektoratit të Pyjeve të qarkut Dibër përbëhet nga 12 punonjës, ku vetëm 4 prej tyre plotësojnë kriterin e arsimit përkatës. Nga shqyrtimi i të dhënave të punonjësve të inspektoratit të pyjeve në nivel vendi rezulton se pak a shumë kemi të njëjtën situatë, ku nga 184 punonjës që ka inspektorati i pyjeve në të gjithë vendin rezulton se vetëm 53 janë me arsimin përkatës pyjor.

Referuar pikës 10, të nenit 2 të ligjit nr 9385, përcaktohet se; “Inspektor i policisë pyjore” është punonjësi me arsimin përkatës pyjor, i inspektoratit shtetëror përgjegjës për pyjet, i cili ka për detyrë zbatimin e ligjit, administrimin, mbrojtjen dhe parandalimin e dëmtimeve, zbulimin e veprimtarisë kriminale dhe mbikëqyrjen e fondit pyjor kombëtar<sup>10</sup>. Pra, duke ju referuar kërkesave të ligjit 9385, për qarkun Dibër rezulton se vetëm 30% e stafit plotësojnë kriterin e arsimit përkatës, ndërkohë që në nivel vendi rezulton se vetëm 28.8 % e stafit ka arsimin pyjor.

<sup>9</sup> QBZ: Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr. 44, 2005, 14 qershor, 1579.

<sup>10</sup> QBZ: Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr. 44, 2005, 1574.

c. Norma/ngarkesa territori ku ushtron aktivitetin

Degët rajonale të ISHMPU-së ushtrjnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut përkatës dhe janë përgjegjëse për inspektimin në qarkun përkatës<sup>11</sup>.

**Tabela nr. 3.1: Të dhënat për Fondin Pyjor në Qarkun e Dibrës**

Nr.	Bashkitë	Sipërfaqja e fondit pyjorkullosor, gjithsej	Nga këto		
			Pyll (ha)	Kullota (ha)	Joproductive (ha)
1	Dibër	36662	25213	5412	6036
2	Bukqizë	32952	21949	6677	4326
3	Mat	29049.9	26003	1454	1592
4	Klos	2325.9	16635	2504	4114.9
Totali		121,978.8	89800	16047	16068.9

Burimi: INSTAT (2018)

Duke marrë në konsideratë sipërfaqen totale të fondit pyjor për qarkun Dibër, prej 123 700 ha, si dhe strukturën e inspektoratit të pyjeve, prej 12 punonjës, rezulton se një punonjës inspektor pyjesh ka në ngarkim një sipërfaqe të fondit pyjor prej 14844 ha, ose një punonjës ka në ngarkim një sipërfaqe të fondit pyjor prej 7483.3 ha pyll, 1337.25 ha kullotë dhe 1339.1 ha joproductive.

Duke pasur parasysh se sipërfaqja e përgjithshme e fondit pyjor, në nivel vendi, është 1 740 880 ha si dhe numrin total të inspektoratit prej 184 punonjësish, rezulton se mesatarisht, në nivel vendi një inspektor ka në ngarkim një sipërfaqe ligjit të fondit pyjor prej 9461.3 ha.


d. Kundërvajtjet dhe pamundësia e vjeljes së gjobave dhe dëmit

Referuar nenit 4 të ligjit nr. 10279, datë 2015 nënvizohet se “Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ligji parashikon dënim administrative<sup>12</sup>”.

- Gjobat

Sipas nenit 10, të ligjit nr. 10279 “Masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative. Masa e dënimit me gjobë mund të jetë fikse apo e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë<sup>13</sup>”.

Gjobat vendosen për: vepra administrative, dhe/ose vepra penale.



**Figura 3.1: Natyra e shkeljeve të ligjit të pyjeve**

<sup>11</sup> QBZ: Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr. 52, 2013, 2288.

<sup>12</sup> QBZ: Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr. 73, 2010, 3915.

<sup>13</sup> QBZ: Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr. 73, 2010, 3917.



Veprat administrative procedohen sipas ligjeve administrative (në këtë rast: ligji i pyjeve, ligji i kullotave, ligji për mbrojtjen e faunës së egër, bashkërenduar me dispozita të tjera si p.sh. “Kodi i procedurave administrative në Shqipëri” (i vitit 1999), dhe janë pjesë e kompetencave të inspektoratit pyjor (enti i autorizuar shtetëror), i cili heton shkeljen dhe përcakton gjobën, ndërkohë që strukturat qeveritare (vendore) mbledhin gjobat. Në rastet e mospagimit të vendimit të kundërvajtjeve administrative, kuadri ligjor parashikon sekuestron ku nënvizohet se: “Kur gjoba dhe detyrimet e tjera të parashikuara në vendimin për kundërvajtjen administrative nuk paguhen ose nuk nxirren dot nga paga, ato nxirren duke vënë sekuestro mbi pasurinë e të dënuarit për kundërvajtje administrative, qoftë edhe sikur ajo të ndodhet në dorën e personave të tjerë”. Ndërkohë që, “Procedura e ekzekutimit të dënimit me heqje lirie për një kundërvajtje administrative bëhet sipas procedurave për ekzekutimin e vendimit të dënimit me heqje lirie për një vepër penale<sup>14</sup>”. Veprat penale procedohen sipas kodit penal.

Tabela Nr. 3.2: Të dhënat mbi veprat administrative dhe penale si dhe inspektimet për periudhën 2014 - shtator 2019 në qarkun e Dibrës

Nr		Vitet													
		2014		2015		2016		2017		2018			Shtator 2019		
		Adm	Pen	Adm	Pen	Adm	Pen	Adm	Pen	Adm	Pen	Insp	Adm	Pen	Insp
1	Dibër	24	0	12	0	10	0	7	0	5	0	27	4	0	27
2	Bulqizë	30	0	28	0	18	0	12	0	9	0	10	6	0	21
3	Mat	12	0	8	0	6	0	2	0	1	0	10	3	0	22
4	Klos														
<b>Totali</b>		<b>64</b>	<b>0</b>	<b>48</b>	<b>0</b>	<b>34</b>	<b>0</b>	<b>21</b>	<b>0</b>	<b>20</b>	<b>0</b>	<b>47</b>	<b>13</b>	<b>0</b>	<b>70</b>

**Burimi:** Inspektorati i Pyjeve, Dibër.

**Shënim:** Të dhënat për numrin e inspektimeve u siguruan vetëm për vitet 2018-2019.

Pra, siç shihet nga tabela e mësipërme, rezultojnë se për vitet nga 2014 deri në shtator 2019 nuk kemi asnjë vepër penale, ndonëse janë të përcaktuara saktë se kur përbën vepër penale një ndërhyrje në pyje dhe kullota. Ndërkohë, që gjatë vitit 2019 ka filluar edhe procesimi me aplikimin e mbajtjes së procesverbaleve *on-line*. Duke analizuar më në detaje natyrën e kundërvajtjeve për vitin 2018 rezultojnë se në qarkun e Dibrës u kryen: 431 inspektime, ku nga këto 74 inspektime janë bërë gjueti lidhur me zbatimin e moratoriumit të gjuetisë. Rezultojnë se në 20 raste janë marrë masa administrative me një vlerë gjobe prej 1 590 000 lekë. Drurët e prerë në mënyrë abuzive 2871 copë drurë, ku volumi i vlerësuar i prerjeve abuzive ishte 654.3 m<sup>3</sup>, ndërkohë që shkalla e mbulimit me procesverbale ishte vetëm 1 rast. Lidhur me sekuestrimin e lëndës drusore, rezultojnë se u krye sekuestrimi i lëndës drusore në 26 raste dhe sasia e lëndës së sekuestruar ishte 155.4 m<sup>3</sup>. Rezultojnë se rreth 60% e kundërvajtjeve administrative kanë të bëjnë me prerje ilegale të pyjeve, 30% transport i paligjshëm i materialit drusor, 8% zënie të territorit dhe 1-2% zjarre në pyje.

Zjarret në pyje dhe kullota vazhdojnë të mbeten një tjetër problem shqetësues, ku në vitin 2018 ndodhën 74 raste zjarri dhe sipërfaqja e djegur është 1954.7 ha. Një ndër problemet kryesore lidhur me kundërvajtjet në pyje dhe kullota është shkalla e vjeljes së gjobave, ku rezultojnë se nuk ka asnjë vjelje të gjobave dhe vlerës së dëmit. Duke iu referuar praktikave ligjore bashkëkohore, shohim se legjislacioni modern aplikon gjoba

<sup>14</sup> QBZ: Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr. 73, 2010, 3923.

më të larta kur rasti i kundërvajtjes përsëritet, ndërkohë që kemi vjelje të plotë gjobave. Vlerësimi i situatës në vendin tonë si dhe përqasja me praktikatat e vendeve fqinje na çon në konkluzionin se para së të aplikojmë vlera të mëdha financiare për gjobat, duhet të synohet vjelja e plotë e gjobave.

- *Vlera e dëmit*

Vlera e dëmit, ndryshe nga gjoba, është një funksion pronësie, sipas ligjit (kodi civil). Kërkesa për kompensimin e vlerës së dëmit mund të bazohet në kontekstin e shkeljes së ligjit të pyjeve (dëmtimi i pyjeve), apo në formën e kufizimeve ligjore gjatë menaxhimit të pyjeve (p.sh., pyjet më funksion të veçantë), të cilët mund të kryhen mbi bazën e një kontrate (sipas ligjit), të bërë midis ministrit kompetent dhe pronarit, e që specifikon detyrimet e pronarit për ruajtjen e sipërfaqes pyjore dhe detyrimet e shtetit për kompensimin e humbjeve apo dëmtimeve dhe pagesën e kostove shtesë.

#### 4. Konkluzione

- Nga analizimi i gjendjes aktuale të inspektoratit pyjor në qarkun e Dibrës rezulton se ka kapacitete të ulëta për të monitoruar dhe kontrolluar sipërfaqen e fondit pyjor, ku një trupë prej 12 punonjësish do të monitorojë dhe kontrollojë një sipërfaqe prej 121 979 ha në nivel qarku. I njëjti konkluzion rezulton për tërë ISHMPUT-in, pasi me 184 punonjës duhet të kontrollojë gjithë territorin e vendit.

- Numër i kufizuar i personelit inspektues dhe kapacitet e pamjaftueshme logjistike për të realizuar inspektimet *on-line* në kohë reale dhe patrullimet e shpeshta përgjatë periudhave të shfrytëzimeve të materialit drusor e ul nivelin e arritjes së rezultateve institucionale.

- Gjocat shumë të larta prej 5 000 000 lekë, çon domosdoshmërisht edhe në vështirësinë për t'i vjelë gjocat.

- Rezultoni një numër i lartë i shkeljeve të konstatuara dhe niveli shumë i ulët i arkëtimit të sanksioneve administrative, gjë që kanë cenuar zbatimin e moratoriumit për pyjet në qarkun e Dibrës, por edhe në shkallë vendi.

- Vjelja e gjobave përbën një ndër problemet kryesore të ISHMPUT-së, pasi asnjë nga gjocat e vendosura në kuadër të moratoriumit të pyjeve nuk është vjelë.

- Ndërhyrjet e paligjshme në pyje ngelen ende të shumta dhe shqetësuese, pavarësisht moratoriumit.

- Abuzimet në pyje nuk vijnë vetëm nga persona individuale, por edhe nga kompani të organizuara sipas të gjitha dispozitave ligjore dhe me kapacitete të plota, të cilat mund të shkelin përcaktimet e kontratave që aktualisht kanë me bashkitë.

- Mungesa e një strukture “ndërlidhëse” midis MTM, bashkive dhe inspektoratit pyjor, e cila ka sjellë një konfuzion dhe pasivitet në sektorin e pyjeve.

- Inspektimet me fushata nga inspektorati pyjor Dibër me objekt shfrytëzimin e fondit pyjor nga subjektet e kontraktuara me afat 10-vjeçar, ka rezultuar vetëm në frenim të përkohshëm të ushtrimit të aktivitetit të paligjshëm.

#### 5. Rekomandime

- Përmirësim të kuadrit rregullues në përputhje me legjislacionin e vendeve të zhvilluara për përshkallëzimin e sanksioneve kundrejt subjekteve që përsërisin shkeljen e kriterëve ligjore të përdorimit të fondit pyjor dhe kullësor.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

- Propozohet një ndarje sa më e qartë e kompetencave të inspektoratit pyjor dhe rekrutim të një stafi profesional.
- Intensifikimi i përpjekjeve për të gjetur mekanizmin e vjeljes së gjobave, e cila do të bëjë që të ndryshojë praktika e deritanishme e mosndëshkimit të kundërvajtësve në pyje dhe kullota.
- Mbështetje me fondet e nevojshme, logjistikë, uniforma, mjete lëvizëse, mjete komunikimi, GPS, dhe harta për ISHMPUT.
- Në rastet kur subjektet që kanë lidhur kontrata shfrytëzimi me bashkitë, kryejnë shkelje të përsëritura të afateve dhe çështjeve kontraktore, duhet që ISHMPUT t'ju propozojë bashkive prishjen e njëanshme të kontratave të lidhura me këto subjekte, si dhe rritje të masës së dënimit, siç parashikohet në ligjet e vendeve të zhvilluara.
- Të ngrihet dhe vihet në funksion sa më shpejt Agjencia Kombëtare e Pyjeve, e cila do të shërbejë si një "urë lidhëse" ndërmjet MTM, ISHMPUT dhe bashkive.
- Të finalizohet sa më shpejt i inventari kombëtar i pyjeve dhe kullotave, i cili do të krijojë më shumë informacion për punën e inspektoratit pyjor.
- MTM në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të hartojë dhe miratojë procedurën ligjore të akteve apo proceseve që operatorët vendas të shfrytëzimit dhe përpunimit të fondit pyjor duhet të ndjekin, për të tregtuar ndërkombëtarisht drurin dhe elementët e tij, me qëllim gjurmimin e origjinës së këtyre produkteve gjatë periudhës së moratoriumit mbi pyjet.
- Të forcohet bashkëpunimi ndërmjet ISHMPUT, pushtetit vendor dhe drejtorisë së policisë së qarkut, MTM.

## Bibliografi

### ARTIKUJ (NË REVISTA DHE NË PËRMBLEDHJE)

1. Cabbage, Frederick W., and Paul V. Ellefson. 1980. *State forest practice laws: A major policy force unique to the natural resources community*. *Natural Resources Lawyer* 13(2):421-468.
2. Hickman, Clifford A., William C. Siegel, and Christopher E. Martus. 1991. *Forest practice regulatory developments in the East*. Pp. 327-332 in *Proceedings, 1991 Convention, Society of American Foresters*. Bethesda, MD.

### DOKUMENTE TË NDRYSHME LIGJORE

3. Qendra e Botimeve Zyrtare: *Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr. 44, 14 qershor 2005, 1573-1593. Akti: ligji nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor". [www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al).
4. Qendra e Botimeve Zyrtare: *Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr. 20, 11 shkurt 2016, 2059. Akti: ligji nr. 5/2016: "Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë". [www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al).
5. Qendra e Botimeve Zyrtare: *Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr. 84, 11 maj 2016, 4665. ligji nr. 48/2016: "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005, të ndryshuar". [www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al).
6. Qendra e Botimeve Zyrtare: *Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr. 137, 1 shtator 2014, 6365-6390. Akti: ligji nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë". [www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al).
7. Qendra e Botimeve Zyrtare: *Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr. 121, 3 shtator 2019, 8929-8933. Akti: VKM nr. 570, datë 17.7.2019: "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve". [www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al).
8. Qendra e Botimeve Zyrtare: *Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr. 52, 12 prill 2013. 2287-2290. Akti: VKM nr. 223, datë 13.3.2013 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave". [www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al).
9. Qendra e Botimeve Zyrtare: *Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr. 73, 29 qershor 2010, 3915-3926. Akti: ligji nr. 10279 datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative". [www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al).
10. Qendra e Botimeve Zyrtare: *Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr. 90, 2011, 3715-3732. 5 korrik 2011. Akti: ligji nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. [www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al).

### BURIME TË PËRGJITHSHME INTERNETI

11. Instituti i Statistikave: *Databaza Statistikore/Pyjet/Fondi pyjor sipas mënyrës së qeverisjes 2006-2018*. [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al). <http://databaza.instat.gov.al/>



---

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »**

**291**

---

# Politikat mjedisore në qeverisjen demokratike



■ **Dr. (proc.) Kozeta LIGEJA**  
*Instituti i Studimeve Europiane,  
Universiteti i Tiranës*  
*k.oz.i2006@hotmail.com*

## Abstrakt

*Qëllimi i këtij artikulli është të analizojë vlerën e sigurisë mjedisore në një shtet demokratik. Artikulli do të ndërgjegjësojë dhe informojë opinionin publik rreth rëndësisë që ka politika mjedisore në zbatimin e saj në vendin tonë. Ka një korrelacion të drejtë midis sigurisë mjedisore me sigurinë kombëtare në një shtet demokratik. Hipoteza e këtij artikulli është: sa më shumë politika mjedisore të zhvilluara dhe zbatuese të kemi në përputhje me legjislacionin evropian, aq më shumë forcohet siguria kombëtare në vendin tonë. Nisur nga ky përcaktim, vlen të theksojmë vlerën praktike të këtij drejtimi, në shoqërinë e një vendi të caktuar për të vërtetuar hipotezën e ngritur. Qëllimi i këtij punimi është që përmes provave të analizës teorike, por edhe të rasteve në praktikën shqiptare, të provojë hipotezën e ngritur. Qëllimi i përgjithshëm i studimit, është kuadri analitik për këtë çështje. Ky artikull do të bazohet në disa metoda studimi. Do të përdoret kryesisht metoda induktive, duke kaluar nga fakte specifike në konkluzione të përgjithshme dhe metoda e përshkrimit dhe rishikimit të literaturës për këtë çështje.*

## Fjalëkyçe:

**demokracia, Bashkimi Evropian, qytetarët, institucionet, mirëqenie.**

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,  
siguria mjedisore  
dhe siguria  
kombëtare »

## 1. Hyrje

Shqipëria sot gjendet në një *momentum* shumë të rëndësishëm të procesit të integritit drejt Bashkimit Evropian. Më datë 17 prill 2018 Komisioni Evropian rekomandoi hapjen e negociatave për anëtarësimin saj në BE. Procesi i integritit evropian të Shqipërisë ka nisur me përfshirjen e saj në procesin e stabilizim-asociimit dhe fillimin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit në vitin 2003. Marrëveshja (MSA) u nënshkrua në 2006 dhe hyri në fuqi në prill 2009. Zbatimi i kësaj marrëveshje nënkuptonte një angazhim të plotë të shtetit shqiptar për harmonizimin e legjislacionit shqiptar me *acquis*-n (legjislacionin) e BE-së një shumëllojshmëri fushash dhe politikash të BE-së.<sup>1</sup>

Procesi i integritit është subjekt i kushteve që vendos BE-ja dhe këto kushte kërkojnë angazhim në të gjitha drejtimet. Kushtet e BE-së njihen ndryshe dhe si 3 kriteret e Kopenhagës dhe ato përfshijnë atë politik, ekonomik dhe ligjor. Plotësimi i kriterit politik është çelësi i suksesit për marrjen e statusit të vendit kandidat dhe hapjen e negociatave. Arritjet e evidentuara në përmbushjen e këtij kriteri bënë të mundur marrjen e statusit kandidat në vitin 2014, ndërkohë që fati i negociatave varet nga përmbushja e të ashtuquajturave prioritetëve kyçe brenda kriterit politik të Kopenhagës që lidhen me reformën në drejtësi, administratën e pavarur, luftën kundër korrupsionit, krimet të organizuar dhe respektimin e të drejtave të njeriut.<sup>2</sup>

Gjatë tridhjetë viteve të fundit Evropa është shqetësuar lidhur me gjendjen e mjedisit

<sup>1</sup> Manual informues për *Rolin e qeverisjes lokale në procesin e integritit evropian të Shqipërisë*, (me mbështetjen e BE-se) (Tiranë: 2018), fq. 24.

<sup>2</sup> Po aty, fq. 24-25.

dhe u bë shumë e vendosur për të reduktuar dëmet, duke bërë shmangie të mundshme. Një valë e brengosjes për mjedisin ka filluar në kohën e ngritjes. Me dobësimin e ekonomike dhe me rritjen e shkallës së papunësisë ra dhe interesimi. Kjo nuk duhet të befasojë askënd. Në kohëra të vështira njerëzit më së shumti brengosen për punën e tyre, shtëpitë e tyre dhe se a do të jenë në gjendje për të ushqyer familjen. Vetëm kur kanë siguri ekonomike janë në gjendje që të çlirohen sa duhet për të përqendruar vëmendjen e tyre në çështje të tjera.<sup>3</sup>

Në këtë kontekst vendi ynë si një shtet demokratik ka parashikuar realizimin e përputhshmërisë së legjislacionit të BE-së edhe në drejtim të politikave mjedisore. Ky artikull ka për qëllim analizimin e ndërjegjësimit dhe informimit të opinionit publik për rëndësinë për një zbatim efektiv të politikave mjedisore. Kjo temë u zgjodh për të shfaqur korrelacionin e drejtë midis sigurisë mjedisore dhe sigurisë kombëtare, gjë që gjeneron një mirëqenie në jetët e njerëzve, në një shtet demokratik. Ky artikull i realizuar përmes metodës përshkruese do të paraqesë një panoramë teorike të kuadrit mjedisor në vendin tonë.

## 2. Kuadri teorik për politikat mjedisore

Koncepti i mjedisit ka pasur një shtrirje globale, ashtu sikurse të drejtat mjedisore dhe problematikat, që hasen në fushën e mjedisit janë globale. Tashmë përdorimi modern i termit mjedis ndryshon shumë nga përdorimi i tij fillestar dhe paraqet karakteristika të veçanta duke bërë, që në disiplina të ndryshme shkencore, ku ai përdoret të marrë kuptime po aq të ndryshme. Ky koncept është përkufizuar, gjerësisht në nenin 2 të “Konventës së përgjegjësisë civile për pasojat e dëmeve nga aktivitetet e rrezikshme ndaj mjedisit”.<sup>4</sup>

Në Bashkimin Evropian, mjedisi është përcaktuar si mjedisi natyror, ku ekzistojnë njerëzit dhe burimet natyrore nga të cilat ata varen. Çështjet e mjedisit lidhen me ndikimin e aktiviteteve të njeriut në mjedisin përreth, te burimet dhe mbi vetë qeniet njerëzore, ndërsa politikat mjedisore ndërmerren nga qeveria dhe kanë për qëllim menaxhimin e aktiviteteve njerëzore për parandalimin e pasojave të dëmshme mbi natyrën dhe burimet natyrore duke siguruar, që ndryshimet e bëra nga njeriu në mjedis, nuk do të kenë një efekt të dëmshëm mbi njerëzit.<sup>5</sup>

Me fjalën mjedis nënkuptojmë të gjitha gjërat që ndodhen rreth nesh, dhe me të cilat në mënyrë direkte apo indirekte është e lidhur jeta dhe veprimtaria e njeriut. Ai ka kuptim të njëjtë me ambientin, mjedisin jetësor, rrethin mjedisor apo natyrën. Të gjitha këto emërtime nënkuptojnë hapësirën në të cilën jetojmë. Çdo gjë që gjendet rreth nesh quhet mjedis. Në jetojmë në këtë mjedis dhe jemi pjesë e këtij mjedisi. Mjedisit për ne ka krijuar shumë gjëra që ne të përfitojmë duke i shfrytëzuar të mirat e tij. Ai na dhuroi natyrën, ajrin, ujin, shtazët, bimët, pasurit nëntokësore, etj. Njeriu gjithmonë ka ndikuar në mjedisin jetësor dhe anasjelltas. Ai me ose pa vetëdije duke i shfrytëzuar këto të mira në të shumtën e rasteve ndikon negativisht, gjegjësisht ndikon keq në pamjen dhe

<sup>3</sup> Raporti nga Konferenca Rajonale Parlamentare për Mjedisin në Evropën Juglindore, *Mjedisit si medium për promovimin e Demokracisë dhe zhvillimit ekonomik të shoqërive në tranzicion*, Prishtinë: OSCE, Tetor 2007, f. 5.

<sup>4</sup> Koncepti i mjedisit, zhvillimi i qëndrueshëm dhe respektimi i të drejtave të njeriut, në <https://akipal.wordpress.com/2013/03/14/koncepti-i-mjedisit-zhvillimi-i-qendrueshem-dhe-respektimi-i-tedrejtave-të-njeriut/>.

<sup>5</sup> J. McCormick, *Environmental policy in the European Union*, Palgrave, 2001, f. 21.

përbërjen e tij duke i hedhur mbeturinat në hapësira të hapura, duke e ndotur ajrin me gazra të ndryshme të dëmshme edhe për vetë njeriun, duke e ndotur ujin në mënyra të ndryshme, duke i shkatërruar pyjet, etj. Njeriu me veprimet e tij ka bërë që çdo element i mjedisit të dal nga baraspesha. Si pasojë e zhvillimit të shpejtë të teknikës dhe industrisë dhe shtrirjen globale në tërë planetin janë shkaktuar çrregullime të mëdha mjedisore.<sup>6</sup>

